

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRAN

Nr. / Br. 42831/26

Nr. i fq. / Br. sh. - 1 -

Data: / Datum: 14.09.2026

VUSHTRRI - VUČITRAN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 132/26 14/09/2026

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë:

J u f t o n

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **24 shtator 2026 (e enjte), me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë, mbajtur më datë 30 korrik 2026;
2. Shqyrtimi i draft- buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2027;
3. Raporti i performancës së Komunës së Vushtrisë për vitin 2025;
4. Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese, për periudhën janar-qershor 2026;
5. Informatë për procesin e korrje-shirjeve për vitin 2026, si dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore;
6. Plani i veprimt për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm.
7. Draft-rregullore për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrisë;
8. Propozim-vendim për plotësimin e vendimit nr.22294/26 i datës 28.05.2026 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
9. Pyetje dhe përgjigje.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB-119/26 24.09.2026

PROCESVERBAL

NGA MBLEDHJA E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË: 30 KORRIK 2026

Mbledhja është mbajtur në sallën e "Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë dhe filloi në orën 10:20. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Behar Duraku, Berat Sadikum, Betim Grabanica, Blerina Shala, Diellza Pllana, Drita Dibrani, Edmond Hyseni, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Fidan Bejta, Gentiana Rama, Gresa Muli, Hava Mlinaku, Isak Uka, Kushtrim Hyseni, Kushtrim Veseli, Leonora Gërguri, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Pllumb Maliqi, Ramadan Parduzi, Refik Maloku, Rrahim Ajeti, Stefan Markovic, Xhon Gubetini dhe Ymer Haradinaj.

Munguan: Mentor Ferizi dhe Vlerë Tahiri.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës z. Ferit Idrizi, përfaqësuesit e MAPL-së, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, - Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 29 anëtarë të kuvendit, kuorum i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-pasi konstatoi kuorumin, ceku se materialet për të gjitha pikat e rendit të ditës janë dorëzuar sipas afateve ligjore, andaj procedoi me rendin e punës sipas rregullores së punës së kuvendit.

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit deklaroi: Jemi sot këtu për të ngritur dy çështje për të cilat, natyrisht, përgjigjet i presim nga Kryetari i komunës. Po flas në cilësinë e shefit të grupit kuvendar të LDK-së dhe dëshiroj të ngre dy shqetësime që i konsiderojmë të rëndësishme. Çështja e parë ka të bëjë me një shqetësim për të cilin ditëve të fundit kemi pasur reagime të shumta, qoftë në rrjetet sociale, qoftë nga shoqëria civile dhe qytetarë të ndryshëm. Si përfaqësues të qytetarëve në këtë Kuvend, konsiderojmë se është detyrë e jona t'i adresojmë këto shqetësime dhe të kërkojmë përgjigje institucionale. Në të njëjtën kohë, kemi pasur edhe një reagim nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtri. Bëhet fjalë për iniciativën për ndërtimin e një kishe katolike në Komunën e Vushtrrisë, përkatësisht në fshatin Zagori. Jemi dëshmitarë se në këtë fshat aktualisht nuk jeton asnjë banor, ndërsa në fshatrat përreth jetojnë

kryesisht banorë të komunitetit musliman. Në bazë të reagimeve që kemi parë edhe Këshilli i Bashkësisë Islame ka kërkuar transparencë nga komuna. Konsiderojmë se kjo është një kërkesë legjitime dhe të njëjtën kërkesë e kemi edhe ne si përfaqësues të qytetarëve dhe anëtarë të këtij Kuvendi. Prandaj, Kryetar, na intereson të dimë nëse për këtë iniciativë ekziston një kërkesë zyrtare për leje ndërtimore për ndërtimin e këtij objekti fetar, apo nëse po tentohet që një objekt i tillë të ndërtohet pa leje?! Ajo që kërkojmë ne si anëtarë të Kuvendit Komunal, është që ligji të respektohet në përpikëri dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë. Natyrisht, ne nuk jemi kundër ndërtimit të objekteve fetare. Përkundrazi, e drejta për ushtrimin e besimit dhe ndërtimin e objekteve fetare duhet të respektohet. Mirëpo, në këtë rast shtrohet një pyetje e arsyeshme: kujt do t'i shërbejë ky objekt fetar në fshatin Zagori, ku aktualisht nuk ka asnjë banor? Po ashtu, jemi dëshmitarë se në rrjetet sociale një person nga fshati Maxhunaj ka bërë një numër të madh postimesh që, sipas përmbajtjes së tyre, përmbajnë gjuhë të urrejtjes dhe nxitje të dhunës. Mendoj se kjo është një çështje që nuk duhet ta anashkalojmë. Do të ishte mirë që Kuvendi Komunal, si institucion që përfaqëson të gjithë qytetarët, të dalë me një deklaratë të përbashkët kundër gjuhës së urrejtjes, gjuhës përçarëse dhe çdo forme të nxitjes së konfliktit ndërfetar. Kosova, populli shqiptar dhe në veçanti Vushtrria janë të njohur për traditën e bashkëjetesës ndërfetare ndër shekuj. Prandaj, duhet të bëjmë gjithçka që kjo traditë të ruhet dhe të forcohet. Në këtë drejtim, kërkoj nga të gjithë shefat e grupeve kuvendare që të shqyrtojmë mundësinë për të dalë me një deklaratë të përbashkët kundër gjuhës së urrejtjes, përçarjes ndërfetare dhe çdo forme të nxitjes së dhunës. Çështja e dytë që dëshiroj ta ngre, Kryetar, ka të bëjë me një premtim që është dhënë gjatë fushatave zgjedhore, si në vitin 2021, ashtu edhe në vitin 2025. Bëhet fjalë për kyçjen në rrugën magjistrale, afër restorant “Prestige”, në drejtim të rrugës Shotë-Galica. Besoj se e keni të qartë për cilin segment rrugor bëhet fjalë. Dje kemi pasur edhe një reagim nga një portal, por njëkohësisht kemi marrë shqetësime edhe nga qytetarët e asaj zone. Kryetar, premtimet që janë dhënë para qytetarëve duhet të mbahen. E dimë dhe e kuptojmë se komuna jonë përballlet me vështirësi buxhetore dhe se jo çdo projekt mund të realizohet menjëherë. Por një vonesë prej një viti apo, në raste të jashtëzakonshme dy vitesh, mund të jetë e kuptueshme. Mirëpo, tani jemi në vitin e pestë dhe mendoj se për këtë problem është dashur të gjendet një zgjidhje shumë më herët. Sipas informatave që kemi, KRU-ja ka dalë në terren dhe është e gatshme t'i përfundojë punët që janë në kompetencën e saj. Po ashtu edhe gjeodetët nga Drejtoria e Kadastrit kanë dalë në terren dhe kanë konstatuar se ekziston pronë e mjaftueshme komunale. Prandaj, nëse këto informacione janë të sakta, atëherë një problem i tillë mund të zgjidhet nëse ekziston vullneti institucional dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve përkatëse. Këto ishin dy çështjet që dëshiroja t'i ngritja në emër të grupit kuvendar të LDK-së.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit në adresimin e tij para kuvendit deklaroi: se ka disa çështje që dëshiron t'i ngrit në mbledhjen plenare të kuvendit. Çështja e parë ka të bëjë me ndërtimin e kompleksit prapa Kompleksit Diari. Shpesh jemi kritikuar se po i pengojmë bizneset, mirëpo kjo nuk është e vërtetë. Ne jemi për krijimin e kushteve për zhvillimin e bizneseve, por jo për krijimin e favoreve për individë apo kompani të caktuara. Siç e dini, ekziston edhe një peticion i banorëve të Kompleksit Diari lidhur me këtë çështje. Prandaj, kemi disa pyetje konkrete:

- A është kjo parcelë pjesë e planit zhvillimor të komunës dhe a është paraparë për ndërtim?
- A është lëshuar leja ndërtimore?
- A është marrë pëlqimi përkatës për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore?
- A është i kompletuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për fillimin e punimeve?

Pra, kërkojmë të dimë nëse investitori i ka përmbushur të gjitha kushtet dhe procedurat ligjore për të ndërtuar në atë lokacion. Çështja e dytë ka të bëjë me bursat për studentë. Drejtoresha e Arsimit na ka njoftuar përmes një emaili se këtë vit nuk do të ketë bursa për studentë, me arsyetimin se nuk ka mjete të mjaftueshme financiare. Kryetar, për aq sa mbaj mend, kjo është hera e parë që Komuna nuk ndan bursa për studentët. Nëse arsyetimi është mungesa e mjeteve financiare, atëherë lind pyetja nëse ka qenë e mundur që këto mjete të gjendeshin duke rishikuar disa shpenzime të tjera të komunës. Për shembull, janë ndarë rreth 23 mijë euro për angazhimin e një këshilltari për këshillat lokale dhe rreth 23 mijë euro të tjera për shërbime juridike. Pra, bëhet fjalë për rreth 46 mijë euro gjithsej. Me këto mjete do të mund të financoheshin së paku 46 bursa nga 1 mijë euro. Prandaj, pyetja ime është: a është bërë një analizë e prioriteteve buxhetore dhe pse bursat për studentë nuk janë konsideruar prioritet? Çështja e tretë lidhet me një rast të ndodhur në disa shkolla fillore në Vushtrri, ku disa nxënës kishin përfunduar vitin shkollor pa e kaluar atë. Sipas informatave që kemi, pas ankesave të nxënësve është formuar një komision nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe, brenda një periudhe shumë të shkurtër, është bërë rivlerësimi i tyre, pas së cilit nxënësit kanë kaluar klasën. Këtu kemi një shqetësim serioz. Nëse një nxënës është përcjellë gjatë gjithë vitit nga disa mësues, dhe ata, bazuar në punën dhe rezultatet e tij kanë vlerësuar se nuk i ka përmbushur kriteret për kalimin e klasës, atëherë me çfarë baze një komision i krijuar më vonë e ndryshon atë vlerësim? Kjo ngre dy pyetje: E para, cilat kanë qenë kriteret dhe bazat profesionale mbi të cilat komisioni ka marrë vendimin për ta ndryshuar vlerësimin e mësuesve? E dyta, çfarë mesazhi u dërgohet mësuesve dhe nxënësve nëse vlerësimi i bërë gjatë gjithë vitit mund të ndryshohet në këtë mënyrë? Kjo është veçanërisht shqetësuese në një kohë kur dinjteti dhe autoriteti profesional i mësuesve duhet të mbrohen dhe të fuqizohen, jo të dobësohen. Mësuesi që punon me nxënësin gjatë gjithë vitit duhet të ketë përgjegjësi, por edhe autoritet profesional në procesin e vlerësimit. Çështja e katërt ka të bëjë me mënyrën e specifikimit të kriterëve në tenderët komunalë. Kemi parë raste ku në specifikimet teknike është kërkuar, për shembull, përdorimi i një bageri me kapacitet prej 50 tonësh për punë të caktuara infrastrukturore. Pyetja është: a është e domosdoshme një makineri e tillë për realizimin e këtyre punëve dhe mbi çfarë kriteresh teknike është përcaktuar kjo kërkesë? Kur një kriter është tepër specifik dhe kufizon numrin e kompanive që mund të konkurrojnë, krijohet përshtypja se tenderi mund të jetë përshtatur për një operator të caktuar. Ne kemi kompani lokale që kanë kapacitete për të kryer shumë prej këtyre punëve, qoftë në kanalizime, rrugë apo projekte të tjera infrastrukturore. Prandaj, kërkojmë që specifikimet teknike në tenderë të jenë të bazuara në nevojat reale të projektit dhe të mos vendosen kriteret që pa arsye të justifikuar përjashtojnë kompanitë lokale nga konkurrenca. Në përfundim, kërkoj përgjigje konkrete për këto çështje, me dokumentacion dhe arsyetime të qarta, sepse bëhet fjalë për transparencën e institucioneve, trajtimin e barabartë të qytetarëve dhe bizneseve dhe përdorimin e drejtë të parasë publike.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit në adresimin e tij para kuvendit deklaroi: diskutimi im para jush lidhet me organizimin e dobët të dëgjimeve publike me qytetarët për përgatitjen e draft-buxhetit të Komunës së Vushtrrisë dhe përcaktimin e projekteve prioritare për vitin 2027, të cilat janë mbajtur gjatë muajit korrik të vitit 2026. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, një rol të rëndësishëm në organizimin dhe zhvillimin e këtyre aktiviteteve kanë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF). Ndërkaq, Drejtoria për Buxhet dhe Financa është dashur të përgatisë një raport për secilin takim, përkatësisht për secilin këshill lokal, lidhur me obligimet e kryera dhe të pakryera nga qytetarët, veçanërisht sa i përket pagesës së tatimit në pronë. Ky raport do të duhej t'u prezantohej qytetarëve gjatë diskutimeve për buxhetin dhe planifikimin e projekteve kapitale, duke u shpjeguar se të hyrat nga tatimi në pronë

do të kthehen në investime dhe projekte kapitale në lokalitetet përkatëse. Megjithatë, së paku në takimet ku kam qenë vetë i pranishëm dhe udhëheqës i tyre, Drejtoria për Buxhet dhe Financa nuk ka marrë pjesë dhe nuk ka përgatitur raporte të tilla. Si pasojë e informimit të dobët, shumë prej këtyre takimeve ose nuk janë mbajtur fare, ose janë mbajtur me një numër shumë të vogël qytetarësh. Pra, kemi pasur një problem serioz me informimin dhe mobilizimin e qytetarëve për pjesëmarrje në këto dëgjime publike. Për më tepër, Komuna e Vushtrisë nuk ka bashkëpunuar sa duhet as me këshillat lokalë dhe kryetarët e tyre për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve në këto takime. Të paktën, është dashur që kryetarët e këshillave lokalë të njoftoheshin në kohë për datën, orën dhe vendin e mbajtjes së takimeve, në mënyrë që ata të mund t'i informonin qytetarët. Po ashtu, në disa raste, edhe objektet e shkollave ku ishte planifikuar të mbahej takimet kanë qenë të mbyllura. Po i përmend vetëm disa raste konkrete. Takimi i planifikuar të mbahej më 8 korrik 2026, në orën 18:00, në Samadrexhë, në shkollën e fshatit, ka dështuar, pasi në takim ka marrë pjesë vetëm një qytetar. Takimi i planifikuar të mbahej më 9 korrik, në orën 18:00, në fshatin Nadakoc, po ashtu nuk është mbajtur për shkak të mungesës së interesimit për pjesëmarrje. Ndërsa takimi i planifikuar të mbahej më 9 korrik, në orën 20:00, në Stanoc të Poshtëm, gjithashtu nuk është mbajtur, pasi shkolla ka qenë e mbyllur dhe nuk ka pasur interesim nga qytetarët. Një rast edhe më shqetësues është takimi i planifikuar të mbahej më 17 korrik 2026, në orën 14:00, me banorët e qytetit, në sallën e Kuvendit Komunal. Ky takim nuk është mbajtur, pasi nuk ka marrë pjesë as kryesuesja e Kuvendit, në cilësinë e kryesueses së KPF-së, dhe asnjë qytetar. Prandaj, Kryetar, shtrohet pyetja: si do t'i planifikoni dhe implementoni projektet në këto fshatra dhe vendbanime, kur dëgjimet publike me qytetarët nuk janë mbajtur ose janë zhvilluar me një pjesëmarrje minimale? Si do të mund të përgatitet në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente draft-buxheti për vitin 2027, nëse qytetarët nuk janë informuar dhe nuk kanë pasur mundësi të shprehin nevojat dhe prioritetet e tyre? Mendoj se organizimi i dëgjimeve publike nuk duhet të trajtohet vetëm si një obligim formal, por si një mundësi reale që qytetarët të marrin pjesë në përcaktimin e prioritetëve dhe në planifikimin e investimeve të komunës.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit- pasi i përshëndeti të gjithë vijoi: Dua ta ndërlihd shkurtimisht këtë çështje edhe me dëgjimet buxhetore. Unë nuk i fajësoj aspak qytetarët që nuk kanë marrë pjesë në këto dëgjime. Që nga viti 2017, kur jam anëtare e Kuvendit Komunal, vetëm në fshatin tim, në dëgjimet buxhetore që janë mbajtur çdo vit, pothuajse asnjë nga kërkesat e qytetarëve nuk është realizuar. Atëherë, për çfarë arsye të vijnë qytetarët në dëgjime, vetëm për të plotësuar një fotografi që më pas publikohet në faqen zyrtare të komunës? Natyrisht që, kur kërkesat e tyre vazhdimisht nuk merren parasysh, ata humbin interesimin për të marrë pjesë. Ndërkaq, dua të ngre edhe një çështje tjetër që shqetëson shumë banorë të qytetit, konkretisht banorët e rrugës “Gëzim Rama”, prapa ish-objektit të Gjykatës. Ky është viti i tretë me radhë që në atë hapësirë janë vendosur disa lodra për fëmijë, të cilat shkaktojnë zhurmë të madhe dhe për më tepër nuk janë plotësisht të sigurta. Unë nuk e di se kush e ka dhënë lejen për vendosjen e tyre dhe mbi çfarë kriteresh është bërë kjo. Qytetarët që jetojnë në atë pjesë janë ankuar vazhdimisht se nuk mund të pushojnë gjatë natës për shkak të zhurmës. Madje, kohët e fundit kam marrë ankesë edhe nga një nënë me një foshnjë të vogël, e cila jeton në afërsi të kësaj hapësire. Kur qytetarët janë ankuar në komunë, përgjigjja ka qenë se nuk ka pajisje për matjen e nivelit të zhurmës. Por shtrohet pyetja: si është lejuar kjo hapësirë dhe si mund të tolerohet një zhurmë e tillë deri në orët e vona të natës? Po ju paraqes edhe një video të regjistruar në orën 23:41, e cila tregon nivelin e zhurmës që shkaktohet në atë hapësirë.

Kryetar, nuk është e arsyeshme që një pjesë e konsiderueshme e qytetit të përballlet me zhurmë deri në mesnatë, ndërkohë që për bizneset, përfshirë lokalet e gastronomisë, përcaktohen orare për

përfundimin e muzikës. Prandaj, duke qenë se na presin edhe dy muaj të verës, kur kjo hapësirë do të ketë frekuencim edhe më të madh, ju lutem që këtë çështje ta merrni seriozisht. Çfarë masash planifikon Komuna të ndërmarrë për këtë problem? Kërkoj që edhe Drejtoria e Inspeksionit ta trajtojë me seriozitet këtë çështje dhe nëse nuk mund të gjendet zgjidhje tjetër, të paktën gjatë orëve të mbrëmjes të merren masa për të ndaluar zhurmën dhe për t'u mundësuar banorëve të pushojnë normalisht.

Drita Dibrani, anëtare e kuvendit- të nderuar qytetarë të Vushtrrisë, e nderuar kryesuese, i nderuar kryetar, të nderuar anëtarë të Kuvendit, para rendit të ditës dua të prek dy çështje që i konsideroj shumë të rëndësishme. E para lidhet me bursat për studentët. Siç u përmend edhe më herët, është plotësisht e papranueshme që të na thuhet se këtë vit nuk do të ketë konkurs për ndarjen e bursave, me arsyetimin se mungojnë mjetet buxhetore. Nuk po mund ta kuptoj se çfarë mesazhi po u dërgojmë të rinjve tanë kur arsimi dhe mbështetja e tyre financiare mbeten ndër gjërat e para që sakrifikohen në buxhetin komunal. Bursat nuk janë luks dhe as lëmoshë për studentët. Ato janë investim në të ardhmen e të rinjve dhe në zhvillimin e komunës sonë. E njëjta neglizhencë po vërehet edhe në fushën e sportit. Klubet sportive po përballen me mungesë kritike të subvencioneve dhe mbështetjes financiare. Trajnerët, sportistët dhe të gjithë entuziastët tanë po e mbajnë gjallë sportin kryesisht përmes sakrificës së tyre, ndërsa nga komuna po marrin më shumë premtime sesa mbështetje konkrete. Unë nuk mund ta pranoj vazhdimisht arsyetimin se mungojnë mjetet buxhetore, ndërkohë që shpenzimet për kategori të tjera, të cilat mund të mos jenë më prioritare, vazhdojnë të realizohen. Rishikimi i prioriteteve buxhetore është obligim institucional dhe mbi të gjitha moral. Prandaj, kërkoj nga ju, si ekzekutiv komunal, që ta rishikoni urgjentisht mundësinë buxhetore dhe të gjeni mjetet e nevojshme për shpalljen e konkursit për bursa, si dhe për ndarjen e subvencioneve të merituar për klubet sportive. Nuk mendoj se rinia dhe studentët tanë duhet të mbështeten vetëm me fjalë, por edhe me vepra konkrete. Nëse klubet sportive, të cilat po sjellin suksese dhe po e përfaqësojnë Vushtrinë, nuk i mbështesim, rrezikojmë që disa prej tyre të shkojnë drejt shuarjes. Një gjë e tillë nuk duhet të ndodhë, sidomos kur bëhet fjalë për klube që kanë një traditë dhe kontribut të gjatë në sportin e komunës sonë. Prandaj, ju bëj thirrje që ta rishikoni buxhetin komunal, të gjeni mundësinë për ndarjen e bursave dhe të garantoni mbështetjen e nevojshme për klubet sportive. Rinia, arsimi dhe sporti duhet të jenë prioritet, jo sakrifica e parë kur përballemi me kufizime buxhetore.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit- të nderuar qytetarë të komunës së Vushtrrisë, të nderuar anëtarë të Kuvendit, i nderuar Kryetar, e nderuar kryesuese, të nderuar drejtorë, kam disa çështje për t'i ngritur sot si shqetësime të qytetarëve. Njëra prej tyre ka të bëjë me pjesën ku ka filluar të zgjerohet dhe të rregullohet lumi Silica, nga pjesa te Podrança deri në Dobërllukë, pra në pjesën ku po zhvillohen punimet për rregullimin e lumit. Kam marrë një shqetësim nga banorët e asaj zone, të cilët më kanë informuar se dikush po merr zallë në atë pjesë dhe u ka thënë banorëve se po e bën këtë me leje të komunës. Unë nuk e di se kush është personi që po merr zallë aty dhe as nëse ka leje për një veprim të tillë. Mirëpo, shqetësimi kryesor është se aty po rrezikohen banorët dhe fëmijët përreth. Ne e dimë se ajo pjesë ka qenë edhe e rrezikuar nga vërshimet, prandaj kërkoj që të kontrollohet nëse ky aktivitet është i lejuar dhe nëse po respektohen të gjitha rregullat e sigurisë. Shqetësimi tjetër që e kam ngritur edhe disa herë më parë ka të bëjë me kamionët që hyjnë në qytet për të shkarkuar mallra te marketet. Nuk po them që duhet t'u ndalohet puna bizneseve apo marketeve, sepse ata duhet të operojnë normalisht. Por duhet të gjendet një zgjidhje që të mos lejohet hyrja e kamionëve të rëndë, 7 apo 8 tonë, në pjesët e qytetit ku dëmtohet infrastruktura, trotualet dhe kubëzat. E dimë të gjithë se shumë prej këtyre pjesëve nuk janë të ndërtuara dhe të betonizuara në atë mënyrë që të përballojnë peshën e kamionëve të tillë. Për këtë arsye, kërkoj që

të gjendet një zgjidhje dhe të përcaktohen rregulla të qarta për hyrjen dhe shkarkimin e kamionëve në qytet. Çështja tjetër që dëshiroj ta ngre ka të bëjë me dëgjimet publike. Edhe unë, si anëtare e Kuvendit Komunal, kam qenë pjesë e këtyre proceseve dhe kam qenë kryesuese në dy dëgjime publike. Prandaj i arsyetoj plotësisht kolegët që thanë se qytetarët kanë munguar në këto dëgjime. Për shembull: në dëgjimin publik me gratë, ku tash e pesë vite jam pjesë e këtij procesi, gratë vazhdimisht i kanë paraqitur kërkesat e njëjta. Për fat të keq, shumë prej këtyre kërkesave nuk janë realizuar. Edhe dëgjimi tjetër me sportistët ka qenë shqetësues, sidomos për shkak të mungesës së përkrahjes së tyre. Edhe vitin e kaluar, siç e dini të gjithë, ka pasur raste të favorizimit të personave apo subjekteve të caktuara. Ka pasur edhe raste kur një individ ka marrë mjete në vlerë prej 25 mijë eurosh, ndërsa klubet sportive nuk janë financuar fare. Është për keqardhje që të lejojmë të shuhet klubet sportive në qytetin tonë. Vushttria njihet për klubet e saj të hendbollit, për sportin dhe për futbollin. Është viti i dytë që disa prej këtyre klubeve nuk kanë pasur kurrfarë mbështetjeje financiare. Prandaj, ju kisha lutur që të bëjmë një zgjedhje të drejtë dhe të përpiqemi të gjejmë mjete financiare për t'i mbështetur këto klube, në mënyrë që të mos shuhet. Sporti është një prej vlerave që e përfaqëson qytetin tonë dhe këto klube kanë një traditë të gjatë. Çështja tjetër ka të bëjë me bursat për studentët. Siç e përmendët edhe ju, kjo çështje ka ardhur në rend të ditës, por ndoshta nuk duhet të mbetet vetëm te një email. Do të ishte e nevojshme që drejtoresha përkatëse të jetë këtu për të na dhënë një arsyetim dhe një përgjigje konkrete. Në email është dhënë si arsyetim mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare. Prandaj, nuk e di tani nëse ka apo nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për t'i mbështetur studentët me bursa. Është për keqardhje që komunat e tjera i mbështesin studentët, ndërsa ne të mos jemi në gjendje ta bëjmë një gjë të tillë. Studentët tanë kanë nevojë për përkrahje dhe kjo përkrahje duhet të jetë konkrete, jo vetëm me fjalë.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-në adresimin e tij para kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrisë deklaroi: Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, të nderuar drejtorë, përfaqësues të KFOR-it, mediave, shoqërisë civile dhe të gjithë ju të pranishëm, Të nderuar qytetarë të komunës së Vushtrisë, unë jam munduar të mbaj shënime për secilin diskutim dhe për secilën vërejtje që është ngritur sot dhe do të mundohem t'i përgjigjem secilit me transparencë. Po fillojmë me anëtarin e parë, Berat Sadikun, i cili ngriti shqetësimin për iniciativën për ndërtimin e një kishe katolike në fshatin Zagorë. Po, është e vërtetë që ky shqetësim është ngritur edhe nga komunitete të tjera, përfshirë edhe Bashkësinë Islame. Dua t'ju njoftoj se për këtë iniciativë nuk ka as kërkesë për leje dhe nuk ka as leje të dhënë. Nuk do të lejohet të ndërtohet pa leje. Pra, nëse pyetja është nëse do të ndërtohet pa leje, përgjigjja është: jo, nuk do të ndërtohet pa leje. Tani jemi edhe në fazën finale të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe askund nuk do të lejohet të ndërtohet jashtë konturave dhe përcaktimeve të këtij plani. Ne nuk jemi kundër asnjë komuniteti fetar. I respektojmë të gjitha komunitetet fetare, sepse këtë e garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës. E garantojnë edhe ligjet e Republikës së Kosovës dhe ne jemi të obliguar t'i zbatojmë edhe Kushtetutën, edhe ligjet. Mirëpo, ua kemi bërë të qartë të gjithëve se ekzistojnë procedura që duhet të ndiqen deri te realizimi i një veprimi të tillë. Për këtë arsye, dje kemi pasur edhe një takim të përbashkët me Policinë e Kosovës, përkatësisht me njësinë që vepron në Vushtri, ku kemi diskutuar këto çështje. Sa i përket pyetjes së dytë, është fjala për një shtyllë në udhëkryqin te rruga "Shotë Galica", e cila është e tensionit të lartë dhe ndodhet në një pozitë shumë të keqe. Ne kemi bërë kërkesë te KEDS-i, ua kemi adresuar këtë shqetësim dhe është bërë edhe zgjidhja teknike. Presim që shtylla të dislokohe, në mënyrë që të lirohet ajo pjesë, e cila është rreth katër-pesë metra.

Po dua t'ju njoftoj gjithashtu se për këtë pjesë i jemi drejtuar edhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me kërkesën që kjo rrugë të na jepet në pronësi dhe në menaxhim të Komunës. Meqenëse është ndërtuar ajo pjesë e autostradës, rruga që nga dalja në autostradë, përkatësisht nga Nadakoci deri në Smrekonicë, është një rrugë që nuk i nevojitet më ministrisë në atë funksion që e ka pasur më parë. Ne kemi plan dhe e kam premtuar edhe më herët që në këtë pjesë të vendosim disa rrethrotullime, sepse kanë ndodhur ngjarje shumë tragjike në këto udhëkryqe, sidomos në udhëkryqin e Begajve. Edhe te rruga “Shotë Galica” jemi në pritje të përgjigjes dhe besoj se duhet të na e japin këtë pjesë në menaxhim. Ju e keni parë se ajo pjesë e rrugës, prej daljes së autostradës, është mirëmbajtur vetëm një herë nga ministria, sepse është pronë e ministrisë. Ndërkaq, unë po e them hapur para jush se asnjëherë nuk kam dashur të dal dhe të propagandoj se ajo rrugë nuk është e komunës, por është e ministrisë. Mirëpo, po vjen një moment kur më duhet t'ua tregoj këtë qytetarëve, sepse ata llogarinë po e kërkojnë nga unë personalisht. Sapo shohin se po asfaltohet një rrugë diku, menjëherë fillojnë komentet: “Shikoni si është bërë hyrja e qytetit të Vushtrisë.” Pra, segmenti prej daljes së autostradës deri te rrethrotullimi është pronë e ministrisë. Ne e kemi kërkuar atë segment dhe në momentin që ministria na e jep në menaxhim, atëherë edhe ne do të merremi me të. Profesor Refik, pyetja e parë e juaja ka të bëjë me ndërtimin e një kompleksi prapa kompleksit “Diari”. Unë i them Drejtorisë së Urbanizmit që t’jua përcjellë informacionin përmes emailit. Asgjë nuk është duke u ndërtuar pa leje. Edhe çdo specifikë që kërkon, shumë singërisht, mund të jetë dashur të kërkohej më herët, por edhe këto informacione do të jenë transparente dhe do t’jua përcjellim. Po e them qartë: pa leje nuk guxon dhe nuk lejohet të punohet. Pyetja e dytë ka të bëjë me njoftimin e DKA-së se nuk do të ketë bursa për studentë. Shikoni, të gjithë jemi dëshmitarë të situatës financiare në të cilën ndodhet komuna. Do të kisha pasur dëshirë që ju, si përfaqësues të qytetarëve, ashtu sikurse edhe unë, të reagonit nganjëherë kur dëmtohet komuna. Në fund të fundit, ju i përfaqësoni qytetarët e komunës së Vushtrisë dhe jo institucione të tjera. Duhet të reagojmë kur komunës i shkaktohet dëm. Komunës i janë marrë 14 milionë euro përmes obligimeve që kanë dalë nga kontrata kolektive, e cila nuk është përmbushur dhe për të cilën komuna nuk ka pasur faj. Sikur këto mjete të ishin marrë për shkak të ndonjë gabimi të komunës, unë do të dilja këtu para jush dhe do të thosha: “Faji është imi.” Dhe do të kisha dy mundësi: ose të vazhdoja të punoja duke e pranuar përgjegjësinë, ose të jepja dorëheqje. Por 14 milionë euro janë shumë para. Dhe besoni se komuna është në prag të një situatë shumë të rëndë financiare. Kurrë prej pasluftës, komuna nuk ka qenë më keq financiarisht. Na janë marrë 14 milionë euro. Ju e dini se buxheti për vitin 2026 për investime kapitale është rreth 5.3 milionë euro. Ndërsa vetëm përmes këtyre obligimeve, që nga viti 2022, na janë marrë 14 milionë euro. Pra, na kanë goditur rëndë financiarisht. Dhe tash, sa i përket asaj që po thoni ju, duhet ta dini edhe një gjë tjetër: buxheti është i ndarë në kategori. Ekziston kategoria e subvencioneve, përmes së cilës subvencionohen edhe bursat e studentëve, edhe klubet sportive dhe kategoritë e tjera. Nuk mund t’i marrësh mjetet nga kategoritë e mallrave dhe shërbimeve apo nga investimet kapitale, dhe me ato mjete të bësh pagesa për subvencione. Këtë e dinë mirë edhe këshilltarët, edhe kolegët që janë këtu, përfshirë edhe ekonomistët. Askush më shumë se unë, këtë po e them publikisht, nuk është munduar të bëjë për rininë. Rreth 1300 të rinj i kemi subvencionuar, jo përmes bursave studentore, por përmes trajnimeve profesionale në fushën e programimit dhe inteligjencës artificiale. Kemi paguar edhe trajnime për zanate në Qendrën Gjermane të Trajnimit dhe kemi ndarë edhe bursa. Por sivjet jemi në një situatë të vështirë. Nuk kemi mundësi financiare. Unë po ju them hapur dhe le ta dinë të gjithë. Edhe studentëve, edhe juve ju kam thënë: e kuptoj dëshirën tuaj për të thënë “bëni diçka”. Por cilido që mendon se ka një mundësi tjetër, le ta formojë

një komision, ta marrë komplet buxhetin dhe ta analizojë: a mund të bëhet diçka apo nuk mund të bëhet? Nuk ka pasur mundësi. Dhe më ka ardhur tepër keq për këtë.

Edhe sivjet po mendoj se vitin e ardhshëm, nëse arrijmë t'i kryejmë këto borxhe, do të kemi mundësi të krijojmë hapësirë më të madhe financiare. Dy mundësi i ka pasur Qeveria për këtë çështje. Njëra ka qenë t'i paguante këto obligime, ndërsa një qeveri para kësaj ka nënshkruar kontratën kolektive pa mbulesë buxhetore. Është nënshkruar pa mbulesë buxhetore dhe pa deklaratë financiare, duke marrë përsipër një obligim për mësimdhënësit. Në tërë Kosovën, obligimet që kanë dalë nga kontrata kolektive kanë qenë mbi 300 milionë euro. Mundësia e dytë ka qenë që, meqë nuk ka pasur mundësi të paguheshin, kontrata të ndërpritej menjëherë dhe në mënyrë të njëanshme. Por kontrata nuk u ndërpre për gati tre vjet dhe gjatë kësaj kohe obligimet u akumuluan. Pastaj, kur erdhi koha e pagesës, barra ra mbi komunat. Ne nuk e kemi nënshkruar këtë kontratë dhe nuk kemi pasur lidhje me të. Dhe nuk është vetëm Komuna e Vushtrrisë që është përballur me këtë problem. Prandaj, jemi në një situatë ku duhet të gjejmë një mënyrë për të dalë nga kjo krizë. Sa i përket çështjes së dy shkollave fillore, ku është thënë se nxënësit e kanë humbur vitin dhe janë kthyer në ripërsëritje, dua të them se unë nuk i përcjell personalisht të gjitha çështjet, sepse ekzistojnë mekanizmat përkatës në DKA. Nëse diçka është bërë në kundërshtim me ligjin apo me udhëzimet administrative të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, unë e marr me shumë përgjegjësi këtë çështje dhe, nëse ka shkelje, dikush do të japë përgjegjësi juridike. Do ta shqyrtoj nëse kjo çështje është në harmoni me ligjin. Nëse është në harmoni me ligjin, atëherë do të veprojmë në përputhje me procedurat. Sa i përket specifikimeve të kriterëve gjatë tenderëve, nuk e di nëse e dini, por ekziston Organi Shqyrtues i Prokurimit, OSHP-ja, i cili merret me këto çështje. Çdo operator ekonomik që konsideron se është dëmtuar gjatë një procedure tenderimi mund ta dërgojë lëndën në OSHP. Unë e di se vitin e kaluar, pothuajse në të gjitha rastet që kanë shkuar në OSHP, ka fituar Komuna e Vushtrrisë. Kjo është një tregues se procedurat e prokurimit kanë shkuar në përputhje me ligjin e prokurimit. Për të qenë i qartë: unë nuk përzihem në specifikime dhe nuk kam lidhje me to. Kushdo që mendon se është dëmtuar, le t'i drejtohet OSHP-së. Këto çështje nuk zgjidhen nga anëtarët e Kuvendit dhe as nga kryetari. OSHP-ja është organi kompetent për shqyrtimin e tyre. Sa i përket pyetjeve të Ymer Haradinajt për organizimin e dëgjimeve publike dhe për përgatitjen e draft-buxhetit për vitin 2026, Drejtoria përkatëse e buxhetit e ka tabelën dhe pasi ta përfundoj fjalën, mund të dalë dhe të japë të dhënat konkrete. Mirëpo, dua t'ju tregoj se ka qenë ditë e premtë. Kam pasur edhe obligime të tjera dhe kam pasur qytetarë që kanë pritur për t'u takuar me mua. Besoni se rreth 80 përqind e qytetarëve kanë pasur dëshirë të takohen drejtpërdrejt me mua. Kanë pasur hallet e tyre personale dhe nuk kanë dashur të marrin pjesë në tubim, por kanë dashur të takohen individualisht me kryetarin. Për këtë arsye, në disa raste ka pasur numër më të vogël të pjesëmarrësve, jo të kënaqshëm, por kjo nuk do të thotë se qytetarët nuk kanë pasur interes. Sa i përket qytetarëve, ashtu siç e përmende edhe ti, mund të mos kenë ardhur edhe për shkak se shumë prej punëve tashmë janë kryer. Për shembull, kemi pastruar lumin, kemi shtruar rrugë, kemi çuar ujësjellës dhe kanë mbetur vetëm edhe disa punë për t'u përfunduar. Kur i kryen punët dhe qytetarët nuk kanë më shqetësime, për çfarë të vijnë në dëgjim? Njerëzit vijnë kur kanë halle dhe kur kanë nevojë t'i paraqesin ato. Sa i përket anëtares së kuvendit znj. Gresës, është pothuajse e njëjta përgjigje për pjesëmarrjen në dëgjimet buxhetore. Drejtori i Financave mund t'ju tregojë se informimi është bërë me kohë dhe në të gjitha vendet. Edhe unë kam qenë i interesuar që të ketë pjesëmarrje më të madhe, por në disa raste pjesëmarrja ka qenë më e ulët. Sa i përket vendosjes së lodrave, më falni, por për këtë çështje kam thirrur drejtorin e Inspeksionit dhe drejtorin e Urbanizmit, sepse edhe më herët e kam ngritur këtë shqetësim.

Kemi biseduar edhe me zëvendëskomandantin e Stacionit Policor për çështjen e zhurmës pas orës 22:00. Kjo çështje është në kompetencë të Policisë dhe jo të Inspektoratit. Megjithatë, do ta shqyrtoj mundësinë për tërheqjen e pëlqimit, sepse e dimë që ajo hapësirë është shumë e ngushtë dhe se ka ankesa nga qytetarët. Tek anëtarja e kuvendit znj. Drita Dibrani, sa i përket çështjes së bursave, po përgjigjem edhe një herë. Unë kam qenë mësues dhe, kur flisja, gjithmonë kam pasur dëshirë që të më dëgjonin të tjerët. Nuk po e them këtë me ironi. Sa i përket bursave dhe çështjeve që u ngritën, dua të theksoj se ne i kemi mbështetur sportet fuqishëm. Mirëpo, nuk mund të pretendohet se të gjitha kërkesat e sportistëve mund të plotësohen vetëm përmes subvencioneve të komunës. Vetëm për klubin e futbollit kemi arritur të gjejmë sponsorë dhe vlera e mbështetjes ka kaluar 1 milion euro. Komuna nuk ka mundësi t'i japë vetë këto mjete. Kjo mbështetje ka ndikuar që ta dërgojmë klubin në Superligë. Në mandatet e mëparshme klubi i futbollit nuk ka qenë në Superligë dhe, në momentin kur kemi arritur këtë sukses, secilit lojtar i kam ndarë nga 1,000 euro shpërblim nga fondi i kryetarit. Tash mund të thoni: “Pse nuk i ke dhënë bursa?” Por duhet t'i kuptojmë kategoritë buxhetore. Kam vepruar edhe tani. Për klubin “Sama”, i cili ka zënë vendin e parë, lojtarëve u është ndarë nga 1,000 euro shpërblim. Edhe klubeve të tjera u kam ofruar mundësi për sponsorë, sepse Kosova e ka një prej ligjeve më të mira në gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor sa i përket mbështetjes së sportit përmes sponsorizimit. Sivjet nuk kemi pasur mundësi për subvencione. Kjo është e njëjta përgjigje sikurse për të gjithë të tjerët. Por nuk kemi qëndruar duarkryq në asnjë moment. Tash jemi duke intervenuar edhe në stadiumin e Dobërllukës. Atje është bërë një punë shumë e madhe për të krijuar kushtet që të zhvillohen stërvitjet derisa të ndërtohet stadiumi. Anëtarja e kuvendit znj. Fatmir Cecilia ngrii çështjen e largimit të zhavorrit nga lumi Silnica. Për këtë çështje do të drejtohem i drejtoritë përkatëse për ta shqyrtuar situatën dhe për të parë se çfarë mund të bëhet. Sa i përket kamionëve me peshë të rëndë, do t'i kërkoj Drejtorisë së Shërbimeve Publike ta shqyrtojë këtë çështje, përfshirë edhe qarkullimin e mjeteve të rënda të kompanisë “Përparimi” dhe të mjeteve të tjera që mund të dëmtojnë rrugët me kalldrëm. Sa i përket dëgjimeve publike dhe buxhetit, për vitin e ardhshëm shpresojmë të kemi një draft-buxhet më të favorshëm. Kemi obligim që të krijojmë, së paku, rreth 8 milionë euro për pagesën e borxheve. Duhet të krijojmë edhe një kod të veçantë buxhetor për pagesën e këtyre borxheve, në mënyrë që, kur të vijë përmbaruesi, të kemi mjete të planifikuara dhe të mos na bllokohen llogaritë. Edhe raporti i Auditorit është i rëndësishëm. Ne duhet t'i kemi të planifikuara këto obligime dhe t'i menaxhojmë në mënyrë transparente. Draft-buxhetin do ta sjellim para jush. Ju, si anëtarë të Kuvendit, dhe qytetarët do të mund ta shihni se çfarë kemi planifikuar dhe cilat janë prioritetet. Unë, siç e dini, jam çdo ditë në terren. Më keni parë te qytetarët dhe nëpër lagje e fshatra. Kërkesat e qytetarëve i di dhe e di se ka shumë prej tyre. Sa i përket largimit të zhavorrit, dëgjimeve publike dhe çështjes së bursave, përgjigjen tashmë e dhashë: për bursat, këtë vit ka pasur mungesë të mjeteve financiare. Faleminderit shumë që patët durimin të më dëgjoni. Besoj se jam munduar, me respekt dhe transparencë, t'i përgjigjem secilës pyetje dhe secilit shqetësim që është parashtruar.

Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së-Sa i përket pastrimit të lumit nga Podrança deri te pjesa e kufirit me Mitrovicën, aktualisht jemi në fazën e parë të punimeve. Në këtë fazë nuk është paraparë largimi i zhavorrit. Përveç ekskavatorit dhe buldozerit, për momentin nuk ka makineri të tjera, si kamionë apo mjete të ngjashme. Aktualisht jemi duke punuar në krasitjen dhe largimin e drunjve, si dhe në pastrimin dhe rregullimin e shtratit të lumit. Sa i përket Dobërllukës, dua të theksoj se, pas drenazhimit të stadiumit, fillimisht është bërë gërmimi dhe hapja e kanalit të drenazhimit. Materiali i nxjerrë është deponuar në pjesën e bankinës, ku është përdorur për nivelizimin e

terrenit. Prandaj, nuk ka asnjë arsye për shqetësim sa i përket deponimit të zhavorrit apo materialeve të tjera.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit-tha se u përmendën shumë çështje me rëndësi. Njëra prej tyre është edhe çështja e deklaratës së përbashkët, të cilën e kërkoja edhe më herët nga kolegët. Kisha propozuar që kjo çështje të hynte si pikë e rendit të ditës dhe që, bashkërisht si kolegë, ta hartonim një deklaratë të përbashkët për të dënuar dhunën, thirrjet për dhunë dhe për të kërkuar nga organet kompetente hetimin dhe vendosjen e përgjegjësisë ndaj personave që nxisin një fenomen të tillë në shoqërinë tonë. Sa i përket çështjes së bursave, nuk desha ta ndërpres kryetarin, por dua të rikthehem edhe një herë te kjo çështje. Ne, si kolegë që marrim kompensim për punën tonë në Kuvend, duhet të japim shembullin tonë dhe të kontribuojmë në gjetjen e një zgjidhjeje për studentët. Nuk dua të merremi me arsyetime se kush ka faj apo të kthehem në kohë. Jemi në vitin 2026 dhe duhet të gjejmë zgjidhje konkrete. Kur kërkojmë zgjidhje, unë dua të filloj nga vetja. Prandaj, publikisht deklaroj se jam i gatshëm të ndaj nga paga ime nga 400 euro për dy ose tri paga radhazi, si mbështetje për studentët. Ftoj edhe kolegët që kanë mundësi dhe e shohin të arsyeshme t'i bashkohen kësaj iniciative. Nëse arrijmë të krijojmë një fond të përbashkët, këto mjete mund t'u dedikohen studentëve më të dalluar dhe atyre që kanë kushte të vështira ekonomike dhe e kanë të vështirë të vazhdojnë studimet. Mendoj se, nëse kërkojmë zgjidhje nga të tjerët, duhet të jemi të gatshëm të fillojmë edhe nga vetja. Ky do të ishte një kontribut konkret dhe një mesazh i mirë për studentët tanë. Sa i përket çështjeve të tjera që u ngritën lidhur me rendin e ditës dhe propozimet e bëra, konsideroj se ato tashmë janë tejkaluar dhe nuk ka nevojë të ndalemi më gjatë. Për sa i përket deklaratës së përbashkët, mund ta hartojmë edhe pa e futur si pikë të veçantë në rendin e ditës. Mund të marrim një pauzë dhe, varësisht nga qëndrimi i shefave të grupeve kuvendare, të ulemi së bashku dhe ta përgatisim deklaratën.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-kërkoj që të futet në rendin e ditës, ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për kategorizimin e klubeve sportive. Kjo është një kërkesë që vjen nga të gjitha klubet sportive. Aktualisht kemi një rregullore të miratuar, të cilën e kemi mbështetur dhe e kemi votuar të gjithë së bashku. Megjithatë, kjo rregullore është e mangët dhe, në praktikë, ka vështirësi për t'u zbatuar dhe nuk i përfshin të gjitha nevojat e klubeve sportive. Prandaj, konsideroj se është e nevojshme që ta rishikojmë dhe ta ndryshojmë këtë rregullore, në mënyrë që të jetë më funksionale dhe t'u përgjigjet nevojave reale të klubeve sportive. Duke qenë se kjo është një çështje me interes për të gjitha klubet sportive, propozoj që të shqyrtohet seriozisht dhe të punohet në ndryshimet e nevojshme. Sa i përket dëgjimit publik të mbajtur para një jave, mendoj se është shumë shpejt të themi se nuk është marrë seriozisht puna e bërë. Megjithatë, puna duhet të vazhdojë dhe të përfshihen të gjitha palët relevante. Gjithashtu, do të ishte mirë që në komisionin që do të merret me këtë çështje të jenë të përfshirë edhe anëtarë të Kuvendit Komunal, dhe jo vetëm përfaqësues të drejtorisë. Në këtë mënyrë do të sigurohej një proces më gjithëpërfshirës dhe më transparent.

Në vazhdim kuvendi pas votimit me 14 vota “për”, 3 vota “kundër” dhe 3 vota “abstenim”, e inkorporoj në rendin e ditës Propozim vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale.

Kuvendi pas votimit të veçuar me 16 vota “për”, 2 vota “abstenim”, e inkorporoj në rendin e ditës Propozim-vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.

Në fund të debatit, jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me 16 vota “për”, 2 vota “abstenim”, aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 25 qershor 2026.
2. Informatë lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të komunës, për periudhën janar-qershor 2026.
3. Raport gjashtëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2026.
4. Pasqyrat financiare për vitin 2025 dhe raporti i auditorit të përgjithshëm.
5. Informatë lidhur me mbrojtjen e mjedisit janar-qershor 2026.
6. Raport i veçantë mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarret, për periudhën 2023 – qershor 2026.
7. Propozim-vendim paraprak, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale.
8. Propozim-vendim paraprak, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.
9. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 25 qershor 2026.;

Pas shqyrtimit, pas votimit me vota “unanime”, kuvendi aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës së Vushtrrisë, mbajtur në datën 25 qershor 2026.

2. Informatë lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të komunës, për periudhën janar-qershor 2026.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se, siç shihet nga të dhënat e paraqitura në informatë, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 janë miratuar gjithsej 23 vendime. Në muajin janar janë marrë tetë vendime. Shtatë prej tyre janë zbatuar, ndërsa një është ende në procedurë të zbatimit. Bëhet fjalë për vendimin për formimin e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë. Më intereson të di se cila është arsyeja, pse ky vendim ende është në procedurë të zbatimit, kur kanë kaluar më shumë se pesë muaj nga miratimi i tij?! Pse ende nuk është përfunduar procedura për zbatimin e këtij vendimi?! Në muajin shkurt janë marrë dy vendime dhe të dyja janë zbatuar. Në muajin mars janë marrë tri vendime. Të tria janë zbatuar, por njëri prej tyre është kthyer nga MAPL-ja. Bëhet fjalë për vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete. Në muajin prill janë marrë tri vendime. Dy prej tyre janë zbatuar, ndërsa një është ende në procedurë të zbatimit. Bëhet fjalë për vendimin për themelimin e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës së Kuvendit. Për këtë çështje, përgjegjësia është drejtpërdrejt edhe e juaja si kryesuese e Kuvendit. Prandaj, do të doja të dija se cila është arsyeja pse ka ngecur zbatimi i këtij vendimi dhe pse ende nuk është funksionalizuar komisioni. Në muajin maj janë marrë katër vendime dhe sipas informatës, të gjitha janë të zbatuara. Ndërsa, vendimet e muajit qershor, gjithsej dy, janë ende në procedurë, përkatësisht janë dërguar në MAPL dhe ndodhen në procedurë të vlerësimit të ligjshmërisë. Pra, do kërkoja përgjigje

konkrete për këto dy çështje që i ngrita: arsyen e vonës në zbatimin e vendimit për formimin e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës, si dhe arsyen e ngecjes së vendimit për themelimin e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës së Kuvendit?!

3. Raport gjashtëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2026;

Drita Dibrani, anëtare e kuvendit- të nderuar qytetarë të Vushtrrisë, e nderuar kryesuese, kryetar, anëtarë të Kuvendit, Sot po diskutojmë raportin buxhetor për periudhën janar-qershor 2026. Buxheti i komunës nuk është thjesht një dokument me shifra matematikore, tabelare apo financiare. Buxheti është pasqyrë e prioriteteve të këtij qyteti, është zgjedhje politike dhe është përgjegjësi morale e qeverisjes. Çdo euro në arkën e komunës është djersa e punëtorit, mundi i fermerit, taksa e biznesit të vogël dhe sakrificat e secilës familje të Vushtrrisë. Prandaj, pyetja kryesore që duhet t'ia bëjmë vetes sot është: Ku po shkon djersa e qytetarëve tanë? Raporti gjashtëmujor që kemi përpara tregon një të vërtetë të hidhur. Ky raport nuk pasqyron një qeverisje të orientuar drejt zhvillimit, por tregon keqmenaxhim dhe prioritete të gabuara. Mbi 3.4 milionë euro të taksapaguesve tanë janë përfunduar në procese përmbarimore dhe në dyert e gjykatave. Mbi 1 milion euro janë shpenzuar për subvencione, mbi 2.2 milionë euro për investime kapitale dhe afër 230 mijë euro për shpenzime procedurale gjyqësore. Edhe më herët, kryetari u arsyetua se një pjesë e buxhetit po shkon dëm. Por këto nuk janë para që kanë rënë nga qielli. Këto janë para të qytetarëve, të cilat duhet të investohen në shkollat, çerdhet, ambulancat dhe rrugët e Vushtrrisë, e jo të përdoren për të mbuluar pasojat e dështimeve të kësaj qeverisjeje. Përdorimi paraja publike shkon në përmbarime, luksin e pushtetit nuk mund ta justifikojmë. Raporti paraqet një kontrast të pafalshëm. Mbi 29 mijë euro janë shpenzuar për udhëtime dhe mëditje jashtë vendit, ndërsa mbi 30 mijë euro janë shpenzuar për vetura me qira. Ndërkohë, për mirëmbajtjen e të gjitha objekteve të kujdesit parësor shëndetësor në komunën e Vushtrrisë, për gjashtë muaj janë ndarë vetëm 256 euro. Atëherë, pyetja është e thjeshtë: A janë më të rëndësishme udhëtimet e zyrtarëve dhe veturat me qira sesa shëndeti i qytetarëve? Kjo, për besë, nuk është vetëm paaftësi. Kjo është një filozofi e gabuar e qeverisjes dhe një mënyrë e gabuar e përcaktimit të prioriteteve. E treta, dhe ndoshta një nga çështjet më shqetësuese, është ajo që në dokumentet buxhetore figuron si kodi nënkodi 13460, i emërtuar “Shërbime kontraktuese të tjera”. Sipas raportit, në këtë zë janë shpenzuar hiç më pak se 1.9 milionë euro. Pra, një shumë jashtëzakonisht e madhe e buxhetit për mallra dhe shërbime është përqendruar në një zë të tillë. Qytetarët kanë të drejtë të dinë se cilët operatorë ekonomikë i kanë marrë këto mjete, për çfarë shërbimesh janë paguar dhe çfarë rezultatesh konkrete janë arritur me këto para. Dhe përdorimi paratë shpenzohen për udhëtime, vetura me qira dhe përmbarime, projektet jetike figurojnë me 0% realizim. Bëhet fjalë për projekte si stacioni i autobusëve, çerdhet e reja, shkollat në Naim Frashri, shkollat në Novolan, rregullimi i lumit Sitnica dhe shumë projekte të tjera të rëndësishme për qytetarët. Të nderuar të pranishëm, Si anëtare e këtij Kuvendi, besoj se paratë e popullit duhet t'i kthehen popullit. Buxheti duhet të përkthehet në drejtësi sociale, në barazi, në arsim cilësor dhe në shëndetësi të dinjitetshme. Vushtrria nuk ka nevojë për arsyeime politike. Vushtrria ka nevojë për llogaridhënie, transparencë të plotë dhe një qeverisje me duar të pastra, e cila punon për qytetin dhe qytetarët e saj, e jo vetëm për veten. Prandaj, kryetar, pyetja ime për ju është kjo: Siç e përmenda, 1.9 milionë euro janë shpenzuar në zërin “Shërbime kontraktuese të tjera”. Qytetarët e Vushtrrisë kanë të drejtë të dinë cilët janë operatorët ekonomikë që i kanë marrë këto mjete, për çfarë shërbimesh janë përdorur dhe sa prej tyre janë përdorur për kontrata mbi vepër apo marrëveshje për shërbime të veçanta.

Gjithashtu, si është e mundur që për udhëtime, mëditje dhe akomodime zyrtare jashtë vendit të shpenzohen mbi 29 mijë euro, ndërsa për vetura me qira të shpenzohen mbi 30 mijë euro, kur për mirëmbajtjen e të gjitha objekteve të kujdesit parësor shëndetësor në komunën e Vushtrrisë janë ndarë vetëm 256 euro për gjashtë muaj? A janë më të rëndësishme udhëtimet dhe shpenzimet e pushtetit sesa shëndeti i qytetarëve?

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit- Kur jemi te raporti i shpenzimeve për periudhën janar–qershor 2026 dhe krahasimi i tyre me vitin 2025, kryetari disa herë gjatë fjalimit të tij e theksoi se bëhet fjalë për kategori të ndryshme dhe të ndara buxhetore. Kryetar, ne kemi qenë pjesë e qeverisjes dhe e dimë shumë mirë se kategoritë buxhetore janë të ndryshme. Mirëpo, përtej kategorizimit buxhetor, nganjëherë duhet të shihen edhe vullneti, puna dhe vizioni i qartë për t'i adresuar nevojat e qytetarëve. Dua të ndalem te shpenzimet për shërbimet rezidenciale. Ju e dini shumë mirë, kryetar, se në Lummadhë funksionon një qendër rezidenciale. Këtë çështje e kam ngritur edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa. Në buxhet nuk po shoh të paraparë ndonjë zë apo kod buxhetor për sigurimin e një automjeti për këtë qendër. Është viti i pestë që e ngre këtë çështje: qendra rezidenciale nuk ka një automjet. Nuk e di nëse keni pasur rastin ta vizitoni ndonjëherë këtë qendër dhe të shihni se çfarë kategorie njerëzish jetojnë aty dhe cilat janë nevojat e tyre. Kam informacione se nuk e keni vizituar, prandaj do t'ju rekomandoja ta vizitoni dhe ta shihni nga afër gjendjen dhe nevojat e tyre. Ata kanë nevojë për një automjet, madje për një automjet që t'u përshtatet nevojave të tyre specifike. Kryetar, në këtë raport shohim se janë shpenzuar mjete të konsiderueshme për vetura me qira. Atëherë, pse të mos sigurohet një automjet me qira edhe për qendrën rezidenciale, në vend që kjo nevojë të mbetet e pazgjidhur për pesë vjet? Nëse kemi mundësi të marrim vetura me qira për nevoja të administratës, duhet të kemi mundësi të sigurojmë një automjet edhe për një qendër që ka nevojë reale për të. Sa i përket kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, unë e di shumë mirë se si ndahet dhe planifikohet buxheti. Kam qenë drejtoreshë dhe e di se nuk mund të bëhet një shpenzim për subvencione, mallra dhe shërbime apo investime kapitale nëse nuk është paraparë në kategorinë përkatëse buxhetore. Këtë e kam shumë të qartë, prandaj nuk është nevoja që vazhdimisht të arsyetoheni vetëm me kategorizimin buxhetor. Por, kryetar, a ka mundësi të merrni një veturë me qira për nevojat e qendrës rezidenciale? A ka mundësi që, në kuadër të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, të rregullohen qendrat e mjekësisë familjare dhe shkollat, ku ka aq shumë mungesa? Ka mungesë të higjienës në çerdhe. Ka mungesë të mjeteve higjienike në shkolla. Në disa shkolla të Vushtrrisë mungojnë edhe gjërat elementare, si sapuni për larjen e duarve. Ndërkohë, në të njëjtën kategori buxhetore shohim shpenzime të konsiderueshme për nevoja të tjera të administratës. Ne e dimë shumë mirë se si bëhen furnizimet me materiale higjienike, materiale për zyrë dhe materiale të tjera shpenzuese. Prandaj, pyetja ime është: a është më mirë të furnizohen objektet e komunës me pajisjet dhe materialet e nevojshme, apo të vazhdohet me shpenzime të tjera që nuk janë domosdoshmërisht prioritet? Për shembull, shpenzimet për udhëtime zyrtare janë të konsiderueshme. Në raport figurojnë shuma prej 12,882 euro, 5,300 euro, 6,500 euro dhe mbi 11,000 euro në zëra të ndryshëm. Nuk po i përmend të gjitha shpenzimet, por po e ngre këtë shqetësim sepse, me këto mjete, do të mund të bëheshin shumë punë të mira për qytetarët. Sa i përket kompjuterëve, e kuptoj se mund të ketë pasur nevojë për zëvendësimin e tyre dhe se bëhet fjalë për një vlerë të konsiderueshme. Por dua të ngre një shqetësim tjetër lidhur me shpenzimet në arsim, konkretisht me trajnimet e vazhdueshme të mësimdhënësve. Pse nuk janë organizuar trajnime të vazhdueshme për mësimdhënësit? Trajnimi dhe zhvillimi profesional janë jetikë. Njeriu mëson gjatë gjithë jetës, ndërsa mësimdhënësit kanë nevojë të vazhdueshme për zhvillim profesional. Në këtë vit, sipas informatave që kemi, nuk janë organizuar trajnime të vazhdueshme për të gjithë mësimdhënësit.

Nuk e di cila është arsyeja dhe çfarë ka ndikuar në këtë situatë, por mendoj se kjo është një çështje që duhet të sqarohet. Po ashtu, shpenzimet për vetura me qira dhe karburante janë në vlera mjaft të larta. Me këto mjete, brenda kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, do të mund të realizoheshin shumë punë të mira dhe të adresoheshin shumë nevoja konkrete të qytetarëve. Prandaj, kryetar, nuk po them se nuk duhet të shpenzohen paratë. Po them se duhet të shpenzohen me prioritet, me përgjegjësi dhe në funksion të nevojave reale të qytetarëve.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se po e shoh që kryetari sot, në një moment, ishte në siklet kur tha se nuk po kemi para, ndërsa me kalimin e kohës u relaksua. Por, sa i përket raportit të shpenzimeve, ky raport tregon shumëçka për gjendjen në të cilën ndodhet Komuna e Vushtrisë dhe për mënyrën e punës së kryetarit dhe qeverisë komunale. Ne po shohim se, bazuar në këtë raport, paratë janë shpenzuar, por punët në terren nuk janë përfunduar. Madje, jo vetëm që nuk janë përfunduar, por në shumë raste as nuk kanë filluar. Prandaj, edhe nga takimet që kemi pasur me qytetarët dhe nga qytetarët që kam pritur në zyrë, kam marrë ankesa të shumta për qeverisjen tuaj, për mënyrën e shpenzimit të parasë publike dhe për mënyrën se si po menaxhohet Komuna e Vushtrisë. Po e filloj me shpenzimet e luksit që i keni bërë si qeveri komunale. Nëse e krahasojmë periudhën janar-qershor 2025 me periudhën janar-qershor 2026, shohim se shpenzimet për udhëtime zyrtare jashtë vendit në vitin 2026 janë 12.820 euro, ndërsa në vitin e kaluar kanë qenë 15.900 euro. Sa i përket mëditjeve për udhëtime zyrtare jashtë vendit, vitin e kaluar janë shpenzuar 3.200 euro, ndërsa sivjet 5.388 euro. Për akomodimin gjatë udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, këtë vit janë shpenzuar 6.500 euro, ndërsa vitin e kaluar 2.651 euro. Ndërsa për shpenzime të tjera të udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, këtë vit janë shpenzuar 11.000 euro, krahasuar me 7.900 euro vitin e kaluar. Pra, duket qartë se një pjesë e konsiderueshme e mjeteve është shpenzuar për udhëtime jashtë vendit, ndërsa para qytetarëve dhe para kuvendarëve dilni dhe thoni se nuk kemi para për ndarjen e bursave për studentë. Unë dje dëgjova se Komuna e Fushë Kosovës ka ndarë 754 bursa për studentë të nivelit bachelor dhe 160 bursa për studentë të nivelit master. Edhe ajo është një komunë në kuadër të Republikës së Kosovës. Po ashtu, kemi parë edhe kryetarë të komunave të tjera duke dalë në terren dhe duke shpërndarë traktorë për bujqit. Prandaj, mosndarja e bursave në Komunën e Vushtrisë lidhet, në masë të madhe, me menaxhimin e dobët të komunës dhe me mënyrën se si po prioritetizohen shpenzimet. Sa i përket blerjes së kompjuterëve, parafolësi tha se kjo është në rregull. Mirëpo, ka qenë kërkesë e kahmotshme që edhe asamblastët të pajisen me kompjuterë ose laptopë. Sigurisht, kjo ka mbetur si pasojë e neglizhencës së kryesueses së Kuvendit, e cila, me sa duket, nuk e ka iniciuar këtë çështje. Sa i përket shpenzimeve për karburant, e dimë që sivjet kemi pasur rritje të çmimeve. Por nuk e di se si mund të arsyetohet kjo rritje, kur në terren shumë punë nuk po kryhen, ndërsa shpenzimet për karburant janë rritur ndjeshëm. Nga 23.000 euro sa kanë qenë vitin e kaluar, sivjet kanë arritur në 25.233 euro. Sa i përket mirëmbajtjes së autorrugëve lokale, vitin e kaluar janë shpenzuar 436.000 euro, ndërsa sivjet mbi 1 milion euro. Për mirëmbajtje rutinore janë shpenzuar 263.000 euro. Pastaj kemi edhe qiratë për automjete. Në njërin anë keni blerë automjete, ndërsa në anën tjetër e keni rritur shpenzimin për qira të automjeteve për rreth 30.000 euro. Kjo kërkon një sqarim të qartë. Nëse e shohim raportin në mënyrë specifike, shihet se në shumicën e kodeve buxhetore mjetet janë realizuar, madje në disa raste 100%, ndërsa punët në terren nuk janë kryer. Për shembull, sa i përket ndërtimit të urës në Lumadh, kanë qenë të planifikuara 30.000 euro dhe, sipas raportit, ato mjete janë shpenzuar. Unë nuk kam informacion se ajo urë është ndërtuar apo se kanë filluar punimet. Po ashtu, edhe për ndërtimin e rrugëve lokale mjetet janë shpenzuar, ndërsa punët në terren, në disa raste, as që kanë filluar.

Prandaj, kjo nuk është çështje për të qeshur, kryetar. Unë e di që po qeshni, por kjo çështje duhet të trajtohet me seriozitet, sepse bëhet fjalë për paranë e qytetarëve. Sa i përket ndërtimit të rrugëve në Gracë, për shembull, janë ndarë 80.000 euro dhe, sipas raportit, këto mjete janë shpenzuar. Mirëpo, unë nuk kam parë që të ketë filluar ndonjë punim në rrugët e Gracës. Po ashtu, për ndërtimin e rrugëve lokale në Studime, Ceceli dhe Samadrexhë janë ndarë 220.000 euro dhe, sipas raportit, janë shpenzuar të gjitha. Por unë nuk e di se ku janë realizuar këto punime, sepse, nga ajo që shohim në terren, ato nuk kanë filluar. Prandaj, është për keqardhje kjo gjendje në të cilën ndodhet Komuna e Vushtrisë.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit-tha se për të mos u përsëritur në vërejtje dhe sugjerime me pyetjet që u ngritën nga kolegët, po ndalem vetëm në disa çështje për të cilat kërkoj sqarim. Po filloj në faqen 4. Në kolonën e gjashtë, te titulli thuhet „Buxheti i planifikuar për vitin 2024“, ndërsa në kolonën e fundit thuhet „Viti i kaluar“ dhe paraqitet shpenzimi i realizuar për periudhën e njëjtë të vitit 2023. Me të vërtetë, po kalojmë nga një vit në tjetrin dhe nuk po kuptojmë qartë se cilat vite po krahasohen. A po flasim për krahasimin e vitit 2026 me vitin 2025, apo bëhet fjalë për krahasimin e tre viteve të fundit? Kërkoj një sqarim të qartë për këtë çështje. Një çështje tjetër është në faqen 5. Në kolonën e gjashtë, te „Buxheti i planifikuar“, thuhet „Plani i reviduar i buxhetit për vitin 2023“, ndërsa bëhet fjalë për buxhetin e mbetur për vitin 2026. Çfarë korrelacioni apo ndërlidhjeje ka në këtë rast? Pse bëhet krahasimi i vitit 2026 me vitin 2023, kur në dokument kemi të bëjmë me planin e reviduar të buxhetit për vitin 2026? Për më tepër, në këtë pjesë vlerat janë zero, prandaj nuk është e qartë se çfarë informacioni synohet të paraqitet me këtë krahasim. Pjesën tjetër të shqetësimeve e ndaj me kolegët dhe nuk do të përsëritem.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-pasi i përshëndeti të pranishmit deklaroi: Drejtoria për Buxhet, Thesar dhe Financa, bazuar në planin e punës, ka hartuar raportin gjashtëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2026. Sa i përket pyetjeve që u parashtuan, po filloj me pyetjen e deputetes Drita Dibrani. Singerisht, për ta kuptuar më mirë raportin, duhet të konsultoheni me njerëz profesionistë të fushës së ekonomisë. Arsyeja është se, meqenëse jeni deputete fillestare, duhet ta dini se kjo është një formë standarde e raportit, e cila është e obligueshme dhe përcaktohet nga Ministria e Financave. Edhe në të kaluarën kemi pasur forma të ndryshme. Ju e dini që ka qenë një lloj „fontane dëshirash“: një deputet kërkonte këtë formë, një tjetër një formë tjetër dhe kështu me radhë. Mirëpo, kjo çështje tashmë është rregulluar në nivel të të gjitha komunave të Kosovës dhe ekziston një formë standarde e raportimit. E kuptoj që për dikë mund të jetë e vështirë për t'u kuptuar, por për profesionistët e fushës së ekonomisë është shumë e qartë. Nga një tabelë e vetme mund të flasim edhe dy orë dhe ta shpjegojmë në detaje. Për informimin tuaj, në përmbledhjen e shpenzimeve sipas burimeve të financimit, buxheti i planifikuar për këtë periudhë ka qenë 20 milionë e 673 mijë e 630 euro, ndërsa buxheti i realizuar është 19 milionë e 947 mijë euro, që në përqindje paraqet rreth 96%. Mund të them se ky është një realizim shumë i mirë për një periudhë relativisht të shkurtër kohore. Sa i përket kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, për të cilën u pyet se pse shpenzimet janë më të mëdha se vitin e kaluar, ju e dini se vitin e kaluar ka pasur mungesë të mjeteve financiare. Shumica e obligimeve të papaguara nga viti 2025 janë bartur në vitin 2026. Pra, si te qiratë, ashtu edhe te kategoritë e tjera, kemi pasur obligime të bartura nga viti 2025, të cilat janë realizuar dhe paguar gjatë vitit 2026. Sa i përket qirasë së automjeteve, edhe këtu kanë qenë obligime të vitit të kaluar. Këtë vit ka skaduar kontrata dhe tash duhet të shohim se si do të veprojmë më tutje. Ndërsa, sa i përket shpenzimeve për udhëtime zyrtare, kjo është një kategori ekonomike e veçantë dhe mjetet e parapara në këtë kategori nuk mund të përdoren për ndarjen e bursave apo për qëllime të tjera. Secila kategori ekonomike e ka destinimin e caktuar me planin buxhetor dhe, në bazë të këtij plani, duhet të bëhet edhe realizimi i shpenzimeve, sipas

kërkesave dhe aprovimit të tyre nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA). Sinqerisht po ju them se të gjitha të dhënat e prezantuara në raport janë të sakta dhe të mbështetura me dëshmi. Sa i përket çështjes së viteve, si dhe vërejtjeve dhe sugjerimeve tuaja, ato i mirëpres. Ne jemi njerëz dhe mund të ketë edhe ndonjë gabim të thjeshtë teknik. Mirëpo, pikërisht për këtë është Kuvendi Komunal: ai është hallka e fundit e kontrollit dhe shqyrtimit, përmes së cilës raportet mund të përmirësohen dhe të finalizohen në mënyrën më të mirë të mundshme.

Drita Dibrani, anëtare e kuvendit-duke ju refruar diskutimit të Drejtorit të Financave deklaroi Drejtor, nuk desha të më jepni këtu leksione se si duhet t'i analizoj linjat buxhetore. Unë kërkoja sqarime konkrete për disa çështje. Sa i përket mirëmbajtjes së objekteve shëndetësore, vitin e kaluar janë shpenzuar 15.000 euro, ndërsa këtë vit, për periudhën gjashtëmuajore, janë shpenzuar vetëm 256,90 euro për mirëmbajtjen e objekteve të kujdesit shëndetësor parësor. Për këtë kërkoja sqarim. Po ashtu, ju kam dërguar edhe email lidhur me mënyrën e paraqitjes së tabelave. Kam kërkuar që të na ofrohet një pasqyrë financiare më e qartë dhe më e lexueshme. Kjo nuk është kërkesë vetëm për mua, por për të gjithë anëtarët e Kuvendit, në mënyrë që raportet të jenë sa më të kuptueshme dhe transparente. Po ashtu, ju bëra një pyetje shumë konkrete lidhur me kontraktimet e tjera, ku janë realizuar rreth 1.9 milion euro. Pyetja ime ishte e qartë: cilët operatorë ekonomikë i kanë përfutur këto mjete? Prandaj, kërkoj përgjigje konkrete për këto çështje dhe jo shpjegime të përgjithshme se si duhet ta lexojmë raportin.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- tha se ne jemi të obliguar që materialin ta dërgojmë përmes Sekretarisë së Kuvendit. Kryesuesja e Kuvendit jua ka përcjellë materialin përmes një emaili zyrtar, të cilin ma keni adresuar më herët, dhe raportin e kam përgatitur në përputhje me kërkesën tuaj. Sa i përket shërbimeve të tjera kontraktuese, në kodin 13460, do t'ju dërgoj në mënyrë të veçantë pasqyrën e të gjitha shpenzimeve. Në tabelë, në përshkrim, paraqitet shuma totale prej 1.905.384 eurosh. Pra, të gjitha shpenzimet e përfshira në këtë shumë do t'ju dërgoj përmes emailit, për informacionin që keni kërkuar. Ndërsa, sa i përket përshkrimit të raportit, kjo tabelë paraqet në mënyrë të përmbledhur shpenzimet, planin buxhetor dhe krahasimin me vitin paraprak. Buxheti është transparent dhe të gjitha shpenzimet mund t'ju vihen në dispozicion. Çdo informacion shtesë që ju intereson mund ta kërkonit dhe ne mund t'ju adresojmë përmes emailit. Formën analitike të shpenzimeve do t'ju dërgojmë secilit prej jush.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës- tha se do të mundohem t'u përgjigjem, sepse u prekën shumë çështje. Shumicën e tyre i shpjegoi drejtori i Buxhetit, përfshirë edhe çështjen e automjeteve me qira, ku sqaroi se bëhet fjalë për obligime të viteve të kaluara dhe se kontrata tashmë ka skaduar. Sa i përket shpenzimeve për naftë, këtë e tha edhe vetë anëtari i Kuvendit si vërejtje. Arsyeja është e thjeshtë: çmimi i naftës është rritur ndjeshëm dhe kjo ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve për karburant. Asgjë tjetër. Sa i përket udhëtimeve jashtë vendit, ato kanë të bëjnë me anëtarët e komisioneve. Edhe ju, kur keni qenë anëtarë të komisioneve, keni pasur raste kur keni udhëtuar, herë në Shqipëri e herë në vende të tjera. Nuk ju kam ndaluar, sepse qëllimi ka qenë puna: të punoni, të hartoni një rregullore të mirë dhe të përmbushni detyrat e komisionit. Edhe anëtarët e tanishëm të Kuvendit dhe të komisioneve nuk paguhën për këtë punë. Prandaj, një lloj motivimi është i nevojshëm. Nuk mendoj se është ndonjë humbje e madhe nëse një anëtar merr mëditje për një angazhim pune. Në fund të fundit, nëse për një aktivitet janë shpenzuar 3.000 euro, ndërsa tash janë shpenzuar 5.000 euro, ajo që na intereson është rezultati i punës. Është përmendur edhe çështja e bursave që po i ndajnë komunat e tjera. Kjo është e vërtetë. Mirëpo, duhet ta shohim edhe situatën dhe mundësitë e secilës komunë. Komuna e Obiliqit, për shembull, ka një ligj të veçantë lidhur me ndotjen e mjedisit dhe përfiton mjete të veçanta nga kjo çështje.

Sa i përket planifikimeve tona, ju e dini në çfarë gjendjeje kanë qenë objektet e banimit të njohura si banesat e bardha. Kush ka shkuar dhe i ka parë ato objekte, e di shumë mirë se në çfarë gjendjeje të mjerë kanë qenë. Ne i kemi orientuar një pjesë të mjeteve nga fundi i subvencioneve, sepse nuk kemi pasur mundësi të tjera, dhe presim që ai projekt të finalizohet. Edhe sa i përket vërshimeve, duhet ta pranojmë një fakt. Kur ka pasur reshje të mëdha, shumë komuna të tjera kanë pasur probleme serioze me vërshimet, duke iu mbushur garazhet me ujë si nga lart, ashtu edhe nga poshtë. Edhe Vushtrria ka pasur reshje të mëdha dhe vërshime. Kur punohet mirë, duhet ta pranojmë dhe ta themi: „Këtu është punuar mirë.“ Nuk duhet që çdo gjë të shihet vetëm nga ana e kritikës. Sa i përket shërbimeve kontraktuese, ju e dini se çdo kontratë është e publikuar në faqen zyrtare të Komunës. Mund t’i shikoni aty se ku janë kryer shërbimet dhe cilat kanë qenë kontratat. Unë nuk mundem tani t’i përmend me radhë të gjitha shërbimet dhe shumën që ka kushtuar secila prej tyre. Raportet janë publike dhe gjithçka është transparente. Për vitin e kaluar, Komuna e Vushtrrisë ka zënë vendin e parë në transparencë, me 100 pikë. Edhe këtë vit synojmë ta ruajmë të njëjtin standard. Për çdo pyetje që keni, ne do të dalim këtu dhe do të japim përgjigje. Ku kemi gabuar, do ta pranojmë se kemi gabuar. Por aty ku punohet, duhet të pranohet se po punohet. U përmendën edhe projektet që kanë mbetur përgjysmë. Po, është e vërtetë se ka projekte të tilla. Mirëpo, duhet ta kuptoni edhe arsyen pse kanë mbetur të papërfunduara. Për shembull, është paraparë të asfaltohej rruga në lagjen e Muhaxherëve në Stanoc të Poshtëm. Ne e kemi zgjeruar atë rrugë, sepse e dini sa e ngushtë ka qenë. Mirëpo, për shkak të mungesës së mjeteve, ato mjete na janë marrë për obligime të tjera. Tash presim që të vazhdojmë me asfaltimin. Edhe kompanitë janë në krizë, sidomos për shkak të rritjes së çmimeve të naftës dhe materialeve të ndërtimit, sepse shtrimi i rrugëve lidhet drejtpërdrejt me çmimin e bitumit dhe materialeve të tjera. Edhe rruga “Dibran Imeri” në Pantinë ka qenë vetëm rreth tre metra e gjerë. Unë vetë kam shkuar dhe kam negociuar me banorët e asaj zone dhe kemi arritur ta zgjerojmë rrugën në mbi pesë metra. Nuk kemi mundur ta shtrojmë ende, por puna është bërë. Edhe rruga Stanoc i Poshtëm–Lumi i Madh, ura në Lumadh dhe projekte të tjera që i përmendët janë çështje reale. Por duhet ta kuptoni se një pjesë e konsiderueshme e mjeteve, rreth 14 milionë euro, na janë marrë për obligime të tjera. Nuk po e them këtë për t’u viktimizuar, sepse nuk kam nevojë të viktimizohem. Po e them për ta bërë situatën transparente para jush dhe para qytetarëve. Por edhe ju, kur bëni kritika, mos u frikësoni. Kritikoni aty ku nuk punohet, por kritikoni edhe institucionet e tjera kur përgjegjësia është e tyre. Për shembull, rruga nga dalja e Nadakocit, e cila prej vitesh është në gjendje të keqe, duhet të trajtohet nga Ministria, nëse është rrugë në kompetencë të saj. Nuk kam dëgjuar që ndonjë anëtar i Kuvendit të ketë dalë dhe ta ketë pyetur Ministrinë se çfarë po bën me atë rrugë, nëse do ta asfaltojë apo nëse do t’ia japë Komunës në menaxhim. Mos u frikësoni të kritikoni edhe institucionet qendrore. Nëse një rrugë është në kompetencë të Ministrisë, kërkonte përgjegjësi edhe prej saj. Për shembull, rruga e Artakollit afër pompes së benzinës të familjes së Strocit, ajo rrugë ka shumë probleme me gropa të mëdha dhe po thuhet është shkarruar tersisht. Edhe aty duhet të kërkohej përgjegjësi nga Ministria përkatëse, sepse rruga është në kompetencën e saj. Në komunën tonë ka shumë rrugë që janë në gjendje të keqe dhe për të cilat duhet të kërkohej zgjidhje. Ne ju japim raport dhe jemi të gatshëm të përgjigjemi për punën tonë, por edhe ju duhet t’ua drejtoni pyetjet institucioneve të tjera kur ato kanë përgjegjësi. Sa i përket rrugëve që janë në marrëveshje me Ministrinë, është e vërtetë se disa prej tyre janë pronë dhe në kompetencë të Ministrisë, por ne kemi nënshkruar marrëveshje dhe kemi marrë përsipër menaxhimin dhe bashkëfinancimin e tyre. Për shembull, rruga e Balincit dhe rruga deri në Dolak janë projekte ku kemi marrë përsipër përgjegjësi konkrete. E keni parë edhe vetë se sa është zgjeruar rruga, në disa segmente deri në 11 metra. Prandaj, kur flasim për këto projekte, duhet të jemi të qartë se kush e ka përgjegjësinë dhe

çfarë marrëveshjesh ekzistojnë ndërmjet Komunës dhe Ministrisë. Nuk është e drejtë që çdo problem i rrugëve t'i faturohet vetëm Komunës. Për shembull, për rrugën nga dalja e Nadakocit deri tek rrethi te Emonës, ka qindra komente nga qytetarët që pyesin pse kryetari po shtron rrugë nëpër fshatra dhe nuk po e shtron atë rrugë. Përgjigjja është se ajo është rrugë në kompetencë të Ministrisë. Nëse Ministria na e jep në menaxhim, ne jemi të gatshëm ta kryejmë punën. Sa i përket rrugës në fshatin Druar, e cila lidhet edhe me projektin e kanalizimit, është bërë një pjesë e punës dhe kanë mbetur edhe disa segmente për t'u përfunduar. Në përgjithësi, për projektet që kanë mbetur pa u përfunduar, duhet ta kemi parasysh edhe çështjen e afateve të kontratave. Kur nuk ka mjete për t'i paguar operatorët ekonomikë, ekzistojnë dy mundësi: ose të ndërpritet kontrata, ose të vazhdohet afati i ekzekutimit të saj. Në shumë raste është dashur të vazhdohet afati, pikërisht për shkak të mungesës së mjeteve për pagesë. Pra, këto janë arsytet që duhet t'i kemi parasysh kur flasim për projektet që janë në proces ose që kanë mbetur të papërfunduara.

Drita Dibrani, anëtare e kuvendit- Kryetari përmendi disa rrugë të cilat po shtrohen. Është mirë që po shtrohen rrugë, kryetar. Por është mirë që, kur i publikoni këto projekte edhe në Facebook, të tregoni qartë se cilat prej tyre janë realizuar në kuadër të marrëveshjeve të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës së Kosovës. Nuk mjafton vetëm një fjali e shkurtër se „po shtrohet kjo rrugë“. Duhet t'i informoni qytetarët se cilat janë burimet e financimit dhe në kuadër të cilit institucion po realizohet projekti. Për shembull, rehabilitimi i rrugës së fshatit Akrahticë–Balincë, rehabilitimi i rrugës nga Ura deri në Llamkoc, projekti i rehabilitimit të rrugës Magjistrale, pastaj rruga Dumnicë e Ultë–Dumnicë e Mesem, si dhe projekti i rehabilitimit të rrugës „Dëshmorët e Kombit“, janë projekte që realizohen në kuadër të marrëveshjeve dhe memorandumeve të bashkëpunimit me Ministrinë e Infrastrukturës. Prandaj, kur flasim për këto projekte, duhet të jemi transparentë edhe për kontributin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Nëse Qeveria ka ndarë fonde, duhet ta bëjmë të ditur se sa mjete janë ndarë nga Qeveria dhe sa janë ndarë nga Komuna. Nëse kjo sqarohet, atëherë nuk kemi asnjë problem. Po flasim për Qeverinë e Republikës së Kosovës, e cila drejtohet nga kryeministri Albin Kurti dhe që është qeveria e të gjithë qytetarëve të Kosovës, përfshirë edhe qytetarët e Vushtrrisë. Prandaj, edhe ju duhet ta përmendni kontributin e Qeverisë së Kosovës dhe t'u tregoni qytetarëve se këto projekte janë realizuar edhe me fondet e shtetit. Nuk është në rregull që në sallën e Kuvendit të krijohet përshtypja sikur të gjitha këto investime janë vetëm rezultat i punës së Komunës. Një çështje tjetër që e përmendët është rruga prej rreth 900 metrash, ku po kërkohet ndërhyrje. A keni bërë kërkesë për këtë çështje? Dhe nëse po publikojë kërkesën.

Betim Grabanica, anëtar i kuvendit-tha se Dëgjova me vëmendje kryetarin. Ne, si anëtarë të Kuvendit, e përfaqësojmë qytetarin e Komunës së Vushtrrisë dhe pa marrë parasysh se cila qeveri është në pushtet, ne duhet të kërkojmë atë që është në interes të qytetarëve tanë. Unë flas në emrin tim, por besoj se ky është edhe shqetësim i përgjithshëm i qytetarëve të Vushtrrisë. Pavarësisht nëse në Qeverinë e Kosovës është Albin Kurti, Lumir Abdixhiku apo dikush tjetër, neve na intereson Komuna e Vushtrrisë dhe interesat e qytetarëve tanë. Sa i përket buxhetit dhe transparencës, është e vërtetë se kryetari deklaroi se ka transparencë maksimale. Por dua të ngre një shqetësim konkret: a është profesionale që Drejtoria e Bujqësisë të mos ketë pasur asnjë projekt të financuar për tre vjet radhazi? Për tri vite, kjo drejtori nuk ka pasur asnjë projekt të veçantë. Unë nuk dua të paragjykoj punën e drejtorit, sepse e njoh dhe e di që është profesionist, ka vullnet dhe dëshirë për të punuar. Pikërisht për këtë arsye mendoj se duhet t'i krijohen mundësi dhe t'i ndahet buxhet për të mbështetur sektorin e bujqësisë. Nëse kemi fermerë që kanë nevojë për mbështetje dhe subvencione, atëherë duhet të ketë mjete të planifikuara për këtë sektor. Nuk është e mjaftueshme që fermerëve t'u premtohet vazhdimisht se do të përkrahen, ndërsa në praktikë

mungojnë projektet dhe mbështetja konkrete. Prandaj, kryetar, kërkoj që Drejtorisë së Bujqësisë t'i krijohen mundësi reale për të punuar dhe për t'i mbështetur fermerët e Komunës së Vushtrrisë.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës- Ajo që kërkon ti dhe ajo që kemi realizuar ne nuk janë e njëjta gjë. Prandaj, dua vetëm ta sqaroj se nuk është çështja „krejt ose hiç“. Për herë të parë, gjatë mandatit tonë është subvencionuar ujitja e tokave në një sipërfaqe prej 1.300 hektarësh. Për herë të parë është subvencionuar edhe qumështi. Po ashtu, kemi mbështetur bletarët dhe kemi subvencionuar 273 sera, nga një ari për secilën. Prandaj, nuk është e drejtë të thuhet se nuk është bërë asgjë për fermerët. Nëse më thua se nuk kemi ndarë traktorë, atëherë ke të drejtë, sepse nuk kemi ndarë traktorë dhe nuk kemi pasur mundësi për një program të tillë. Por të thuhet se nuk kemi bërë asgjë për fermerët, kjo nuk qëndron. Për herë të parë kemi hapur rrugë bujqësore nëpër ara në Dobërllukë, Pestovë dhe në zona të tjera. Në disa prej tyre kemi shtruar zhavorr, në mënyrë që fermerët të kenë qasje më të lehtë në tokat e tyre bujqësore. Për fermerët, këto rrugë kanë qenë shumë të rëndësishme. Prandaj, ajo që më pengon është vlerësimi ekstrem, sikur të jetë bërë „krejt ose hiç“. Nuk është bërë gjithçka dhe e pranoj se ka ende shumë nevojë për mbështetje të bujqësisë. Ka shumë punë për t'u bërë dhe shumë nevoja të fermerëve që duhet të adresohen. Por, nëse thuhet se nuk është bërë asgjë, kjo nuk është korrekte. Vetë fermerët e dinë çfarë kanë përfituar. Dikush ka përfituar serrë, dikush mbështetje për ujitjen e tokave, ndërsa dikujt i janë hapur dhe rregulluar rrugët bujqësore. Prandaj, duhet të jemi më korrektë në vlerësimet dhe në kritikën tona. Kritika është e mirë dhe e nevojshme, por duhet të bazohet në atë që është bërë dhe në atë që nuk është bërë. Në fund të fundit, ne kemi synuar të krijojmë njëfarë balance dhe të bëjmë atë që kemi mundur, në harmoni me mundësitë dhe buxhetin e komunës.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 14 vota “për”, 8 vota “kundër”, 4 vota “abstenim” aprovoi Raportin gjashtëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2026.

4. Pasqyrat financiare për vitin 2025 dhe raporti i auditorit të përgjithshëm.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit- Fillimisht, njoftoi se ka ardhur një email nga Instituti GAP, ku thuhet se prej këtij muaji do të monitorohet puna e Kuvendit Komunal. A është komuna e njoftuar për këtë? Në lidhje me raportin, nuk e di çfarë ka ndodhur, por në vend që të avancojmë me standardet e raportimit, kemi një situatë që duhet ta marrim seriozisht. Ajo që është shqetësuese, veçanërisht për kuvendarët e rinj që mund të mos e kuptojnë plotësisht këtë çështje, është fakti se raporti është i kualifikuar. Kur një raport i auditimit është i kualifikuar, kjo nënkupton se auditori ka evidentuar të gjetura dhe çështje që kërkojnë vëmendje. Ndërsa, kur raporti nuk është i kualifikuar, atëherë nënkuptohet se komuna është në një situatë më të rregullt sa i përket pasqyrave financiare. Në faqen e katërt janë paraqitur bazat mbi të cilat është kualifikuar ky raport. Janë evidentuar katër çështje. Veçanërisht dua të ndalem te çështja e parë, ku thuhet se raportimi mbi detyrimet kontingjente, i shpalosur në pasqyrat vjetore financiare, ishte mbivlerësuar me 1,568,004 euro. E kuptoj që një pjesë e kësaj situate lidhet me rastet e mësimdhënësve që kanë përfituar, përmes kontratës kolektive, të drejtat që u takojnë. Mirëpo, përveç çështjeve të tjera që nuk po dua t'i lexoj një nga një, pasi raportin e keni të gjithë para vetes, veçanërisht shqetësuese është vlera prej 687,855 eurosh, e cila, në kuadër të kësaj çështjeje, është paguar për interesa, tarifa të kësaj natyre dhe shpenzime gjyqësore. Me të vërtetë, kjo është shqetësuese. Kryetar, përgjegjësia, edhe në bazë të raportit të auditimit, por edhe në bazë të kompetencave që i keni si kryetar i komunës, është e juaja që këto çështje t'i shqyrtoni, t'i adresoni dhe t'i merrni seriozisht këto vërejtje që sot

i keni në tavolinë përmes një raporti të pavarur. Nuk po dua të përsëritem duke e lexuar pikën e pestë, e cila paraqet bazën e këtyre konkluzioneve, dhe t'i numëroj të gjitha me radhë, sepse janë shumë tekstuale. Por dua të ndalem te pjesa që përcakton përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të organeve drejtuese të qeverisë për pasqyrat financiare. Aty theksohet se kryetari i komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare pa keqdeklarime materiale, të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo nga gabimi. Kjo përgjegjësi nënkupton edhe përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Rregullorja për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore. Prandaj, konsideroj se këto të gjetura duhet të merren shumë seriozisht dhe të ndërmerren masat e nevojshme për adresimin e tyre.

Drita Dibrani, anëtare e kuvendit- tha se do të flas në emër të grupit, kështu që uroj të mos më ndërprisni gjatë diskutimit. Të nderuar kolegë kuvendarë, Sot, para nesh, nuk kemi thjesht një përmbledhje shifrash apo një dokument rutinor burokratik. Sot, mbi tavolinë kemi një pasqyrë më të saktë, më të pamëshirshme dhe më zyrtare të punës së kësaj qeverisjeje komunale. Bëhet fjalë për raportin zyrtar të auditimit. Për të disatin vit me radhë, nga kjo foltore kemi dëgjuar premtime me ngjyra, reklama në rrjete sociale, inaugurime dhe prerje shiritash. Por, kur bie perdja, flet Auditori i Përgjithshëm dhe e vërteta del në shesh. Ky raport tregon se kjo qeverisje ka dështuar në menaxhim, ka shkaktuar probleme financiare dhe ka treguar papërgjegjshmëri ndaj parasë publike. Dhe këtu le të flasim me fakte, drejtpërdrejt nga raporti. Së pari, investimet kapitale dhe projektet e bllokuara. Auditori ka konfirmuar zyrtarisht se tetë projekte kryesore kapitale nuk kanë përfunduar brenda afateve të përcaktuara ligjore dhe kontraktuale. Bulevardi „Adem Jashari“ dhe parkingu nëntokësor – një projekt me vlerë prej 2.7 milionë eurosh, i cili është dashur të përfundojë në dhjetor të vitit 2025, por edhe sot vazhdon të jetë një kantier i hapur. Madje, ende po vendosen pllaka dhe çdo ditë shohim punime të reja, ndërhyrje dhe prishje. Në raport përmendet edhe Tregu i Gjelbër për prodhuesit tanë vendorë, me vlerë prej 1.1 milion eurosh, i cili është dashur të përfundojë në tetor të vitit 2025, por vazhdon të mbetet i papërfunduar. Ndërtimi i shkollës fillore „Mustafë Venhari“, një projekt me vlerë mbi 1 milion euro, ende nuk ka përfunduar. Ndërsa rruga „Bekim Berisha – Abeja“, rruga „Lumni Surdulli“ është dashur të përfundojë në tetor të vitit 2024. Pra, kemi rreth dy vite vonesë për projekte infrastrukturore që qytetarët i paguajnë nga xhepi i tyre. Së dyti, menaxhimi i kontratave. Problemi i tejkalimit të afateve është vetëm ana vizuale e problemit. Ajo që zbulojmë në raport, në kapitullin për menaxhimin e kontratave, shkon përtej paaftësisë në realizimin e projekteve. Flasim për pagesa të pranuar për punë për të cilat auditori ka konstatuar se nuk janë realizuar në terren. A e dini se në projektin e rrugës “2 Maji” është faturuar dhe është pranuar pagesa prej 14 mijë eurosh për zyrat në vendpunishte? Por, kur auditori doli fizikisht në terren, nuk u gjet asnjë zyrë e vetme. Ku shkuan ato 14 mijë euro? Te shkolla „Mustafë Venhari“ janë pranuar si të përfunduara punimet për mbjelljen e barit dhe drurëve dekorativë, në vlerë prej 2,600 eurosh, të cilat nuk janë realizuar në terren. Në Tregun e Gjelbër janë pranuar punime në vlerë prej 3,900 eurosh, edhe pse ato nuk ishin përfunduar fare. Kjo nuk është më thjesht çështje pakujdesie. Kjo është dështim i kontrollit institucional dhe nënshkrim i faturave pa u verifikuar nëse puna është kryer apo jo. Unë nuk e kuptoj se si mund të nënshkruhet një faturë dhe të pranohet një punë e pakryer. Së treti, çështja e financave dhe borxheve. Në fund të vitit, komuna ka bartur 45 fatura të papaguara, me një vlerë alarmante prej mbi 2.36 milionë eurosh. Vonesat në pagesat ndaj operatorëve ekonomikë variojnë nga një deri në tetë muaj. E dini çfarë do të thotë kjo për buxhetin e Vushtrrisë, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal? Do të thotë se nesër kjo komunë mund të përballet me padi gjyqësore, me procedura përmbarimore dhe me kamata ndëshkuese, duke dëmtuar paranë publike për shkak të vonesave të pushtetit. Ndërkohë

që komuna vonon pagesat për punët e kryera, nga ana tjetër tregon një tolerancë të çuditshme ndaj qiramarrësve të pronave publike. Një prej lokaleve që e kam përmendur disa herë në seancat e kaluara, në rrugën „Dëshmorët e Kombit“, ka grumbulluar mbi 30 mijë euro borxh ndaj komunës, pa u shqetësuar nga askush. Edhe toka bujqësore në Gracë ka krijuar borxh mbi 22 mijë euro. Dhe sa e sa prona të tjera janë ku qiratë nuk mblidhen fare? Unë nuk mund ta kuptoj se si ka ndodhur kjo. Apo ndoshta ka qenë vit zgjedhor dhe nuk i ka konvencuar kryetarit të komunës dhe kësaj qeverisjeje që t’i adresojnë këto borxhe? Mbi të gjitha, sipas Ligjit për Tatimin në Pronë, komuna ishte e detyruar të bënte verifikimin e të paktën 20 për qind të pronave. Çfarë ka bërë kjo qeverisje gjatë vitit 2025, kryetar? Siç e thashë edhe më herët, ishte vit zgjedhor. Shkuat në zgjedhje dhe ndoshta nuk deshët t’i evidentoni këto borxhe, që të mos i mbetej hatri askujt. Zero verifikim. Asnjë kontroll i vetëm. Dhe kjo ka dëmtuar drejtpërdrejt të hyrat vetanake të komunës sonë. Ndërsa sot del kryetari dhe thotë: „Nuk kemi buxhet.“ Të nderuar kolegë, Të mbyllësh sytë para këtij raporti do të thotë të bëhesh bashkëpërgjegjës për këtë keqmenaxhim. Ky raport vërteton se komuna nuk po udhëhiqet me plane, me llogaridhënie dhe me përkushtim të mjaftueshëm ndaj qytetarëve. Si anëtare e këtij Kuvendi, si anëtare e opozitës, kërkoj nga kryetari i komunës dhe nga ekzekutivi që të dalin sot këtu dhe të japin përgjegjësi publike. Pse janë pranuar faturat për punë që nuk janë kryer kurrë në terren? Kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe duhet të marrë përgjigje. Si mund të pranohet një punë e pakryer, të faturohet dhe të paguhet sikur të ishte kryer? Kush do të mbajë përgjegjësi financiare për vonesat që po dërgojnë miliona euro në procedura gjyqësore dhe përmbarimore? Duhet ta dimë edhe këtë pjesë, sepse nuk është në rregull që qytetarët të paguajnë pasojat e keqmenaxhimit. Dhe, së fundi, kur do të përfundojnë projektet që kanë bllokuar jetën e bizneseve dhe të qytetarëve të Vushtrrisë? Qytetarët e Vushtrrisë meritojnë projekte të përfunduara, menaxhim të përgjegjshëm dhe llogaridhënie për çdo euro të parasë publike.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-në adresimin e tij para kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë deklaroi: Ajo që po na bie në sy është se, në momentin që kuvendarët kritikojnë më rëndë, po e përjeton kryesuesja sesa kryetari. Kryetari, në njëfarë mënyre, po duket më i relaksuar. Pra, duhet të pajtoheni me një gjë: ne vetëm po ju tregojmë juve dhe qytetarëve se çfarë ka gjetur raporti i auditimit. Nuk jemi ne ata që i kemi gjetur këto të meta; është raporti i auditimit, i cili është një dokument zyrtar dhe i pranueshëm për të gjithë Kosovën. Ajo që bie në sy në këtë raport është se opinionin e auditimit është i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore të komunës. Çfarë do të thotë kjo? Opinioni i kualifikuar formulohet kur janë zbuluar keqdeklarime ose mospajtueshmëri, qoftë një e vetme apo një grumbull i tyre, që janë të barabarta me ose tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi. Po ashtu, opinionin mund të jetë i kualifikuar kur keqdeklarimi ose mospajtueshmëria brenda një klase të caktuar transaksionesh është e barabartë me ose tejkalon nivelin më të ulët të materialitetit të vendosur për atë klasë transaksionesh. Pra, Komuna e Vushtrrisë, edhe këtë vit, për të pestin vit me radhë, e ka opinionin e auditimit të kualifikuar. Shumëçka është thënë tashmë nga ky raport. Unë vetëm dua t’i përmbledh dy-tri pika, të cilat i kam konsideruar të rëndësishme dhe të nevojshme për t’i theksuar. Së pari, në regjistrin e llogarive të arkëtueshme të tatimit në pronë është ngarkuar me tatim në pronë një parcelë publike, e cila është pronë e Komunës së Vushtrrisë. Pra, duke vlerësuar llogaritë e arkëtueshme në vlerë prej 26,231 eurosh, sipas faqes 11 të raportit, komuna e ka ngarkuar me tatim në pronë vetveten. Kjo ka ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontroleve të brendshme në mirëmbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme. Sinqerisht, kjo është për keqardhje. Një e gjetur tjetër ka të bëjë me procedurën e rekrutimit. Komuna e Vushtrrisë ka zhvilluar një procedurë rekrutimi dhe ka lidhur kontratë pune me afat të caktuar me një mësimdhënëse, me

qëllim zëvendësimin e përkohshëm të një mësimdhënëseje që ishte në pushim të lehonisë. Me kthimin e mësimdhënëses së rregullt në vendin e saj të punës, e drejta e kontratës me afat të caktuar ka pushuar. Megjithatë, mësimdhënësjë e angazhuar me kontratë me afat të caktuar është transferuar në një shkollë tjetër për të zëvendësuar një mësimdhënëse tjetër, pa u zhvilluar një procedurë e re rekrutimi. Kjo ka ndodhur si pasojë e mosrespektimit të kufizimeve ligjore për përdorimin e kontratave me afat të caktuar vetëm për qëllimin për të cilin janë shpallur, si dhe për shkak të mungesës së inicimit të një procedure të re të rekrutimit për pozitën e krijuar rishtazi, duke vazhduar angazhimin jashtë kornizës fillestare të kontratës. Një e gjetur tjetër lidhet me kontratën për ndërtimin e rrugës „2 Maji“, me infrastrukturë përcjellëse. Në pozicionin 1.1, për punët përgatitore për fillimin e punimeve, mobilizimin e punishtes me zyrë, shenjat e nevojshme të sigurisë dhe paralajmërimet në vendpunishte, ishte paraparë një vlerë prej 14,000 eurosh. Sipas situacionit të punimeve, bëhej fjalë për katër zyra në vendpunishte. Mirëpo, gjatë verifikimit në terren është konstatuar se nuk është gjetur asnjë zyrë e vendosur në vendpunishte. Nga dëshmitë e siguruar rezultoi se, edhe në fazat fillestare, kishte qenë e vendosur vetëm një zyrë, e cila më pas ishte larguar. Edhe te kontrata për ndërtimin e shkollës fillore „Mustafë Venhari“ janë evidentuar të gjetura. Nga inspektimi i punimeve është identifikuar se pozicionet 14.6, 14.7 dhe 14.8, që kanë të bëjnë me punimet dhe mbjelljen e barit dhe drurëve dekorativë në kopsht, në vlerë prej 2,600 eurosh, nuk ishin realizuar, por ishin pranuar si të përfunduara përmes situacioneve të punimeve. Po ashtu, në kontratën për ndërtimin e Tregut të Gjellbër për prodhuesit vendorë, nga inspektimi i punimeve është identifikuar se pozicioni 13.3, që kishte të bënte me furnizimin dhe mbështjelljen e ballkoneve të shkallëve dhe pushimoreve me pllaka mermeri, në vlerë prej 3,900 eurosh, ishte i papërfunduar, por ishte pranuar si i përfunduar në situacionin e punimeve. Gjithashtu, nga auditimi i projekteve kapitale është identifikuar se, në katër kontrata të tjera, sigurimet e ekzekutimit nuk ishin vazhduar, edhe pse projektet kapitale nuk ishin finalizuar sipas afateve të përcaktuara në kontrata. Ndërsa, në gjashtë raste të tjera, kontratave nuk u ishin sjellë garancionet e cilësisë së punimeve pas përfundimit të punimeve. Këto dhe shumë të gjetura të tjera janë pjesë e raportit të auditimit, për të cilat ju, si qeverisje komunale, dhe ju, kryetar i komunës, së bashku me drejtorët e drejtorive përkatëse, duhet të angazhoheni seriozisht për t'i adresuar dhe përmirësuar.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit- thas se tek raporti i auditorit keni çfarë të themi shumë. Besoj që shumica prej jush e keni parë dhe i keni identifikuar të gjeturat. Është për keqardhje që ky është viti i katërt me radhë që raporti i auditorit vjen i kualifikuar. Jo vetëm për shkak të kontratës kolektive, e cila po i rëndon buxhetit të komunës, por ka edhe të gjetura të tjera që ndikojnë që raporti të jetë i kualifikuar. Kryetar, u fol shumë nga parafolësit për vonesat e projekteve dhe për vonesat e pagesave. Unë desha të ndalem te disa çështje të tjera. Në njërin prej tyre thuhet se nuk i keni përcaktuar qartë specifikat teknike në projekte. Unë nuk po pajtohem me këtë të gjetur të auditorit, për shkak se ne po e shohim qartë që ju po vendosni specifika, madje po vendosni specifika aq të detajuara, sa që po i diskualifikoni pothuajse të gjithë operatorët në Vushtrri dhe rrethinë dhe po shkoni të kërkonit operatorë që i kanë makineritë e nevojshme për të punuar në detaje të caktuara. Këtu nuk po pajtohem me të gjeturën e auditorit, sepse mendoj se problemi është i kundërt. Sërish duhet të kthehemi te çështja e rregullimit të lumit Silica, sepse aty e dini edhe ju se çfarë specifikash keni vendosur. Keni kërkuar kamionë, bagera dhe makineri të tjera, me kërkesa shumë specifike, të cilat kanë ndikuar në konkurrencën ndërmjet operatorëve. Çështja tjetër, kryetar, është mangësia në procesin e subvencionimit për renovimin e banesave kolektive. Edhe këtu auditori ju ka evidentuar mangësi dhe ka konstatuar se ekziston rreziku për shpenzime të cilat, në bazë ligjore, mund të mos mund të realizohen. Kjo ka ndodhur për shkak të paqartësisë në përcaktimin e klasifikimit buxhetor. Kryetar, kjo kontratë e punimeve për

rregullimin, renovimin, izolimin, fasadimin e çative dhe bodrumeve të banesave kolektive është dashur fillimisht të sillet në Kuvend dhe të votohet nga ne, si anëtarë të asamblesë. Kontrata është lidhur me ndërmarrjen publike lokale „Përparimi“ dhe me palë të tjera. Pse nuk na ka ardhur kjo kontratë në Kuvend për ta votuar? Do të duhej ta shihnim kontratën dhe, më pas, të vazhdohej me procedurat e tjera. Edhe këtu keni dështuar. Punimet nuk janë rregulluar siç duhet; ndoshta edhe ju e keni pranuar këtë, ndërsa disa projekte kanë mbetur ende pa përfunduar. Për më tepër, auditori ka evidentuar edhe vërejtje lidhur me marrëveshjen e lidhur për këtë projekt. Diçka tjetër ku mendoj se është problemi: a nuk keni staf të mjaftueshëm për të dalë në terren dhe për t'i inkasuar këto të hyra? Kemi qiramarrës, operatorë ekonomikë dhe persona të tjerë që kanë obligime ndaj komunës. Kemi borxhe prej 30 mijë, 50 mijë, 5 mijë eurosh e të tjera. Mendoj se, nëse komuna, konkretisht drejtoria përgjegjëse, do t'i inkasonte këto borxhe, këto mjete financiare do të mund të përdreshin për nevoja të tjera të komunës. Pastaj, në faqen 20, kemi edhe çështjen e mosvlerësimit të performancës. Sipas rregullave të prokurimit publik, çdo menaxher i kontratës duhet t'i vlerësojë punët dhe kontraktuesin me të cilin komuna ka lidhur kontratë. Auditori ka gjetur se nuk i keni vlerësuar menaxherët e kontratave dhe se menaxherët e kontratave nuk i kanë vlerësuar kontraktuesit. Kjo mund të ndikojë që, edhe në rast se një operator ka dështuar në realizimin e një kontrate, ai operator të mund të fitojë përsëri një projekt tjetër, pikërisht për shkak se nuk është bërë vlerësimi i performancës së tij. Domethënë, nuk ka pasur fare vlerësim të performancës. Një tjetër e gjetur, të cilën e përmendi edhe parafolësi, është se komuna ka arritur deri në atë pikë sa t'i evidentojë pronat e veta si obligime tatimore, pra t'i ngarkojë me tatim pronat që janë vetë pronë e komunës. Kemi gjithashtu mangësi në procesin e subvencionimit, mangësi në të gjitha kategoritë. Pra, kemi të gjetura të shumta dhe, për fat të keq, përsëri kemi një raport të kualifikuar.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- tha se më erdhi ndërmend edhe një çështje që dua ta theksoj. Ky është viti i pestë që kryetari është në detyrë dhe, përveç një projekti, vështirë se mund të përmendim ndonjë punë tjetër të përfunduar. Edhe atë projekt e ka vonuar rreth 30 muaj, duke i lënë qytetarët pa ujë për një kohë të gjatë dhe, në fund, duke e paraqitur si të vetmen punë të përfunduar gjatë mandatit. Kolegët i përmendën të gjitha të gjeturat kryesore të raportit të auditorit. Por problemi është se, përderisa ne këtu diskutojmë, këto çështje vazhdojnë të përsëriten. Prandaj, përderisa raporti i auditorit nuk shqyrtohet nga Prokuroria e Shtetit dhe nuk hetohen rastet për të cilat, përveç shkeljeve procedurale, mund të ketë edhe shkelje ligjore, ne këtu vetëm mund të flasim. Për këtë arsye, i bëj thirrje Prokurorisë që t'i shqyrtojë të gjitha rastet e evidentuara në raportin e auditorit, veçanërisht ato për të cilat ekzistojnë dyshime për shkelje të ligjit. Aty ku nuk ka shkelje, le të konstatohet kjo, ndërsa aty ku ka shkelje, të ndërmerren masat e nevojshme ligjore. Ne e dimë se edhe më herët janë dërguar raste në Prokurori, përfshirë rastin e një procesi të votimit për një pozitë dhe rastin kur një kandidateje për mësimdhënëse dyshohet se i është dhënë testi i plotësuar. Megjithatë, për këto raste nuk kemi parë ndonjë epilog të qartë. Prandaj, ajo që kërkoj është e thjeshtë: çdo rast ku ka dyshime për shkelje ligjore duhet të shqyrtohet nga organet kompetente dhe të marrë epilog në përputhje me ligjin.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- Kjo është një informatë që as nuk votohet, as nuk përmirësohet dhe as nuk ndryshohet, sepse fjalën përfundimtare e ka dhënë Auditori i Përgjithshëm. Për ta kuptuar drejt këtë raport, duhet pasur parasysh terminologjia e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik. Terminologjia e përdorur në këto standarde dallon nga kuptimi që mund t'u japim këtyre termave në gjuhën e përditshme. Sipas auditorit, pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrrisë paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik. Tani, sa u përket të gjeturave, raporti përmban 17 rekomandime, për të cilat ne duhet të japim komentet

tona në muajin shtator dhe të tregojmë se cilat janë realizuar dhe cilat janë ende në proces. Qëllimi ynë duhet të jetë që këto rekomandime t'i adresojmë gjatë këtij viti dhe të arrijmë opinionin e pakualifikuar, sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik. Në këtë rast, një nga çështjet kryesore që ka ndikuar në opinionin e auditimit është kodi ekonomik 004, që lidhet me vendimet gjyqësore dhe përmbartimore. Prandaj, duhet të fokusohemi në zbatimin e rekomandimeve të auditorit, në mënyrë që në raportin e ardhshëm të kemi një përmirësim të dukshëm dhe, nëse plotësohen të gjitha kërkesat, të arrijmë opinionin e pakualifikuar.

5. Informatë lidhur me mbrojtjen e mjedisit janar-qershor 2026.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- tha se sa i përket informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit për periudhën janar-qershor 2026, mund të themi se mbrojtja e mjedisit duhet të bëhet përmes veprimeve të përditshme nga institucionet komunale, individët dhe komuniteti. Pra, mbrojtja e mjedisit është përgjegjësi e të gjithëve. Duke u kujdesur për natyrën, ne mbrojmë shëndetin tonë dhe sigurojmë një mjedis më të pastër për ne dhe për brezat e ardhshëm. Një nga hapat e parë është përcaktimi konkret i problemeve kryesore me të cilat përballlet komuna jonë. Vushtrria përballlet me sfida të mëdha mjedisore, të cilat ndikojnë në mirëqenien e njerëzve dhe në qëndrueshmërinë e burimeve natyrore. Vushtrria ka disa lumenj, të cilët përbëjnë një nga pasuritë më të rëndësishme natyrore të komunës. Pikërisht për këtë arsye, menaxhimi dhe mbrojtja e tyre duhet të jetë një prioritet i përhershëm i komunës sonë. Lumenjtë dhe shtretërit e tyre janë thelbësorë jo vetëm për ruajtjen e biodiversitetit, por edhe për zhvillimin e qëndrueshëm dhe cilësinë e jetës së qytetarëve. Çdo ndërtim pa leje, përdorim i pakontrolluar apo ndërhyrje e paautorizuar në këto zona rrit rrezikun e ndotjes së ujit dhe cenon ekuilibrat ekologjikë. Ndotja e ajrit, tokës dhe ujit nga aktivitetet bujqësore dhe industriale, por edhe nga pakujdesia e qytetarëve, ka ndikuar në përkeqësimin e gjendjes së përgjithshme mjedisore. Ndotja e ajrit është kthyer në një problem serioz. Shkarkimi i gazrave ndotës nga komunikacioni ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e ajrit dhe në shëndetin e qytetarëve, duke rritur rrezikun e sëmundjeve të ndryshme. Ndotja e ujit është gjithashtu një sfidë serioze. Burimet ujore, përfshirë lumenjtë, janë të ndotura nga faktorë të ndryshëm. Lumenjtë si Llapi dhe Sitnica ndoten nga ujërat e zeza, aktivitetet industriale, mbeturinat e ngurta dhe mbeturinat e amvisërisë. Kjo paraqet një problem serioz, veçanërisht për faktin se uji i këtyre lumenjve përdoret edhe për ujtime në bujqësi. Shkatërrimi i pyjeve është një tjetër problem mjedisor në komunën e Vushtrrisë. Dëmtimi dhe shkatërrimi i pyjeve kanë pasoja negative në ekonomi, në turizmin natyror dhe në prodhimin e ushqimit nga burimet natyrore. Ndërsa zgjerimi i vendbanimeve në toka bujqësore dhe në zona industriale ndikon në degradimin e peizazhit rural. Komuna e Vushtrrisë, në një afat sa më të shkurtër, duhet të ndërmarrë hapa konkretë për përmirësimin e gjendjes mjedisore. Duhet të hartojë Planin Zhvillimor Lokal, Hartën Zonale Komunale dhe Planin Lokal të Veprimit në Mjedis. Gjithashtu, duhet të formohen ekoklube ose klube të gjelbra në të gjitha shkollat e mesme të ulëta dhe të mesme të larta, si dhe të zgjerohen sipërfaqet e gjelbra si në qytet, ashtu edhe në fshatra. Komuna duhet të investojë në impiante për trajtimin e ujërave të zeza dhe në sistemet e riciklimit të mbeturinave. Po ashtu, duhet të investojë më shumë në infrastrukturë të qëndrueshme, edukim mjedisor dhe teknologji të pastra. Është e nevojshme të vendosen pajisje për matjen e cilësisë së ajrit dhe të largohen të gjitha deponitë ilegale që gjenden në territorin e komunës sonë. Në fund, është i domosdoshëm edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut, si dhe mbështetja e organizatave dhe komunitetit rinor që punojnë për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit. Mbrojtja e mjedisit nuk mund të jetë vetëm një pikë në një raport

apo një aktivitet i herëpashershëm. Ajo duhet të jetë pjesë e politikave dhe e veprimeve të përditshme të komunës.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-pasi i përshëndeti të pranishmit vijoj: Kështu, kolegu e tha shumë qartë dhe i theksoi të gjitha ato që duhej të përmendeshin. Unë po e them pak më shkurt dhe në mënyrë më të rrumbullaksuar. Mjedisi është shëndet, ndërsa shëndeti është jetë. Me të vërtetë, ne kemi dalë nga sistemi i vlerave dhe i përgjegjësisë ndaj mjedisit. Jemi bërë shumë të pakujdesshëm. Po ju marr vetëm një shembull: të gjithë po përpiqemi të uzurpojmë çfarëdo që mundemi, të ndërtojmë, të prishim, të presim pyjet dhe të marrim tokat. Thjesht dua të them, kryetar, se qasja jonë ndaj mjedisit është katastrofale. Këtë duhet ta pranojmë dhe duhet të marrim masa urgjente si shoqëri. Qoftë si individë, qoftë si shoqëri në tërësi, duhet t'i kushtojmë një trajtim dhe vëmendje shumë më të madhe mjedisit në të cilin jetojmë. Nga kjo varet sa do të kemi mundësi të jetojmë mirë dhe sa do të kemi zhvillim në të gjitha aspektet e tjera. Për fat të keq, shpesh jemi të fokusuar vetëm te aspekti material: sa mund të marrim, sa mund të ndërtojmë, sa mund të shfrytëzojmë dhe sa mund të përfitojmë. Kjo qasje duhet të ndryshojë.

6. Raport i veçantë mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarret për periudhën 2023 – qershor 2026.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-sqaroi që, për t'i kompensuar këto dëme, ky raport aprovohet në Kuvend. Meqenëse nuk kemi diskutime, vetëm dua t'ju jap një sqarim që sapo më erdhi nga drejtoria. Shuma e përgjithshme e dëmeve e cila në raport është llogaritur rreth 237,000 euro, sipas sqarimit të fundit është 236,166.43 €. Pra, shuma e saktë është **236,166.43 €**, që është më e vogël se shuma e paraqitur në raport.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendi të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet raporti i Komisionit Komunal lidhur me Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera në Komunën e Vushtrisë, për periudhën 2023 - qershor 2026.

2. Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, ka dalë në terren dhe ka bërë evidentimin e dëmeve të shkuara nga moti i ligë (erërat e forta, breshëri dhe zjarret), që kanë mbretëruar në periudhën e lartëcekur, në Komunën e Vushtrisë.

3. Komisioni i cekur më lartë, ka bërë vlerësimin e dëmeve nga zjarret për periudhën kohore janar 2023 – qershor 2026, ka shqyrtuar kërkesat e qytetarëve dhe konform të gjeturave ka evidentuar dhe kalkuluar shumat e mjeteve financiare të dëmeve në vlerë totale prej **236,166.43 € (dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro e katërdhjetë e tre centë)**, dëme këto të shkuara në objekte private (shtëpi banimi), shtalla, punëtori, shupa, në ekonomi familjare dhe në bujqësi të cilat janë evidentuar dhe verifikuar nga komisioni profesional e të cilat janë të bashkangjitura në mënyrë tabelare në raport.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, në Komunën e Vushtrisë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Vushtrrisë, dhe po ashtu ky vendim i dërgohet edhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME).

6. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Propozim-vendim paraparak, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale.

Rahim Ajeti, anëtar i kuvendit- i nderuar kryetar, të nderuar kolegë, mendoj se këto dy vendime duhet të shtyhen, për shkak se janë përgatitur pa u respektuar të gjitha procedurat e nevojshme. Në pikën e dytë të këtij vendimi thuhet se për dhënien në shfrytëzim do të vendosë komisioni. Mirëpo, ne nuk e kemi të formuar këtë komision dhe mendoj se, në këtë formë, vendimi mund të kthehet nga ministria. Prandaj, kërkoj që këto pika të shtyhen për seancën e radhës dhe të plotësohen të gjitha procedurat e nevojshme. Nëse e votojmë sot vendimin pa e pasur komisionin përkatës, ekziston mundësia që ministria ta kthejë vendimin si të paligjshëm. Kemi pasur edhe më herët raste kur disa vendime janë kthyer për shkak të mangësive procedurale. Prandaj, është më mirë që ta rregullojmë këtë çështje tani, sesa ta votojmë një vendim që më pas mund të kthehet.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-e di që këtë vendim e merr Kuvendi për dhënien në shfrytëzim të pronës, por dua të kuptoj më qartë arsyen e propozimit. Meqë propozuesi jeni ju, kryetar, dua të di çfarë ju ka shtyrë që këtë pronë ta nxirrni në ankand dhe jo të ndiqni procedura të tjera, siç ka ndodhur me disa prona të tjera që kanë mbetur pezull. E dini edhe ju se ka rreth dy vjet që disa kompani serioze kanë shprehur interes për të shfrytëzuar prona komunale dhe për të investuar në Komunën e Vushtrrisë. Natyrisht, ka pasur edhe raste kur kompani apo individë kanë tentuar t'i shfrytëzojnë pronat në mënyrë jo të rregullt, por në mesin e tyre ka pasur edhe kompani serioze, të cilat kanë dashur të investojnë, të rrisin numrin e të punësuarve dhe të kontribuojnë në rritjen e të hyrave të komunës. Megjithatë, disa prej këtyre rasteve kanë mbetur pezull, ndonëse procedurat kanë qenë të qarta. Tani, nga ana juaj kemi një propozim që kjo pronë të jepet në shfrytëzim përmes ankandit. Sa i përket kësaj çështjeje, për fat të mirë, kam edhe përvojë personale, pasi në vitin 2018 kam qenë pjesë e një komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës të Ura e Gurit, përmes ankandit. Kam qenë pjesë e komisionit nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje. Po flas nga përvoja. Në atë kohë kam qenë relativisht e re dhe kam besuar se gjithçka po zhvillohej në mënyrë të rregullt. Në ankand kanë marrë pjesë tre ose katër ofertues, të cilët kanë dhënë ofertat e tyre. Ne ia kemi dhënë pronën ofertuesit që kishte bërë ofertën më të mirë dhe kemi menduar se procedura kishte përfunduar në mënyrë të rregullt. Mirëpo, rreth një vit më vonë, derisa po pija kafe në një lokal në Vushtri, i pashë të katër ofertuesit duke pirë kafe bashkë. Kjo më krijoi bindjen se procesi mund të kishte qenë i orkestruar paraparakisht. Prandaj, nuk po them se domosdoshmërisht e njëjta gjë do të ndodhë edhe me këtë pronë, por kjo përvojë më bën të jem shumë e kujdesshme. Për këtë arsye, personalisht nuk e përkrah dhe nuk do ta votoj këtë propozim. Megjithatë, ajo që dua të di nga propozuesi është: pse është zgjedhur pikërisht procedura e ankandit për këtë pronë, ndërkohë që disa prona të tjera, për të cilat ka pasur interesim dhe procedura të qarta, kanë mbetur pezull? Gjithashtu, duke qenë se bëhet fjalë për një pronë në një pozitë të rëndësishme, dua të di se për çfarë qëllimi planifikohet të jepet në shfrytëzim. Çfarë aktiviteti pritet të zhvillohet aty? Sepse mund të ndodhë që në ankand të paraqiten disa ofertues dhe dikush të japë një ofertë shumë të mirë

financiare, por ne duhet të shohim edhe interesin e komunës dhe të qytetarëve në aspektin afatgjatë. Nuk duhet të fokusohemi vetëm te oferta më e lartë, por edhe te ajo se çfarë investimi dhe çfarë përfitimi do të sjellë ajo pronë për Komunën e Vushtrrisë. Prandaj, kryetar, kërkoj një sqarim konkret: çfarë ju ka shtyrë ta propozoni këtë pronë për dhënie në shfrytëzim përmes ankandit dhe për çfarë qëllimi planifikohet të shfrytëzohet?

Ferit Idrizi, kryetar i komunës- tha se problemi është vetëm në terminologji. Është e njëjta procedurë që është ndjekur edhe me pronat e tjera. Nuk ka asnjë dallim. Nëse vendimi merret sot, ai do të dërgohet në MAPL për shqyrtimin e ligjshmërisë. Nëse vlerësohet se është i ligjshëm, do të marrim konfirmimin dhe, pas këtij hapi, do ta sjellim çështjen në Kuvend për themelimin e një komisioni të përbashkët, të përbërë nga përfaqësues të ekzekutivit dhe të legjislativit, ashtu siç kemi vepruar edhe herëve të tjera. Më pas do të shpallet oferta publike. Komisioni do t'i përcaktojë kriteret dhe do të vendosë nëse prona do t'u ofrohet bizneseve shërbyese, bizneseve prodhuese apo të dyja kategorive do t'u mundësohet konkurrimi. Pra, edhe në këtë rast procedura është e njëjtë. Nuk ka asgjë të ndryshme nga ajo që po mendon ti dhe nga ajo që po ke frikë se mund të ndodhë. Gjithçka do të zhvillohet përmes procedurave të përcaktuara dhe në mënyrë transparente. Prandaj, nëse dëshironi ta votoni këtë vendim, e votoni; nëse nuk dëshironi, nuk e votoni. Por procedura, në çdo rast, duhet të respektohet. Po, por pasi të vendosë komisioni, a do të jepet prona për një afat të gjatë? Jo, kjo nuk përcaktohet në atë mënyrë. Për çështjen e afatit duhet të respektohen dispozitat e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës. Ne nuk mund t'i anashkalojmë procedurat e përcaktuara me ligj. Njësoj është edhe me rastet e tjera: nëse përcaktohet ndryshe nga ajo që parasheh ligji, atëherë kemi problem procedural dhe ligjor.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- tha se, edhe një herë po e potencoj: nuk jemi kundër zhvillimit të bizneseve. Ne jemi për krijimin e kushteve të favorshme për bizneset, por jo për krijimin e favoreve për biznese të caktuara. Prona komunale na ka mbetur shumë pak, sidomos prona që kanë vlerë dhe mund të shfrytëzohen për zhvillim ekonomik. Rreth magjistrales kemi me dhjetëra, madje qindra biznese, dhe pothuajse të gjitha janë të vendosura në prona private. Dikush e ka pasur pronën e vet, dikush e ka blerë dhe e ka zhvilluar biznesin. Kemi shumë raste të bizneseve të suksesshme që janë zhvilluar në këtë mënyrë. Pra, ai që dëshiron të zhvillojë biznes duhet të ketë mundësi dhe kushte të barabarta për ta bërë këtë. Nuk jam për atë që një pronë komunale të jepet për 30 vjet, pa e ditur paraprakisht se çfarë do të ndërtohet apo çfarë veprimtarie do të zhvillohet në atë pronë. Për mua nuk është relevante se kush do ta marrë pronën. Ajo që është relevante është se çfarë do të bëhet në atë pronë dhe çfarë veprimtarie do të zhvillohet aty. Prandaj, si grup i Lëvizjes Vetëvendosje, nuk jemi për dhënien e kësaj prone në këtë formë, pa u përcaktuar qartë specifikat, qëllimi dhe veprimtaria për të cilën po jepet prona.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit- Prona bujqësore është një potencial i madh për zhvillimin e komunës, por njëkohësisht mund të bëhet edhe burim i veprimeve të padrejta nëse nuk menaxhohet me përgjegjësi. Qoftë me dije apo pa dije, me qëllim apo pa qëllim, për interesa të ndryshme, ne po e shkatërrojmë tokën bujqësore në vazhdimësi. Ju bëj thirrje të gjithëve, si kuvendarë, të hyni në gjeoportalin dhe të shikoni ndryshimet ndër vite, veçanërisht nga viti 2000 e këtej. Do të shihni transformimin e madh të tokës bujqësore në tokë ndërtimore dhe dëmtimin e vazhdueshëm të hapësirave bujqësore. Unë e kuptoj që tokat tona, përfshirë pronat komunale, janë potencial i mirë nëse shfrytëzohen drejt dhe nëse ekziston një vizion i qartë se çfarë duam të zhvillojmë. Por, kur bëhet fjalë për dhënien e tokës bujqësore ose të pronës komunale për veprimtari të ndryshme, qoftë shërbyese, prodhuese apo të tjera, nuk mund ta mbështesim një vendim pa e ditur qartë se çfarë do të zhvillohet aty.

Veprimtari shërbyese kemi mjaftueshëm. Komuna jonë, por edhe vendi ynë në përgjithësi, ka nevojë për prodhim, përpunim dhe eksport, jo për më shumë dyqane, autolarje dhe veprimtari të ngjashme. Një çështje tjetër që dua ta ngre është ajo që ndodhi gjatë këtyre dhjetë minutave. Ku janë shumica e asambleistëve të grupit të PDK-së? Pse janë larguar dhe çfarë e shkaktoi këtë ndryshim të qëndrimit? Fillimisht, propozuesi, z. Rahim, propozoi që kjo pikë të tërhiqej dhe të shtyhej. Tani shtrohet pyetja: çfarë ka ndryshuar ndërkohë? Po ashtu, duhet të qartësohet nëse kjo procedurë është ligjore apo jo. Nëse procedura e ndjekur deri në këtë fazë nuk është në përputhje me ligjin, atëherë shtrohet pyetja nëse vendimi ka kaluar në Zyrën Ligjore dhe në zyrën e kryetarit. Nëse ka kaluar, si është e mundur që një procedurë, për të cilën tani po ngrihen dyshime për ligjshmërinë, të ketë ardhur deri në Kuvend? Këto çështje duhet të sqarohen para se të marrim një vendim. Gjithashtu, është përmendur disa herë se bëhet fjalë për interes publik dhe se prona duhet të jepet përmes ankandit. Por duhet të jemi të qartë: a po flasim për interes publik apo për ankand? Sepse në vendimin që kemi para vetes është përcaktuar ankandi. Të dashur kolegë, Ne kemi përgjegjësi ndaj votës së secilit qytetar që na ka sjellë këtu. Kjo përgjegjësi fillon nga kryetari dhe shtrihet te secili prej nesh. Nuk guxojmë të biem nën presionin e askujt dhe, aq më pak, të marrim vendime për t'u bërë favore personave të caktuar apo interesave partiake. Ata që na përkrahin për atë që jemi, le të na përkrahin. Ata që nuk na përkrahin, le të mos na përkrahin. Nuk bëhet nami. Një ditë kryetari do të shkojë në shtëpi, edhe unë do të shkoj, edhe secili prej nesh. Por vendimet që marrim sot do të mbeten dhe do të kenë ndikim te qytetarët dhe te e ardhmja e Vushtrrisë. Prandaj, nuk duhet të marrim vendime sikur gjithçka përfundon me ne. Duhet të mendojmë për interesin publik, për të tashmen dhe, mbi të gjitha, për të ardhmen e Vushtrrisë.

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- Nëse i shohim pikat e rendit të ditës, vërejmë se pika shtatë është „Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale“. Ndërsa, nëse i shohim dy vendimet paraprake, njëri është për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, ndërsa tjetri është vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë. Pra, këtu duket se ka një mospërputhje në formulimin e pikave. Dhe këtu nuk është dashur të ndodhë një gabim i tillë. Në rendin e ditës kemi pasur diçka tjetër, ndërsa në vendimet paraprake kemi dy çështje të ndryshme. Sa i përket Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, ne e dimë se në fillim të këtij viti kemi miratuar, si Kuvend, listën e pronave që janë në interes të qytetarëve të komunës sonë. Në bazë të këtij ligji, kjo listë duhet të miratohet një vit para se pronat të jepen në shfrytëzim. Tash është hera e dytë apo e tretë që na vijnë propozime të ndryshme për dhënien e pronave në shfrytëzim. Do të ishte shumë më mirë që qeverisja komunale ta sillte një herë gjatë vitit listën e pronave që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit vijues. Kjo do të na mundësonte që procedurat të ishin më të qarta dhe do të shmangte paqartësitë që po i kemi tani me këto pika. Për këtë arsye, ne si grup kuvendar, në këtë rast, jemi kundër votimit të këtyre propozimeve në këtë formë. Do të ishte më e drejtë që, në përputhje me Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, fillimisht të formohet komisioni nga Kuvendi Komunal dhe më pas çështjet të procedohen si pika të veçanta në seancat e ardhshme.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së-sqaroi se çështja e pronave, seriozisht, është problematike, mirëpo duhet të veprojme. Duhet të veprojme dhe të zhvillohemi. Për shembull, për këtë vit keni planifikuar **53,616.00 €** të hyra nga dhënia në shfrytëzim të pronave. Deri tani janë realizuar **21,875.00 €**, apo rreth **48.00%** e planifikimit të periudhës përkatëse. Këto po i ndërlidh me faktin se, për t'i rritur të hyrat, duhet të jepen pronat në shfrytëzim, por gjithmonë përmes procedurave të rregullta dhe në mënyrë sa më transparente, si për ekzekutivin, ashtu edhe për ju, asambleistët. Së pari, sa i përket pyetjes së Beratit: këto prona janë pjesë e listës së miratuar nga Kuvendi. Pra,

edhe kjo pronë, e cila propozohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë, si dhe katër prona të tjera që propozohet të jepen në shfrytëzim afatshkurtër, janë pjesë e listës së miratuar nga Kuvendi. Këtë parcelë, shumica prej jush ndoshta e keni parë edhe në gjeoportalin dhe e dini se ku ndodhet. Ajo gjendet mes shtëpive dhe aty janë edhe tri biznese që aktualisht paguajnë qira. Kjo parcelë ka mbetur e pashfrytëzuar për rreth 20–23 vjet, është mbushur me mbeturina dhe, për këtë arsye, kemi menduar që të jepet në shfrytëzim, por në mënyrë sa më transparente dhe të qartë. Sa i përket procedurës, edhe sekretaria na e ka sqaruar, ndërsa edhe unë e kam ngritur këtë çështje: fillimisht duhet të votohet si pikë e veçantë. Më pas, komisioni përcakton kriteret, përkatësisht nëse prona do t’u ofrohet bizneseve prodhuese, shërbyese apo kategorive të tjera, dhe në bazë të këtyre kriterëve bëhet përzgjedhja dhe vazhdoen procedurat e mëtejshme. Sipas ligjit, janë tri forma të dhënies në shfrytëzim: përmes ankandit, përmes shprehjes së interesit dhe përmes negociatave. Në këtë rast, unë e kam propozuar procedurën përmes ankandit, bazuar në konsultimin me juristët. Por, nëse duhet të jetë ndryshe, atëherë duhet ta korrigjojmë ose ta shtyjmë.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-tha se për shkak të shumë paqartësive që janë krijuar rreth kësaj çështje, grupi kuvendar i Lëvizjes Vetëvendosje nuk do të marrim pjesë në votim.

Rahim Ajeti, anëtar i kuvendit-deklaroi se është i mendimit se kjo pikë duhet të shtyhet, sepse ka dy gabime, kryesuese, dhe të dyja mund të jenë arsye që vendimi të na kthehet. Gabimi i parë, drejtor, është se ne e kemi votuar këtë pronë për t’u dhënë në shfrytëzim për 99 vjet, ndërsa tash në propozim e keni paraqitur për 30 vjet. Gabimi i dytë është se në vendim thuhet se obligohet komisioni. Cili komision? Kush është pjesë e këtij komisioni? Unë kam qenë anëtar i komisionit bashkë me drejtorin edhe para rreth dhjetë vjetësh, kur kemi dhënë prona në shfrytëzim. Fillimisht është themeluar komisioni, pastaj janë përcaktuar pronat, kriteret, mënyra e përzgjedhjes dhe procedurat që duhet të ndiqen. Prandaj, kjo procedurë, sipas meje, nuk është në rregull. Unë po e them edhe si jurist dhe jam i bindur në atë që po e them. Madje, po e garantoj se nëse ky vendim dërgohet në ministri dhe nuk kthehet, unë jam i gatshëm të jap dorëheqje nga pozita e anëtarit të Kuvendit. Prandaj, seriozisht duhet ta trajtojmë këtë çështje në aspektin juridik. Propozimi im është që kjo pikë të shtyhet për seancën tjetër. Ndërkohë, ta themelojmë komisionin dhe pastaj këtë çështje ta sjellim përsëri në rend dite, pasi të jenë plotësuar të gjitha procedurat.

Në vazhdim, kryesuesja e kuvendit e ndërpreu mbledhjen, pasi grupi kuvendar i LVV-së dhe ai i LDK-së e lëshuan sallën e mbledhjes, dhe kësaj nuk kishte kourum për vazhdimin e punimeve të mbledhjes.

Pas një pauze dhe konsultimeve mes grupeve kuvendare u arritë dakordim për vazhdimin e mbledhjes, pasi në sallën e mbledhjes ishin të pranishmë 16 anëtarë të kuvendit, kourum i mjaftueshm për marrejen e vendimeve të plotëfuqishme.

Kushtrim Veseli, anëtar i kuvendit- tha se në cilësinë e anëtarit të Kuvendit, kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë tjetër, jo domosdoshmërisht në seancën e radhës, por atëherë kur të plotësohen të gjitha kushtet dhe të sqarohen çështjet procedurale. Është e dhimbshme dhe e papranueshme që Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje vazhdimisht gjen arsye për t’i penguar dhe zvarritur punët e Kuvendit, sidomos kur bëhet fjalë për investime kapitale dhe zhvillimin e bizneseve.

Në vazhdim, kuvendi pas votimit me 16 vota “për”, vendosi që të shtyhen për shqyrtim për ndonjërin nga mbledhjet e ardhshme të kuvendit, pika e redndit të ditës:

7. Propozim-vendim paraprak, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale.

8. Propozim-vendim paraprak, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.

9. Pyetje dhe përgjigje.

Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit-Përshëndetje për të gjithë, përshëndetje për Kryetarin dhe kryesuesen. Të nderuar kolegë, kam dy pyetje për Kryetarin.

Pyetja e parë: A ka paraparë Komuna e Vushtrisë subvencione për sportin gjatë këtij viti? Duke pasur parasysh se dy klubet tona, Klubi i Volejbollit „Azem Shkodra“ dhe Klubi i Volejbollit „Vushtrria“, janë në vështirësi financiare dhe rrezikojnë të tërhiqen nga garat. Bëhet fjalë për ekipin e meshkujve në Superligën B dhe ekipin e vajzave në Ligën e Parë. Nëse nuk ka mbështetje nga komuna, a ekziston rreziku që këto dy ekipe të tërhiqen nga garat?

Pyetja e dytë: Ka të bëjë me rrugën tek Ujësjellësi, kjo rrugë aktualisht është në gjendje shumë të keqe dhe është vështirë e kalueshme, madje edhe me automjete. Qytetarët kanë kërkuar që, së paku përkohësisht, të shtrohet me zhavorr, në mënyrë që të mund të qarkullohet dhe të kenë qasje më të lehtë në rrugët, por edhe për punimin e tokave të tyre.

Betim Grabanica, anëtar i kuvendit- Kam një pyetje, por edhe një kërkesë lidhur me pikën e rendit të ditës për mbrojtjen e mjedisit. Duke pasur parasysh rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit për komunën tonë, të shqyrtohet mundësia që në një të ardhme të afërt të krijohet ose të specifikohet një Drejtori e veçantë për Mbrojtjen e Mjedisit, pasi konsideroj se kjo çështje duhet të ketë një vëmendje dhe trajtim shumë më të madh institucional? Komuna e Vushtrisë ka një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore, ndërsa një pjesë e tyre po dëmtohet dhe po shkatërrohet vazhdimisht. Për këtë arsye, kërkoj që të rritet bashkëpunimi i komunës me Ministrinë e Bujqësisë dhe Agjencinë e Pyjeve, si dhe të shqyrtohet mundësia që institucionet përkatëse të kenë një zyrë apo përfaqësim më të drejtpërdrejtë në komunën tonë. Pyetja ime është: A jeni të gatshëm që, në bashkëpunim me institucionet qendrore, të ndërmerreni hapa konkretë për forcimin e mbrojtjes së pyjeve dhe mjedisit në Komunën e Vushtrisë dhe për krijimin e një strukture më të veçantë institucionale që do të merrej me këto çështje?

Ferit Idrizi, kryetar i komunës- Sa i përket pyetjes së parë, lidhur me mbështetjen për klubet sportive, jam duke u angazhuar që t'ju sigurojmë edhe sponsorë, sepse, siç e dini edhe ju që merreni me sport, mjetet që kemi në dispozicion kanë qenë të pamjaftueshme. Megjithatë, këtë vit gjendja financiare është vërtet shumë e vështirë. Prandaj, propozoj që të ulemi bashkë dhe të shqyrtojmë mundësinë për të gjetur sponsorë, në mënyrë që së bashku të përpiqemi të dalim nga kjo situatë. Sa i përket rrugës tek Ujësjellësi, sapo ta nënshkruajmë kontratën për rrugët e kategorisë së tretë dhe të katërt, do të ndërhyjmë edhe në këtë rrugë. Siç e kam përmendur edhe më herët, kemi filluar t'i hapim dhe t'i shtrojmë rrugët e kategorive të tilla, sepse ka nevojë të madhe, veçanërisht për zhvillimin e bujqësisë. Për këtë rrugë do të jemi në kontakt dhe do ta dërgojmë kompaninë për ta rregulluar dhe shtruar. Sa i përket propozimit tuaj për krijimin e një Drejtorie për Mbrojtjen e Mjedisit, konsideroj se është një propozim shumë i qëlluar dhe i domosdoshëm. Edhe ne kemi diskutuar shumë për këtë çështje dhe besoj se në seancën e radhës do të na vijë për shqyrtim Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave. Edhe në aspektin teknik kam punuar në këtë rregullore dhe i kemi kushtuar rëndësi të veçantë mbrojtjes së mjedisit. Për shembull, të gjitha serviset e automjeteve që gjenerojnë vajra të përdorur, nëse Kuvendi e miraton rregulloren, do të obligohen që këto vajra të mos i hedhin në mënyrë të pakontrolluar, por t'i ruajnë në enë të

posaçme. E njëjta vlen edhe për pastiçeritë dhe bizneset e tjera që gjenerojnë vajra të përdorur, të cilët shpesh përfundojnë në kanalizime dhe shkaktojnë bllokimin e tyre. Unë jam shumë i përkushtuar ndaj mbrojtjes së mjedisit dhe jam i gatshëm të mbështes çdo nismë që kontribuon në këtë drejtim. Gjendja e mjedisit është shqetësuese dhe duhet të ndërmarrim masa konkrete. Në fund, dua t'i falënderoj publikisht punëtorët e Ndërmarrjes Publike Lokale „Përparimi“, të cilët janë duke bërë një punë të madhe në menaxhimin e mbeturinave dhe në pastrimin e ambientit. Ata po punojnë shumë, edhe pse kushtet e tyre të punës nuk janë gjithmonë të mira. Ne jemi përpjekur t'i përmirësojmë edhe kushtet dhe pagat e tyre, të cilat tashmë janë më të mira krahasuar me disa komuna të tjera.

Shqyrtimi i Deklaratës për Denimin e Gjuhës së Urrejtjes;

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit-para kuvendit lexoj tekstin e deklarates e pëshkruar si më poshtë.

Kuvendi me 16 vota “për” e mbështeti Deklaratën për Denimin e Gjuhës së Urrejtjes:

DEKLARATË

Ne, anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë, në cilësinë e përfaqësuesve të qytetarëve, përmes grupeve kuvendare, shprehim shqetësimin tonë për çdo publikim, deklaratë apo përmbajtje në rrjetet sociale dhe në hapësirën publike që përmban gjuhë të urrejtjes, nxit përçarje mbi baza fetare, etnike apo të tjera, ose mund të interpretohet si thirrje për dhunë.

Ky reagim vjen pas publikimeve të vazhdueshme, nga një qytetar i fshatit Maxhunaj, shkrime këto me përmbajtje të urrejtjes ndërfetare, nxitjes dhe thirrjeve për dhunë.

Liria e shprehjes është e drejtë themelore e garantuar me ligj, por ajo nuk mund të përdoret si justifikim për përhapjen e urrejtjes, diskriminimit apo nxitjes së dhunës. Shoqëria jonë është ndërtuar mbi vlerat e bashkëjetesës, respektit të ndërsjellë, tolerancës dhe harmonisë ndërmjet të gjithë qytetarëve. Çdo veprim që cenon këto vlera dëmton kohezionin shoqëror dhe interesin publik.

Prandaj:

1. Dënojmë fuqishëm çdo formë të gjuhës së urrejtjes, nxitjes së përçarjes dhe çdo deklaratë apo veprim që mund të nxisë intolerancë ose dhunë.
2. Ftojme organet kompetente të Republikës së Kosovës që, në përputhje me kompetencat e tyre, të trajtojnë çdo rast kur ekziston dyshimi për shkelje të ligjit dhe të ndërmarrin veprimet e nevojshme.
3. U bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve, institucioneve, organizatave dhe mediave që të kontribuojnë në ruajtjen e një klime të respektit, dialogut dhe bashkëjetesës, duke promovuar gjuhën e përgjegjshme dhe vlerat demokratike.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë mbetet i përkushtuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dinjitetit të çdo qytetari dhe forcimin e harmonisë e unitetit në komunitetin tonë.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë.

Vushtrri,

30 korrik 2026

Mbledhja përfundoi në ora 13:20

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kuvendi i Komunës



Datë: 10.09.2026

Për: KPF –në dhe Kuvendin Komunal

Propozues: Kryetari i Komunës, Ferit Idrizi 

Hartues i aktit përcjellës: Koordinator i certifikuar për sistemin e menaxhimit të performancës, Islam Latifi 

Për shqyrtim: Raporti i performancës së Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në bashkëpunim me të gjitha komunat e Republikës së Kosovës dhe me partnerët e MAPL-së, ka publikuar raportin e performancës komunale për vitin 2025 i cili prezanton rezultatet e punës së komunave në 16 fusha të kompetencave që janë nën përgjegjësi të tyre, përmes 93 treguesve sa ka gjithsej Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale ndërsa Komunën e Vushtrrisë e ka renditur me një përqindje mesatare 65.70 %.

Raporti përfshin periudhën janar-dhjetor 2025 dhe është tërësisht i bazuar në metodologjinë standarde dhe dokumentin kryesor të sistemit të performancës komunale, dokumente këto të diskutuara dhe të formuluara gjatë viteve të fundit, si dhe Ligjit Nr. 08/1-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave.

Vlerësimi i treguesve të aplikueshëm është bërë në koordinim me zyrtarët komunal, me të cilët para procesit të matjes është realizuar një konsultim i përgjithshëm, duke evidentuar të gjithë treguesit e mundshëm ku edhe mund të bëhet matja e tyre.

Hyrja

Raporti i performancës komunale për vitin 2025 prezanton rezultatet e punës së komunave në 16 fusha të kompetencave që janë nën përgjegjësi të tyre, përmes 93 treguesve sa ka gjithsej Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale.

Vlerësimi i treguesve të aplikueshëm është bërë në koordinim me zyrtarët komunal, me të cilët para procesit të matjes është realizuar një konsultim i përgjithshëm, duke evidentuar treguesit e mundshëm ku edhe mund të bëhet matja e tyre.

Raportimi i të dhënave dhe vlerësimi i tyre është bërë përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale. Qasje në këtë sistem kishin të gjithë zyrtarët raportues të komunave, koordinatorët e performancës, kryetarët e komunave dhe zyrtarët vlerësues të Ministrisë. Krahas raportimit, sistemi ofroi mundësinë e bashkëngjijtes së dokumenteve referuese për të dhënat e raportuara, si dhe një proces komunikimi në mes të komunave dhe Ministrisë, duke lënë gjurmë në secilën fazë të vlerësimit të të dhënave.

Ky raport synon të pasqyroj dy aspekte kryesore të punës së komunave:

- 1) Mënyrën e qeverisjes së komunave bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe
- 2) Ofrimin e shërbimeve në aspektin sasior dhe cilësor, kur është e mundur.

Të dhënat e ofruara shërbejnë për të parë trendët e zhvillimit të komunave nga viti në vit, në mënyrë që prioritetet vijuese të shtrihen në mbështetje të sektorëve më pak të organizuar. Veç kësaj, rezultatet e raportit shërbejnë si mjet vetëkontrolli për punën e administratës komunale, për të rritur kapacitetet dhe reflektuar në përgjegjshmërinë e zyrtarëve publik. Për më tepër, raporti informon qytetarët për pritjet e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve nga institucionet dhe të zgjedhurit e tyre lokal.

Qëllimi

Matja e performancës ka për qëllim përcjelljen sistematike të ngjarjeve dhe aktiviteteve në komuna brenda kornizës së treguesve të caktuar. Qëllimi i kësaj matje është të nxjerr në pah fushat ku shërbimet komunale kanë nevojë për mbështetje dhe avancim, si dhe fushat ku duhet orientuar ndërhyrjet afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata.

Të dhënat e fituara ndihmojnë që komunat të përmirësojnë planifikimin dhe të orientojnë prioritetet e tyre në sektorët e nevojshëm për vitet e ardhshme.

Në fakt, matja e performancës synon të jap përgjigje në pyetjet se:

- Në çfarë niveli kanë performuar komunat?
- Nëse komunat po i arrijnë objektivat e tyre?
- Nëse proceset menaxhuese janë në pajtim me ligjin?
- Cilat duhet të jenë veprimet e nevojshme që duhet bërë në të ardhmen?

Sistemi shërben edhe për autoritetet qendrore për të planifikuar dhe orientuar politikat në sektorët në nevojë, sipas vlerësimeve reale, kritereve të qarta, ashtu që shpërndarja e investimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe objektive. Në këtë drejtim, qëllimi i matjes

shërben edhe për nevoja të Grantit të Performancës Komunale, pasi tërësia e treguesve të këtij granti, shërbehet me të dhënat e raportit të performancës komunale.

Edhe në këtë cikël të matjes dhe vlerësimit të punës së komunave, shtrirja e të dhënave reflekton të arriturat e komunave në kuadër të treguesëve, rezultateve (nënobjektivave) dhe fushave sipas kompetencave vetanake përkatëse.

Matja e performancës së komunave rezulton me të dhëna që pasqyrojnë shkallën e përmbushjes së standardeve të shërbimeve nga ana e komunave. Ndër vite kanë ndryshuar elementet e matjes së performancës ngase numri i treguesve ka ardhur gjithnjë duke u rritur. Qëllimi i zgjerimit të fushave dhe treguesve ka qenë që të maten sa më shumë shërbime të mundshme të cilat ofrohen nga ana e institucioneve lokale.

Metodologjia

MAPL ka përcaktuar dhe normuar metodologjinë për përgatitjen, mbledhjen, përpunimin, verifikimin dhe raportimin e të dhënave në SMPK. Udhëzimet për mbledhje dhe raportim të të dhënave janë dhënë përmes: trajnimeve për koordinatorët komunal për performancë dhe zyrtarët raportues. Në hap me këtë janë përgatitur udhëzimet e shkruara të cilat shpjegojnë në detaje gjithë skenarin e funksionimit të SMPK-në.

Procesi i matjes së performancës ka kaluar nëpër fazat e mëposhtme:

- Konsolidimin e procesit të raportimit, koordinimin me zyrtarët komunal dhe themelimin e komisioneve përgjegjëse për vlerësim;
- Hapjen e thirrjes për raportim në komuna;
- Pranimin e të dhënave të raportuara nga komuna;
- Verifikimit të të dhënave në fazën e konsultimit paraprak,
- Vlerësimit kushteve formale të raportimit;
- Verifikimit të dhënave me mostër
- Nxjerrjen dhe komunikimin preliminar të rezultateve të performancës në komuna;
- Përmbylljen e periudhës së ankesave;
- Finalizimin e raportit;

Raportimi dhe dokumentimi i të dhënave për SMPK është bërë në Sistemin Elektronik të SMPK-së. Për përdorimin e këtij sistemi janë dhënë udhëzimet dhe janë ofruar trajnimet nga MAPL dhe DEMOS. Procesi i mbledhjes, dokumentimit dhe raportimit të të dhënave brenda institucioneve të ndryshme komunale është koordinuar nga koordinatori komunal për performancë. Të dhënat e raportuara janë autorizuar nga kryetarët e komunave. Dokumentimit përmes monitorimit të ueb-faqeve zyrtare;

Procesi i verifikimit ka kaluar nëpër fazën e verifikimit të rregullt dhe përfundimtar.

Verifikimi i rregullt ka kaluar në tri stadi: verifikimi në fazën e konsultimit paraprak, verifikimit për pranueshmërinë e të dhënave dhe verifikimit me mostër.

Në fazën e verifikimit përmes konsultimit paraprak, janë identifikuar të dhënat me gabime ose të pakompletuara. Komunitat janë udhëzuar që të plotësojnë këto të dhëna duke i mbështetur me dokumentet referuese.

Në fazën e verifikimit për pranueshmërinë është verifikuar respektimi afateve kohore për raportim dhe respektimi i autorizimeve nga zyrtarët përgjegjës në komunë.

Në fazën e verifikimit me mostër është zbatuar Metodologjia e verifikimit, duke aplikuar kriteret për përzgjedhje të treguesve në pajtim me këtë dokument.

Raporti nxjerrë përfundimet e përgjithshme për shkallën e të arriturave të komunave dhe jep rekomandimet përkatëse për përmirësimin e shërbimeve në bazë të rregullave juridike në fuqi apo standardeve të kërkuara qeverisëse.

Informatat e përgjithshme për Komunën e Vushtrrisë

Komuna	Territori në km ²	Numri i banorëve	Performanca %
Vushtrri	345	61528	65.70%

Në bazë të analizave individuale të të dhënave, është konstatuar se Komuna e Vushtrrisë gjatë vitit 2025 ka arritur performancë të shkallës mbi mesatare (65.70%).

Konkluzione dhe rekomandime

Vlerësimi i performancës komunale për vitin 2025 nxjerr të gjetura të shumta për 16 fusha të kompetencave komunale. Përfundimet e këtij raporti theksojnë një numër të madh të çështjeve, të cilat duhet të merren parasysh dhe trajtohen me prioritet nga organet e pushtetit lokal. Në këtë pjesë të raportit, janë veçuar disa nga konkluzionet dhe rekomandimet me peshë më të madhe në avancimin e shërbimeve komunale. Raporti nxjerr përfundimet se:

Rekomandim

Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike, si dhe gjetjeve nga ky hulumtim, Komunës së Vushtrrisë i rekomandohet që të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Sa më shumë përfshirje të punësuarve me aftësi të kufizuar;
- Përfshirje të punësuarve nga komunitetet joshumicë sipas përkatësisë gjinore;
- Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendim marrëse.
- Rritja e % së vendbanimeve me rrjet të kanalizimit;
- Rritjen e % të vendbanimeve me trajtim të ujërave të zeza;
- Zbatimi i lejeve mjedisore,
- Hartimi i dokumenteve strategjike Planeve dhe Strategjive në nivel të komunës
- Përmbushja e standardeve minimale të konsultimeve publike,
- Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit,
- Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme),
- Inkasimi i mjeteve për menaxhimin e mbeturinave;
- Inkasimi i mjeteve të tatimit në pronë dhe procesi i verifikimit për 20 % të ekonomive familjare

Shtojcë: Raporti i performancës së Komunave të Republikës së Kosovës 2025



Institucioni:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Mbikëqyrja:

Drin Haraçia, Drejtor i Departamentit për Mbikqyrje dhe Performancë Lokale

Autor:

Lazar Mitic, Zyrtar për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Blerta Sejdiu, Zyrtare për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Mbeldhja, analizmi dhe verifikimi i të dhënave:

Haxhi Krasniqi, Udhëheqës i Divizionit për Performancë, MAPL

Lazar Mitic, Zyrtar për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Edina Ibishi, Zyrtare për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Blerta Sejdiu, Zyrtare për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Fatos Ajvazi, Zyrtar për Matje dhe Vlerësim të Performancës, MAPL

Të drejtat autoriale

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e dokumentit nuk mund të kopjohet, shumëzohet dhe të përdoret, në cilën do formë (elektronike dhe fizike) apo të përshkruhet pa lejen me shkrim të MAPL-së.



Përmbajtja	
SHKURTESAT:	4
HYRJE:	5
METODOLOGJIA:	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:	6
KAPITULLI I	7
1. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PERFORMANCËS	7
2. PERFORMANCA E KOMUNAVE 2020-2025	8
3. REZULTATET E VITIT TË VLERËSIMIT	10
KAPITULLI II	14
Pjesa e veçantë - Performanca e komunave 2025	14
REZULTATET E KOMUNAVE SIPAS FUSHAVE DHE TREGUESVE	14
FUSHA 1: SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE	14
FUSHA 2 – TRANSPARENÇA KOMUNALE	15
FUSHA 3 – PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE	16
FUSHA 4 - BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE	18
FUSHA 5 – KULTURË, RINI DHE SPORT	19
FUSHA 6 – MENAXHIMI I FATKEQËSIVE	20
FUSHA 7 – PLANIFIKIMI HAPËSINOR	20
FUSHA 8 – HAPËSIRAT PUBLIKE	21
FUSHA 9 – INFRASTRUKTURA RRUGORË	22
FUSHA 10 – TRANSPORTI PUBLIK	23
FUSHA 11 – SHËRBIME PUBLIKE	24
FUSHA 12 – MBROJTJA E MJEDISIT	24
FUSHA 13 – PËRFAQËSIMI GJINOR	25
FUSHA 14 – ARSIMI PARAUNIVERSITAR	26
FUSHA 15 – KUJDESI PRIMAR SHËNDETËSOR	28
FUSHA 16– ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL	29
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	30
SHTOJCË: PËRQINDJA E TREGUESVE SIPAS FUSHAVE	33

**Shkurtesat:**

SMPK	Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale
MAPL	Ministria e Administrimit të pushtetit lokal
DPK	Divizionin për Performancë Komunale
DEMOS	Decentralisation and Municipal Support
GPK	Granti i Performancës Komunale
SEMPK	Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Performancës Komunale



Hyrje

Raporti i performancës komunale për vitin 2025 pasqyron rezultatet e punës së komunave në 16 fusha, të vlerësuara përmes treguesve të Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale. Vlerësimi është bërë në bashkëpunim me zyrtarët komunalë, duke konsultuar përpara procesit të matjes për treguesit e mundshëm dhe pezulluar disa prej tyre. Raporti është hartuar dhe vlerësuar përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale, duke përfshirë dokumentet referuese të të dhënave të raportuara.

Raporti analizon dy aspekte kryesore: 1) Mënyrën e qeverisjes së komunave sipas legjislacionit në fuqi, dhe 2) Ofrimin e shërbimeve në aspektin sasior dhe cilësor.

Të dhënat ndihmojnë në analizën e trendeve të zhvillimit të komunave dhe përmirësimin e sektorëve më pak të zhvilluar. Gjithashtu, raporti shërben si mjet vetëkontrolli për administratën komunale, duke rritur kapacitetet planifikuese dhe përmirësuar përgjegjshmërinë e zyrtarëve. Përdoret për të informuar qytetarët për pritjet e shërbimeve.

Raporti është hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-103 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2023 për Menaxhimin e Performancës Komunale. Raporti publikohet çdo vit pas miratimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë. Matja, vlerësimi dhe verifikimi i të dhënave janë udhëhequr sipas legjislacionit dhe udhëzimeve të përcaktuara.

Metodologjia

MAPL ka përcaktuar dhe normuar metodologjinë për përgatitjen, mbledhjen, përpunimin, verifikimin dhe raportimin e të dhënave në SMPK.

Udhëzimet për mbledhje dhe raportim të të dhënave janë dhënë përmes: trajnimeve për koordinatorët komunal për performancë dhe zyrtarët raportues. Në hap me këtë janë përgatitur udhëzimet e shkruara të cilat shpjegojnë në detaje gjithë skenarin e funksionimit të SMPK-në.

Procesi i matjes së performancës ka kaluar nëpër fazat e mëposhtme:

- Konsolidimin e procesit të raportimit, koordinimin me zyrtarët komunal dhe themelimin e komisioneve përgjegjëse për vlerësim;
- Hapjen e thirrjes për raportim në komuna;
- Pranimin e të dhënave të raportuara nga komuna;
- Verifikimit të të dhënave në fazën e konsultimit paraprak,
- Vlerësimi kushteve formale të raportimit;
- Verifikimit të dhënave
- Nxjerrjen dhe komunikimin preliminar të rezultateve të performancës në komuna;
- Përmbylljen e periudhës së ankesave;
- Finalizimin e raportit;

Raportimi dhe dokumentimi i të dhënave për SMPK është bërë në Sistemin Elektronik të SMPK-së. Për përdorimin e këtij sistemi janë dhënë udhëzimet dhe ofruar trajnimet nga MAPL dhe DEMOS. Procesi i mbledhjes, dokumentimit dhe raportimit të të dhënave brenda institucioneve të ndryshme komunale është koordinuar nga koordinatori komunal për performancë. Të dhënat e raportuara janë autorizuar nga kryetarët e komunave.

Dokumentimi përmes monitorimit të ueb-faqeve zyrtare;



- Shqyrtimit të dokumenteve zyrtare të bashkëlidhura me formularët e plotësuar në sistemin elektronik;
- Sqarimeve të ofruara nga koordinatorët në Sistemin Elektronik të Performancës;
- Krahasimit të të dhënave me dokumente të tjera zyrtare të institucioneve publike;
- Për të dhëna të caktuara janë kontaktuar direkt zyrtarët përgjegjës në komuna

Procesi i verifikimit ka kaluar nëpër fazën e verifikimit të rregullt dhe përfundimtar.

Verifikimi i rregullt ka kaluar në tri stade: *verifikimi në fazën e konsultimit paraprak, verifikimit për pranueshmërinë e të dhënave dhe verifikimit të të dhënave, ku janë verifikuar të gjithë treguesit e performancës për dallim nga vitet tjera kur verifikimi është kryer me mostër.*

Në fazën e verifikimit përmes konsultimit paraprak, janë identifikuar të dhënat me gabime ose të pakompletuara. Komunitat janë udhëzuar që të plotësojnë këto të dhëna duke i mbështetur me dokumentet referuese.

Në fazën e verifikimit për pranueshmërinë është verifikuar respektimi afatshkëlqor për raportim dhe respektimi i autorizimeve nga zyrtarët përgjegjës në komunë.

Përmbledhje ekzekutive

Raporti i Performancës së Komunave të Kosovës për vitin 2025 ofron një vlerësim të hollësishëm të punës së komunave në ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe mënyrën e qeverisjes, duke analizuar përmbushjen e detyrimeve ligjore ndaj qytetarëve. Ky raport përmbledh rezultatet e performancës në 16 fusha kryesore, duke përfshirë shërbimet administrative, qeverisjen transparente, llogaridhënien, barazinë në punësim, arsimin, shëndetësinë, transportin publik, planifikimin hapësinor, menaxhimin e fatkeqësive, infrastrukturën rrugore, dhe sektorë të tjerë të rëndësishëm për zhvillimin socio-ekonomik dhe mirëqenien lokale. Vlerësimi i performancës realizohet në kuadër të Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK), një platformë e standardizuar për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave, duke mundësuar një qasje të unifikuar dhe të qëndrueshme për vlerësimin e arritjeve të komunave.

Të dhënat e raportura nga komunitat për vitin 2025, në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale, ju nënshtuan verifikimit të përgjithshëm për të gjithë treguesit të cilët janë pjesë përbërëse në SMPK. Për këtë fakt në vitin 2025 kemi rritje të performancës së përgjithshme të komunave.

Procesi i matjes së performancës përfshinë **38** komuna, të cilat raportuan për **89** tregues të SMPK-së. Gjetjet kryesore të raportit për vitin **2025** tregojnë rritje në performancën e përgjithshme të komunave krahasuar me vitin paraprak, me një rritje prej **13.6%**. Nëse krahasojmë të arriturat e përgjithshme ndër vite, vërehet se mesatarja varion nga **57.06%** deri në **43.46%**.

Duhet theksuar se elementet e matjes së performancës kanë ndryshuar ndër vite, për shkak të përfshirjes së risive brenda SMPK-së, përkatësisht reduktimit të treguesve të caktuar. Ndryshimet në fusha dhe tregues janë bërë në disa tregues ku komunitat kanë arritur një standard të mirë të funksionimit, duke i bërë këta tregues të panevojshëm për matje të mëtejshme. Nga ana tjetër, ekzistojnë parametra të caktuar për të cilët komunitat akoma qëndrojnë në një nivel të ulët zhvillimi. Për këtë arsye, treguesit e matjes duhet të mbeten të pranishëm në një periudhë afatgjatë.



Sa i përket performancës specifike sipas fushave, komunat treguan një nivel të kënaqshëm në ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët, me një performancë të përgjithshme prej 74.01%, duke dëshmuar efikasitet të lartë në trajtimin e kërkesave brenda afateve të përcaktuara ligjore. Nga ana tjetër, fushat si përfaqësimi i barabartë gjinor, barazia në punësim, arsimit parauniversitar, transporti publik dhe hapësirat publike vazhdojnë të shfaqin sfida të ndjeshme, me përqindje nën mesataren e përgjithshme. Kjo reflekton nevojën për përmirësim dhe për burime mbështetëse në këto fusha të kompetencës.

Në fusha të tjera, siç është transparencja komunale, raporti tregon për një rënie në krahasim me vitin e kaluar, me një rezultat të përgjithshëm prej 59.64% nga 84.82% vitin e kaluar. Rënia kryesisht lidhet me verifikimin e të gjithë indikatorëve të kësaj fushe për këtë vit krahsuar me verifikimin me mostër të vitit të kaluar. Megjithatë pjesa më e madhe e komunave ka treguar përpjekje për të siguruar qasje më të gjerë në informacione për qytetarët, disa sfida mbeten, sidomos në veprimet që synojnë përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

Rënit janë shprehur edhe në fushën e arsimit parauniversitar, me një trend negativ në ofrimin e shtrirjes adekuate të infrastrukturës arsimore, objekte dhe hapësira të pajisura me mjete bashkëkohore për zhvillimin e aktiviteteve mësimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, përfshirë edhe edukimin e hershëm. Ky regres është rezultat i mungesës së investimeve nga komunat në infrastrukturën arsimore.

Rënie të tjera janë evidentuar në fushën e përgjegjshmërisë komunale. Kjo fushë rezulton me 59.64%, duke shënuar ulje prej 11.69% krahsuar me vitin paraprak nga 71.33%. Edhe më tutje komunat qëndrojnë jo mirë në zbatimin e rregullave për standardet minimale të konsultimit publik. Rëndësia e zbatimit të këtyre standardeve qëndron në përmirësimin e planifikimit të politikave, mbështetjen e tyre në informata të vlefshme dhe nevoja reale, për të siguruar shpërndarje të drejtë të investimeve me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik lokal.

Rezultatet e raportit nxjerrin në pah një larmi të madhe në performancën e komunave dhe identifikojnë fushat ku nevojiten ndërhyrje për përmirësime strukturore dhe operacionale. Andaj, të dhënat e raportit duhet të merren për referencë nga vendimmarrësit dhe institucionet lokale, në përpjekje për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe për të arritur një qeverisje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse në nivel lokal.

Kapitulli I

1. Aspekte të përgjithshme të performancës

Matja e performancës së komunave është proces i rregullt që zbatohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim me të gjitha strukturat përgjegjëse në komunë, duke përfshirë zyrtarët raportues, koordinatorët e performancë dhe kryetarët e komunave, si autorizues të fundit të të dhënave të raportuara nga komunat.

Ky proces i matjes zbatohet brenda kornizës së kompetencave të komunave, siç përcaktohet nga bazë dhe atij sektorial. Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje lokale ka përcaktuar në mënyrë taksative kompetencat e komunave në fusha të shumta të qeverisjes lokale, përfshirë: shërbimet publike, infrastrukturën lokale, mirëmbajtjen e rrugëve dhe hapësirave publike, ndriçimin publik, zhvillimin



ekonomik lokal, planifikimin urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe ndërtimin, furnizimin me ujë të pijshëm, rrjetin e kanalizimit, mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbeturinave, ofrimin e arsimit parauniversitar, shëndetësinë primare, shërbime të mirëqenies sociale, aktivitetet kulturore, si dhe shumë çështje të tjera të përcaktuara shprehimisht me ligj.

Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) mundëson që rezultatet e fituara të shërbejnë si mjet identifikimi për aspektet e forta dhe të dobëta të qeverisjes lokale, duke lejuar që informacionet e grumbulluara të ndihmojnë në ndërtimin e strategjive për përmirësim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Matja e vitit 2024 është realizuar në 16 fusha të kompetencave komunale, me gjithsej 93 tregues. Elementet e matjes së performancës shprehin grupin e të drejtave dhe obligimeve që komunat i ushtrojnë në shërbim të qytetarëve mbi bazën e kompetencave ligjore. Indikatorët e përdorur japin informacione të rëndësishme për nivelin e shërbimeve të ofruara. Të dhënat e fituara japin indikacione të rëndësishme për menaxhimin e komunës për të shtrirë prioritetet në sektorët më pak të zhvilluar.

Edhe për vitin 2025, procesi i matjes së performancës komunale u realizua përmes Sistemit Elektronik i menaxhimit të Performancës, në të cilin kanë qasje të gjithë zyrtarët raportues të komunave dhe ministrisë. Digjitalizimi i këtij procesi ka mundësuar një formë interaktive të komunikimit, për të qartësuar të gjitha të dhënat diskutabile dhe për të rritur shkallën e dokumentimit. Njëherësh sistemi mundëson gjurmimin e të gjithë hapave të vlerësimit dhe ruan të gjitha dokumentet relevante mbi të cilat bazohet raportimi.

2. Performanca e komunave 2020-2025

Në vitin 2025, kërkesës për raportim të performancës u janë përgjigjur 38 komuna. Rezultatet tregojnë se niveli i arritjeve të komunave ndër vite varion nga 57.06% në vitin 2020 në 43.46% në vitin 2025. Në përgjithësi, performanca e komunave ka mbetur konstante ndër vite, me ndryshime shumë të vogla nga një vit në tjetrin, duke reflektuar një gjendje të ngjashme në efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara, pa përmirësime të dukshme në nivel të përgjithshëm.

Sidoqoftë, niveli i tanishëm i performancës në treguesit e SMPK-së, është rezultat i ndikimit pozitiv të Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) dhe Grantit për Performancë Komunale. Faktorë të tjerë ndërlidhen me rritjen e buxhetit të komunave, por edhe përmirësimin e aspekteve administrative në përgjithësi. Treguesit në fushën e përgjegjshmërisë komunale, kontrollit dhe transparencës në proceset e menaxhimit po ashtu kanë kontribuar në identifikimin dhe adresimin e çështjeve të dobëta, duke forcuar kështu besimin e qytetarëve në institucionet lokale. Këta faktorë së bashku kanë ndihmuar në arritjen e rezultateve më të mira dhe në ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët.

Më poshtë janë paraqitur përqindjet mesatare nga viti 2020 deri në vitin 2025, si në vijim:

Viti	2020	2021	2022	2023	2024	2025
%	57.1	56.8	59.4	58.2	65.5	43.4

Tab.1. Tabela krahasimore e performancës 2020-2025



Sa i përket ndryshimeve të performancës në fushat e SMPK-së, tabela në vijim tregon të dhënat nga viti 2020 deri në vlerësimet e fundit për vitin 2025. Duhet theksuar së me rishikimin e SMPK-së të implementuar në vitin 2023, fusha e parkingjeve publike është larguar nga matja, derisa fusha e ujit të pijshëm, kanalizimit dhe mbeturinave janë integruar në një fushë të vetme – shërbimet publike. Detajet e performancës janë si në vijim:

Fusha	2020	2021	2022	Fusha	2023	2024	2025
Shërbimet publike administrative	70.47	81.66	88.04	Shërbimet publike administrative	80	87.85	74.01
Transparenca Komunale	72.93	66.92	86.11	Transparenca komunale	73.02	84.82	59.64
Përgjegjëshmëria komunale	62.64	53.97	62.41	Përgjegjëshmëria komunale	63.79	71.33	54.88
Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare	57.7	55.09	60.3	Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare	49.71	58.11	33.81
Kulturë, rinë, sport	67.99	74.81	83.67	Kulturë, rinë, sport	62.7	93.39	63.21
Menaxhimi i fatkeqësive	77.19	61.67	53.68	Menaxhimi i fatkeqësive	69.3	54.21	45.44
Planifikimi hapësinor komunal	45.2	50.35	55.37	Planifikimi hapësinor komunal	67.9	61.88	50.84
Hapësirat publike	51.58	50.35	47.84	Hapësirat publike	51.59	71.62	31.52
Infrastruktura rrugore	47.67	52.04	55.05	Infrastruktura rrugore	42.45	57.08	28.77
Transporti publik	64.13	56.64	47.41	Transporti publik	46.93	43.10	24.79
Parkëngjet publike	40.41	47.04	47.35	<i>E larguar nga SMPK</i>			
Uji i pijshëm	73.1	67.35	74.6				
Kanalizimi	36.51	35.49	39.74	Shërbimet publike	58.05	90.60	40.81
Mbeturinat	68.36	70.15	69.84				
Mbrojtja e Mjedisit	65.64	63.61	52.19	Mbrojtja e Mjedisit	52.56	63.69	47.87
Përfaqësimi gjinor		38.02	39.2	Përfaqësimi gjinor	39.66	49.77	34.13
Arsimi parauniversitar	66.6	58.39	58.3	Arsimi parauniversitar	48.78	56.33	32.28
Shëndetësia primare	51.19	51.14	50.81	Kujdesi parësor shëndetësor	68.61	60.55	41.73
Zhvillimi Ekonomik Lokal	59.35	44.55	56.38	Zhvillimi ekonomik lokal	56.75	43.66	31.69

Tab.2. Performanca e fushave të performancës 2020-2025

Sipas të dhënave të mësipërme, të gjitha fushat kanë shënuar një rënie në vitin 2025. Të dhënat tregojnë se më sfiduese mbeten fushat si barazia në punësim dhe shërbimet sociale, hapësirat publike, infrastruktura rrugore dhe transporti publik. Rënie të performancës vërehet edhe në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, kujdesin parësor shëndetësor dhe arsimin parauniversitar.



3. Rezultatet e vitit të vlerësimit (2025)

Të dhënat për vitin 2025 tregojnë se performanca e përgjithshme e komunave në 16 fusha me 89 tregues të matjes është 43.46%, që do të thotë se komunat kanë ofruar shërbime në përqindje më të ultë për 22.13% krahasuar me vitin 2024.

Referuar % sipas fushave, nevoja më e madhe për rritjen e performancës shprehet në këto fusha: Transport publik (24.79%), Infrastruktura rrugore (28.77%), Hapësirat publike (31.52%), Zhvillimi Ekonomik Lokal (31.52%), Arsimi parauniversitar (32.28%), Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare (33.81), Përfaqësimi gjinor (34.13%), Shërbimet publike (40.81%) dhe Shëndetësia primare (41.73).



Fig. 1. Performanca sipas fushave, 2025

Figura e mësipërme tregon se përqindja më e lartë shprehet në fushat: shërbimet publike administrative, kulturë, rini dhe sport, transparenca komunale, përgjegjëshmëria komunale, planifikim hapësinor komunal, mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i fatkeqësive.

Ndarja e fushave sipas kategorive dhe niveleve të performancës - Në vijim është paraqitur figura me të arriturat e komunave në fusha të kompetencave për të cilat bëhet matja e performancës për vitin 2025.

Performanca maksimale sipas fushës specifike është 74.01% tek Shërbimet publike administrative, kurse më e ulëta shprehet tek transporti publik 24.79%. Kategorizimi i fushave është bërë sipas nivelit të performancës të ndarë në tri nivele: e ulët < 50%, e mesëm 50-65% dhe e lartë % 71-94% si vijon:



Performancë (< 50%)	
Transporti publik	24.79
Infrastruktura rrugore	28.77
Hapësirat publike	31.52
Zhvillimi Ekonomik Lokal	31.69
Arsimi parauniversitar	32.28
Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare	33.81
Përfaqësimi gjinor	34.13
Shërbimet publike	40.81
Shëndetësia primare	41.73
Menaxhimi i fatkeqësive	45.44
Mbrojtja e Mjedisit	47.87
Performancë (50-60%)	
Planifikimi hapësinor komunal	50.84
Përgjegjëshmëria komunale	54.88
Transparenca Komunale	59.64
Performancë (>60%)	
Kulturë, rinj, sport	63.21
Shërbimet publike administrative	74.01

Tab.3. Kategorizimi i fushave sipas nivelit të performancës

Elementet e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale sigurojnë informata edhe për procedura dhe aspekte ligjore të një shërbimi publik, për këtë arsye kategorizimi i fushave për nga niveli arritjeve është bërë duke marrë parasysh qëllimin e treguesve, ngjashmëritë në mes të tyre, përmbajtjes dhe llojit të fushës së kompetencës. Së këndejmi, grupimi i fushave në vijim merr parasysh këto segmente:

- 1) *Standardet e qeverisjes së mirë dhe*
- 2) *Ofrimin e shërbimeve publike.*

1) Standardet e qeverisjes së mirë, përfshijnë të dhëna rreth respektimit të parimeve të ligjshmërisë, transparencës, llogaridhënies, përfshirjes aktive të qytetarëve, standardeve të konsultimit publik si dhe çështje të ngjashme. Treguesit e kësaj kategorie kryesisht mbulojnë aktivitetet në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, planifikimin e pronës, punësimin, rregullativën ligjore për të drejtat e komuniteteve, personave me aftësi të veçanta, përfaqësimit gjinor shërbimeve sociale etj.




Fig.2. Performanca e komunave në fushat e matjes së shërbimeve publike gjatë vitit 2025

Nga figura 2 vërejmë që në kuadër të fushave të qeverisjes, në vitin 2025 mesatarja është 47.81%, nga 66.38% sa ishte në vitin 2024.

Në kuadër të **Transparencës komunale**, niveli i përgjithshëm i të arriturave shprehet me 59.64% nga 84.82% sa ishte në vitin 2024, apo 25.18% më e ultë.

Transparenca komunale lidhet ngushtë me fushën e **përgjegjshmërisë komunale**, e cila vlerësohet me numrin më të madh të treguesve në kuadër të SMPK-së. Komunitet nuk qëndrojnë aq mirë në treguesit e përgjegjshmërisë komunale. Kjo fushë rezulton me 59.64%, duke shënuar ulje prej 11.69% krahasuar me vitin paraprak 71.33%. Edhe më tutje komunitet qëndrojnë jo mirë në zbatimin e rregullave për standardet minimale të konsultimit publik. Rëndësia e zbatimit të këtyre standardeve qëndron në përmirësimin e planifikimit të politikave, mbështetjen e tyre në informata të vlefshme dhe nevoja reale, për të siguruar shpërndarje të drejtë të investimeve me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik lokal.

Në kuadër të veprimeve që **ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal** komunitet kanë pësuar rënie. Kjo fushë rezulton me 31.69% duke shënuar një rënie krahasuar me vitin 2024 sa ishte 43.66%.

Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare - Në kuadër të kësaj fushe janë matur veprimet e komunave për ofrimin e banimit social, si dhe kujdesin institucional ndaj grupeve të cenueshme. Po ashtu janë mbledhur të dhëna për punësimin e personave me aftësi të veçanta dhe punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë bazuar në të drejtat ligjore të tyre. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 32.54%, krahasuar me 58.11% në vitin paraprak.

Transporti publik mbetet ndër fushat me performancën më të ulët, me 24.79%. Niveli i të arriturave nuk shënon ndonjë progres gjatë viteve, çka e bën atë një ndër fushat më sfiduese për institucionet lokale.



2) Fushat me tregues për ofrimin e shërbimeve publike.

Në kuadër të këtyre fushave bëjnë pjesë tregues për lloje të ndryshme të ofrimit të shërbimeve nga ana e komunave, si në: menaxhim të mbeturinave, furnizim me ujë, mbrojtje të ambientit, kanalizim, planifikim urban, aktivitete kulturore, arsim, shëndetësi, infrastrukturë rrugore, trotuare, ndriçim publik, mirëmbajtje të hapësirave publike, shtigje të biçikletave, shenjëzim të rrugëve etj. Nga figura 4 rezulton që në kuadër të treguesve të shërbimeve publike, mesatarja e përgjithshme e arritur është 40.7%.




Fig.3. Performanca e komunave në fushat e matjes së shërbimeve publike gjatë vitit 2025

Fusha Kulturë, Rini dhe Sport dhe Shërbimet Publike tregojnë rezultate më të mira krahasuar me fushat e tjera. Në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit komunat treguan rezultate në përqindje prej 63.21%. Nga ana tjetër, fusha e Arsimit Parauniversitar, si kompetencë vetanake komunale, ka një renditje jo të mirë, me një nivel arritjeje prej 32.28%. Gjithashtu, të dhënat flasin për rezultate jo të mjaftueshme në fushën e Infrastrukturës Rrugore, e cila ka një vlerë prej 28.51 %, si dhe në atë të transportit publik me 24.79%.

Fusha e Arsimit parauniversitar mbledh tregues të shumtë për kompetencat e komunave në krijimin e kushteve për edukimin dhe arsimimin e nxënësve, prioritetet e vëna në këtë sektor përmes planifikimit të buxhetit, nivelin e planifikimit dhe realizimit të orëve mësimore, rezultatet e nxënësve, kushtet teknike dhe higjienike në shkollë, pajisjet e klasave me mjete pune, digjitalizimin e shkollave, aspektet e sigurisë, kriteret për kualifikimin dhe licencimin e mësimitdhënësve, mbingarkesën në klasa, hapësirat shkollore etj. Në këtë fushë komunat kanë treguar performancë në shkallë prej 32.28%. Nisur nga niveli parafillor, të dhënat flasin për përfshirje tejet të ulët të fëmijëve nëpër çerdhe, e sidomos në zonat rurale, për shkak të mungesës së investimeve në këto zona.



Në fushën e **shëndetësisë primare** janë ofruar të dhëna për infrastrukturën dhe hapësirat e destinuara për shëndetësinë primare, resurset dhe personelin e mjaftueshëm, si dhe ofrimin e shërbimeve nga niveli komunal. Sipas të dhënave të raportuara nga komunat, në përgjithësi kjo fushë ka nivel prej 41.73%.

Kapitulli II

PJESA E VEÇANTË - PERFORMANCA E KOMUNAVE 2025

1. Rezultatet e komunave sipas fushave dhe treguesve

Matja e performancës në vitin 2025 ka pasur në fokus pasqyrimin e të arriturave për 38 komuna. Kërkesës për raportim i janë përgjigjur 38 komuna, megjithëse shkalla e pavarshmërisë së të dhënave ishte mjaft e shprehur në disa komuna.

Shkalla e ofrimit të shërbimeve dhe respektimit të standardeve të qeverisjes ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, varësisht nga fusha e kompetencave që matet. Në nivelin e performancës mund të ndikojnë faktorë të shumtë, si: prioritetet e vëna nga komuna brenda fushave për të cilat ushtrohet matja, mënyra dhe cilësia e planifikimit të punëve, realizimi në raport me planifikimin, realizimi në raport me mundësitë dhe pengesat e caktuara, kapacitetet dhe resurset, kompleksiteti i çështjeve, cilësia e raportimit të të dhënave në SMPK, si dhe faktorë të tjerë relevant.

Në vijim të këtij raporti, janë paraqitur detaje të të arriturave të komunave sipas fushave dhe treguesve përkatës. Llogaritja e rezultatit përfundimtar të fushave të matjes, merr për bazë edhe vlerën 0 për të dhënat e të cilave janë shpallur të pavlefshme. Kjo është bërë për arsye se edhe keqraportimi konsiderohet performancë e dobët, gjë që duhet të ndikoj në rezultatin përfundimtar të komunave që nuk kanë ofruar të dhëna. Kjo reflekton edhe në krahasimet në mes të komunave si dhe vlerësimet e bëra për qëllime të Grantit për Performancë.

Fusha 1: Shërbimet publike administrative

Kjo fushë përbëhet nga katër tregues, ku përfshihen shërbimet publike administrative (SHPA) dhe efikasiteti i organeve komunale në shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve, personave fizik dhe juridik, për çështjet që lidhen me kompetencat e tyre të cilat kalojnë nëpërmjet Qendrës për Shërbimin e Qytetarëve. Njëkohësisht, kjo fushë matë gatishmërinë e komunave për të ofruar shërbime administrative në formën online apo përmes e-kioskut.

Krahasuar me 16 fushat e tjera, në vitin 2025 kjo fushë radhitet e para për nga performanca, me nivel të përgjithshëm prej 74.01%. Komunat Obiliq, Prizren, Podujevë, Hani i Elezit, Rahovec, Junik dhe Mamushë kanë nivelin maksimal të realizimit të këtij shërbimi prej 100%.

Treguesit	%
Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit	77.65
Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	77.68



Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna	79.65
Shërbimet administrative të thjeshtuara për zvoglimin e barrës administrative në nivel komunal	61.05

Tab.4. Treguesit e performancës në fushën e shërbimeve administrative

Të dhënat tregojnë se komunat në masë të madhe i kanë shqyrtuar kërkesat administrative të cilat u janë parashtruar. Gjatë vitit 2025 komunave u janë parashtruar 1,849,042 kërkesa për shqyrtim, nga të cilat janë shqyrtuar 1,703,639 kërkesa. Mesatarja e trajtimit të kërkesave për komunë është 44,833 kërkesa. Këtu përfshihen kërkesat për leje të ndryshme komunale, dokumentet e gjendjes civile, kërkesat për qasje në informata, kërkesat qytetare për financim dhe adresim në organet përgjegjëse të komunës.




Fig.4. Krahasimi i performancës së komunave në fushën e shërbimeve administrative

Sipas figurës së mësipërme, shihet se përqindja më e lartë në përmbushjen e treguesve është në komunat: Komunat Obiliq, Prizren, Podujevë, Hani i Elezit, Rahovec, Junik dhe Mamushë me 100%, kurse më ulët qëndrojnë komunat Shtërcë 16.67%, Ranillug 49.97%, Zveçan 50% dhe Pejë 50%.

Fusha 2 – Transparenca Komunale

Në këtë fushë janë aplikuar 7 tregues me 21 të dhëna të cilat japin informata për publikimin e akteve, planeve, buxhetit, kritereve të ueb-faqeve, qasjen në dokumentet publike, publicitetin e seancave të kuvendit, etj. Performanca e përgjithshme e arritur është 59.64%, për dallim nga viti paraprak ku ishte 84.82%. Sa u përket performancës sipas treguesëve, përqindja më e lartë është në përmbushjen e kritereve të faqes zyrtare elektronike të komunës shprehur me 84.21%. Në vijim është paraqitur tabela me treguesit e matur të transparencës për periudhën raportuese:

Treguesit	%
Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe transmetuara drejtpërdrejtë online	53.04
Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët	79.70
Përmbushja e kritereve të faqes zyrtare elektronike të komunës	84.21
Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal në faqen zyrtare të komunës	64.26
Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës	42.49



Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit	53.68
Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës	55.38

Tab.5. Treguesit e performancës në fushën e transparencës komunale

Nga figura e mësipërme shihet se treguesi për transmetimin online të mbledhjeve të kuvendit del në nivel 53.04%, krahasuar me vitin paraprak prej 93.75%. Tetë kriteret e matura për ueb-faqe komunale del të jenë përmbushur në masën 84.21%, ndërsa aktet e kuvendit të komunës janë publikuar në shkallë prej 64.26%. Të dhënat tregojnë për trend negativ në publikimin e akteve me karakter të përgjithshëm të aprovuara nga kryetarët e komunave, shprehur në përqindje prej 42.49% apo 47.31% më pak se në vitin 2024.



Fig.5 Krahasimi i performancës së komunave në fushën e transparencës

Figura e mësipërme tregon për 36 komuna të cilat kanë treguar performancë në mes 8-100% në fushën e transparencës, prej të cilave: Suharekë (100%), Prizren (100 %), Skenderaj (100 %), Vushtrri (100 %) dhe Pejë (100%).

Fusha 3 – Përgjegjshmëria Komunale

Përgjegjshmëria komunale ka gjithsej 19 tregues, të aplikuar në vitin 2025. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 54.89%. Në kuadër të kësaj fushe, performanca më e lartë është shprehur në dëgjime publike për KAB, buxhet komunal dhe buxhetimi me pjesëmarrje prej 73.86%. Treguesit e kësaj fushe theksojnë të arriturat e komunave në 5 shtylla të qeverisjes së mirë, duke përfshirë: pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse, llogaridhënien, respektimin e procedurave të prokurimit publik, ndërmarrjen e masave antikorupsion, si dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.

Sa i përket aktiviteteve për fuqizimin e pjesëmarrjes në vendimmarrje, të dhënat për treguesit e performancës janë si në vijim:

Treguesit	%
Dëgjime publike për KAB, buxhet komunal dhe buxhetimi me pjesëmarrje	73.86
Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike	54.61
Adresimi i kërkesave të qytetarëve në takimet për buxhet	47.58
Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	37.73



Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	32.68
Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	27.19
Funksionimi i këshillave lokal	22.37

Tab.6. Treguesit e përgjegjshmërisë për fuqizimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje

Referuar të dhënave të mësipërme, pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike edhe në vitin 2025 mbetet e ulët, përkundër standardit të SMPK-së për 3% të popullsisë së komunës. Ky standard është përmbushur në shkallën 27.19% krahasuar me vitin paraprak që ishte 28.75%. Gjithashtu, funksionalizimi i këshillave të fshatrave mbetet sfidë e cila duhet adresuar në periudhat e ardhshme.

Krahas kësaj, komunat kanë ndërmarrë veprime të tjera në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe trajtimit të çështjeve thelbësore siç është miratimi me kohë i buxhetit në kuvendet komunale. Treguesit për këtë pjesë të performancës reflektojnë të arriturat si në vijim:

Treguesit	%
Miratimi me kohë i propozimi buxhetit vjetor komunal	61.58
Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimt për adresim të rekomandimeve në Kuvendin Komunal	52.63
Mbledhjet e Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	42.8
Diskutime për raportet tre-mujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	40.13
Diskutim për raportin e performancës komunale nga kuvendi komunal për vitin paraprak	36.84
Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga auditori i brendshëm	22.16

Tab.7. Treguesit e përgjegjshmërisë për forcimin e llogaridhënies

Sa i përket nivelit të zbatimit të planit të prokurimit, bazuar në shumën e shpenzuar kundrejt shumës së planifikuar, performanca rezulton në masën 58.54%. Treguesi i për nivelin e adresimit të rekomandimeve të ZKA-së ka përqindjen prej 33.48%. Treguesi i pagesave brenda afateve ligjore prej 30 ditësh në përqindje i shprehur 46.06%.

Treguesit	%
Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	58.54
Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve	46.06
Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit	33.48

Tab.8. Treguesit e përgjegjshmërisë në fushën e prokurimit dhe zbatimit të rekomandimeve të auditorit

Ligji për zyrtarët publik ka përcaktuar një numër obligimesh për institucionet e administratës shtetërore, përfshirë komunat, në zbatimin e masave administrative ndaj zyrtarëve të cilëve u janë iniciuar procedura penale për veprat penale të kryera gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Po ashtu, komunat obligohen të hartojnë planet e integritetit, në mënyrë që të forcojnë transparencën dhe llogaridhënien në veprimtarinë e tyre. Treguesit e performancës në këtë drejtim pasqyrohen me këto rezultate:

Treguesit	%
-----------	---



Përgatitja e planit për zhvillimin e personelit	86.84
Pezullimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre	76.32
Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit në kuvendin komunal	36.84

Tab.9. Treguesit e përgjegjshmërisë për masat antikorrupsion dhe integritet

Në 14 treguesit e kësaj fushe, 13 komuna kanë treguar performancë mbi 70%, 11 komuna nga 50-70%, derisa pjesa tjetër e komunave janë nën 50%. Në vijim është paraqitur figura krahasimore e rezultateve të kësaj fushe sipas komunave:



Fig 6. Krahasimi i performancës së komunave në fushën e përgjegjshmërisë

Fusha 4 - Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare

Kjo fushë prej dy rezultateve dhe katër treguesve mbulon përfaqësimin e grupeve të ndryshme në punësim komunal, si dhe shërbimet sociale të grupeve më me nevojë në komuna. Në kuadër të punësimit treguesit matin nivelin e punësimit të personave me aftësi të veçanta në institucionet komunale, si dhe përqindjen e përfshirjes së komuniteteve jo shumicë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë prej 33.81%.

Treguesit	%
Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi social	49.25
Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi	35.75
Zyrtarë Publik të punësuar nga komunitetet jo shumicë në institucionet komunale ¹	37.22
Programi trevjeçar komunal i banimit social	30.26
Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale	21.19

Tab.10. Treguesit e fushës së Barazisë në Punësim, Shërbimeve Sociale dhe Familjare

¹ Komunitat në të cilat komunitetet joshumicë përbëjnë më pak se 1% të popullsisë (sipas regjistrimit të fundit të popullsisë) nuk vlerësohen, por marrin mesataren e komunave të Kosovës që kanë raportuar me rregull me të dhëna



Sipas të dhënave niveli i përmbushjes së kuotës për të punësuar me nevoja të veçanta mbetet i ulët, referuar kriterit të përcaktuar në Ligjin Nr. 05L-051 për mbrojtje nga diskriminimi. Më poshtë, janë pasqyruar të arriturat për secilën komunë në kuadër të kësaj fushe. Përqindje më e lartë është shënuar në dy tregues, familje në nevojë të cilave iu është siguruar banimi social, në masën 49.25% dhe fëmijëve në nevojë që iu është siguruar strehimi familjar, në përqindjen prej 35.75%.



Fig.7. Krahësimi i performancës së komunave në fushën e Barazisë në Punësim, Shërbimeve Sociale dhe Familjare

Fusha 5 – Kulturë, Rini dhe Sport

Në kuadër të kësaj fushe maten aktivitetet komunale kulturore, rinore dhe sportive, si një nga kompetencat vetanake të komunave. Fusha mbulon edhe shërbimet e ofruara nga komunat që kanë të bëjnë me kulturën, rininë dhe sportin, përfshirë hapësirat sportive. Treguesit, aktivitete të kulturës rinisë dhe sportit të mbështetura me buxhet komunal sipas përqindjes janë në vlerë prej 70.65% kurse hapësirat për aktivitete sportive krahasuar me numrin e banorëve në komuna shprehen me 55.77%. Në vijim është paraqitur tabela me treguesit e performancës së kësaj fushe:

Treguesit	%
Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal	70.65
Hapësira për aktivitete të sportit për numër të banorëve	55.77

Tab.11. Treguesit e performancës në fushën e kulturës

Të arriturat për secilën komunë në kuadër të kësaj fushe janë si vijon:






Fig.8 Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e kulturës

Fusha 6 – Menaxhimi i fatkeqësive

Kjo fushë matë planifikimin, organizimin dhe udhëheqjen e sistemit të organizuar të komunës për tu përgjigjur ndaj dukurive të shkaktuara nga fuqitë e pakontrolluara dhe nga fuqitë tjera. Fusha ka vetëm një rezultat dhe dy tregues, që kryesisht vlerësojnë realizimin e planit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore, si dhe nivelin e përgjigjeve të institucioneve komunale ndaj rasteve të paraqitura në këtë fushë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 45.44%. Rezultate maksimale prej 100 % në vitin 2025 kanë arritur dy komuna në menaxhim efikas të faktëkeqësive.

Treguesit	%
Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	75.64
Niveli i realizimit të planit komunal për Reagim Emergjent	15.24

Tab.12. Treguesit e performancës në fushën e menaxhimit të fatkeqësive

Të arriturat për secilën komunë në kuadër të kësaj fushe janë si vijon:




Fig.9 Të dhënat krahasimore në mes komunave në menaxhimit të fatkeqësive

Fusha 7 – Planifikimi Hapësinor

Kjo fushë matë zhvillimin hapësinor komunal nëpërmjet instrumenteve të planifikimit hapësinor, por edhe nivelin e planifikimit të ndërtimeve komunale. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 50.84%.

Treguesit	%
Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit	75.30
Territori i komunës i rregulluar sipas planeve hapësinore komunale	44.74
Objekte të inspektuara me leje të ndërtimit	38.59

Tab.13. Treguesit e performancës në fushën e planifikimit hapësinor



Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese të hollësishme është në shkallë prej 44.74%. Sa i përket lejeve ndërtimore nga komunat u shqyrtuan me kohë 75.30%. Sipas të dhënave, ndërtesat e reja për të cilat u lëshuan leje ndërtimi inspektuar në shkallë prej 38.59%. Të dhënat krahasimore sipas komunave janë si vijon:



Fig.10. Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e planifikimit hapësinor

Fusha 8 – Hapësirat Publike

Kjo fushë matë hapësirat publike të cilat janë me interes për qytetarët, menaxhohen nga komunat dhe të cilat ndikojnë në cilësinë dhe standardin e jetesës së qytetarëve. Performanca e përgjithshme sipas të dhënave të ofruara nga komunat është 31.52%. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, komunat ndër të tjera janë kompetente për ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike. Sipas të dhënave për vitin 2025 rreth 33.44% të hapësirave publike mirëmbahen rregullisht, ndërsa 37.44% të hapësirave publike janë të përcjella me ndriçim publik. Sipërfaqe të gjelbra për kokë banori në m² janë 23.68% në nivel vendi. Në vijim është paraqitur përqindja sipas treguesve:

Treguesit	%
Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik	37.44
Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht	33.44
Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m ² për kokë banori	23.68

Tab.14. Treguesit e performancës në fushën e hapësirave publike

Përpos nivelit të hapësirave të gjelbra për kokë banori, kjo fushë matë edhe sipërfaqen e hapësirave publike të cilat mirëmbahen rregullisht nga komunat, si dhe numrin e hapësirave publike të përcjella me ndriçim publik. Për nivelin e përmbushjes së treguesve referojuni figurës së mësipërme.




Fig.11. Të dhënat krahasimore në mes komunave në fushën e hapësirave publike

Sipas të dhënave të raportuara nga Komunitat në nivel maksimal prej 100% janë 3 komuna të cilat e kanë ofruar këtë shërbim për qytetarët e vet, ndërsa për 18 komuna ende mbetet sfida ofrimi i këtij shërbimi.

Fusha 9 – Infrastruktura Rrugore

Kjo fushë matë rrugët komunale dhe infrastrukturën përcjellëse që janë nën kompetencën e komunës. Kjo fushë përmban tregues të pasqyrojnë rezultatet e komunave në aspektin e mirëmbajtjes së rrugëve gjatë dimrit dhe verës, pastaj riasfaltimin e rrugëve, shtigjet me biçikleta, shoqërimin e rrugëve me trotuare, ndriçim publik dhe shenjëzim vertikal dhe horizontal. Performanca e përgjithshme vlerësohet në shkallë prej 28.77%. Përqindja e treguesve të kësaj fushe që pasqyrojnë mirëmbajtjen e rrugëve është si në vijim:

Treguesit	%
Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit	37.93
Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës	24.50

Tab.15. Trebesit e mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore

Sa i përket projekteve të realizuara infrastrukturore në këtë fushë, treguesit pasqyrohen si në vijim:

Treguesit	%
Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal	37.28
Rrugë lokale të riasfaltuara	36.33
Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik	28.44
Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare	16.78
Rrugët me shteg të biçikletave	12.83

Tab.16. Treguesit e investimeve në projekte të infrastrukturës rrugore

Në kuadër të këtyre treguesve, komunat duhet të orientojnë investimet në krijimin e shtigjeve për biçikleta, rregullimin e trotuareve dhe ndriçimit publik, të cilat pasqyrohen me vlera më të ulëta. Performanca e komunave në nivel të fushës është paraqitur si më poshtë:



Fig.12. Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e infrastrukturës rrugore

Fusha 10 – Transporti Publik

Kjo fushë matë ofrimin e transportit publik për qytetarët e komunës. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 24.79%.

Treguesit	%
Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	33.39
Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik	23.95
Realizimi i planit komunal për transport lokal publik (planit të mobilitetit)	17.04

Tab.17. Treguesit e performancës në fushën e transportit publik lokal

Në kuadër të kësaj fushe performanca për tre tregues është pasqyruar në grafikun më lart. Sipas të dhënave vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik 33.39%, kurse vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik qëndrojnë në nivelin 23.95%. Në nivel të ulët është përmbushur plani për transport publik i cili në përqindje është 17.04%.

Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunat e Kosovës:



Fig.13. Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e transportit publik



Fusha 11 – Shërbime Publike

Kjo fushë përfshinë pesë 5 tregues të ofrimit të shërbimeve publike. Performanca në nivel të fushës është 40.81%. Përqindja sipas treguesve është si në vijim:

Treguesit	%
Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave	64.26
Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave	57.88
Realizimi i Planit për investime kapitale në sistemin e kanalizimit	36.84
Realizimi i Planit për investime kapitale në sistemin e ujësjellësit	29.82
Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	15.23

Tab.18. Treguesit e performancës në fushën e shërbimeve publike

Sipas tabelës së mësipërme, treguesi me performancës më të lartë ka të bëjë me inkasimin e mjeteve për mbledhjen e mbeturinave në një vlerë prej 64.26%, pastaj realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave 57.88%. Treguesit e realizimin e planit komunal për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kanalizimit 36.84% dhe realizimin e planit komunal për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit 29.82%.

Në vijim është paraqitur arritjet e komunave në këtë fushë në përqindje.



Fig.14. Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e shërbimeve publike

Fusha 12 – Mbrojtja e Mjedisit

Kjo fushë matë veprimet e komunës përkatëse për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe jetësor (urban dhe rural) nga dëmtimi, degradimi apo ndotja si pasojë e veprimtarisë njerëzore ose të ndikimit natyror. Kjo fushë ka një performancë të përgjithshme prej 47.87%. Përqindja e treguesve të kësaj fushe është si në vijim:

Treguesit	%
Lejet mjedisore komunale të lëshuara	48.36
Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale	47.37



Tab.20. Treguesit e performancës në fushën e mbrojtjes së mjedisit

Lejet mjedisore të lëshuar ishin në shkallën 48.36%, ndërsa ndërtesat e reja që kanë zbatuar lejet mjedisore komunale del në shkallë prej 47.37%.



Fig.15. Të dhënat krahasimore në fushën e mjedisit

Në grafikun më sipër paraqiten komunat me rezultatet e kësaj fushe, ndërsa mesatarja e vendit është 47.87%.

Fusha 13 – Përfaqësimi Gjinator

Përfaqësimi gjinator matet më gjerësisht në këtë fushë duke përfshirë qasjen e të dy gjinive në programet për zhvillim social, ekonomik, si dhe në aktivitetet komunale. Po ashtu, treguesit matin shkallën e përfaqësimit të të dy gjinive në institucionet lokale dhe trupat e kuvendeve komunale. Me gjithë progresin e komunave ndër vite në sigurimin e përfaqësimit të barabartë në trupat e kuvendeve dhe në komisionet komunale, të dhënat për treguesit e caktuar ndikojnë në përqindjen e përgjithshme që kjo fushë të renditet mjaft të ulët, 34.13%. Në vijim, është paraqitur figura e përfaqësimit gjinator sipas treguesve:

Treguesit	%
Barazia gjinore tek anëtarët e komitetëve komunale	78.95
Gratë e punësuar në institucione/administratën komunale	62.56
Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive	48.54
Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	47.29
Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale	8.70

Tab.21. Përfaqësimi i grave në trupat komunale

Sipas të dhënave të raportuara nga 38 komuna, niveli i të punësuarve gra në institucione komunale është 62.56% në raport me kriterin 50x50. Po ashtu, Gratë të emëruara në pozita politike, është arritur 47.29% e kriterit ligjor. Sipas të dhënave të përfaqësimit të grave në pozitat udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive, 48.54% të përmbushjes së kriterit ligjor. Ndërsa barazia gjinore tek anëtarët e komitetëve komunale ka shënuar një vlerë prej 78.95%.



Në vijim janë paraqitur treguesit e përfaqësimit gjinor në programet komunale

Treguesit	%
Pjesëmarrja e grave në konsultime publike	40.84
Realizimi i planit komunal për barazi gjinore	31.54

Tab.22. Përfaqësimi i grave në trupat komunale

Hartimi i planit për barazi gjinore ka përqindje më të ulët, derisa komunat më mirë rezultojnë në Pjesëmarrja e grave në konsultime publike në vlerë prej 40.84%. Tregues të tjerë që paraqesin përfaqësimin e barabartë gjinor janë si në vijim:

Treguesit	%
Regjistrimi i pronësishë në emër të dy gjinive	19.19
Përfaqësimi gjinor tek emërtimet e rrugëve	14.80

Tab.23. Përfaqësimi gjinor në procese të rëndësishme shoqërore në komunë

Sa i përket të arriturave sipas komunave, në vijim është paraqitur figura krahasuese:



Fig.16. Krahasimet sipas komunave në fushën e barazisë gjinor

Fusha 14 - Arsimi Parauniversitar

Kjo fushë synon rezultate në hapësira për çerdhe dhe shkolla të pajisura me kabinete për internet, masa të efikasitetit të energjisë, rekrutimin e personelit arsimor, licencimin e mësuesve, mjetet e konkretizimit, pajisjet e shkollave me mjete mësimore, kabinete të TIK-ut, si dhe kushtet e sigurisë në shkollë. Kjo fushë ka performancën e përgjithshme në nivel prej 32.28%. Në përgjithësi, në treguesit e arsimit të dhënat e raportuara nga komunat nuk kanë qenë të plota, kështu që përqindjet e fituara mund të paraqesin një vlerë relative të saktësisë.



Treguesit	%
Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar	42.03
Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar	38.50
Shkolla me masa të efikasitetit të energjisë	26.48

Tab.24. Infrastruktura arsimore

Të dhënat tregojnë se komunat duhet të angazhohen në sigurimin e masave të efikasitetit në institucionet shkollore, pastaj ofrimit të sigurisë në shkollë efikasitet, por edhe plotësimi të kushteve me infrastrukturë, pajisje dhe mjete mësimore.

Tregues të tjerë të kësaj fushe janë si në vijim:

Treguesit	%
Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës	28.84

Tab.25. Vijueshmëria dhe rezultatet e shkollimit parauniversitar

Sipas të dhënave, braktisja e shkollës nga nxënësit, ku paraqitet shkalla inverse ka shënuar vlerën në 57.40%. Ndërsa shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit është përmbushur 41.09%. Kalueshmëria në testin e maturës kombëtare ka vlerën 34.62%. Fëmijë që vlijojnë kopshtin 5.85%, kjo mbetet e ulët edhe përkundër përpjekjeve nga komunat.

Treguesit	%
Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse)	57.40
Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit	41.09
Kalueshmëria në maturën kombëtare për klasat 12 -të (ndarja sipas gjinisë)	34.62
Mesatarja në rezultatet e testit të arritshmërisë për klasat e 9-ta	23.75
Fëmijë që vlijojnë kopshtin	5.85

Treguesit	%
Trajtimi i kërkesave për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevojë të veçanta arsimore nga komisioni i DKA	37.17
Shkalla e sigurimit të mbështetjes me pedagog - asistent ndihmës për fëmijët / nxënësit me nevojë të veçanta në klasat e rregullta	26.94

Sa i përket të dhënave krahasimore të përgjithshme për komuna, në vijim është paraqitur figura me të arriturat e kësaj fushe:



Fig.17. Krahasimet sipas komunave në fushën e arsimit parauniversitar

Fusha 15 – Kujdesi primar shëndetësor

Kjo fushë matë infrastrukturën dhe hapësirat e destinuara për shëndetësinë primare, resurset dhe personelin e mjaftueshëm, si dhe ofrimin e shërbimeve nga niveli komunal. Sipas të dhënave të raportuara nga komunave, kjo fushë ka nivel të ulët të performancës në përgjithësi, apo 41.73%. Në vijim është paraqitur figura me % e performancës sipas treguesve në këtë fushë:

Treguesit	%
Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe fëmijë	67.11
Njësitë e shëndetësisë primare me pajisje dhe shërbime laboratorike sipas udhëzimit administrativ	50.20
Niveli i pajtueshmërisë me ekipet e mjekësisë familjare dhe shëndetit oral	41.45
Fëmijë të përfshirë në program të imunizimit	0.00

Tab.26. % e treguesve në fushën e shëndetësisë primare

Pasqyra e mësipërme e të dhënave tregon se gjithsej përfshirja e fëmijëve në programin e imunizimit është në shkallën 0.00%. Komunitat nuk kanë bashkangjitur dokumentet që kërkohen sipas Dokumentit kryesor për këtë tregues. Gjithashtu, ofrimi i kujdesit shëndetësor specialistik për gra e fëmijë është përmbushur në 67.11%.

Në vijim është paraqitur performanca e fushës përqindje për secilën nga komunitat e Kosovës:



Fig.18. Krahasimet sipas komunave në fushën e shëndetësisë primare

Fusha 16 – Zhvillimi Ekonomik Lokal

Kjo fushë merr aktivitetet e planifikuara dhe të zbatuara për zhvillimin e aktivitetit ekonomik në nivel lokal duke mobilizuar pronat komunale, dhe përditësim i rregullt i regjistrit të tatimpaguesve si dhe shkallë e lartë e inkasimit të tatimit në prone. Kjo fushë ka performancën e përgjithshme prej 43.66%, në vitin 2024.

Treguesit	%
Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim	43.42
Strategjia për zhvillim ekonomik lokal	28.78
Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në prone (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	22.88

Tab.27. % e treguesve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal

Fusha e Zhvillimit Ekonomik Lokal është prezantuar nga 4 tregues në grafikun më lartë. Strategjia për zhvillim ekonomik lokal është përbushur nga komunat 28.78%. Kurse niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në prone pa borxhe interes dhe ndëshkime është përbushur në 22.88%, Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale në shfrytëzim është përbushur në 43.42%.



Fig.19. Krahasimet sipas komunave në fushën e zhvillimit ekonomik lokal



Sipas figurës së mësipërme vërejmë se mbi mesataren e vendit për vitin 2025 janë 18 komuna, kurse nën mesatare janë 8 komuna. Komuna e Suharekës ka arritur rezultatin më të lartë prej 85.03% të treguesve për këtë fushë, renditet e dyta komuna e Rahovecit me 83.39% dhe e treta komuna e Podujevës me 76.04%.

Konkluzione dhe rekomandime

Një nga prioritetet kryesore nga ky raport është forcimi i sistemit të raportimit dhe verifikimit të të dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK). Për këtë arsye, rekomandohet që Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të organizojë trajnime shtesë për koordinatorët, zyrtarë komunalë të performancës dhe nje administrim më efikas nga drejtoritë komunale, me qëllim që të sigurohet një kuptim i plotë i procedurave të raportimit dhe shmangies së të dhënave të pavlefshme. Po ashtu, është e nevojshme të hartohen udhëzime të standardizuara për dokumentimin e të dhënave dhe të krijohen mekanizma për konsultime paraprake me komunat, në mënyrë që të garantohet cilësia e raportimit para finalizimit të rezultateve. Një tjetër element thelbësor është nxitja e qeverisjes së mirë. Komunat duhet të angazhohen në zbatimin e plotë të standardeve minimale të konsultimit publik, duke mundësuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje. Përfshirja më e gjerë e qytetarëve në proceset buxhetore dhe në hartimin e planeve zhvillimore do të kontribuojë drejtpërdrejt në forcimin e llogaridhënies dhe transparencës.

Përveç kësaj, rekomandohet që komunat të rrisin efikasitetin në përdorimin e fondeve publike. Ky qëllim mund të arrihet duke fokusuar investimet në projekte kapitale që adresojnë boshllëqet më të theksuara strukturore, si transporti publik, infrastruktura rrugore apo ndërtimi i çerdheve dhe shkollave të reja. Njëkohësisht, duhet përmirësuar zbatimi i planit të prokurimit dhe mbikëqyrja e kontratave për të siguruar që fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efektive.

Vlerësimi i performancës komunale për vitin 2025 nxjerr të gjetura të shumta për 16 fusha të kompetencave komunale. Përfundimet e këtij raporti theksojnë një numër të madh të çështjeve, të cilat duhet të merren parasysh dhe trajtohen me prioritet nga organet e pushtetit lokal:

Në fushën e **shërbimeve publike administrative**, rekomandohet që komunat të zgjerojnë më tej ofrimin e shërbimeve elektronike për qytetarët, duke i bërë ato të qasshme në mënyrë online. Thjeshtimi i procedurave administrative mbetet një domosdoshmëri për të zvogëluar barrën burokratike, ndërsa vendosja e standardeve të njëjta për kohën e trajtimit të kërkesave do të sigurojë një qasje më të barabartë dhe efikase në të gjitha komunat.

Në fushën e **transparencës komunale**, është e domosdoshme të sigurohet publikimi i të gjitha dokumenteve kryesore si buxhetet, planet komunale dhe vendimet e kuvendit, në format të hapur dhe të lehtë për t'u lexuar nga qytetarët. Transmetimi online i seancave të kuvendeve komunale duhet të bëhet praktikë e detyrueshme, ndërsa raportet periodike mbi proceset e konsultimeve publike duhet të publikohen rregullisht, duke dëshmuar ndikimin e qytetarëve në vendimmarrje.

Sa i përket **përgjegjshmërisë komunale**, rekomandohet rritja e përqindjes së qytetarëve që marrin pjesë në konsultimet publike, në përputhje me standardin e SMPK-së. Funkcionalizimi i këshillave lokalë duhet të trajtohet si prioritet, pasi ato janë mekanizma të rëndësishëm të demokracisë vendore. Gjithashtu, komunat duhet të përmirësojnë nivelin e adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, i cili aktualisht mbetet i ulët. Monitorimi i pagesave brenda afateve ligjore është gjithashtu i nevojshëm për të shmangur vonesat dhe për të rritur efikasitetin financiar.



Në fushën e **barazisë në punësim dhe shërbimeve sociale**, është e nevojshme që komunat të zbatojnë realisht kuotat për punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe të sigurojnë mbështetje për komunitetet joshumicë. Investimet në banimin social dhe përkujdesja për familjet në nevojë duhet të forcohen, ndërsa fëmijët që kanë nevojë për strehim duhet të kenë mbështetje të garantuar përmes programeve të dedikuara.

Fusha e **kulturës, rinisë dhe sportit** ka treguar rezultate të mira, por rekomandohet që komunat të sigurojnë financim të qëndrueshëm për organizatat kulturore lokale dhe të nxisin partneritete me sektorin privat për të përmirësuar ofertën e aktiviteteve kulturore dhe sportive. Për më tepër, duhet të krijohen hapësira të reja sportive dhe kulturore, duke iu dhënë prioritet zonave që kanë mungesa të theksuara.

Në fushën e **menaxhimit të fatkeqësive**, komunat duhet të hartojnë dhe zbatojnë plane të mirëfillta për reagim emergjent, pasi aktualisht niveli i realizimit mbetet i ulët. Trajnimet për stafin komunal mbi menaxhimin e rreziqeve dhe fuqizimi i koordinimit ndërkomunal për ndërhyrje të shpejta janë hapa të domosdoshëm për të rritur sigurinë e qytetarëve.

Sa i përket **planifikimit hapësinor**, rekomandohet rritja e mbulimit të territorit të komunave me plane rregulluese të hollësishme, pasi kjo ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin urban dhe rural të qëndrueshëm. Kontrolli i rreptë i ndërtimeve të reja për respektimin e lejeve ndërtimore duhet të jetë prioritet, ndërsa integrimi i planifikimit hapësinor me strategjitë e zhvillimit ekonomik lokal do të sigurojë zhvillim të balancuar.

Në fushën e **hapësirave publike**, komunat duhet të punojnë në rritjen e sipërfaqeve të gjelbra për kokë banori dhe të sigurojnë mirëmbajtje të rregullt të parqeve dhe ndriçimit publik. Investimet në hapësira rekreative dhe shëtitore janë të rëndësishme për të rritur cilësinë e jetesës së qytetarëve, sidomos në zonat urbane të mbipoplluara.

Sa i përket **infrastrukturës rrugore**, rekomandohet orientimi i investimeve drejt ndërtimit të trotuareve, shtigjeve për biçikleta dhe përmirësimit të ndriçimit publik, që aktualisht mbeten të mangëta. Riasfaltimi i rregullt i rrugëve lokale dhe mirëmbajtja e tyre gjatë stinëve janë po ashtu të domosdoshme. Një fokus i veçantë duhet të jetë vendosja e shenjzimit horizontal dhe vertikal në të gjitha rrugët lokale për të rritur sigurinë në trafik.

Në fushën e **transportit publik**, komunat duhet të hartojnë dhe zbatojnë plane të mobilitetit lokal, të zgjerojnë rrjetin e transportit publik për të përfshirë më shumë vendbanime dhe të vendosin infrastrukturë të përshtatshme për stacionet dhe ndalesat e transportit. Kjo do të përmirësonte ndjeshëm qasjen e qytetarëve në shërbimet komunale dhe do të ndikonte në uljen e trafikut privat.

Në fushën e **shërbimeve publike**, përfshirë ujë, kanalizimin dhe menaxhimin e mbeturinave, komunat duhet të përfundojnë projektet e ujësjellësit dhe kanalizimit, sidomos në zonat rurale. Përmirësimi i sistemit të inkasimit të pagesave për shërbimin e mbeturinave dhe përdorimi i teknologjive moderne për riciklim dhe menaxhim të qëndrueshëm të tyre janë hapa që duhet të ndërmerren në të ardhmen.

Në fushën e **mbrojtjes së mjedisit**, rekomandohet hartimi dhe zbatimi i planeve lokale për mjedisin, pasi aktualisht ato janë realizuar vetëm në një shkallë shumë të ulët. Monitorimi i vazhdueshëm i ndërtimeve për respektimin e lejeve mjedisore duhet të forcohet, ndërsa ndërgjegjësimi i qytetarëve për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm.

Sa i përket **përfaqësimit gjinor**, komunat duhet të rrisin numrin e grave në pozita vendimmarrëse në administratë dhe të mbështesin programet që promovojnë barazinë gjinore në nivel lokal. Fushatat



vetëdijësuese për rolin e grave në politikën vendore janë të domosdoshme për të rritur përfshirjen e tyre aktive.

Në fushën e **arsimit parauniversitar**, rekomandohet zgjerimi i rrjetit të çerdheve dhe shkollave, sidomos në zonat rurale, për të siguruar qasje më të barabartë në arsim. Përmirësimi i kushteve teknike dhe higjienike në shkolla, digjitalizimi i tyre dhe pajisja me mjete bashkëkohore mësimore janë investime që duhet të jenë prioritet. Një fokus i veçantë duhet të jetë reduktimi i mbingarkesës në klasa, që mund të arrihet përmes ndërtimit të objekteve të reja shkollore.

Në fushën e **kujdesit parësor shëndetësor**, komunat duhet të investojnë në ngritjen e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, përfshirë ndërtimin e qendrave të reja të mjekësisë familjare dhe furnizimin me pajisje moderne. Rritja e numrit të personelit shëndetësor në nivel komunal është e domosdoshme, ndërsa duhet të hartohen plane të veçanta për ofrimin e kujdesit shëndetësor në zonat rurale dhe më pak të zhvilluara.

Në fund, në **fushën e zhvillimit ekonomik lokal**, rekomandohet hartimi i strategjive të qarta për të tërhequr investime private, krijimi i zonave ekonomike dhe mbështetja për ndërmarrjet e vogla e të mesme. Përfshirja e komunave në projekte të partneritetit publik-privat do të mundësonte zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Shtojcë: % e treguesve sipas fushave

Fushat	Treguesit	%	%
Fusha 1:	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit	77.65	74.01
Shërbimet publike administrative	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	77.68	
	Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna	79.65	
	Shërbimet administrative të thjeshtuara për zvoglimin e barrës administrative në nivel komunal	61.05	
Fusha 2:	Treguesit	%	%
Transparenca komunale	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe transmetuara drejtpërdrejtë online	53.04	59.64
	Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët	79.70	
	Përbushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës	84.21	
	Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal në faqen zyrtare të komunës	64.26	
	Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës	42.49	
	Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit	53.68	
	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës	55.38	
Fusha 3:	Treguesit	%	%
Përgjegjëshmëria komunale	Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike	54.61	71.33
	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	27.19	
	Adresimi i kërkesave të qytetarëve në takimet për buxhet	47.58	
	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	37.73	
	Dëgjime publike për KAB, buxhet komunal dhe buxhetimi me pjesëmarrje	73.86	
	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	32.68	
	Funksionimi i këshillave lokal	22.37	
	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	61.58	
	Diskutime për raportet tre-mujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	40.13	
	Diskutim për raportin e performancës komunale nga kuvendi komunal për vitin paraprak	36.84	
	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Kuvendin Komunal	52.63	
	Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga auditori i brendshëm	22.16	
	Mbledhjet e Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	42.80	
	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	58.54	
	Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve	46.06	



	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit	33.48	
	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit në kuvendin komunal	36.84	
	Pezullimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre	76.32	
	Përgatitja e planit për zhvillimin e personelit	86.84	
Fusha 4:	Treguesit	%	%
Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare	Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale	21.19	33.81
	Zyrtarë Publik të punësuar nga komunitetet jo shumicë në institucionet komunale	37.22	
	Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi social	49.25	
	Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi	35.75	
	Programi trevjeçar komunal i banimit social	30.26	
Fusha 5:	Treguesit	%	%
Kulturë, Rinë dhe Sport	Hapësira për aktivitete të sportit për numër të banorëve	55.77	63.21
	Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal	70.65	
Fusha 6:	Treguesit	%	%
Menaxhimi i fatkeqësive	Niveli i realizimit të planit komunal për Reagim Emergjent	15.24	45.44
	Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	75.64	
Fusha 7:	Treguesit	%	%
Planifikimi Hapësinor	Territori i komunës i rregulluar sipas planeve hapësinore komunale	44.74	50.84
	Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit	75.30	
	Objekte të inspektuara me leje të ndërtimit	38.59	
Fusha 8:	Treguesit	%	%
Hapësirat Publike	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m ² për kokë banori	23.68	31.52
	Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht	33.44	
	Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik	37.44	
Fusha 9:	Treguesit	%	%
Infrastruktura Rrugore	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës	24.50	28.77
	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit	37.93	
	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare	16.78	
	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik	28.44	
	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal	37.28	
	Rrugët me shteg të biçikletave	12.83	
	Rrugë lokale të riasfaltuara	36.33	
Fusha 10:	Treguesit	%	%
Transporti Publik	Realizimi i planit komunal për transport lokal publik (planit të mobilitetit)	17.04	24.79
	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	33.39	



	Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik	23.95	
Fusha 11:	Treguesit	%	%
Shërbime Publike	Realizimi i Planit për investime kapitale në sistemin e ujësjellësit	29.82	40.81
	Realizimi i Planit për investime kapitale në sistemin e kanalizimit	36.84	
	Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	15.23	
	Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave	57.88	
	Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave	64.26	
Fusha 12:	Treguesit	%	%
Mbrotja e Mjedisit	Lejet mjedisore komunale të lëshuara	48.36	47.87
	Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale	47.36	
Fusha 13:	Treguesit	%	%
Përfaqësimi Gjinnor	Gratë e punësuara në institucione/administratën komunale	62.56	34.13
	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive	48.54	
	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	47.29	
	Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale	78.95	
	Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale	8.70	
	Pjesëmarrja e grave në konsultime publike	40.84	
	Realizimi i planit komunal për barazi gjinore	31.54	
	Përfaqësimi gjinnor tek emërtimet e rrugëve	14.80	
	Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive	19.19	
Fusha 14:	Treguesit	%	%
Arsimi parauniversitar	Shkolla me masa të eficientë të energjisë	26.48	32.28
	Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar	42.03	
	Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar	38.50	
	Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësuesdhënëse	28.84	
	Fëmijë që vijnë në kopshtin	5.85	
	Mesatarja në rezultatet e testit të arritshmërisë për klasat e 9-ta	23.75	
	Kalueshmëria në maturën kombëtare për klasat 12 -të (ndarja sipas gjinisë)	34.62	
	Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse)	57.40	
	Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit	41.09	
	Trajtimi i kërkesave për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore nga komisioni i DKA	37.17	
	Shkalla e sigurimit të mbështetjes me pedagog - asistent ndihmës për fëmijët / nxënësit me nevoja të veçanta në klasat e rregullta	26.94	
Fusha 15:	Treguesit	%	%
Kujdesi primar shëndetësor	Njësitë e shëndetësisë primare me pajisje dhe shërbime laboratorike sipas udhëzimit administrativ	50.20	41.73



	Niveli i pajtueshmërisë me ekipet e mjekësisë familjare dhe shëndetit oral	41.45	
	Fëmijë të përfshirë në program të imunizimit	0.00	
	Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe fëmijë	67.11	
Fusha 16:	Treguesit	%	%
Zhvillimi Ekonomik Lokal	Strategjia për zhvillim ekonomik lokal	28.78	31.69
	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim	43.42	
	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	22.88	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



R A P O R T

**PËR SITUATËN EKONOMIKE FINANCIARE DHE ZBATIMIN E PLANEVE
INVESTUESE PËR JANAR – QERSHOR 2026**

Shtator 2026

Hyrje

Në këtë raport është paraqitur puna dhe aktivitetet e qeverisë komunale nga janari deri në fund të muajit qershor 2026, bazuar në planifikimin që është bërë në këtë vit si për projektet prioritare ashtu edhe për punët dhe aktivitetet për secilën drejtori dhe sektorë me qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara.

Sa i përket projekteve kapitale, prioritetin ia kemi dhënë vazhdimëti të projekteve nga viti paraprak të cilat kanë mbetur të pa përfunduara, megjithëse kemi hasë në vështirësi për shkak të mungesës së mjeteve financiare të cilat janë tërhequr nga përmbaruesit bazuar në vendimet gjyqësore të cilat janë marrë për obligimet që kanë rrjedhë nga kontratat kolektive të disa viteve më parë. Ky problem i mungesës së mjeteve huxhetore për projektet e planifikuara nga ka përcjellë në këto vite të fundit e që janë duke ata përcjellë edhe tani. Për më keq nuk ka të dhëna të sakta se kur do të përfundojnë këto borxhe të cilat janë duke u ekzekutuar pa paralajmërim dhe për pasojë kemi ngecje në realizimin e projekteve tani më të filluara. Ngecje kemi edhe në realizimin e obligimeve nga kategoritë tjera: mallra dhe shërbime, subvencione dhe komunalit.

Për dallim nga vitet e kaluara, këtë vit, për shkak të mungesës së mjeteve të nevojshme buxhetore nuk kemi mundur të ndajmë bursa për student, pastaj nuk kemi ndarë subvencione për bujq, përveç atyre të cilat janë planifikuar të ipen nga Ministria e Bujqësisë ku bujqit e komunës sonë kanë aplikuar përmes Drejtorisë për bujqësi. (1700 aplikant).

Gjithashtu këtë vit nuk kemi pasë mundësi të shpallim thirrje publike për subvencionim të Organizatave joqeveritare, shoqatave të dalë nga lufta etj -- arsyetja, mungesa e mjeteve buxhetore.

Në vijim po paraqesim projektet kapitale të planifikuara me buxhetin e vitit 2026 të realizuara apo në realizim, si në vijim:

Projekti: Ndërtimi i stacionit të autobusëve – për këtë projekt, për vitin 2026 janë parapa 20,000 euro. Duke qene se prona në të cilën është parapa të realizohet ky projekt (parcela të ish Kooperativa bujqësore) është nën menaxhim të AKP-së dhe kemi bërë kërkesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për shpronësime të tokës, por deri tani nuk kemi marrë përgjigje. Nëse kjo kërkesë realizohet pjesa tjetër e mjeteve për realizim të këtij projekti do të planifikohet me buxhetin e vitit 2027.

Projekti, Ndërtimi i kanalizimeve ka filluar në shumicën e fshatrave në të cilat nuk është i shtrirë rrjeti i kanalizimit por në mungesë të mjeteve buxhetore punët në këto projekte janë ndërpre.

Projekti Ndërtimi i vigut në Novolan është në përfundim e sipër.

Projekti, Rregullimi dhe pastrimi i harrit "Siltica" është në realizim.

Projekti: Rregullimi i bulevardit "Adem Jashari" - në realizim

Projekti, Ndërtimi i rrugës 2 Maji është gjithashtu në realizim.

Projekti, Restaurimi i objektit "Arkivi i vjetër" -- ish fshatra e vjetër, është i përfunduar.

Projekti, Ndërtimi i stacionit të pompimit në pjesën lindore të Vushtrisë - në procedurë të ekzekutimit

Projekti, Ndërtimi i vigut në Novolan, i përfunduar

Projekti, Njërtimi i parkut te dyneku, nuk ka filluar në mungesë të mjeteve buxhetore

Projekti, Rregullimi i Rr. "Isak Halili" - në realizim

Projekti, Ndërtimi i Rr. "Bekim Berisha: - i përfunduar

Projekti, Ndërtimi i Rr. "Avni Saraqi" - i përfunduar

Projekti, Ndërtimi i Rr. "Lumni Surdulli" - i përfunduar

Projekti, Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve lokale nëpër fshata si:

- Vërnice – Shalë, Akashticë, Bukosh, Dolak - në procedurë të ekzekutimit
- Smrekonicë dobërllukë, Sllatinë, Pasomë – nuk ka filluar
- Dumnicë, Maxhunaj, Stanoc, Lumadh, Vilanc, Ropicë, Pestovë - në procedurë të ekzekutimit
- Gracë – nuk ka filluar, Prelluzhë – ka filluar
- Samadrexhë - nuk ka filluar, Studime e Ulët – ka filluar, Ceceli – nuk ka filluar, Sfaraçak - ka filluar.
- Stroc, Beqek Gllavatin dhe Zhilivodë – nuk ka filluar, Bivolak – ka filluar,
- Duboc, Beqik – nuk ka filluar
- Projekti, Rregullimi i memorialëve në Gllavatin, Reznik, Beqik, DubocGalicë, Pantinë, Studime, Zhilivodë, Pasomë - në procedurë të ekzekutimit
- Projekti, Ndërtimi i fushave Sportive në NMaxhunaj, Lumadh Stanoc Reznik Pestovë Dobërllukë Pantinë Shitaricë, Novolan, Druar Samadrexhë Beqik dhe Bruznik - në procedurë të ekzekutimit
- Projekti Ndërtimi i tregut të gjelbër - është në fazë të përfundimit,
- Projekti Ndërtimi i qerdheve – nuk ka filluar

Te fondi për projekte për bashkëfinancim me donatorë jemi në fazën e nënshkrimit të marrëveshjes me KEDS-in për realizim të projektit "Rrjeti i TM 10(20) kV dhe TU 04 kV – Vesekofe" në vlerë prej 241,937.42 € në të cilin KEDS merr pjesë me 51% ndërsa Komuna e vushtriasë me 49% nga vlera e përgjithshme e projektit.

Te projektet tjera me donatorë vlen të përmendim marrëveshjet që i kemi nënshkruar të cilat janë në fazën e realizimit të tyre si: Islamic Relief me të cilën kemi arritur marrëveshje me bashkëfinancim për ofrim të shërbimeve shëndetësore për gratë lehona dhe persona të moshuar si dhe atyre me sëmundje të rënda përmes vizitave të drejtpërdrejta në terren. Pastaj, me "Ibër Lepencin" poashtu kemi lidhë marrëveshje për subvencionimin e bujqve me 50% për ujitje të kulturave bujqësore ndërsa sa i përket subvencionimit me 5 cent për liter qumësht të fermerëve, dhe subvencionimit të bletarëve me 4 euro për koshere të bletëve këtë vit nuk i kemi subvencionuar në mungesë të mjeteve buxhetore por i kemi kryer pagesat për vitin 2024 dhe 2025 pasi që këto borxhe nuk kanë mundur të kryhen me kohë për shkak të mungesës së jetëve buxhetore.

Në fushën e kulturës, janë zhvilluar aktivitete të shumta. Vlen të përmendim që edhe në këtë vit sikurse edhe vitet e kaluar kemi organizuar manifestimin "Ditët e Diasporës" në fund të muajit korrik dhe fillim të muajit gusht ku disa ditë me radhë kanë performuar grupe të ndryshme muzikore para qytetarëve të shumtë në sheshin "Adem Jashari" me këngëtarë nga vendi dhe shtete të ndryshme si: Turqia, Bullgaria, Meksika etj.

Sa i përket punëve në administratë, për muajin korrik dhe gusht të këtij viti kemi parapa që në sektorin e gjendjes civile të punohet edhe ditëve të shtuna në mënyrë që të iu ofrohen kushte dhe mundësi bashkatdhetarëve tan të cilët vijnë për pushime që të pajisen me dokumente personale.

Kemi shënuar progres të jashtëzakonshëm në transparencën komunale buxhetore, ku në raportin vjetor të Institutit GAP, kemi siguruar vendin e parë në Kosovë me 100 pikë.

Jemi të vetëdijshëm që kemi edhe shumë punë për të bërë por për sa i përket realizimit të objektivave tona por problem kryesor edhe në muajt në vazhdim të këtij viti mbetet mungesa e mjeteve buxhetore.

Në vijim të këtij raporti do të i paraqesim në mënyrë të detajuar punët që janë kryer në secilën drejtori përkatësisht sektorë gjatë këtij gjashtëmuaji.

Buxhet dhe Financa

Planifikimi i buxhetit për periudhën Janar-Qershor 2026 është si në vijim

• Paga dhe mëditje.....	9,080,058.48€
• Mallra dhe shërbime.....	4,903,774.62€
• Shpenzime Komunale.....	507,474.17€
• Subvencione dhe transfero.....	2,241,015.04€
• Investime kapitale.....	3,941,310.69€

Totali i buxhetit për vitin 2026 është..... 20,673,633.00€

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar-Qershor 2026 është si në vijim

• Paga dhe mëditje.....	9,047,012.28€
• Mallra dhe shërbime.....	4,342,942.69€
• Shpenzime Komunale.....	498,478.78€
• Subvencione dhe transfero.....	2,197,461.62€
• Investime kapitale.....	3,861,198.99€

Totali i buxhetit për vitin 2026 është..... 19,947,094.36€

Sqarim: Sipas kategorive të shpenzimeve buxheti i planifikuar për periudhën Janar-Qershor 2026.

Realizimi është 20,673,633.00,Realizimi i shpenzimeve është 19,947,094.36 euro,Realizimi 96%.

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar – Qershor 2025

PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT									
PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VJETORE				Viti i kaluar
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti i planifikuar për 2025	Buxheti i mbetur për 2025	Plani i reviduar 2025	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Shpenzimi i realizuar për periudhën e njëjtë 2025
		4	5	6 = 5/4*100	7	8= 7-5	9	10 = 7-9	11
		€	€	%	€	€	€	€	€
Financimi nga huamirret	04			0%		0.00	0.00	0.00	
Granti Qeveritar	10	18,605,257.34	18,529,575.46	100%	28,464,288.20	7,934,712.74	0.00	25,464,288.20	15,058,858.35
Të hyrat vetanake	21	2,034,519.64	1,399,887.50	69%	3,827,647.08	2,427,759.58	0.00	3,827,647.08	1,628,867.34
Mjetet e bërta	22			MDIV/01			0.00	3,623.23	728755.12
Donacionet e brendshme	31	3,623.23		0%	3,623.23	3,623.23	0.00	12,238.46	
Donacionet e jashtme	32	30,232.79	17,631.40	58%	12,238.46	3,623.23	0.00	12,238.46	7,387.40
TOTALI		20,673,633.00	19,947,094.36	96%	30,307,796.83	10,360,702.53	0.00	30,320,035.35	17,423,866.41

Sqarim:Përmbledhja e shpenzimeve sipas burimit të financimit sipas kategorive ekonomike është si vijon:

Granti Qeveritar për periudhën Janar-Qershor 2025,planifikimi është 18,605,257.34 euro,Realizimi i shpenzimit shuma 18,529,575.46euro. Realizimi100%

Kategoria Të Hyrat vetanake fondi 21 për periudhën Janar-Qershor 2025,planifikimi është 2,034,519.64euro,Realizimi i shpenzimit shuma 1,399,887.50euro. Realizimi69%

Donacionet e brendshme të planifikuara janë 3,623.23euro,të shpenzuara në këtë gjashtëmuajorik ka.

Donacionet e jashtme të planifikuara janë 30,232.79euro,të shpenzuara janë 17,631.40euro,realizimi 58%

Totali i planifikimit në këto kategori ekonomike është 20,673,633.00euro,Realizimi është 19,947,094.36eur,përqindja e realizimit 96%

PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE									
PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VJETORE				Viti i kaluar
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar %	Buxheti i planifikuar për 2026	Buxheti i mbetur për 2026	Plani i reviduar 2026	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Shpenzimi i realizuar për periudhën e njëjtë 2025
		€	€	%	€	€	€	€	€
Zyra e Kryetarit	160	312,466.11	267,466.11	86%	444,641.20	177,175.09	0.00	444,641.20	262,062.18
Administrata dhe personeli	163	375,627.56	339,345.78	90%	646,697.72	305,351.96	0.00	646,697.72	359,978.93
Inspeksionet	166	91,224.24	91,224.24	100%	176,105.80	83,881.56	0.00	176,105.80	89,659.78
Prokurimi	167	28,742.18	28,742.18	100%	55,518.02	26,775.84	0.00	55,518.02	20,801.17
Zyra e Kuvendit Komunal	169	186,938.25	186,938.25	100%	295,848.14	108,909.89	0.00	295,848.14	137,393.13
Buxheti dhe financat	175	158,157.99	158,655.09	98%	261,410.60	95,755.51	0.00	251,410.60	101,118.16
shërbime publike, Mbrojtja civile dhe emergjencë	180	4,054,185.80	3,880,746.48	96%	5,001,099.97	1,120,353.51	0.00	5,001,099.97	3,860,026.18
Zyra lokale e komuniteteve	195	66,884.56	66,884.56	100%	113,787.80	46,903.24	0.00	113,787.80	41,582.62
Bajqësi, pylltari, zhvillimi rural	470	1,448,247.79	1,393,802.91	96%	2,073,817.00	680,014.09	0.00	2,073,817.00	1,573,744.50
Gjendësi dhe Kadashtëri	650	76,330.09	76,330.09	100%	142,734.40	66,406.31	0.00	142,734.40	64,024.19
Planifikimi urban dhe mjedisi	660	2,482,324.03	2,471,223.86	99%	2,991,159.80	519,935.92	0.00	2,991,159.80	1,503,372.55
Shëndetësia primare	730	2,048,341.44	2,057,888.23	101%	3,380,811.40	1,322,923.17	0.00	3,380,811.40	1,946,339.95
Shërbimet sociale rezidenciale		392,234.18	392,114.10	100%	695,827.80	203,713.70	0.00		161,047.16
kulturë, rinë, sport	850	772,395.18	741,738.72	96%	991,052.38	249,312.66	0.00	991,052.38	431,875.12
Arsimi	920	8,171,834.60	7,798,992.78	95%	13,149,282.86	5,352,290.08	0.00	13,149,282.86	8,890,968.61
TOTALI		20,673,633.00	19,947,094.36	96%	30,307,796.89	10,360,702.53	0.00	30,307,796.89	17,423,866.41
Sqarim: Sipas kategorive të shpenzimeve buxheti i planifikuar për periudhën Janar-Qershor 2026. Planifikimi është 20,673,633.00, Realizimi i shpenzimeve është 19,947,094.36 euro, Realizimi 96%.									

Emri i Komunës :	K.K.VUSHTRRI								
Kodi i Komunës:	644								
Periudha raportuese Janar - Mars 2026									

TE HYBAT VETANAKE (THV) SIPAS DREJTORIVE DHE KODIT EKONOMIK

Pershkrimi	Kodi	Periudha raportuese			Vjetore				Vite i shuar
		Buxheti i planifikuar për PR	Te hyrat e realizuar në PR	Përqindja e buxhetit të realizuar për PR $\frac{B}{A} \times 100$	Buxheti i planifikuar për 2026	Buxheti i mbetur për 2026	Plani i reviduar	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar $10 - 7-8$	Te hyrat e realizuara ne periudhen e njëjte 2025
		A	B		7	8= 7-6	9		11
		€	€	%	€	€	€	€	€
Administrata dhe personeli	188								
Taksa administrative		60,000.00	32,029.00	53%	130,000.00	67,971.00	0.00	120,000.00	17,989.00
TOTAL		60,000.00	32,029.00	53%	130,000.00	67,971.00	0.00	120,000.00	17,989.00
Buxheti dhe Financa	179								
Taksat e firmave		7,500.00	7,500.00	100%	15,000.00	7,500.00	0.00	16,000.00	8,250.00
Taksa per regjistrim te automj			68,980.00						
Tatimi ne proni		666,733.50	527,505.00	79%	1,333,507.00	806,000.01	0.00	1,333,507.00	270,824.00
TOTAL		674,233.50	603,985.00	90%	1,348,507.00	813,500.01	0.00	1,348,507.00	279,074.00
Arsleri	900								
Mirja e produkteve bujq.				0%		0.00	0.00	0.00	
Participimi ne garat		55,000.00	61,432.00	233%	70,000.00	-11,432.00	0.00	70,000.00	19,522.00
Shkolle e Mesme Te shkolle e Mesme Per		7,000.00	20,972.00	280%	15,000.00	-8,972.00	0.00	16,000.00	4,859.00
Shkolle e Mesme Per		7,000.00	19,850.00	283%	14,000.00	-5,650.00	0.00	14,000.00	5,230.00
TOTAL		49,000.00	122,254.00	247%	89,000.00	-23,074.00	0.00	99,000.00	29,591.00
Gjeoenerji dhe Kadezitet	650								
Motjet e tokave		55,000.00	42,083.00		70,000.00	27,917.00		70,000.00	27,442.00
Jetese e pronetive		0.00	2,596.00						
Qiraja nga objektet		26,000.00	22,480.00	86%	53,000.00	30,520.00	0.00	53,000.00	3,000.00
TOTAL		81,000.00	67,159.00	100%	123,000.00	38,437.00	0.00	123,000.00	30,442.00
Kulturë, rinia dhe sport	850								
Palestra e sportit		250.00		0%	500.00	500.00	0.00	500.00	120.00
Siblioteka		250.00		0%	500.00	500.00	0.00	500.00	
Parkingu		250.00	474.00	190%	500.00	26.00	0.00	500.00	
TOTAL		750.00	474.00	63%	1,500.00	1,026.00	0.00	1,500.00	120.00
Shërbime e publikë	180								
Parkingu		1,500.00	3,217.25	213%	3,000.00	-217.75	0.00	3,000.00	495.00
Regjistrimi i automj		70,000.00	29,010.00	41%	140,000.00	110,990.00	0.00	140,000.00	34,476.00
Taksat e mbeturinave		423,000.00	487,732.22	115%	846,000.00	356,207.78	0.00	846,000.00	150,886.56
TOTAL		494,500.00	820,019.47	105%	989,000.00	468,980.00	0.00	989,000.00	185,410.56
Gujesia	470								
Shitja e Drujeve		0.00		0%		0.00	0.00	0.00	
Ndërrhyrjet i dastinir		7,500.00	33,956.00	453%	15,000.00	-18,956.00	0.00	15,000.00	13,216.00
Leje pune		0.00	30.00	6000%		-30.00	0.00		
TOTAL		7,500.00	34,086.00	453%	15,000.00	-18,986.00	0.00	15,000.00	13,216.00
Shëndeti	700								
Participim		30,000.00	29,490.00	98%	60,000.00	30,510.00	0.00	60,000.00	12,911.99
Participim OPS		3,000.00	3,291.00	109%	2,000.00	-1,291.00	0.00	2,000.00	1,170.00
TOTAL		33,000.00	32,781.00	100%	62,000.00	29,219.00	0.00	62,000.00	14,081.99
Inspektion	186								
Pranimet teknike		2,500.00	3,365.00	98%	5,000.00	2,445.00	0.00	5,000.00	1,725.00
Gjendat e inspektion		2,500.00	800.00	32%	5,000.00	4,200.00	0.00	5,000.00	1,500.00
TOTAL		5,000.00	4,165.00	83%	10,000.00	6,645.00	0.00	10,000.00	3,225.00
Urbanizimi	600								
Lejet e ndërtimit		230,073.50	409,342.91	140%	560,147.00	150,804.00	0.00	560,147.00	65,594.88
Leje mjedisorë		15,000.00	24,787.08		70,000.00	45,262.97	0.00	70,000.00	60.00
Legjislacion i Objektave		7,500.00	8,534.41		15,000.00	8,468.59	0.00	15,000.00	11,441.37
Rezim i objekteve		0.00	1,225.87			-1,225.87	0.00	0.00	688.64
Shfrytëzimi i pronës		2,500.00	1,823.00	73%	5,000.00	3,177.00	0.00	5,000.00	240.00
TOTAL		255,073.50	445,663.22	137%	650,147.00	204,688.78	0.00	650,147.00	78,394.89
850									
Gjendat e pyetjeve				0%		0.00	0.00	0.00	530.00
Te hyrat tjera		0.00	0.00	0%	0.00	0.00	0.00	0.00	521.20
TOTAL		0.00	0.00	0%	0.00	0.00	0.00	0.00	1,051.20
TOTAL		1,709,077.00	1,831,327.28	107%	3,416,154.00	1,566,826.72	0.00	3,416,154.00	686,617.23

Ekonomi

Pasqyra tabelare e bizneseve të regjistruara gjatë periudhës 01.01. – 30.06.2026

CODE	VEPRIMTARITË EKONOMIKE	Bizneset prej 01.01-30.06.2026	%
A	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria dhe peshkimi	/.	
B	Minierat dhe guroret (Industria nxjerrëse)	/.	
C	Industria përpunuese	27	16.08
D E	Furnizimi me energji elektrike dhe ujë Kanalizimi aktivitetet e menaxhimit dhe të trjtitimit të mbeturinave	/.	
F	Ndërtimtaria	5	2.98
G	Treg.me shumicë dhe pakicë, riparimi i auto. dhe aparateve tjera të amvisërisë	66	39.2
H	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	7	4.17
I	Transporti dhe magazinimi Informimi dhe komunikimi	20	11.90
J	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	15	8.92
K	Aktivitetet e patundshmërisë Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, shërbimet administrative dhe mbështetëse	11	6.54
M	Arsimi	10	5.95
N	Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	7	4.17
O	Artet, argëtimi dhe rekreacioni, aktivitetet tjera shërbyese	/.	
P	Aktivitetet e ekonomive familjare	/.	
	Gjithsej	168	100

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme, si veprimtari dominuese ekonomike është tregtia me 39.2 % apo me 66 biznese prej numrit të përgjithshëm, pastaj industria përpunuese me 27 biznese apo 16.08 %, transporti dhe magazinimi me 11.90% apo me 20. biznese,etj

Pasqyra tabelare e bizneseve të shuara, sipas veprimtarive ekonomike.

Kodi	VEPRIMTARIT EKONOMIK	Bizneset prej 01.01-30.06.2025	%
1	2		
A	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria dhe peshkimi	4	13.8
B	Minierat dhe guroret (Industria nxjerrëse)		
C	Industria përpunuese	4	13.8
D	Furnizimi me energji elektrike dhe ujë		
E	Kanalizimi aktivitetet e menaxhimit dhe të trjtimt të mbeturinave		
F	Ndërtimtaria		
G	Treg.me shumicë dhe pakicë, riparimi i auto. dhe aparateve tjera të amvisërisë	8	27.6
H	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	1	3.45
I	Transporti dhe magazimi Informimi dhe komunikimi	4	13.8
J	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	1	3.45
K	Aktivitetet e patundshmërisë Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, shërbimet administrative dhe mbështetëse	6	20.65
M	Arsimi	1	3.45
N	Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale		
O	Artet, argëtimi dhe rekreacioni, aktivitetet tjera shërbyese		
P	Aktivitetet e ekonomive familjare		
	Totali	29	100

Sic shifet nga te dhënat e tabelës edhe tek shuarjet dominon po ashtu tregtia me 11 biznese apo 36.7% dhe bujqësia me 13.33%etj.

Deri më 30.06.2024 janë kryer gjithsej këto shërbime:

<i>Nr.</i>	<i>Përshkrimi i aktivitetit</i>	<i>Nr.i llojit</i>	<i>Vërejtje</i>
1.	Biznese të reja (të regjistruara)	168	
2.	Shuarje të bizneseve	29	
3.	Ndërrime të logove të certifikatave	115	
4.	Ndryshime në bizneset ekzistuese	84	
5.	Vertetim		
	Gjithsej	396	

Njëkohësisht, vërehet një interesim më i madh i pronarëve për të hapur biznese bujqësore (prodhuese) për shkak të subvencioneve që përfitojnë nga donatorët e ndryshëm, si dhe nga shoqatat e ndryshme joqeveritare, donacione të Ministrisë së Bujqësisë etj.

Bujqësia

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për shkak të kufizimeve buxhetore, në vitin 2026 ka kryer pagesat e subvencioneve të pa paguara nga viti paraprak 2024 dhe 2025, ku janë përkrahë fermerëve lokalë në vlerë totale prej **298,576.10 euro**, duke përfshirë blegtorinë, bletarinë, prodhimin e qumështit dhe projektet e përbashkëta për zhvillim socio-ekonomik.

Më poshtë gjeni raportin e strukturuar të realizimit të deritanishëm:

Përmbledhja Financiare sipas Viteve dhe Programeve për borxhet paraprake

Programi / Sektori i Përkrahjes	Viti 2024 (€)	Viti2025 (€)	Totali (€)
Mbarështimi i kafshëve (Dele, dhi dhe buallica)	16,745.00	0.00	16,745.00
Sektori i Bletarisë (Përkrahje për bletë)	52,075.00	55,625.00	107,700.00
Subvencionimi për Litër Qumësht (Gjashtëmuajshat I & II)	152,131.10	0.00	152,131.10
Bashkëfinancimi me IADK (10 përfitues)	22,000.00	0.00	22,000.00
TOTALI I PËRGJITHSHËM	220,951.10	55,625.00	298,576.10

Janë kryer edhe punë tjera si:

- Ndërrim destinimi i tokës bujqësore; nga data 19.03.2026 te hyra nga ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore gjithsejtë 18,572.00 €
- Marrëveshja për ujitjen e tokave bujqësore me Iber-Lepenc për fermerët e komunës së Vushtrisë ko komuna mbulon shumën me 50% .
- Tri organizime Panairi tre ditore për gratë femërore prodhuese.
- Hapja e disa rrugëve fushore me qëllim krijimin e kushteve për qasje për autokombajna në parcelat e mbjella me grurë Etj.

Gjatë këtij viti, kultura e grurit ka pasur shtrirjen më të madhe në territorin e komunës sonë, ku sipërfaqet e mbjella kanë arritur në gjithsej **3,700 hektarë**, duke u pasuar nga kultura e elbit e cila është kultivuar në një sipërfaqe më modeste prej **60 hektarësh**. Rezultatet e korrjes tregojnë për një ecuri të mirë të prodhimit bujqësor, ku gruri ka shënuar një rendiment mesatar mjaft të lartë prej **5,700 kilogramësh për hektar**, ndërsa për kulturën e elbit është regjistruar një rendiment mesatar prej **3,500 kilogramësh për hektar**. Për të siguruar grumbullimin e suksesshëm të të gjithë këtij prodhimi, në terren kanë qenë të angazhuara gjithsej **63 autokombajna**, të cilat kanë mbuluar të gjitha zonat bujqësore të Vushtrisë. Sa i përket kostos operative, çmimi unik i vendosur për shërbimin e korrje-shirjes gjatë këtij sezoni ka qenë **130 euro për hektar**.

Pavarësisht angazhimit maksimal të sektorit dhe mekanizatorëve, procesi i korrje-shirjeve ka hasur në disa vështirësi të theksuara që kanë ndikuar në dinamikën e punës në terren. Një ndër pengesat kryesore ka qenë

fragmentimi i lartë i tokës, ku parcelat me sipërfaqe të vogla kanë pamundësuar efikasitetin e plotë të makinerisë dhe kanë zgjatur kohën e kryerjes së punimeve. Kjo situatë është rënduar edhe më shumë nga kushtet atmosferike, ku koha me shi të herëpashershëm ka sjellë ndërprerje të vazhdueshme të procesit dhe ka vështirësuar korijen në parametrat e duhur të lagështisë. Po ashtu, një sfidë më vete ka qenë edhe gjendja teknike e makinerisë bujqësore, e cila në disa raste është shfaqur e vjetruar, duke shkaktuar raste të defekteve dhe vonesave të paparashikuara gjatë operimit.

Lidhur me kulturat e tjera bujqësore, siç janë **misri, kungujt, pemët dhe perimet dhe kulturat tjera**, zyrtarët tanë janë duke grumbulluar dhe përpunuar informacionet e fundit nga terreni. Ky raport i dytë është **duke u finalizuar** dhe shumë shpejt do të jetë gati, ku në të do të përfshihen të gjitha të dhënat e plota mbi sipërfaqet, rendimentet dhe ecurinë e vjeljes për këto kultura. (për arsye të vonesave nga MBPZHR për pagesa direkte ky raport mbetet për gjashtë mujorin e dytë).

Administrata

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, Drejtoria ka vazhduar angazhimin në modernizimin e administratës, avancimin e proceseve të digjitalizimit, përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët. Njëkohësisht, ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet qendrore dhe lokale, si dhe me partnerët vendorë e ndërkombëtarë, me qëllim të realizimit të projekteve të përbashkëta dhe avancimit të shërbimeve publike.

Përveç realizimit të detyrave të rregullta administrative, gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë iniciativa konkrete që kanë ndikuar në përmirësimin e infrastrukturës administrative, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Me qëllim të krijimit të një administrate më miqësore dhe më funksionale për qytetarët, janë realizuar këto aktivitete:

- është krijuar **Këndi për Fëmijë** në ambientet e Drejtorisë së Administratës, duke ofruar një hapësirë të përshtatshme për fëmijët e qytetarëve gjatë kohës së pritjes për marrjen e shërbimeve administrative;
- me kërkesë të Drejtorisë së Administratës, Drejtoria për Shërbime Publike ka realizuar **mini-parkun para Zyrës së Gjendjes Civile**, duke përmirësuar dukshëm pamjen dhe funksionalitetin e hapësirës;
- po ashtu është realizuar **rruga e kalueshme për këmbësorë** në oborrin e komunës, duke lehtësuar qarkullimin dhe duke rritur sigurinë e qytetarëve.

Këto ndërhyrje kanë ndikuar në krijimin e një ambienti më të rregullt, më funksional dhe më të qasshëm për qytetarët.

Për shkak të rritjes së kërkesave për shërbime gjatë sezonit veror, Drejtoria ka iniciuar angazhimin e **20 praktikantëve**, në bashkëpunim me Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës.

Pas miratimit të kërkesës, praktikantët janë sistemuar në drejtoritë komunale sipas nevojave të identifikuara, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve administrative dhe përmirësimin e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve.

Në vazhdim të modernizimit të administratës komunale është vazhduar me:

- përdorimin e sistemit elektronik SMAED;
- administrimin elektronik të dokumenteve;

- përdorimin e sistemit **INTRANET**;
- administrimin elektronik të lëndëve;
- përmirësimin e sigurisë së të dhënave;
- furnizimin me pajisje të reja kompjuterike për zyrtarët komunalë.

Këto investime kanë ndikuar në rritjen e efikasitetit të administratës dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve administrative.

Zyra e Gjendjes Civile

Zyra e Gjendjes Civile gjatë kësaj periudhe ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e qytetarëve për të cilat kërkohet një afat ligjor më i shkurtër për shqyrtim dhe përgjigje, ndërsa kërkesat e tjera për të cilat parashihet një afat ligjor më i gjatë për përgjigje janë në fazën e shqyrtimit dhe të përfundimit, sipas afateve ligjore.

Certifikatat dhe dokumentet e lëshuara gjatë periudhës, 01.01.2026-30.06.2026

Nr.	Lloji i certifikatës	Totali
1.	Certifikatës i lindjes	5795
2.	Ekstrakt nga regjistri qendror	12043
2.	Certifikata e martesës	2765
3.	Certifikata e statusit martesor	487
4.	Certifikata e vendbanimit	2980
5.	Certifikata e shtetësisë	586
6.	Deklarata e bashkësisë familjare	1705
7.	Certifikata e vdekjes	1236
8.	Vërtetimi nga arkiva	1588
Gjithsej		29185

Regjistrimet në regjistrat e gjendjes civile:

1.	Regjistrime të lindjes	224
2.	Martesa	243
3.	Regjistrime të vdekjes	179
4.	Regjistrime të lindjes jashtë shtetit	101
5.	Regjistrime të martesës jashtë shtetit	31
6.	Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit	16
Gjithsej		794

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar kërkesat e qytetarëve dhe janë nxjerr këto vendime dhe shkresa të tjera:

01.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të vdekjes	44
02.	Vendime për ndërrimin e emrit ,mbiemrit personal	29
03.	Vendime për anulimin e faktit të lindjes	05
04.	Dëshmi të vdekjes	166
05.	Lajmërimi dhe ç'lajmërimi të adresës së vendbanimit	1854
06.	Vendime për korrigjimin e Akteve të lindjes,vdekjeve, martesese	36
07.	Aplikime për natyralizim(fitim të shtetësisë)	88
08.	Aplikime për humbje të shtetësisë së Kosovës me lirim	02
Gjithsej regjistrime të bëra		2224

Qendra për Shërbim të Qytetarëve

Qendra për Shërbim të Qytetarëve (QSHQ), në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, gjatë periudhës janar-qershor 2026 ka ofruar shërbime administrative për qytetarët në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kompetencat e saj.Gjatë kësaj periudhe është siguruar ofrimi i shërbimeve cilësore, trajtimi profesional i kërkesave të qytetarëve, administrimi korrekt i dokumentacionit zyrtar, si dhe mbështetja administrative për të gjitha drejtoritë komunale.Gjatë periudhës raportuese janë pranuar dhe trajtuar: **27,358 kërkesa administrative.**

Kërkesat sipas drejtorive,

Nr.	Pershkrimi	Nr. Kërkesave
1	Drejtoria për Administratë	19.177
2	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	1.917
3	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	1.757
4	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	18
5	Drejtoria për Shërbime Publike	524
6	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	1.038
7	Drejtoria për Arsim	359
8	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	407
9	Drejtoria për Inspeksion	369
10	Personeli	710

11	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	257
12	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	156
13	Zyra Ligjore	0
14	Kryetari i Komunës	551
15	Drejtoria e Prokurimit	5
16	Kuvendi i Komunës	92
17	Zyra Lokale e Komuniteteve	0
18	Njësia e Auditimit të Brendshëm	0
19	Drejtoria Për Ekonomi dhe Investime Kapitale	21
20	Drejtoria për diasporë dhe Integritet Evropian	0
		27.358

Qendra e Thirrjeve

Qendra e Thirrjeve, është themeluar në vitin 2018 nga Komuna e Vushtrisë, gjatë periudhës raportuese ka regjistruar:

- 916 telefonata
- Mesatarisht 6.9 thirrje në ditë pune
- 741 qytetarë të informuar drejtpërdrejt
- 175 kërkesa të procesuara pa pasur nevojë për prezencë fizike.

Arsimi

Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtri ka zhvilluar aktivitetet e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe prioritetet e përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), në bashkëpunim të vazhdueshëm me Inspektoratin Rajonal të Arsimit, institucionet arsimore, partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe organizatat që mbështesin zhvillimin e arsimit.

Puna e Drejtorisë është fokusuar në:

- përmirësimin e cilësisë në arsim;
- fuqizimin e menaxhimit të institucioneve arsimore;
- zhvillimin profesional të mësuesve;
- mbështetjen e nxënësve;
- avancimin e arsimit profesional;
- zgjerimin e bashkëpunimit me partnerët institucionalë dhe ndërkombëtarë;
- përmirësimin e infrastrukturës shkollore;
- sigurimin e kushteve më të mira për mësues dhe mësues.

Ky raport paraqet në mënyrë të përmblëdhur aktivitetet, rezultatet, investimet, sfidat dhe të arriturat e Drejtorisë Komunale të Arsimit gjatë gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2025/2026.

Numri i nxënësve

Niveli	Numri
Arsimi parashkollor (Niveli 0)	1,329
Arsimi fillor (Kl. I-V)	4,529
Arsimi i mesëm i ulët (Kl. VI-IX)	3,787
Arsimi i mesëm i lartë (Kl. X-XII)	2,194
Gjithsej	11,839

Numri i paraleleve

Niveli	Numri
Parafillor	40
Fillor (I-V)	266
I mesëm i ulët	206
I mesëm i lartë	105
Gjithsej	617

Personeli arsimor

Kategoria	Numri
Zyrtarë të DKA-së	11
Drejtorë	34
UD. Drejtorë	4
Zëvendësdrejtorë	8
Pedagogë	10
Psikologë	10
Asistentë	12
Bibliotekistë	9
Këshilltarë të karrierës	2
Sekretarë	11
Punëtorë teknikë	140
Edukatore	86

Mësimdhënës të klasës	266
Mësimdhënës lëndorë (VI-IX)	372
Mësimdhënës lëndorë (X-XII)	174

Gjithsej personel: 1,149

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar një numër i konsiderueshëm aktiviteteve në funksion të përmirësimit të cilësisë në arsim. Përmes koordinimit të vazhdueshëm ndërmjet Drejtorisë Komunale të Arsimit, institucioneve arsimore, MASHTI-t dhe partnerëve zhvillimorë, janë realizuar projekte, investime, trajnime, gara, aktivitete kulturore, sportive dhe profesionale, duke kontribuar në ngritjen e cilësisë së arsimit në Komunën e Vushtrisë.

Përkundër rezultateve të arritura, gjatë periudhës raportuese janë evidentuar edhe sfida që lidhen me infrastrukturën shkollore, nevojën për pajisje shtesë didaktike, zgjerimin e mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta dhe rritjen e investimeve në zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Zhvillimet, aktivitetet dhe të arriturat

Aktivitetet

- Monitorimi i të gjitha institucioneve arsimore të Komunës së Vushtrisë, me fokus në menaxhimin dhe qeverisjen e shkollave, sigurimin e cilësisë dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi.
- Aktiviteti me fëmijët parashkollor për nder të 17 Shkurtit Ditës së Pavarësisë së Kosovës, në bashkëpunim me DKRS.
- Programi festiv me rastin e 7 Marsit – Ditës së mësuesit, ku dhe u ndanë mirënjohje për mësimdhënësit e dalluar dhe vizitë tek veteranët e Arsimit në bashkëpunim me Kryetarin
- Aktivitete të realizuara për fëmijët me Sindromën Down, në bashkëpunim me Drejtorinë e Administratës.
- Aktivitete me rastin e Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit për Autizmin
- Menaxhimi dhe mbikëqyrja e kontratave për furnizim me material mirëmbajtës, inventar shkollor, material administrativ, lëndë djegëse, transport të nxënësve, internet dhe furnizime të tjera për institucionet arsimore.
- Organizimi i transportit të nxënësve në 36 linja transporti, duke siguruar vijueshmëri të rregullt në procesin mësimor.
- Vlerësimi i tre (3) nxënësve dhe rivlerësimi i nëntë (9) nxënësve me nevoja të veçanta arsimore nga Ekipi Komunal për Vlerësim.
- Subveçionimi i fëmijëve me nevoja të veçanta
- Realizimi i vlerësimit të brendshëm të performancës në institucionet parashkollore "Foleja", "Foleja 2" dhe "Foleja 3".

Bashkëpunimet institucionale

- Bashkëpunim i vazhdueshëm me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Inspektoratin Rajonal të Arsimit dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës – Kolegjiumi për Arsim.
- Bashkëpunim me KFOR-in Slloven (CIMIC) në realizimin e aktiviteteve edukative dhe trajnimeve për mësimdhënës.

- Bashkëpunim me Policinë e Kosovës për organizimin e ligjëratare vetëdijesuese për sigurinë në komunikacion, përdorimin e sigurt të internetit dhe parandalimin e rreziqeve nga mjetet piroteknike.
- Bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Kosovës, Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe institucionet relevante për organizimin e ushtrimit praktik në situata emergjente.
- Bashkëpunim me **Future Minds Academy, Kosovo Education Center, Innovation Academy** dhe partnerë të tjerë në realizimin e aktiviteteve edukative dhe zhvillimore.

Takimet dhe punëtoritë

- Mbajtja e takimeve të rregullta me Inspektoratin Rajonal të Arsimit.
- U zhvillua punëtori me grupin punues për hartimin e draft Rregullores së re për Arsimin Parauniversitar në Komunën e Vushtrisë, ku u diskutuan çështje të rëndësishme në fushën e arsimit dhe u dhanëtribute për hartimin e Rregullores. Punëtori për hartimin e Draft-Rregullores së re për Arsimin Parauniversitar.
- Mbajtja e takimeve të rregullta me përfaqësues të KFOR-it Slloven.
- Pjesëmarrja në takimet e Kolegjiumit për Arsim të Asociacionit të Komunave të Kosovës.
- Organizimi i punëtorive për hartimin e rregulloreve komunale në fushën e arsimit.
- Pjesëmarrja e përfaqësuesve të DKA-së në trajnime profesionale për menaxhimin e projekteve dhe qasjen në fondet e Bashkimit Evropian.
- Certifikimi i 50 mësimitdhënësve në trajnimin "Të Drejtat Tona", të organizuar nga KFOR-i Slloven (CIMIC).

Vizitat

- Vizita të rregullta monitoruese në Qendrën Arsimore të Komunitetit VORAE në Prelluzhë.
- Vizita studimore e përfaqësuesve të SHMT "Lutfi Musiqi" në Holandë dhe Finlandë në kuadër të projektit **CG-International**.
- Vizitë në Denizli, Turqi nga data 23 deri me 27 shkurt, një grup prej pesë nxënësish dhe dy mësimitdhënësish të SHMT "Lutfi Musiqi", me mbështetjen e Drejtorisë së Arsimit dhe Kryetarit të Komunës, vizituan Denizlinë, ku qëndruan dhe zhvilluan aktivitete të ndryshme me shkollën partnere.
- U realizua një turne muzikor në Itali nga nxënësit e shkollës së muzikës "Tefi Tashko", gjatë të cilit u mbajtën katër koncerte artistike në Termoli, Montecilfone dhe Chieuti. Në kuadër të vizitës u vendosën edhe bazat për bashkëpunim ndërmjet shkollave. Në këtë aktivitet morën pjesë Kryetari i Komunës, Drejtoresha e Arsimit, zyrtarja e DKA dhe drejtori i shkollës.
- Vizitë studimore në Shqipëri, me drejtorë të institucioneve edukativo-arsimore.
- Vizita studimore e përfaqësuesve të SHMP "Bahri Haxha" në Athinë, në kuadër të projektit **CG-International**.
- Vizita e eksperteve zvicerane të arsimit parashkollor në institucionet arsimore të Komunës së Vushtrisë.

Projektet

- Vazhdimi i renovimit të SHFMU "Enver Hadri" në Smrekonicë, në bashkëpunim me Komandën Evropiane të Shteteve të Bashkuara dhe MASHTI-n.
- Përzgjedhja e Gjinnazit "Eqrem Çabej" ndër tetë projektet fituese të programit **BELL**.
- Dhurimi i projektit "Panorama" për Gjinnazin "Eqrem Çabej", i cili mundëson prezantimin virtual 360° të objektit shkollor.

- Nënshkrimi i marrëveshjeve me 18 biznese lokale për realizimin e mësimit dual për 30 nxënës të SHMT "Lutfi Musiqi".
- Pjesëmarrja e SHMP "Bahri Haxha" në projektin CultivET.
- Pjesëmarrja e nxënësve në projektin "Drejt Malit", të mbështetur nga MASHTI.

Garat e diturisë dhe garat sportive

Gjatë gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2025/2026, nxënësit e institucioneve arsimore të Komunës së Vushtrrisë morën pjesë në gara të ndryshme të diturisë dhe aktivitete sportive, duke arritur rezultate të rëndësishme në nivel komunal, rajonal, republikan dhe ndërkombëtar.

Garat e diturisë

- Nxënësja **Mirjeta Hasani** nga SHFMU "Andon Zako Çajupi" fitoi vendin e parë në garën e shkrimit në gjuhën gjermane "**Schreibwettbewerb im Rahmen der Tage der Deutschen Sprache 2026**", në kategorinë e shkollave publike për klasat VI–IX.
- Nxënësit e SHFMU "Emin Duraku" në Novolan arritën rezultate të shkëlqyera në **Olimpiadën e Fizikës**, duke fituar vendin e parë për klasat VII dhe VIII, ndërsa vendin e tretë për klasën IX.
- Në garën komunale të eseve në lëndën e Gjuhës Shqipe, nxënësja e SHFMU "Emin Duraku" fitoi vendin e parë në kategorinë e klasave të teta.
- SHFMU "Liria" në Stroc u dallua në garat e gjuhës shqipe. Nxënësja **Sumea Aliu** u shpall "Eseistja më e mirë" në nivel komunal, ndërsa nxënësit **Rrezart Aliu** dhe **Adnit Saraçi** u kualifikuan në finalen e Olimpiadës së Gjuhës Shqipe të organizuar nga Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë. Nxënësja **Rrezarta Aliu** fitoi vendin e tretë.
- SHFMU "Migjeni" në Stanoc të Epërm u rendit në katërshen finale të Olimpiadës Shtetërore të Gjuhës Shqipe.
- SHMU-2 në Vushtrri fitoi vendin e parë në Garat Komunale të Diturisë. Vendin e dytë e fitoi SHFMU "28 Nëntori" në Vërnice, ndërsa vendin e tretë SHFMU "Latif Berisha" në Dobërlukë.
- U organizua Olimpiada Komunale e Gjuhës Shqipe për nxënësit e klasave të nënta. Vendin e parë e fitoi SHFMU "Liria" në Stroc, vendin e dytë SHFMU "Andon Zako Çajupi", ndërsa vendin e tretë SHMU-2.
- Nxënësja **Jara Meniqi** u rendit në vendin e katërt në Olimpiadën Republikane të Fizikës.
- Nxënësi **Laurent Maxhuni** fitoi vendin e parë në Olimpiadën Republikane të Fizikës, ndërsa nxënësi **Redon Hajrizi** u rendit në vendin e dytë. Të dy nxënësit u kualifikuan për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare.

Garat sportive

- Ekipi i futbollit për djem (klasat VI–VII) i SHFMU "Andon Zako Çajupi" u shpall kampion në nivel komunal.
- Ekipi i futbollit për vajza i së njëjtës shkollë fitoi vendin e parë në nivel komunal dhe siguroi pjesëmarrjen në kampin sportiv-rekreativ dimëror në Brezovicë, të organizuar në kuadër të aktiviteteve të MASHTI-t.
- Ekipi i volejbollit për djem i SHFMU "Andon Zako Çajupi" u shpall kampion në nivel komunal.
- SHFMU "Emin Duraku" në Novolan fitoi vendin e parë në garat komunale dhe vendin e dytë në nivel rajonal në disiplinën e volejbollit për vajza.
- Ekipi i basketbollit për vajza i SHMU-2 u shpall kampion në nivel republikan.

- Nxënësit e Gjinnazit "Eqrem Çabej" morën pjesë në garat sportive ndërkombëtare në Ohër, ku ekipi i futbollit për vajza shënoi fitore ndaj përfaqësueses së Gjeorgjisë.
- Gjinnazi "Eqrem Çabej" arriti rezultate të shkëlqyera në garat sportive republikane, duke fituar vendin e parë në hendboll (vajza), futboll (vajza), volejboll (djem) dhe pingpong.
- Në bashkëpunim me **Innovation Academy**, Drejtoria Komunale e Arsimit organizoi garën komunale në shah për nxënësit e klasave të pesta. Vendin e parë e fitoi SHFMU "Mustafë Venhari" në Vushtri.

Rezultatet e arritura në garat e diturisë dhe ato sportive dëshmojnë nivelin e lartë të angazhimit të nxënësve, mësimitdhënësve dhe institucioneve arsimore të Komunës së Vushtrrisë. Këto suksese kanë kontribuar në promovimin e vlerave arsimore dhe sportive, duke përfaqësuar denjësisht komunën në nivel lokal, republikan dhe ndërkombëtar.

Investimet

Në kuadër të investimeve të realizuara janë:

- SHFMU "Dëshmorët" – Zhillivodë është pajisur nga Drejtoria Komunale e Arsimit me një televizor 65 inç dhe një laptop **ASUS Vivobook**, me qëllim të përmirësimit të kushteve për zhvillimin e procesit mësimor dhe përdorimin e teknologjisë në mësimitdhënie.
- SHFMU "12 Qershori" – Mihaliq është pajisur me pajisje për klimatizim, duke kontribuar në krijimin e kushteve më të përshtatshme për nxënësit dhe stafin shkollor.
- Në SHMU-1 Vushtri është realizuar rregullimi i trotuarit përreth objektit shkollor, me qëllim të përmirësimit të sigurisë dhe qasjes së nxënësve dhe personelit në hapësirat shkollore.
- SHFMU "Latif Berisha" – Dobërllukë është pajisur me dy laptopë, një kompjuter dhe dy televizorë LED, të cilat do të shfrytëzohen për avancimin e procesit edukativo-arsimor dhe digjitalizimin e mësimitdhënies.
- SHFMU "Migjeni" – Stanoc i Epërm ka përfituar mbështetje nga Komuna përmes sigurimit të 250 luleve sezonale dhe disa titujve të lekturve për bibliotekën e shkollës, duke kontribuar në përmirësimin e ambientit shkollor dhe pasurimin e fondit të leximit.

Përmes këtyre investimeve është vazhduar përpjekja institucionale për përmirësimin gradual të infrastrukturës, pajisjeve dhe kushteve të përgjithshme në institucionet arsimore të komunës.

Donacionet

Gjatë periudhës raportuese, institucionet arsimore të Komunës së Vushtrrisë kanë përfituar donacione të ndryshme nga organizata, biznese, shtëpi botuese, individë dhe partnerë të tjerë mbështetës. Këto donacione kanë kontribuar në përmirësimin e kushteve të punës, pasurimin e bibliotekave shkollore, pajisjen me mjete teknologjike dhe krijimin e ambienteve më të përshtatshme për zhvillimin e procesit edukativo-arsimor.

Donacione në pajisje dhe inventar shkollor

- SHFMU "Nedakoc" ka përfituar donacion prej gjashtë (6) klimave nga kompania **Gorenje**, duke përmirësuar kushtet e qëndrimit dhe punës në ambiente shkollore.
- SHFMU "Adem Voca" – Pasomë ka përfituar donacion prej pesë (5) klimave (kondicionerëve) nga kompania **GNTC Group**, me seli në Prishtinë.
- SHMU-1 Vushtri ka pranuar donacion prej pesë (5) klimave nga kompania **Gorenje**.

- Gjinnazi "Eqrem Çabej" – Vushtrri ka përfutuar një tabelë pingpongu nga **Ordinanca Bava Dent**, duke kontribuar në zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe rekreative të nxënësve.
- Gjinnazi "Eqrem Çabej" ka pranuar një tabelë interaktive (smart tabelë) nga kompania **SHPK Butrinti**, e cila do të shfrytëzohet për avancimin e mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor.
- Humanisti dhe biznesmeni nga diaspora **Shahin Dervishaj** i ka dhuruar Gjinnazit "Eqrem Çabej" pajisje me vlerë prej 1,500 euro, në mbështetje të zhvillimit të kushteve shkollore. **Donacione në libra dhe materiale edukative**
- SHFMU "Andon Zako Çajupi" – Vushtrri ka përfutuar rreth 200 tituj librash dhe lektyrash shkollore për nxënësit e klasave I–V nga shtëpia botuese "Dukagjini", duke kontribuar në pasurimin e bibliotekës shkollore.
- SHFMU "Lummadh" ka përfutuar nga shtëpia botuese "Dukagjini" lektyra shkollore për ciklin I–V, duke pasuruar fondin e bibliotekës dhe duke nxitur kulturën e leximit të nxënësit.

Donacione për përmirësimin e ambienteve shkollore

- Me iniciativën dhe angazhimin vullnetar të prindërve të klasave IV/I dhe IX/I të SHFMU "Andon Zako Çajupi", është realizuar rregullimi i plotë i klasave, përfshirë ngjyrosjen, pastrimin dhe sistemimin e ambienteve mësimore.
- SHFMU "Liria" – Stroc ka pranuar donacion nga z. **Kushtrim Klinaku**, i cili ka dhuruar një makinë fotokopjuese **HP Laser MFP 135a**, si dhe nga donatori **Fidan Zeqiri**, i cili ka mbështetur shkollën me 400 euro materiale për realizimin e muralit me motivin "Mbretëresha Teutë".
- SHFMU "Lummadh" ka përfutuar donacion me materiale për lyerjen e objektit shkollor dhe aneksit të ndarë nga fabrika gjermane e ngjyrave **Bitter Deutsche Farben**, duke përmirësuar dukshëm pamjen dhe ambientin e shkollës.

Suksesi i gjysmëvjektorit të dytë të vitit shkollor 2025/2026

Në përfundim të gjysmëvjektorit të dytë të vitit shkollor 2025/2026, institucionet arsimore të Komunës së Vushtrrisë kanë realizuar vlerësimin e arritjeve të nxënësve në përputhje me kurrikulën, udhëzimet administrative dhe kriteret e përcaktuara për vlerësimin e nxënësve.

Procesi i vlerësimit është zhvilluar me qëllim të evidentimit të nivelit të arritjeve të nxënësve, identifikimit të fushave ku nevojitet mbështetje shtesë dhe planifikimit të masave për përmirësimin e rezultateve mësimore.

Në kuadër të analizës së suksesit janë marrë parasysh:

- suksesi i përgjithshëm i nxënësve;
- përqindja e kalueshmërisë;
- rezultatet sipas niveleve dhe institucioneve arsimore;
- nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm;
- nxënësit me nevojë për përkrahje shtesë në procesin mësimor.

Drejtoria Komunale e Arsimit ka vazhduar monitorimin e rezultateve të nxënësve dhe bashkëpunimin me drejtoritë e shkollave, mësimeve dhe prindërit, me qëllim të ngritjes së cilësisë së arsimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të rezultateve në të gjitha nivelet.

Suksesi i nxënësve të klasave I–V

Krahasimi i suksesit të gjysmëvjetorit të dytë 2025/2026

Perioda	Shkëlqyeshëm	Shumë Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të panotuar	Nota negative
2025	66.87%	19.25%	10.74%	3.03%	0.07%	0%	0.02%
2026	69.07%	18.26%	9.34%	3.20%	0.04%	0%	0.20%
Krahasimi	+2.20%	-0.99%	-1.40%	+0.17%	-0.03%	0%	+0.18%

Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, në klasat I–V është shënuar rritje e numrit të nxënësve me sukses **shkëlqyeshëm** prej 2.20%, si dhe ulje e kategorisë së nxënësve me sukses **të pamjaftueshëm** prej 0.03%.

Kategoria **shumë mirë** ka shënuar ulje prej 0.99%, ndërsa kategoria **mirë** ulje prej 1.40%. Kategoria **mjaftueshëm** ka shënuar rritje prej 0.17%.

Për kategorinë e nxënësve **të panotuar** nuk është evidentuar ndryshim, duke mbetur në nivelin 0%, ndërsa kategoria e nxënësve me **nota negative** ka shënuar rritje prej 0.18% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Në përgjithësi, rezultatet paraqesin një përmirësim të lehtë të suksesit të nxënësve të klasave I–V, veçanërisht në rritjen e numrit të nxënësve me sukses të shkëlqyeshëm dhe uljen e nxënësve me sukses të pamjaftueshëm.

Suksesi i nxënësve të klasave VI–IX

Krahasimi i suksesit të gjysmëvjetorit të dytë 2025/2026

Periudha	Shkëlqyeshëm	Shumë Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshem	Të panotuar	Përsëritën klasën
2025	29.54%	21.92%	26.72%	13.72%	7.08%	0.14%	0.88%
2026	27.99%	20.76%	24.80%	14.00%	5.05%	0.29%	2.06%
Krahasimi	-1.55%	-1.16%	-1.92%	+0.28%	-2.03%	+0.15%	+1.18%

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, te klasat VI–IX është evidentuar ulje e lehtë në kategoritë e suksesit **shkëlqyeshëm** (-1.55%), **shumë mirë** (-1.16%) dhe **mirë** (-1.92%). Ndërsa, kategoria e nxënësve me sukses **të pamjaftueshëm** ka shënuar ulje prej 2.03%, që paraqet përmirësim në këtë drejtim. Kategoria **mjaftueshëm** ka shënuar rritje prej 0.28%, ndërsa nxënësit e **panotuar** kanë shënuar rritje prej 0.15%. Numri i nxënësve që kanë **përsëritur klasën** ka shënuar rritje prej 1.18% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë nevojën për vazhdim të punës në ngritjen e suksesit të nxënësve dhe në mbështetjen e kategorive që kanë nevojë për përmirësim.

Suksesi i nxënësve të klasave X–XII

Periudha	Shkëlq.	Sh. Mirë	Mirë	Mjaft.	Të pamjaftueshëm	Të panotuar	Përsëritën klasën
2025	13.94%	20.08%	31.25%	23.44%	9.13%	1.27%	0.63%
2026	13.90%	22.15%	32.18%	19.83%	3.91%	0.18%	0.00%
Krahasimi	-0.04%	+2.07%	+0.93%	-3.61%	-5.22%	-1.09%	-0.63%

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, te klasat X–XII është evidentuar një **rritje e suksesit** në kategoritë **shumë mirë** (+2.07%) dhe **mirë** (+0.93%), ndërsa kategoria **shkëlqyeshëm** ka shënuar ulje të lehtë prej 0.04%.

Kategoria **mjaftueshëm** ka shënuar ulje prej 3.61%, ndërsa është zvogëluar dukshëm numri i nxënësve me sukses **të pamjaftueshëm** (-5.22%). Po ashtu, është shënuar ulje e numrit të nxënësve **të panotuar** (-1.09%) dhe e nxënësve që kanë **përsëritur klasën** (-0.63%).

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë përmirësim të suksesit të nxënësve të klasave X–XII, me ulje të dukshme të rezultateve të pamjaftueshme dhe rritje të kategorive të suksesit **shumë mirë** dhe **mirë**.

Numri i nxënësve që kanë braktisur mësimin e obliguar:

Klasa	Meshkuj	Femra	Gjithsej nxënës	Braktisën (M)	Braktisën (F)	Gjithsej braktisën	% Braktisjes
Grupa 1–2	33	30	63	0	0	0	0.00%
Grupa 2–3	32	31	63	0	0	0	0.00%
Grupa 3–4	72	55	127	0	0	0	0.00%
Grupa 4–5	66	75	141	0	0	0	0.00%
Grupa 5–6 Parafillor	333	308	641	0	0	0	0.00%
Grupa 5–6 Parashkollor (Çerdhe)	159	135	294	0	0	0	0.00%
Klasa 1	447	396	843	0	0	0	0.00%
Klasa 2	525	394	919	0	0	0	0.00%
Klasa 3	461	464	925	0	0	0	0.00%
Klasa 4	501	448	949	0	0	0	0.00%
Klasa 5	500	418	918	0	0	0	0.00%
Klasa 6	475	430	905	0	0	0	0.00%
Klasa 7	508	469	977	0	0	0	0.00%
Klasa 8	503	506	1009	0	0	0	0.00%
Klasa 9	451	457	908	0	0	0	0.00%
Gjithsej	5066	4616	9682	0	0	0	0.00%

Gjatë këtij gjysembjeteri, sipas të dhënave të paraqitura, **nuk është evidentuar asnjë rast i braktisjes së mësimin të obliguar në nivelet e paraqitura. Shkalla e braktisjes në të gjitha klasat është 0.00%.**

Testi i Arritshmërisë – Rezultatet sipas shkollave (2025/2026)

Nr.	Shkolla	Nr. nx.	Kalueshmëria %	Meshkuj %	Femra %
1	SHFMU "Dëshmorët"	1	68.00	68.00	0.00
2	SHFMU 2	235	56.55	55.58	57.44
3	SHFMU "Azem Bejta"	6	56.23	55.50	59.50
4	SHFMU "Emin Duraku"	11	55.00	53.33	55.63
5	SHMU-1	156	54.18	54.90	55.62
6	SHFMU "Mustafë Shyti"	5	53.60	46.00	84.00
7	SHFMU "A.Z. Çajupi"	82	50.09	46.57	52.98

Nr.	Shkolla	Nr. nx.	Kalueshmëria %	Meshkuj %	Femra %
8	SHFMU "Adem Voca"	5	49.00	41.70	60.00
9	SHFMU "Enver Hadri"	35	47.08	48.31	46.28
10	SHFMU Nedaqoc	11	46.91	20.18	26.73
11	SHFMU "7 Marsi"	26	46.53	42.64	51.08
12	SHFMU "Nazmi Zhegrova"	19	46.05	44.50	46.90
13	SHFMU "Liria"	20	46.05	41.60	50.50
14	SHFMU "Martirët"	14	45.79	51.40	42.67
15	SHFMU Lummadh	12	45.75	42.80	47.86
16	SHFMU "Bahri Kuqi"	24	45.21	43.07	49.28
17	SHFMU "Lumni Surdulli"	12	45.08	39.86	52.20
18	SHFMU "Gj.K. Skënderbeu"	13	44.44	45.92	43.16
19	SHFMU "28 Nëntori"	14	44.05	43.85	44.33
20	SHFMU "Pestovë"	16	43.81	38.38	49.25
21	SHFMU "Abdyl Frashëri"	16	42.06	38.08	54.00
22	SHFMU "Migjeni"	35	42.06	38.08	54.00
23	SHFMU "12 Qershori"	14	41.71	38.14	45.29
24	SHFMU "Hajrullah Shala"	20	41.15	23.42	61.04
25	SHFMU "Latif Berisha"	17	41.12	31.81	55.58
26	SHFMU "Jusuf Gërvalla"	12	40.83	36.75	42.87
27	SHFMU "Rilindja"	43	39.74	36.61	44.52
28	SHFMU "Bajram Curri"	14	39.42	39.83	39.12
29	SHFMU "Rexhep Musa"	3	39.00	41.50	34.00
Gjithsej			46.86	42.82	48.71

Sipas rezultateve të Testit të Arritshmërisë për vitin shkollor 2025/2026, mesatarja e përgjithshme e kalueshmërisë në nivel komunal është 46.86%.

Nga analiza sipas gjinisë, rezulton se nxënëset femra kanë arritur një përqindje më të lartë të kalueshmërisë (48.71%), krahasuar me nxënësit meshkuj (42.82%).

Rezultatet tregojnë dallime ndërmjet institucioneve arsimore, duke evidentuar nevojën për analiza të vazhdueshme dhe masa mbështetëse në shkollat me rezultate më të ulëta, me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe arritjeve të nxënësve.

Testi i Maturës 2026

Testi i Maturës Shtetërore për vitin 2026 u mbajt më 20 qershor 2026, në 5 qendra testimi. Në këtë proces morën pjesë nxënësit e tri institucioneve të arsimit të mesëm të lartë të Komunës së Vushtrrisë:

- Gjinnazi “Eqrem Çabej”;
- SH.M.T. “Lutfi Musiqi”;
- SH.M.P. “Bahri Haxha”.

Në tabelën në vijim paraqiten rezultatet e kalueshmërisë dhe krahasimi me vitin paraprak.

Nr.	Institucioni	Kalueshmëria 2025	Kalueshmëria 2026	Ndryshimi (%)
1	Gjinnazi “Eqrem Çabej” Vushtrri	90.00%	93.73%	+3.73%
2	SH.M.P. “Bahri Haxha” Vushtrri	42.00%	44.26%	+2.26%
3	SH.M.T. “Lutfi Musiqi” Vushtrri	41.84%	50.00%	+8.16%

Rezultatet e Testit të Maturës 2026 tregojnë përmirësim të kalueshmërisë në tri institucionet e arsimit të mesëm të lartë të Komunës së Vushtrrisë, krahasuar me vitin paraprak.

Gjinnazi “Eqrem Çabej” Vushtrri ka ruajtur nivelin më të lartë të suksesit me **93.73%** kalueshmëri. **SH.M.P. “Bahri Haxha” Vushtrri** ka shënuar rritje të kalueshmërisë nga **42.00% në 44.26%**. **SH.M.T. “Lutfi Musiqi” Vushtrri** ka shënuar përmirësimin më të madh, duke u rritur nga **41.84% në 50.00%**.

Në përgjithësi, tri institucionet kanë treguar progres në rezultatet e Testit të Maturës 2026.

Këto rezultate pasqyrojnë angazhimin e institucioneve shkollore, mësimdhënësve dhe nxënësve në përgatitjen për Testin e Maturës dhe në ngritjen e cilësisë së arsimit të mesëm të lartë.

SFIDAT DHE ÇËSHTJET E IDENTIFIKUARA

Përkundër aktiviteteve dhe rezultateve të arritura gjatë gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2025/2026, Drejtoria Komunale e Arsimit ka evidentuar disa sfida dhe çështje që kërkojnë trajtim, planifikim dhe mbështetje të mëtejshme institucionale.

Ndër sfidat kryesore, të renditura sipas rëndësisë dhe ndikimit në zhvillimin e sektorit të arsimit, janë:

1. **Kufizimet buxhetore dhe nevoja për sigurimin e mjeteve të mjaftueshme financiare**, të cilat kanë ndikuar në mundësinë e realizimit të plotë të disa prioriteteve dhe aktiviteteve në fushën e arsimit.
2. **Pamundësia për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë gjatë vitit 2026**, si pasojë e kufizimeve buxhetore, duke pamundësuar realizimin e kësaj forme të mbështetjes së studentëve nga Komuna e Vushtrrisë.
3. **Mungesa e përfshirjes së pesë (5) mësimdhënësve në listën e pagave**, e cila paraqet sfidë për sigurimin e vazhdimësisë dhe funksionimit të rregullt të procesit edukativo-arsimor, si dhe kërkon trajtim dhe zgjidhje institucionale për rregullimin e statusit të tyre dhe përfshirjen në listën e pagave, në përputhje me procedurat dhe legjislacionin në fuqi.
4. **Nevoja për përmirësimin e rezultateve të nxënësve në vlerësimet e jashtme**, veçanërisht në institucionet arsimore me rezultate më të ulëta, përmes analizave të thelluara dhe ndërmarrjes së masave konkrete për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe arritjeve të nxënësve.

5. **Nevoja për forcimin e mbështetjes për fëmijët dhe nxënësit me nevoja të veçanta arsimore,** përfshirë sigurimin e mekanizmave të nevojshëm për vlerësim, mbështetje profesionale, përfshirje dhe subvencionim.
6. **Nevoja për investime të mëtejshme në infrastrukturën shkollore,** përfshirë renovimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e objekteve shkollore që kërkojnë ndërhyrje.
7. **Nevoja për furnizim të vazhdueshëm me pajisje teknologjike, mjete didaktike dhe inventar shkollor,** me qëllim të krijimit të kushteve më të përshtatshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie.
8. **Nevoja për rritjen e mundësive për zhvillim profesional të mësimitdhënësve dhe stafit arsimor,** në funksion të ngritjes së kompetencave profesionale dhe përmirësimit të cilësisë së procesit edukativo-arsimor.
9. **Nevoja për sigurimin e mbështetjes së qëndrueshme financiare për aktivitetet që lidhen me përfshirjen dhe mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore,** përfshirë mbështetjen për shërbimet dhe programet përkatëse.
10. **Nevoja për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe partneritetit me institucionet qendrore, organizatat ndërkombëtare, sektorin privat dhe partnerët zhvillimorë,** me qëllim të sigurimit të burimeve dhe mundësive shtesë për zhvillimin e arsimit.
11. **Nevoja për forcimin e bashkëpunimit me prindërit, komunitetin dhe bizneset lokale,** në funksion të mbështetjes së institucioneve arsimore dhe krijimit të një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin e nxënësve.
12. **Nevoja për forcimin e arsimit profesional dhe zgjerimin e bashkëpunimit me bizneset,** me qëllim të krijimit të më shumë mundësive për zhvillimin e mësimit dual dhe lidhjen e arsimit me tregun e punës.

Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

D.SH.P.S dhe menaxhmenti i QKMF-së bazuar në Ligjin për Shëndetësi, U/A për K.P.Sh, Statutin e QKMF në Vushtrri dhe në zbatueshmëri me planin e veprimit janë të përkushtuar maksimalisht që të ofrojnë shërbime shëndetësore cilësore, ku përfshihen ato promovuese, parandaluese, diagnostikuese, trajtuese dhe paliative, duke përfshirë në procesin e përkujdesjes shëndetësore për të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Vushtrrisë. Përkujdesja shëndetësore organizohet duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e popullatës, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

QKMF-ja është përgjegjëse për organizimin, implementimin e konceptit të Mjekësisë Familjare, si dhe sigurimin e vazhdimësisë të përkujdesjes shëndetësore për popullatën me objektivë kryesorë, përmirësimin e shëndetit të popullatës, duke ju ofruar shërbime të qasëshme, gjithëpërfshirëse si dhe shërbime të cilësisë së lartë.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dr.Safet Idrizi" në Vushtrri është institucioni shëndetësor kryesor që ofron dhe zbaton Kujdesin Parësor Shëndetësor publik në gjithë territorin e komunës, sipas U/A për KPSH. QKMF kujdeset për qytetarët e komunës për sa i përket Kujdesit Parësor Shëndetësor, nën mbikqyrjen dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë të Drejtorisë së Shëndetësisë (DSHPS), të cilës njeherit i raporton për të arriturat apo sfidat, duke i zgjedhur bashkarisht.

Shërbimet shëndetësore janar - qershor në QKMF 2026

6 mujori 2026		
------------------	--	--

N r.	Emri i sherbimit	Totali	Meshkuj	Femra	Participim	Sherbime	Referime	Mali nje	Kronike	Nga Mjeku Privat		Paliativ
										Inek.	Infuzi	
1	QKMF	30445	14475	15970	5194	94248	2580	48	1785	2416	2110	0
2	Urgjenca	16706	7839	8867	3006	85438	1983	206	2611	785	1224	864
3	Laboratori	9059	3533	5526	954	106290	0	0	0	0	0	0
4	Stomatologjia	3390	1628	1762	594	14566	60	0	0	0	0	0
5	RTG	2717	1257	1460	544	8190	0	0	0	0	0	0
6	Rtge dhembit	150	66	84	30	296	0	0	0	0	0	0
7	Vaksinimi	2422	1330	1092	0	5506	0	0	0	0	0	0
8	QMF-1	31449	14924	16525	8164	116933	3816	99	1810	1141	1515	0
9	QMF-2	2924	1280	1644	563	14576	218	1	186	108	140	0
10	QMF-3	3211	1540	1671	661	22132	51	0	562	82	82	0
11	QMF-AMF	10197	4584	5613	1890	49085	2364	42	1505	307	330	0
	Gjithsejt	112670	52456	60214	21600	517260	11072	396	8459	4839	5401	864

vizitat mjekësore dhe shërbime për QMF dhe AMF, janar – qershor 2026.

	2026 6 mujori	Totali	M	F	Referimet	Participim	Shërbime tjera	Vizitimet kartele	S.Mal inje	S.Kronike	Nga Mjeku Privat	
											LM	Infuzione
QMF dhe AMF	QMF-Lumadh	3595	1444	2151	300	807	20426	205	6	243	190	226
	QMF-Snrekonicë	1384	680	704	387	279	12250	0	8	281	38	19
	QMF-Pantinë	1211	515	696	447	209	4657	0	22	328	24	27
	QMF-Druar	191	85	106	70	23	604	0	0	16	0	0
	QMF-Novolanë	347	171	176	80	8	1012	0	0	100	2	7
	QMF-Maxhumaj	1886	948	938	747	471	6981	0	5	205	25	49

QM-F Dumnicë	106	44	62	29	13	639	0	0	9	4	0
AMF- Samadrexh ë	553	26 2	29 1	152	21	3204	0	0	225	12	2
AM-F Strovc	357	15 5	20 2	97	66	1273	21	1	76	0	0
AMF- Pasomë	155	75	80	4	1	1128	0	0	14	0	0
AMF- Oshlan	105	53	52	13	0	89	0	0	0	7	2
AMF- Beçiq	122	68	54	19	1	172	0	0	5	5	1
AmF- Dubove	55	30	25	13	0	85	0	0	5	0	0
AMF - Ceceli	130	54	76	22	0	1064	0	0	34	0	0
Gjithsej:	101 97	45 84	56 13	2380	1899	53584	226	42	1541	307	333

SHËNDETI PUBLIK

Është përgjegjës për shëndetin publik, imunizim dhe vaksinim dhe për Sistemin Informativ Shëndetësor, ky sektor përcjell gjendjen epidemiologjike në bazë të raporteve kthyesë nga IRSHP dhe bashkë me ta vepron në rast se kërkohet apo dyshohet në ndonjë epidemi. Sëmundjet ngjitëse sipas IKSHPK Mitrovicë

Sektori i Vaksinimit dhe Imunizimit :

Shërbimi i vaksinimit gjatë kësaj periudhe ka qenë i furnizuar me vakcina mjaftueshëm dhe është kryer në bazë të planit në qytet si dhe në fshatra.

Tabela 5. Paraqet administrimin e vaksinave në 6 qendrat e KPSH si më poshtë:

Raporti i Shërbimit të Imunizimit-Vaksinimit 6 mujori 2026											
	Tot ali	M	F	QK MF	QMF -1	QMF -2	Luma dh	Maxhu naj	Panti ne	Smreko nic	Sherbi met
Janar	399	212	187	193	116	33	27	8	14	8	915
Shkurt	301	158	143	121	97	28	23	12	7	13	719
Mars	351	195	156	154	97	30	29	16	12	13	812
Prill	378	208	170	150	135	30	18	18	8	19	905
Maj	481	257	224	160	157	90	25	25	12	12	851
Qersh or	520	304	216	236	188	55	0	28	10	3	1047
Gjiths ejt	243 0	133 4	109 6	1014	790	266	122	107	63	68	5249

SHËNDETI ORAL

Në sektorin e shëndetit oral preventiv janë vizituar gjithsej 3369 pacient dhe ka dhënë 14450 shërbime. Këtu përfshihet këshilla mjekësore, nxjerrja e dhëmbëve, shërimi, bllobimi dhe pastrimi i gurëzve në dhëmbë.

SEKTORI I KUJDESIT URGJENT

Gjatë periudhës kohore 6 mujore ka pas gjithsej 16706 pacient janë dhanë 85438 shërbime shëndetësore. Në Urgjencë shërbimet janë 24h dhe punohet çdo ditë të javës.

Në këtë shërbim janë të angazhuar katër ekupe që punojnë me ndërrime 12 orësh, janë të angazhuar 8 mjek dhe 17 infermier, këtu kryhen vizita mjekësore dhe shumë shërbime tjera që dalin nga këto vizita.

SEKTORI I DIAGNOSTIKËS

Laboratori së bashku me Rëntgenin bëjnë pjesë në sektorin e diagnostikës.

Në vijim do gjeni informacionin lidhur me pacientët të cilët kanë kërkuar shërbime dhe kanë marrë shërbime shëndetësore në Laboratorin e QKMF-së

Gjithsej pacient kanë qenë: 9059

- o **Meshkuj: 3533**
- o **Femra: 5526**

Shërbime 106336

RËNTGENI

Gjatë gjashtë muhorit të parë në shërbimin e Reganit, Puna ka ecur shumë mirë nëpërgjithësi, shërbimet në kabinetin e rengenit janë kryer me kohë dhe pa terminë, puna është organizue në një ndërrime 7-13 ku janë të angazhuar katër puntore, gjatë muajit Janare- Qershorvetem në ndërrimi i pasdites është punuar, pacientët kanë marrë shërbime me filma dhe CD ,furnizimi me material hargjus ka qenë shumë i mirë.

Në shërbimin e RTG është vendosur edhe Mamografija e Gjirit, dhe është bërë trajnimi i teknikeve të Radiologjisë për tju afruar shërbime qytetarëve të Vushtrisë

Edhe në RTG e dhëmbit janë krye afro 500 shërbime , mirëpo në këtë shërbim shumicen e herave është prishur aparati për fotografimin e dhëmbit.

BARNATORJA QËNDRORE

Për shkak të mungesave gjatë furnizimit me barna dhe material shpenzues nga Ministria e Shëndetësisë, QKMF ka qenë e detyruar të bëjë blerjet e tyre nga buxheti i komunës së Vushtrisë të ndarë për blerjet e produkteve medicinale dhe material shpenzues, përmes korniz kontrates me furnizuesin "MEDPLUS ShPK":

Nr.	Vlera e blerjesë €
1	12,899.10
2	1224.80
5	14,123.80

Në tabelën e mëposhtme keni të bashkangjitur përqindjen e furnizimeve nga M.Sh. me barna dhe material shpenzues për periudhën kohore janar – qershor 2026, nga lista esenciale:

Nr.	Muaji	Barnat	Material shpenzues
1	TM-1	56.1 %	55.32%
2	TM-2	50.63%	56.90%
	Mesatarja	58.36%	56.11 %

Furnizimi me insulina përqindja e realizuar janar shtator 2026 të furnizuar nga Ministria e Shëndetësisë

Nr.	Muaji	Insulina
1	Janar	100 %
2	Shkurt	100 %
3	Mars	100%
4	Prill	100 %
5	Maj	100 %
6	Qershor	100 %

Depoja Qendrore Farmaceutike gjatë vitit 2026 ka bërë shpërndarjen e barnave dhe materialit shpenzues në gjithsej 18 QMF dhe AMF të komunës së Vushtrisë, në interval të caktuar kohor, QMF dhe AMF për çdo muaj, ndërsa QKMF dhe QMF-1 në intervale 2 javore.

Gjatë periudhës së parë të vitit 2026 janë realizuar 340 vizita për fëmijë dhe 57 vizita për shtatzëna. Në total janë realizuar 397 vizita

Qëllimi i vizitave në shtëpi është vizita në ditët e para pas lindjes dhe përcjellja e atij fëmija deri në moshën 3 vjeçare . Ky shërbim ofron mundësin që vajzat, gratë, çiftet, shtatzënat dhe lehonat të lajmërohen në dhomën për promovim shëndetësor dhe të informohen për: planifikimin familjar, për gjidhënin, për depresionin pas lindjes, për fazat e lindjes, për ushqyerjen e fëmijëve, ushqyeshmërin e shëndetshme gjatë periudhës së shtatzënisë etj.

Shërbime Publike

Drejtoria për Shërbime Publike ka bërë përpjekje për të ofruar shërbime sa më cilësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrisë,

Furnizimi me ujë

Sa i përket furnizimit me ujë të pijes, fabrika për prodhimin e ujit në Balinc ka vazhduar të operojë me orar të plotë 24 h në ditë. Është bërë ri funksionalizimi i pompave për zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë për vendbanimet e pjesës lindore të komunës. Kemi vazhduar me mirëmbajtjen e sistemeve të pompimit të cilat janë në procedurë të dorëzimit në menaxhim të Ndërmarrjes rajonale „Mitrovica”.

Largimi i ujërave të zeza

Në infrastrukturën e rrjetit të kanalizimit gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2026, janë përmbyllur kontratat për punët e zhvilluara për implementimin e kontratave dy vjeçare për ndërtimin e kanalizimit në fshatrat; Maxhunaj Studime, Dumnice, Beqok, Stroc, Mihaliq, Stanoc i Poshtëm, Akrahticë. Ndërsa është bërë ç'bllokimi i një numri të konsiderueshëm të gypave dhe puseta të bllokuara, si fsh. Sllatinë, Dërvar, Mihaliq, Doberllugë, rr. Adem Ademi në Vushtrri, rr. „Avdulla Nika” dhe një numër të konsiderueshëm të rrjetit të kanalizimit.

Largimi i ujërave atmosferike

Në kuadër të planit të punës së drejtorisë, me planin financiar, është paraparë që të intervenohet në pastrimin e puseta të kanalizimit atmosferik. Gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi i ujëmbledhëseve të prockave dhe rrjedhave të ujit në qytet, përmes kontratës me Ndërmarrjen Përparimi.

Menaxhimi i Mbeturinave

Në fushën e menaxhimit të mbeturinave, Drejtoria për Shërbime Publike, me qëllim të krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë, patë themeluar grupin teknik për hartimin e planit ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave brenda regjionit, i cili plan është hartuar dhe pritet miratimi i tij deri në fund të vitit. Si rezultat i këtyre angazhimeve, Komuna e Vushtrisë është duke bërë ofrimin e shërbimit për të gjitha vendbanimet e komunës. Gjithashtu është duke u bërë grumbullimi i ndarë i mbeturinave të rreth 1500 ekonomive familjare, të cilat janë duke u paketuar në qendrën për paketim në Bukosh.. Qendra për paketim në Bukosh, tashmë është në menaxhim të Ndërmarrjes Përparimi. Po ashtu është bërë eliminimi i qëndrueshëm i deponive ilegale si deponia në fshatin Bajsk dhe aktualisht i kemi vetëm katër deponi të tilla.

Si rezultat i këtij angazhimi ndërmarrjes „Përparimi” i është siguruar një stabilitet financiar dhe kemi arritur që në masë të madhe ta përmirësojmë gjendjen e ambientit.

Është ky viti i pestë prej themelimit të Ndërmarrjes Lokale „Përparimi”, përmes së cilës janë ofruar shërbimet e sigurimit dhe pastrimit të objekteve si dhe është bërë mbjellja e luleve dekorative, mirëmbajtja e hapësirave publike dhe ndriçimit publik.

Gjatë kësaj periudhe është bërë hartimi dhe dorëzimi në AMM Raporti për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2025, si dhe Plani Ndërkomunal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

Ndriçimi publik

Ka vazhduar implementimi i kontratës – marrëveshjes për mirëmbajtje të rrjetit të ndriçimit publik, implementimin e së cilës është duke u bërë nga Ndërmarrja Lokale „Përparimi”

Komunikacioni

Në kuadër të fushës së trafikut, është menaxhuar kontrata për shërbimet e transportit me auto merimangë, janë nxjerrë vendime për bllokim të shiritave rrugor dhe vendime për shfrytëzim të parkingjeve nga operatorët e transportit të udhëtarëve me Radio Taksi, vendime për ndaljen e mjeteve motorike për ngarkim shkarkim.

Në fushën e trafikut është duke u implementuar kontrata për mirëmbajtjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në rrugët e qytetit, me qëllim të krijimit të një rrjeti funksional dhe të integruar, duke synuar rritjen

e shkallës së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, pra krijimin e kushteve për lëvizje të motorizuara dhe të pa motorizuara, duke përfshirë edhe personat me nevojë të veçantë, ndërsa grupi teknik në bashkëpunim me UN – HABITATIN janë në përfundim të hartimit të planit të mobilitetit sipas Marrëveshjes së nënshkruar dhe ky plan pritet të finalizohet nënë gjashtëmujorin e dytë të këtij viti. Gjithashtu është shpallur konkursi për ndarjen e linjave të transportit urbano-periferik në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Gjatë periudhës së parë të vitit, ka vazhduar mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara përmes kontratës për rikonstruim dhe mirëmbajtje të rrugëve, me ç'rast janë riparuar mjaft segmente rrugore me asfalt dhe me kubza dhe të një numri të konsiderueshëm të pusetave dhe ndërrim të gypave të kanalizimit. Gjithashtu janë përmbyllur kontratat për ndërtim të rrugëve me kubza betoni, të cilat kanë qenë kontrata dy vjeçare.

Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit gjatë vitit 2026 fokus të posaçëm ka pasur hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032, kemi mbajtur një numer të madh takimesh me grupin punës të Planit Zhvillimor Komunal për mbajtjen e takimeve lidhur me diskutimet publike me qytetarët, grupet e interesit, kompanit publike etj.

Po ashtu kemi mbajtur disa takime si ekip komunale në konsultim me kompanin Konsulente e cila është kontraktuar nga komuna për mbështetjen në hartimin e PZHK-së.

Gjatë periudhës Janar –Qershor 2026, DUMM ka zbatuar në përpikëri Planin Zhvillimor Komunal ku zyrtaret përgjegjës gjatë çdo shqyrtimi të kërkesave të pranuar që kanë të bëjnë me ndërtime dhe informime tjera rreth destinimit të parcelave kadastrale të tyre janë udhëzuar me destinimin e përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal po ashtu kërkesat e parashtruara për marrjen e Kushteve Ndërtimore, Lejeve Ndërtimore dhe Lejeve për Rrënimin e objekteve për kategorinë e parë (I) dhe të dytë (II) janë trajtuar në harmoni të plotë me Planin Zhvillimor Komunalë.

Sektori i Urbanizmit –është marr me shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me caktim të lokacioneve, Kushtet e Ndërtimit, Lejeve Ndërtimore për kategorinë I dhe II, Pëlqimeve Paraprake, Lejeve për rrënimin e objekteve, Leje përdorimi të objekteve, informacione për destinimin e sipërfaqeve nga planet përkatëse rregulluese duke kaluar nëpërmes procesit të daljes në teren dhe incizimit të gjendjes faktike në terren ku përmes sektorit për planifikim urban e ka vazhduar procesin e mëtutjeshëm për finalizim si dhe punë të tjera në komisione siç janë: Shfrytëzime të hapësirave publike para lokaleve etj.

Gjatë gjashtëmujorit të parë janar-qershor janë zhvilluar procedurat administrative dhe janë nxjerrë akte administrative për:

- Leje Ndërtimore; 18
- Kushte Ndërtimore; 12
- Leje për Rrënim; 7
- Leje Mjedisore Komunale;
- Vendime për pagesë të taksave dhe pagesë me këste;4
- Informatë për shndërrimin e tokës;18
- Certifikata të Përdorimit dhe Pranime Teknike;2
- Njoftime për plotësimin e dokumentacionit;14
- Mendime profesionale dhe rekomandime për Drejtorin;
- Shqyrtim të kërkesave të qytetarëve dhe investitorëve;
- Përgatitje të dokumentacionit për procedura administrative sipas legjislacionit në fuqi.

Të gjitha procedurat janë zhvilluar në pajtim me Ligjin për Ndërtim, Ligjin për Planifikim Hapësinor, Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe aktet nënligjore në fuqi.

Taksat e inkasuara për Leje Ndërtimore dhe Leje rrenimi përfshinë vlerën: 386.535,84 €

Legalizimi- Gjatë këtij viti kemi pranuar 68 kërkesa të parashtruara nga palët për legalizimin e objekteve për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimit.

• Vendime për legalizim.....	48
• Vendime për Listën e Pritjes.....	76
• Dërgesë dokumentacioni – dorëzim palës.....	16
• Dërgimi i dosjeve të legalizimit në Kadastër.....	48
• Kërkesat e reja të pranura.....	22

Të hyrat e inkasuara nga legalizimet:

- Nga legalizimi i Kat I janë.....5005.70 euro
- Nga legalizimi i Kat II janë.....3529.00 euro

Gjithsejtë janë 8534.70€

Spektori për planifikim urban – gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore është bërë sistematizimi i lendeve të ndryshme, koordinimi profesional dhe ligjor brenda drejtorisë, zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, kontrollimi i rregullt i projekteve kapitale, zgjidhje dhe përgjigje të kërkesave të qytetarëve, përgatitja e projekteve konkurruese ideore, vizitat e punimeve në teren-mbikqyrja e projekteve, monitorimi dhe aprovimi për Kushte dhe leje Ndërtimore, pranime teknike të disa projekteve, mbajtja e disa seminareve të organizuara nga organizata të ndryshme, Takimet me grupet punuese dhe UN-Habitat, si dhe:

- Administrimi, përditësimi dhe mirëmbajtja e Sistemit Informativ Gjeografik (GIS);
- Administrimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave hapësinore dhe urbanistike;
- Digjitalizimi i dokumentacionit dhe të dhënave urbanistike në sistemin GIS;
- Trajtimi dhe digjitalizimi i të gjitha kërkesave të qytetarëve për përfshirje të pronave dhe parcelave në procesin e hartimit të **Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2024–2032**, duke evidentuar dhe regjistruar secilën kërkesë në bazën e të dhënave dhe në shtresat gjeohapësinore;
- Përgatitja, përditësimi dhe administrimi i shtresave tematike të GIS-it për nevojat e Planit Zhvillimor Komunal dhe projekteve të tjera zhvillimore;
- Përgatitja e hartave tematike, ekstrakteve grafike dhe materialeve kartografike për procedurat administrative dhe projektet komunale;
- Përpunimi dhe analizimi i të dhënave gjeohapësinore për nevojat e planifikimit hapësinor dhe zhvillimit urban;
- Administrimi dhe organizimi i bazës elektronike të të dhënave dhe dokumentacionit teknik të Drejtorisë;
- Ofrimi i mbështetjes teknike për stafin e Drejtorisë në përdorimin e platformave GIS dhe sistemeve elektronike;
- Kontribut aktiv në hartimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave për **Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (SUMP)**, në bashkëpunim me **UN-Habitat**, përmes përgatitjes së të dhënave hapësinore, analizave kartografike dhe mbështetjes teknike gjatë procesit të planifikimit.

Ky angazhim ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë së të dhënave hapësinore, avancimin e procesit të digjitalizimit, rritjen e efikasitetit në trajtimin e kërkesave të qytetarëve dhe mbështetjen e hartimit të

dokumente strategjike të Komunës së Vushtrrisë, përfshirë **Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) 2024–2032** dhe **Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (SUMP)**.

Sa i përket Investimeve kapitale, jemi duke i realizuar punimet sipas projekteve të parapara për realizim si në vijim:

- Asfaltimi i rrugëve lokale në qytet;
- Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatra;
- Rikonstruimi i Sheshit Adem Jashari dhe lidhja me parkun e qytetit;
- Ndërtimi i situacionit të pompimit rrjetit primar dhe rezervarve të ujit në pjesen lindore në Vushtri;
- Ndërtimi i rrethojave të qelikut mbi Urën e Lumit Sitnica.

Mbrojtje e mjedisit

Bazuar në Planin e punës e cila ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit, janë realizuar projekte që ndikojnë në mbrojtjen e mjedisit siç janë projekte për gjelbërim, pastrimi i rrugëve, mbikëqyrja dhe përkujdesja e parqeve në pjesë të ndryshme të qytetit ku janë të përfshira edhe sektorët nga Drejtoritë përkatëse siç është Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Janë lëshuar Leje Mjedisore Komunale ku nga këto leje janë krijuar të hyra në shumë prej **18350.67 €**

Problem në vete e që ka ndikim në efikasitetin e punës së drejtorisë është mungesa e stafit të inxhinierëve që sjell vështërsi në zbatimin sa më efikas të detyrave dhe përgjegjësi që ka kjo drejtori.

Kulturë Rini Sport

Në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport veprojnë sektorë të ndryshëm, andaj edhe raporti i punës së kësaj drejtorie paraqitet sipas sektorëve. Sa i përket mbarëvajtjes së punëve në këtë periudhë kohore, jemi munduar që të bëjmë më së miri punën që është kërkuar nga ana jonë. Në vazhdim paraqesim të dhëna mbi punën vjetore sipas sektorëve të DKRS-së:

QK "HASAN PRISHTINA"

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar aktivitete kulturore, artistike dhe përkujtimore, të cilat nuk kanë qenë të parapara në planin fillestar, por janë realizuar si rezultat i iniciativave të stafit të Qendrës së Kulturës, bashkëpunimit me institucionet komunale dhe qendrore, organizatat kulturore, shoqërinë civile, si dhe kërkesave të qytetarëve.

Përveç organizimit të aktiviteteve kulturore, Qendra e Kulturës ka ofruar mbështetje të vazhdueshme teknike dhe logjistike për organizimet e Komunës së Vushtrrisë, Zyrës së Kryetarit, Drejtorisë Komunale të Arsimit, Drejtorisë së Diasporës, Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe institucioneve dhe organizatave të tjera, duke siguruar pajisje të zërimit, ndriçimit dhe infrastrukturë tjetër teknike për zhvillimin e aktiviteteve publike.

Janë organizuar ose janë mbështetur këto aktivitete:

- Akademia Solemne për nderë të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës;
- Përrurimi i librit "Balloja mbretërore e Kurorës", të Alejna Selmit, më 16 shkurt 2026;
- Ceremonia për shpalljen "Më të mirët e vitit" për vitin 2025;

- Ekspozita "Kujtesa në fotografi", kushtuar xhamive të shkatërruara në Kosovë dhe Bosnje e Hercegovinë gjatë viteve '90, më 23 shkurt 2026;
- Organizimi i manifestimit tradicional për Epopenë e UÇK-së "Nata e Zjarreve" në fshatin Stroc, me pjesëmarrjen e veteranëve dhe ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;
- Mbështetja në realizimin e Ditës së mësuesit më 5 mars 2026;
- Trilogjia e veprave kushtuar krijimtarisë letrare të shkrimtarit dhe profesorit të shquar, Bedri Tahiri, me rastin e 70-vjetorit të lindjes së tij;
- Mbështetja e aktiviteteve për shënimin e 21 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Sindromës Doën;
- Mbështetja e Korit "VICIANUM";
- Akademia Përkujtimore dhe promovimi i monografisë "Latif Berisha – Jeta dhe Vepra", me autor akademik Isak Shema;
- Mbështetja e organizimit të transmetimit publik (live) të ndeshjes Kosovë – Sllovaki në qytetin e Vushtrrisë (26 mars 2026);
- Koncerti festiv me rastin e 30-vjetorit të themelimit të SHKA "Hasan Prishtina 1996–1998" (27 mars 2026);
- Akademia përkujtimore në 27-vjetorin e rënies së dëshmorit Shaban Krasniqi në Zhilivodë (28 mars 2026);
- Organizimi i transmetimit publik të ndeshjes Kosovë – Turqi (31 mars 2026);
- Promovimi i librit "Po ku je, Ibrahim Rugova?" të autorit Namik Selmani (3 prill 2026);
- Akademia Përkujtimore kushtuar dëshmorit Gëzim Rama (10 prill 2026);
- Organizimi i shkuarjes në Kukës të grupit nga Vushtrria në përkujtimin e "Eksodit 1999";
- Akademia Përkujtimore "Studimja '99";
- Promovimi i librit "Forca e Heshtur" të autores Iris Balli Hajdinaj dhe shfaqja e dokumentarit "Një Princeshë Europiane" (5 maj 2026);
- Ceremonia e rivarrimit të dëshmorit të kombit Bekim Zenuni në Kompleksin Memorial të Dëshmorëve (8 maj 2026);
- Organizimi i Festivalit "Zëbylbylat e Vicianës" nga AKV "Hasan Prishtina";
- Organizimi i përurimit të librit të Klasës së parë nga shkolla "Mustafë Venhari";
- Organizimi i shfaqjes së trupës amerikane Ballet Magnificat me performancën artistike "Stratagem" (18 maj 2026);
- Akademia Përkujtimore për Masakrën e 22 Majit në Vushtri;
- Promovimi i librit "Vushtrria gjatë viteve të rezistencës 1990–1999", me autorë Mr. Veli Karaça dhe Dr. Pajazit Pllana (26 maj 2026);
- Mbështetje teknike në organizimin e finales së Kampionatit të Hendbollit për Femra (28 maj 2026);
- Homazhe përkujtimore për Masakrën mbi Familjen Gërxhaliu (31 maj 2026);
- Organizimi i aktiviteteve dhe koncertit për fëmijë me rastin e 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve;
- Mbështetja në organizimin e "Spelling bee", në bashkëpunim me Innovation Academy;
- Promovimi i librit "Në çdo fletë një botë" të autores Taina Musliu;
- Akademia Solemne për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë (17 qershor 2026);
- Organizimi i mbrëmjes së baletit artistik (19 qershor 2026);
- Ceremonia e diplomimit të maturantëve të Gjinnazit "Eqrem Çabej" (23 qershor 2026);
- Organizimi i përbashkët me Innovation Academy i edicionit të tretë të "Vushtrria Code Fest 2026";
- Organizimi i përbashkët me Innovation Academy i Gala Mbrëmjes së "Vushtrria Code Fest 2026" në Sheshin "Adem Jashari" (24 qershor 2026).

Gjatë periudhës 1 janar – 30 qershor 2026, librat për fëmijë më të kërkuar për lexim ishin:

“Verorja” e Rexhep Hoxhës.

“Andrra e jetës”, Ndre Mjeda

“Dheu është flori”, Sami Frashëri

“Kalamajtë e pallatit tim”, Bedri Dedja

-Sektori për të rritur:

Libri më iu kërkuar për lexim ishte “Prilli i thyer” i Ismail Kadaresë.

“Aksidenti”, Ismail Kadare

“Bardha e Temalit”, Pashko Vasa

“Besa”, Sami Frashëri

- Libri Shkencor: “Vicianë – Vushtrria I”, Dr.sc.Izet Miftari;

“Historia e Skenderbeut”, Marin Barleti;

Aktivitetet e punës në sektorin e bibliotekës së qytetit:

- Në sektorin për fëmijë, gjatë kësaj periudhe janë dhënë për lexim **1821** libra.
- Në sektorin e të rriturve, gjatë kësaj periudhe janë dhënë për lexim **928** libra.
- Sallën e leximit e shfrytëzuan **277** lexues.
- Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar **90** lexues të ri, për fëmijë 48 pa pagesë dhe 26 me pagesë lexues, për të rritur 19.

Gjatë periudhës 05 janar deri më 03 korrik 2026 janë përpunuar gjithsej 350 libra, janë inventarizuar 500 libra, janë signuar 350 libra, janë vendos etiketa në 350 libra, janë vulos 1050 libra.

Gjatë muajit mars bibliotekën e vizituan nxënësit e SHFMU “Enver Hadri” – Smrekonicë, të cilët u njoftuan nga afër me bibliotekën dhe fondin librar.

Shkollat të cilat ishin për vizitë dhe dhuruan libra:

Gjimnazi “Eqrem Çabej” – 21 nxënës dhe secili prej tyre i dhuroi nga një libër.

SHFMU “Andon Zako Çajupi” – 32 nxënës.

SHMU 2 – 32 nxënës dhe dhuruan 15 libra si dhuratë.

SHMLP “Bahri Haxha” - 38 nxënës dhe dhuruan 42 libra si dhuratë.

SHMT “Lutfi Musiqi” - 36 nxënës dhe dhuruan 15 libra si dhuratë.

SHMU 1 - 32 nxënës dhe i dhuruan bibliotekës 30 libra si dhuratë.

Ramadan Beshiri dhuroi librin e tij, “**Kadri Kaçanolli – Jeta dhe Vepra**”.

Shqipe Ademi 33 liobra.

Bahri Shyti dhuroi 10 ekzemplarë të librit të tij me titull: “**Kujt t’i besoj?**”

Gjatë muajit maj, biblioteka u pasurua me 320 libra nga prof. Murteza Dallku.

Gjatë muajit qershor, biblioteka u pasurua me 11 libra. Pesë prej tyre nga autorja Taina Musliu dhe gjashtë nga autori Bahri Bivolaku.

Bibliotekën e vizituan trupat amerikane të baletit “Ballet Magnificat”. Gjatë vizitës së tyre, ne i njoftuam me ambientet e bibliotekës, fondin librar dhe aktivitetet që zhvillohen.

Poashtu, u përrua libri “Vushtrria gjatë viteve të rezistencës 1990/1999”, nga autorët Mr. Veli Karaça dhe Dr. Pajazit Pllana.

Gjatë muajit qershor u përrua libri “Në cdo fletë një botë” nga autorja Taina Musliu.

Me rastin e Ditës së Çlirimit, 17 qershorit, u organizuan disa aktivitete dhe një konferencë shkencore.

Konferenca shkencore "Krimet serbe në Komunën e Vushtrrisë dhe rezistenca e Ushtrrisë Çlirimtare të Kosovës 1998-1999". Bartës kryesor i organizimit ishin: Prof.dr. Mentor Hasani dhe Dr.sc. Izet Miftar

MUZEU HISTORIK – ETNOGRAFIK

Gjatë kësaj periudhe, puna e Muzeut është fokusuar në ruajtjen, dokumentimin, evidentimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe shpirtërore të Komunës së Vushtrrisë, përmes aktiviteteve të ndryshme që kanë pasuruar fondin muzeal, kanë zgjeruar bashkëpunimin me komunitetin dhe kanë afruar gjeneratat e reja me vlerat historike e kulturore të qytetit tonë.

Përveç aktiviteteve të parapara në planin e punës, Muzeu ka vazhduar edhe me angazhimet e rregullta profesionale, duke u kujdesur për mirëmbajtjen e hapësirave muzeale, sistemimin e materialeve ekzistuese, dokumentimin e ekspozitave, pritjen dhe informimin e vizitorëve, si dhe zhvillimin e hulumtimeve të vazhdueshme në terren për identifikimin e vlerave të reja muzeale.

Po ashtu, stafi i Muzeut ka realizuar vizita të shumta hulumtuese në terrenin e Komunës së Vushtrrisë, ku janë identifikuar dhjetëra objekte dhe ekspozitë me vlerë historike nga fusha e etnologjisë, arkeologjisë, historisë dhe folklorit. Si rezultat i punës hulumtuese në terren, gjatë periudhës janar-qershor 2026 fondi i Muzeut të Vushtrrisë është pasuruar me gjithsej 36 ekspozitë të reja.

Biblioteka shkencore e Muzeut të Vushtrrisë, e cila posedon rreth 500 libra me përmbajtje nga fusha e historisë, arkeologjisë, etnologjisë dhe trashëgimisë kulturore, gjatë kësaj periudhe ka qenë në shërbim të studentëve, studiuesve dhe qytetarëve të interesuar. Literatura e saj ka shërbyer si burim i rëndësishëm për realizimin e detyrave studimore dhe punimeve shkencore.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar vizitave të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, përmes të cilave ata janë njohur me ekspozitat muzeale, historinë e qytetit dhe rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Gjithashtu, Muzeu ka vazhduar bashkëpunimin me shkollat verore, duke mirëpritur nxënës nga "American School of Kosova" në Shkabaj – Prishtinë dhe nga Shkolla Verore "Horizon Education" në Vushtri.

SEKTORI I RINISË DHE SPORTIT

Aktivitetet në fushën e rinisë

Janë zhvilluar takime koordinuese me organizata rinore dhe grupe joformale të të rinjve me qëllim planifikimin e aktiviteteve për vitin 2026.

Është vazhduar bashkëpunimi institucional me Qendrën Rinore "Hareja", e cila vazhdon të ofrojë programe dhe aktivitete edukative për të rinjtë.

Është vazhduar bashkëpunimi me organizatën gjermane DVV International në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit për zhvillimin e programeve të aftësimit profesional dhe edukimit joformal për të rinjtë dhe të rriturit.

Janë mbajtur takime informuese dhe konsultative me përfaqësues të organizatave rinore lidhur me mundësitë e aplikimit në programe dhe projekte të ndryshme.

Është ofruar mbështetje profesionale për organizatat rinore për përgatitjen e projekt-propozimeve dhe aplikimeve në programe të ndryshme të donatorëve.

Janë zhvilluar aktivitete informuese për të rinjtë lidhur me mundësitë e trajnimeve dhe programeve edukative që ofrohen përmes Qendrës Rinore.

Ka filluar implementimi i projekteve të mbështetura nga UNDP dhe Komuna e Vushtrrisë, ku disa projekte janë në mbështetje të rinisë

Aktivitetet në fushën e sportit

Është organizuar ceremonia e shpalljes së “Sportistit të Vitit” për Komunën e Vushtrrisë, ku janë vlerësuar sportistët, trajnerët dhe klubet me rezultate të dalluara gjatë vitit paraparak.

Në këtë ceremoni janë ndarë mirënjohje dhe çmime për sportistët më të suksesshëm në kategori të ndryshme.

Spektori i sportit ka mbajtur takime koordinuese me klubet sportive të komunës për identifikimin e nevojave dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive gjatë vitit 2026.

Është bërë monitorimi i aktiviteteve dhe garave sportive të klubeve lokale që garojnë në ligat përkatëse.

Janë zhvilluar komunikime dhe koordinime me përfaqësues të klubeve sportive për organizimin e aktiviteteve dhe turneve sportive gjatë vitit 2026.

Spektori i Rinisë dhe Sportit ka realizuar aktivitete në funksion të zhvillimit të jetës rinore dhe sportive në komunën e Vushtrrisë. Bashkëpunimi me organizatat rinore, qendren rinore dhe klubet sportive ka vazhduar në mënyrë konstruktive dhe pritet që gjatë muajve në vijim të realizohen aktivitete të tjera në dobi të rinisë dhe sportit.

ARKIVI HISTORIK

Arkivi Komunal i Vushtrrisë është institucion përgjegjës për pranimin, ruajtjen, evidencimin, sistemimin, klasifikimin dhe mbrojtjen e dokumentacionit arkivor të krijuar nga institucionet e nivelit lokal. Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Arkivi Komunal i Vushtrrisë ka vazhduar realizimin e detyrave të parapara në kuadër të veprimtarisë së tij, duke u angazhuar në pranimin, përpunimin dhe ruajtjen e dokumentacionit të institucioneve komunale, si dhe në trajtimin e kërkesave të palëve për qasje në dokumentacionin arkivor.

Gjatë periudhës raportuese, Arkivi Komunal ka realizuar punët e rregullta profesionale dhe administrative në bashkëpunim me drejtoritë komunale dhe njësitë tjera organizative të Komunës së Vushtrrisë.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve, është zhvilluar komunikim dhe konsultim i vazhdueshëm me drejtoritë komunale të cilat kanë dorëzuar materiale arkivore për periudha të ndryshme kohore, me qëllim të regjistrimit, përpunimit dhe finalizimit të dosjeve të cilat kanë karakter të ruajtjes së përhershme.

Një ndër aktivitetet kryesore të Arkivit gjatë kësaj periudhe ka qenë pranimi i dokumentacionit arkivor nga drejtoritë komunale dhe njësitë tjera organizative të Komunës së Vushtrrisë.

Pranimi i këtij dokumentacioni ka ndikuar në ruajtjen më të sigurt të materialeve me vlerë administrative dhe juridike, si dhe në funksionalizimin më të mirë të sistemit arkivor komunal. Këto aktivitete kanë kontribuar në organizimin më të mirë të dokumentacionit dhe në krijimin e kushteve më të përshtatshme për ruajtjen dhe gjetjen më efikase të materialeve arkivore.

Depoja e Arkivit Komunal, ku ruhet dokumentacioni arkivor, i plotëson kushtet bazë për ruajtjen e materialeve, megjithatë ekziston nevoja për pajisjen e saj me raftë adekuate, të cilat janë të domosdoshme për sistemimin profesional të dokumentacionit. Materiali arkivor që gjendet në depo është i ndarë sipas njësive organizative dhe institucioneve përkatëse, por mungesa e rafteve e vështirëson sistemimin e plotë dhe renditjen sipas standardeve të parapara me legjislacionin për arkivat dhe lëndën arkivore. Pajisja e depos me raftë profesionale do të mundësonte shfrytëzim më efikas të hapësirës, mbrojtje më të mirë të dokumentacionit dhe menaxhim më të avancuar të fondit arkivor.

Puna e realizuar gjatë kësaj periudhe ka kontribuar në mbrojtjen e trashëgimisë dokumentare të Komunës së Vushtrrisë, në përmirësimin e organizimit të fondit arkivor dhe në ofrimin e shërbimeve profesionale për institucionet dhe qytetarët.

TEATRI I QYTETIT "ADEM MIKULLOVCI"

Hartuam projektin për organizimin e Garës së Recitatorëve, e cila planifikohet të mbahet gjatë muajit prill, me pjesëmarrjen e të gjitha shkollave të komunës. Gara do të zhvillohet në tri kategori: nxënësit e klasave I–V, nxënësit e klasave VI–IX dhe nxënësit e shkollave të mesme. Projekti është dorëzuar për mbështetje dhe jemi në pritje të përkrahjes financiare.

Gjithashtu, kemi hapur audicionin për shfaqjen për fëmijë "Panda dhe Korbi", një shfaqje edukative dhe argëtuese, e cila synon të nxisë kureshtjen e fëmijëve dhe pjesëmarrjen e tyre si spektatorë, por edhe si aktorë të rinj. Edhe ky projekt do të dorëzohet në Drejtorinë për Kulturë, Rinë dhe Sport (DKRS), me shpresën që të mbështetet financiarisht.

Me rastin e 7 Marsit – Ditës së Mësuesit, për dy javë me radhë kemi zhvilluar përgatitje intensive me aktorët dhe recitatorët. Rita Spahiu përgatiti monologun "Epopeja e Prekazit", Vanesa Sahiti poezinë "Mësuesi si Dritë", ndërsa Ragip Musliu poezinë "7 Marsi". Ky aktivitet u realizua në bashkëpunim ndërmjet Teatrit dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit, në kuadër të shënimit të Ditës së Mësuesit.

Gjatë kësaj periudhe, në teatër ishte për vizitë aktori, producenti dhe regjisori James Fetahu, i cili prezantoi disa filma me mundësi shfaqjeje në teatrin tonë dhe zhvilloi diskutime rreth bashkëpunimeve të mundshme në të ardhmen. Për nder të 2 Majit, Teatri u paraqit me dy aktorë, Tuana Grabovci dhe Ragip Musliu, në aktivitetin e organizuar me këtë rast. Po ashtu, organizuam promovimin e librit "Rrënjët – Historia dhe Gjenetika e Familjes Feka", me autor Mr. Sc. Dr. Blerim Feka.

Në muajin maj filluam përgatitjet për shfaqjen teatrale "E Vërteta", me autor Florian Zeller.

Gjeodezi Kadastër dhe Pronë

Gjatë periudhës 01.01.2026–30.06.2026, në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

1.	Kërkesat e pranuara përmes Intranetit 1917, kërkesat e pranuar online 1385, gjithsejtë 3302	
2.	AKTVENDIME PER BARTJE	840
3.	AKT. PER KORRIGJIMIN E EMRAVE DHE MBIEMRA.	160
4.	AKTVENDIME PER REGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	108
5.	AKTVENDIME PER CREGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	35
6.	VERTETIME-CERTIFIKATA	120
7.	NDARJE, BASHKIM I PARCELAVE, KOORDINATA	402
8.	INQIZIMI I GJENDJES FAKTIKE	24
9.	Uzarpimet	
10.	KOPJE TE PLANIT	428
11.	LISTA POSEDUESE	1850
12.	KERKESA ZYRTARE TE NDRYSHME	68
13.	Shpronësime //	
14.	LENDET NE PROCEDURE	48
15.	Kërkesa tjera (identifikim, dalje ne teren, ankesa etj).	121

Në periudhën Janar-qershor 2026 kemi pranuar 840 kërkesa për regjistrimin e bartjes së pronës. Pas zhvillimit të procedurës administrative dhe studimit të lëndëve ky shërbim ka marr 792 aktvendime me të cilat janë miratuar apo refuzuar kërkesat e palëve, kurse në procedurë administrative për vendosje janë edhe 48 kërkesa (lëndë).

Kemi pranuar nga ana e palëve – qytetarëve 160 kërkesa për korrigjimin e gabimeve sa i përket emrit apo mbiemrit në regjistrat e pronave, të cilat gabime kanë pasuar nga e kaluara. Pas zhvillimit të procedurës administrative janë aprovuar 152 kërkesa të tilla ndërsa 8 prej tyre janë refuzuar. Këto kërkesa në lidhje me korrigjimin e emrit apo të mbiemrit bëhen pa pagesë.

Janë pranuar 108 kërkesa për regjistrimin e hipotekave dhe 35 kërkesa për çregjistrimin e hipotekave, të paraqitura nga personat fizik dhe juridik.

Pas zhvillimit të procedurës kemi marr 108 aktvendime për regjistrimin e hipotekave dhe 35 aktvendime për çregjistrimin e hipotekave.

Për nevoja të aplikuasve të ndihmës sociale janë lëshuar 172 certifikata që nuk posedojnë pasuri të paluajtshme si dhe 220 certifikata pronësore. Pasi që përfituesit e ndihmës sociale janë të liruar nga pagesa për shërbimet të tilla nga këto shërbime nuk janë inkasuar mjete financiare.

Gjatë periudhës raportuese janë lëshuar 1850 certifikata pronësore dhe 428 kopje të planit.

Pranë kësaj drejtorie kemi aprovuar kërkesa zyrtare të ndryshme të parashtruara nga ana e organeve komunale, gjyqësore, institucioneve qeveritare dhe joqeveritare etj.

Gjatë periudhës raportuese janë inkasuar mjete financiare në vlerë prej 67,159.14 euro.

MENAXHIMI I PRONËS KOMUNALE

Bazuar në nenin 22, paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së pa Luajtshme të Komunës, nenit 27 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme, paraqesim Informatë të veçantë lidhur me dhënien në shfrytëzim të tokave bujqësore dhe lokaleve afariste në pronësi të komunës për periudhën 01.01.2026-30.06. 2026, e cila informatë do të paraqitet e ndarë nga ky raport.

PUNET E KRYERA PER NEVOJA TE KOMUNES

Gjatë periudhës raportuese zyrtarët e drejtorisë kanë kryer punë të ndryshme për nevoja të Komunës, gjegjësisht të drejtorive tjera gjatë realizimit të projekteve të ndryshme (asfaltim të rrugëve, rregullim të trotuareve, lirim të hapësirave publike etj.)

Vlen të ceket lrimi i hapësirave publike në rrugën Bekim Berisha me që rast janë krijuar kushtet për realizimin e projektit për asfaltimin dhe zgjerimin e rrugës në fjalë.

Për kundër punëve dhe detyrave të punës të kryera në gjashtë mujin e parë të këtij viti, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, ballafaqohet me një sërë problemesh të natyrës objektive dhe subjektive si: Mungesa e Elaborateve kadastrale, të cilat janë plaçkitur nga okupatori serb në vitin 1999,

Problemet e trashëguara të natyrës pasurore-juridike si uzurpimet, kontestet e bartura nga komasacioni etj.

Inspektimet

Drejtoria për Inspektime në Komunën e Vushtrrisë gjatë kësaj periudhe kohore me rastin e ushtrimit të veprimtarisë mbikëqyrëse, aktivitetet inspektuese i ka përqendruar në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira operatorëve ekonomik në aplikimin e dispozitave ligjore dhe ushtrimin e veprimtarive .

Në kuadër të Drejtorisë për Inspektime veprojnë Inspektorë të fushave të ndryshme, andaj raportin gjashtë mujor të punës po e paraqesim në mënyrë të detajuar ku për secilin sektor janë paraqitur aktivitetet sipas fushave të bazuar në planin e punës për vitin 2026 me sa vijon:

Inspektorati i tregut

Gjatë kësaj periudhe aktivitetet e veta i ka përqendruar në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë dhe akteve tjera nënligjore me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira në aplikimin e dispozitave ligjore . Prandaj në raport hynë aktivitetet të ndryshme të punës si në vijim::

- Rregjistrimin e biznesit

- Vendosjen e çmimeve,
- Kontrollimi i dhënjes së kuponave(faturave) blerësve,
- Udhëzimet teknike dhe garancionet e mallrave si dhe saktësia e dokumentacionit përcjellës etj.
- Rrespektimin e orarit të punës,
- Kontrollimin e deklaratave të mallrave,
- Inspektimi i kushteve teknike të subjekteve afariste tregtare që merren me shumicë dhe pakice dhe subjektet shërbyese etj,
- Dekleracioni i mallit,
- Faturat hyrëse dhe dalëse,
- Kontrollimi i shitësve ambulant(dokumentacionin përcjellës).

Mirëpo vlenë të theksohet një koment lidhur me kalimin e kompetencave të Inspektoratit të tregut nga niveli lokal në atë qendror për të cilën është në dijeni edhe kryetari i Komunës.

Andaj në vijim po e citojmë se duke u bazuar në ndryshimin e legjislacionit si dhe vendimeve përkatëse për riorganizimin e sistemit inspektues, kompetencat e Inspektoratit të tregut janë transferuar nga niveli lokal në nivelin qendror në ministri.

Si rezultat i këtij procesi të tranzicionit, inspektorët e tregut që ende nuk janë transferuar përfundimisht në strukturat përkatëse të ministrisë gjenden në një periudhë administrative kalimtare.

Perderisa nuk është përfunduar procedura e sistemit dhe nuk janë nxjerrë vendimet përkatëse nga organet kompetente këta inspektorë nuk kanë autorizim për ushtrimin e aktiviteve inspektuese dhe zhvillimin e procedurave administrative në teren

Veprimtaria inspektuese gjatë kësaj periudhe do të mund të krijonte paqartësi lidhur me kompetencën institucionale dhe vlefshmërinë e akteve të nxjerra.

Prandaj, moszhvillimi i aktiviteteve nga ana e inspektorëve të tregut në nivel lokal nuk paraqet moshkrerje të detyrës, por është pasojë e procesit të transferimit të kompetencave dhe mungesës së autorizimeve përkatëse deri në nxjerrjen e vendimeve përfundimtare nga institucionet përgjegjëse.

Inspekcioni i komunikacionit

Duke u bazuar në planin e punës së lartcekur si dhe në mbështetje të legjislacionit aktual në fuqi inspektorati i komunikacionit për këtë periudhë kohore ka lëshuar: procesverbale, vendime për pranime teknike të autotaksive, vendime për gjoba mandatore, ku dhe janë inkasuar mjete bazuar në vendimet. Me qëllim të përmirimit të gjendjes së transportit rrugor në teritorin e Komunës së Vushtrrisë janë marrë masa konform dispozitave ligjore si dhe inspektimet janë kryer në bashkëpunim me Policinë e Kosovës-Stacioni në Vushtri:

Inspektorati	Nr. i kërkesave	Aktivite Inspektuese	Procesverbale	Urdhëresa	Aktvendime	Gjoba mandatore
Inspektorët e Komunikacionit	15	111	37	22	21	6

Inspekcioni i shërbimeve publike

Aktivitetet

- Inspektimi i hapësirave publike – rrugë, trotuare dhe sheshe
- Përcjellja dhe pastrimi i ujërave të zeza dhe atmosferike
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara publike
- Mbikëqyrja e artjes, deponimit dhe përpunimit të mbeturinave
- Mirëmbajtja e ndriqimit publik
- Mbikëqyrja e mirëmbajtjes së varrezave
- Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave

Inspektimi në qytet është bërë kryesisht në rrugën “Ismail Qemajli”, sheshi “Hasan Prishtina” dhe sheshi “Adem Jashari”. Kurse, sa i përket fshatrave inspektim është bërë në tërë fshatrat e qytetit dhe në vecanti Banjskë, Skoqan, Gracë dhe të tjera përreth me qëllimin e parandalimit të hudhjes së mbeturinave. Gjatë kësaj periudhe kohore është bërë pastrimi i të gjitha deponive në këto fshatra. Përveç aktiviteteve në bazë të planit të punës, kemi bërë edhe inspektimin në pjesë të tjera të qytetit sipas nevojës, në bazë të detyrës zyrtare.

Në mënyrë tabelare:

Procesverbale	43
Vendime	9
Gjoha	9

Inspektorati i ndërtimit

Inspektorati i Ndërtimit edhe pse në mungesë stafi me një inspektorë të vetëm, ka ushtruar veprimtarinë mbikëqyrëse në terren, sipas detyrës zyrtare, si dhe ankesat e qytetarëve dhe në bashkëpunim dhe me kërkesë të Drejtorit të Drejtorisë. Për këtë periudhë janë kryer inspektime lidhur me ndërtimet e objekteve të ndërtimit të lartë dhe të ulët, duke kontrolluar terrenin e komunës së Vushtrrisë, ndërprerjen e të gjitha ndërtimeve pa leje, kontrollimin e objekteve me leje ndërtimi, rrënimin e objekteve pa leje etj.

Për të ardhur deri te një analizë sa më e saktë e punëve kemi bërë grumbullimin e të dhënave për aktivitetet a planifikuara dhe atyre të realizuara, duke nxjerrë statistika e deri te rekomandimet për të rritur efikasitetin në punë.

Aktivitetet e implementuara

- Në kuadër të kontrollimit të terrenit, janë përpiluar procesverbalet dhe Aktvendime për ndërtimet me leje ndërtimi dhe ato pa leje ndërtimi.
- Ndërprerja e ndërtimeve pa leje ndërtimi, ndalimi i punimeve është urdhëruar me afat kohor menjëherë si dhe janë vendosur shirit rrethues të cilët ndalojnë punimet pa leje deri në pajisjen me dokumentacion përkatës të lejes ndërtimore, shumica e ndërtimeve pa leje janë shtëpi banimi, por ka edhe objekte afaristë.
- Kontrollimi i objekteve me leje ndërtimi,

Procesverbale

Procesverbalet janë lëshuar për ndërtimet pa leje ndërtimi dhe pa pëlqime urbanistike, kryesisht për ndërtime të banimit individual, por ka pas edhe raste të ndërtimeve për të cilat kërkohen pëlqimet urbanistike, siç janë: te terasat para objekteve, ndryshimet në objektet ekzistuese me leje ndërtimi, ndryshimet në kulmet e objekteve dhe në fasadat e tyre.

Vendime për ndërprerjen e ndërtimeve pa leje ndërtimi

Vendimet për ndërprerje të punimeve janë lëshuar për objektet që kërkohet leja e ndërtimit por të cilat nuk janë pajisur me leje ndërtimi, vendimet për ndërprerjen të punimeve kanë karakter të urdhërësës së prere për ndërprerje të punimeve deri në pajisje me leje ndërtimi.

Gjopa mandatorë

Gjobat mandatore janë lëshuar në bazë të udhëzimit administrativ për shqiptimin e gjobave mandatorë, për ndërtimet e bëra pa leje dhe pjesëmarrësve në ndërtim si dhe në mbështetje të Ligjit për Kundërvajtje 05/L-087 të cilët kanë punuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në lidhje me ndërtimin e objekteve.

Sfidat

ndër sfidat kryesore të evidentuara janë:

- Mungesa e Planifikimit Hapësinor dhe Planeve Rregulluese të hollësishme, në shumicën e zonës mungojnë planet rregulluese po ashtu pa përputhshmëria e planeve me gjendjen faktike në terren, mangësi të tilla detyrojnë qytetarët të ndërtojnë objekte pa leje ndërtimi.
- Vonesat procedurale në lëshimin e lejeve ndërtimore,
- Pamundësia për tu pajisur me leje ndërtimore (mungesa e Planeve Rregulluese, zona nën komasacion, problemet pronësore, etj.), propozojmë që kuvendi komunal të hartojë rregullore komunale për lehtësimin dhe tejkalimin e këtyre sfidave,
- Nevoja për banim (rritja e familjes, shtimi i numrit të të martuarve, nevoja për banim më të qëndrueshëm),
- Kërcënimet dhe sulmet e vazhdueshme ndaj stafit, mungesa e mbështetjes shëndetësore dhe financiare,
- Mungesa e stafit, numri i vogël i inspektorëve, , objektet me shkallë të lartë të rrezikshmërisë mungesa e inspektorëve profesional për këtë lëmi),

Inspektori i Mjedisit

Angazhimi në edukimin dhe në vetëdijesimin e popullatës në lëmin e Mbrojtjes së Mjedisit

Gjopa të shqiptuara: 3, shuma 850€

- Inspektimi i bizneseve dhe ndërtimeve rreth zbatimit të lejeve mjedisore komunale, gjithsejtë janë Inspektuar 22 objekte në ndërtim e sipër, është shqiptuar nje gjobe për mos respektim të LMK
- Inspektimi i ndërmarrjes publike NPL Përparimi, bizneseve dhe ekonomive familjare rreth aktivitetit të mbeturinave, ripërdorimit dhe riciklimin e tyre kryesisht në zonat rurale – janë inspektuar gjithsejtë 18 biznese dhe ekonomi familjare, janë shqiptuar 2 gjoba për mbeturina dhe me vendim i është ndaluar aktiviteti „MSS Mobile Sanitary Service” SH.P.K si dhe NPL Përparimi i është ndaluar hedhja e mbeturinave në fshatin Bajnskë
- Mbikëqyrjen inspektuese të ujërave në nivele komunale, në fshatin Novolan i është ndaluar një personi nxirrja e rërës dhe dheut në afërsi të Lumit Silnica dhe është njoftuar Inspektorati i KPMM – se pasi që është në kompetencën e tyre inspektimi
- Për çdo aktivitet tjetër ku ka pas ankesa dhe nuk ka qenë kompetence e Inspektorit të mbrojtjes së mjedisit në Komune përmes emailit i është deleguar Inspektorateve kompetente
- Procseverbale: 40
- Vendime:2

Aktivitetet të paraqitur në mënyrë tabelare

Spektori i Inspektoris	Numri i Inspektoris	Fletëparaqitje për Gjykatë	Procesverbale	Aktivendime	Mbyllje të lokaleve përkohsishtë	Gjaba mandatore të realizuara	Urdhëresa	Gjaba mandatore
Inspektoris e Tregut	3	/						
Inspektoris e Ndërtimtarisë	1	/	53	5	/	3	30	
Inspektoris e Komunikacionit	2	/	37	21		6	21	
Inspektori i Mjedisit	1	/	40	5	/	3	/	
Inspektoris e Higjienës Shërbim publikë	4	/	43	9		9	20	
Totali	11		173	40	/	21	71	

Mbrojtje dhe shpëtim

Ky raport pasqyron dëmet e shkaktuara në sektorin e ekonomisë dhe bujqësisë në Komunën e Vushtrrisë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026. Të dhënat janë mbledhur në bazë të kërkesave zyrtare për kompensim të dëmeve të parashtruara nga qytetarët e komunës, si dhe nga vlerësimet e bëra nga Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera në nivel lokal.

Sipas vlerësimit të Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, vlera e përgjithshme e dëmeve për periudhën janar-qershor 2026 është si vijon:

Në sektorin e ekonomisë familjare, të shkaktuara nga vërshimet dhe zjarret: 25,616.00 €

Në sektorin e bujqësisë, të shkaktuara nga vërshimet, temperaturat e ulëta, era e fortë dhe zjarret: 40,431.69 €

Në biznese, të shkaktuara nga vërshimet: 86,078.13 €

Vlera e përgjithshme arrin shumën prej 152,125.82 €.

Gjatë kësaj periudhe, nga situata e krijuar në teren është paraqitë nevoja për intervenim me makineri të ndryshme meqë rast Kompaninë Kontraktuese N.N.P „HYSNIA” kemi angazhuar në vende të ndryshme për intervenime emergjente dhe parandaluese

Vlera e përgjithëshme e shpenzimeve për intervenime emergjente dhe parandaluese për këtë periudhë 6 mujore ka qenë: **34.772.10 euro.**

Prioritetet e DMSH-së për situatat e krijuara:

- Ndihma dhe shpëtimi i njerëzve;
- Hapja e rrugëve dhe kanaleve nëpër vende ku ka mbeturina të ndryshme e që e kanë bllokuar derdhjen e ujit me qëllim të parandalimit të rrezikut.
- Debllokimi i lëshesave dhe kanalizimeve në raste të vërshimeve apo mbylljeve nga shkaktarë të ndryshëm.
- Evitimi i ujit prej shtëpive që kanë qenë të rrezikuara nga vërshimet;
- Furnizimi me ujë të pijshëm për banorët të cilëve iu është ndotur uji i pijes;
- Vizita mjekësore për banorët e izoluar në rast nevojë;
- Hapja e rrugëve si pasojë e rrëshqitjes së dheut.

KATEGORIZIMI I ZJARREVE DHE INTERVENIMEVE SIPAS MUAJVE GJATË VITIT 2026

	LIQI I INTERVENIMIT	Jan.	Shku.	Mars	Prill	Maj	Qersh	GITHËSEJTË
1	ZJARRË	11	12	30	26	28	36	143
2	INTERVENIME TEKNIKE	13	8	6	5	10	12	54
3	SHËRBIME	10	5	8	8	19	30	80
4	AKSIDENTE KOMUNIKACIONI			1	1	1	1	4
5	VËRSHIME	28						28
6	ALARME TË RREJSHME	1	1		1	1	1	5
	Gjithësejtë:	63	26	45	41	59	80	314

Përfundim:

Me gjithë problemet e paraqitura konsiderojmë se Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim me përgjegjësinë më të madhe ka ndërmarrë të gjitha masat, procedurat dhe aktivitetet e duhura, duke azhurnuar dhe mundësuar realizimin e Planit të veprimit për menaxhim të situatës në terren dhe se angazhimet e kompanive dhe akterve tjerë relevant kanë qenë në përputhje me kërkesat e drejtorisë dhe nevojave të qytetarëve për t’u siguruar qëndrim nëpër shtëpitë e tyre dhe lëvizje të lirë. Konsiderojmë se menaxhimi i situatës në terren është kryer me mjaft sukses.

Drejtoria për Diasporë

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar takime të shumta me qytetarë dhe biznese nga diaspora, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe promovimin e investimeve në Komunën e Vushtrisë.

Në bashkëpunim me Shoqatën IVK, të udhëhequr nga z. Naim Sadiku në Kapfenberg të Austrisë, është arritur marrëveshja për organizimin e një festivali ndërkombëtar në Vushtri. Në festival do të marrin

pjesë grupe artistike nga shtete të ndryshme të rajonit, me rreth 120 artistë pjesëmarrës, të cilët do të qëndrojnë dy net në Vushteri dhe do të performojnë para qytetarëve.

Në kuadër të fuqizimit të bashkëpunimit me diasporën, Drejtoria për Diasporë mori pjesë në tryezën e organizuar nga Instituti GAP, me mbështetjen e GIZ-it dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ku u prezantua raporti "Fuqizimi i kapaciteteve të komunave për angazhimin e diasporës në Kosovë". Në këtë raport, Komuna e Vushtrisë u vlerësua ndër komunat më të përgatitura në aspektin e shërbimeve dhe strukturave komunale për diasporën, duke u veçuar për funksionalizimin e Drejtorisë për Diasporë, ofrimin e shërbimeve për mërgatën dhe angazhimin e vazhdueshëm në krijimin e urave të bashkëpunimit me bashkatdhetarët tanë.

Është realizuar bashkëpunim me z. Saim Bivolaku, përmes të cilit fëmijëve të diasporës u është ofruar mundësia që gjatë pushimeve verore të ndjekin pa pagesë mësimet e vallëzimit në Shtëpinë e Kulturës.

Pastaj, pjesëmarrje në punëtorinë për **Angazhimin e Diasporës në Zhvillimin Ekonomik Lokal**, të organizuar nga Caritas Zvicëran. Gjatë punëtorisë u diskutuan mundësitë lokale për investimet e diasporës, ofertat komunale për bizneset e diasporës dhe u punua në hartimin e një prezantimi të ofertës komunale për investitorët nga diaspora.

Drejtorja për Diasporë, në bashkëpunim me këshillat e fshatrave të Komunës së Vushtrisë, ka mbështetur organizimin dhe themelimin e shoqatave të diasporës për fshatra të ndryshme. Qëllimi i këtyre organizimeve është mobilizimi i mërgatës për mbështetjen e projekteve lokale, përmirësimin e infrastrukturës, mbështetjen e arsimit dhe ndihmën për familjet në nevojë.


Një shembull i suksesshëm është fshati Ceceli, ku përmes bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Diasporës dhe Këshillit të Fshatit janë realizuar dhe finalizuar projekte të rëndësishme në vlerë prej mijëra eurosh në dobi të komunitetit lokal.

Drejtorja për Diasporë mbetet e përkushtuar në forcimin e lidhjeve me mërgatën dhe në krijimin e mundësive të reja për zhvillimin e Komunës së Vushtrisë.

Përfundim

Ky Raport paraqet punët që janë kryer nga ekzekutivi i komunës në këtë gjashtëmujor. Nga muaji korrik deri në ditën kur po paraqitet ky raport janë kryer edhe punë tjera të shumta, të cilat do të përfshihen në raportin vjetor 2026.

 Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës

Komuna e Vushtrrisë

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

DATE/A	07.09.2026
PËR:	KPF: KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA
PËRMES:	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Drejtori i DBZHR-së z. Besim Shyti
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë për procesin e korrje-shirjeve 2026 si dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore

Komuna e Vushtrrisë si çdo vit edhe këtë vit ka bërë përgatitjet e nevojshme për procesin e korrje shirjeve për rajonin e Komunës së Vushtrrisë. Disponojmë me regjistrin e poseduesve të autokombajnave e që janë 63 autokombajna . Ministria e bujqësisë e ka caktua çmimin për shërbime të autokombajnave gjatë procesit të korrje shirjeve e që ishte caktuar 130 € për hektarë. Disa auto kombajnerë të komunës sonë fillimisht kanë marrë pjesë në korrje të grurit në rajone tjera ku procesi i pjekjes ka qenë më i hershëm por të njëjtin janë kthyer në kohë në territorin e komunës sonë për korrje.

Procesi i korrje shirjeve ka filluar më 30.06.2026, përkundër reshjeve të herë pas herëshme procesi në tërësi ka shkua mirë, autokombajnerët u kanë përmbajtur udhëzimit të Ministrisë së Bujqësisë në lidhje me çmimin e caktuar, kanë qenë të pajisur me mjete mbrojtëse kundër zjarrit, në përgjithësi e kanë përfillë rendin e korrjes në teren.

Vështirësitë e herëpashershme paraqiteshin me pamundësinë e qasjes së autokombajnave në parcela të caktuara për shkak të rrugëve të pakalueshme me ç'rast Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në bashkëpunim me Drejtorinë e Emergjencave kemi intervenuar në hapje të rrugëve të arave në fshatrat si Stanove i poshtëm, Lummadh, Beçiq, Osblan, Reznik, Dumnice etj.

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural e ka përcjellë në vazhdimësi këtë proces të korrjeve shirjeve duke vizituar numër të konsiderueshëm të autokombajnave në proces të korrje shirjes, përgjigjes të thirrjeve të fermerëve për mundësinë e sigurimit të autokombajnave me ç'rast fermerëve u kemi siguruar autokombajnën për korrjen e grunajave të tyre në viset e thella rurale.

Në proces të korrje shirjeve janë angazhuar edhe një numër i autokombajnave nga komunitat tjera me ç'rast në proces kanë marrë pjesë 75 autokombajna.

Fatmirësisht ky vit njihet si vit i prodhimitarisë rekorde të grurit falë kushteve tejet të favorshme thuaja se gjatë gjithë periudhës vegjetative të grurit me çka pasoi një rendiment tejet i lartë në pjesën më të madhe të ngastrave të mbjella me grurë. Përveç rendimentit të lartë cilësia e kokrrës së grurit në shumë raste ishte në suaza të standardeve normale të kërkuara nga depozuesit e grurit, standarde këto të cilat janë të nevojshme për plotësim nga ana e kokrrës e grurit për tu pranuar e për t'iu nënshtruar procesit të bluarjes. Përkundër kësaj një numri të konsiderueshëm të fermerëve mullinjtë nuk u kanë pranuar një sasi të konsiderueshme të grurit me pretekst se nuk kanë kapacitete për pranim të grurit. Ky grurë i pa pranuar është depozuar në kushte të

pa favorshme nëpër ekonominë familjare kurse një sasi është duke u përdorë për përgatitjen e ushqimeve të koncentruar për kafshë.

1.Data e fillimit dhe përfundimit të korje-shirjeve 30.06.2026 - 05.08.2026

2.Numri i Autokombajnave të angazhuar----- 75 copë

3.Sipërfaqet e korrura me Grurë----- 3700 (ha)

4.Sipërfaqet e korrura me Elb----- 60(ha)

5.Rendimenti mesatar i Grurit----- 3700 (kg/ha)

6.Rendimenti mesatar i Elbit ----- 3500(kg/ha)

Përgatitjet për mbjelljet vjeshtore 2026

Gjendja momentale në terren është mjaft e pa favorshme për procesin e mbjelljeve vjeshtore ngase në muajin e fundit gusht dhe shtator kanë mbizotëruar temperatura të larta me ç'rast i kanë pa mundësi bujqit që të fillojnë me përgatitjet për mbjellje vjeshtore.

Fakti se numër i konsiderueshëm i fermerëve tani më posedojnë mekanizëm të nevojshëm për përgatitje të tokës për mbjellje paraqet një përparësi të rëndësishme për realizimin me kohë të mjellurave vjeshtore. Me përmirësim të kushteve klimatike respektivisht pas reshjeve të shiut pritet intensifikimi i punëve në përgatitjen dhe mbjelljen e kulturave vjeshtore.

Ne bazë të dhënave të Drejtorisë për Bujqësi, gruri vazhdon të jetë kultura kryesore që mbillet me rreth 3800 ha gjatë sezonit vjeshtor .

Për këtë vit parashihet që sipërfaqe të konsiderueshme të tokës të mbillen me grurë, ndërsa pjesa tjetër me elb dimëror 80 ha, tërshërë 60 ha dhe bimë foragjere 60 ha.

Drejtoria për Bujqësi do të vazhdoj të përcjellë gjendjen në terren dhe të bashkëpunojë me fermerët, me qëllim që procesi i mbjelljeve vjeshtore të zhvillohet në mënyrë sa më të suksesshme dhe brenda afateve optimale agroteknike.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË / OPŠTINA VUČITRN / MUNICIPALITY OF VUSHTRRI



Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra
Kombëtare e Auditimit

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
-----	------------------------------------	--------	-------------	--	-----------------------	---	---------

1

**Çështja B1 -
Mbivlerësim
i detyrimeve
kontigjente
në pasqyrat
vjetore
financiare**

Neni 6 i Rregullores MF nr.01/20217, për raportim vjetor financiar, përcakton që OB-të duhet të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare. Gjithashtu, neni 18 i Rregullores, obligon OB-të në harmoni me LMFPP-në të raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.

Kryetari duhet të sigurojë që detyrimet kontigjente të shpalosura nëpasqyrat vjetore financiare, të mos përfshijnë urdhërat përmbarimor për realizimin e pagesave, e për të cilat nuk ka konteste gjyqësore me palët kontraktuese.

Bazuar në rekomandimin e Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente në pasqyrat vjetore financiare ne do i marrim të gjitha hapat e veprimit me qëllim të prezentimit më të sakt .

Zyra Ligjore

Shtat
or-
2026-
Mars-
2027

		Detyrimet kontigjente të prezantuar në pasqyrat vjetore financiare ishin mbivlerësuar për 1,568,004€. Komuna kishte pranuar propozimet përmbartimore për obligimet e tilla ndaj kontraktuesve, dhe nuk kishte bërë prapësimin e këtyre propozimeve për përmbartim, duke mos vazhduar me rastet e tilla në procedurë gjyqësore.		
--	--	---	--	--

Kjo ka ndodhur për shkak të pakujdesisë në përditësimin e informatave në regjistrin e kontigjencave dhe prezantimin e duhur financiar.



2	Çështja B2 - Klasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate	Me Ligjin nr. 08/L-332 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, neni 5, janë miratuar ndarjet buxhetore për kategoritë ekonomike përkatëse për secilën organizatë buxhetore. Gjithashtu, Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF- Shpenzimi i parave publike, neni 18, pika 3, përcakton që shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me udhëzimin administrativ për planin kontabël. Me planin kontabël të SIMFK- së janë përcaktuar saktë kategoritë ekonomike dhe kodet përkatëse prej nga duhet të realizohen pagesat e shpenzimeve sipas secilit lloj.	Kryetari duhet të sigurojë që gjatë hartimit të qarkoreve buxhetore, shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo në koordinim me Ministrin e Financave të shihen mundësit e ridestinimit të mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet nga	Klasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate është bërë për shkak Vendimeve përmbareme në mungesë mjeteve financiare.	Të gjitha Drejtorit	Mars- 2027
---	--	---	--	--	------------------------	---------------

		Pagesat në vlerë totale 1,187,376€ nuk janë klasifikuar në kategorinë e duhur ekonomike. Keqklasifikimet kanë rezultuar te këto kategori ekonomike: • Për shpenzime që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve, të cilat kanë të bëjnë me pagesat për kontratën kolektive të punonjësve të arsimit, janë paguar 428,105 nga buxheti i kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, 407,137€ nga buxheti i kategorisë së investimeve kapitale, dhe 129,000€ nga buxheti i kategorisë së subvencioneve. • Për shpenzimet që i takojnë kategorisë së investimeve kapitale janë	kategoritë ekonomike adekuate			
--	--	--	--------------------------------------	--	--	--

	paguar 223,134€ nga buxheti i kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Sipas regjistrit të siguruar nga Komuna, gjatë vitit 2025, si rezultat i procedurave përmbartimore dhe vendimeve gjyqësore nga paditë e punonjësve të arsimit për kompensimet ndërlidhur me kontratën kolektive, dhe kontraktuesve (furnitoreve) në emër të kamatave, tarifave të përmbartimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore janë paguar kosto shtesë në vlerë 687,855€. Kjo ka ndodhur për shkak të pagesave nga Thesari si rezultat vendimeve gjyqësore të ndërlidhura			
--	---	--	--	--

		me kontratën kolektive për punonjësit e arsimit, si dhe planifikimeve të gabuarra buxhetore.				
--	--	---	--	--	--	--

3	Çështja C1 - Nënvlerësim i pasurisë jofinanciare në pasqyrat vjetore financiare	Rregullorja MF-nr. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në OB, neni 6, paragrafi 3, përcakton që: pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-Pasuria. Pesë (5) pagesa për investime kapitale në vlerë totale 95,416€ nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël të pasurisë në SIMFK, dhe gjashtë (6) pagesa për blerjet e pasurive jokapitale në vlerë 17,316€ nuk janë regjistruar në programin e-Pasuria. Si rezultat, pasuritë jofinanciare të shpalosura në PVF janë	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme efektive që të gjitha pasuritë jofinanciare të regjistrohen në kohë dhe në mënyrë të saktë në regjistrin kontabël të pasurisë në SIMFK dhe në sistemin e-Pasuria.	Ne do l merrim të gjitha hapat e veprimit në mënyr qe ti rregullojm në SIMFK dhe të pasqyrojm gjndjen faktike sipas Rregullores nr.02/2013	Administrata dhe Buxheti	Shtator-2026-Janar-2027
---	--	---	---	---	--------------------------	-------------------------

		nënvlerësuar në total për 112,732€. Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në regjistrimin e pasurisë në sistemet përkatëse.					
4	Çështja B3 - Mbivlerësim i obligimeve të papaguara në pasqyrat vjetore financiare	Neni 6 i Rregullores nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, përcakton që, OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare. Gjashtë (6) fatura në vlerë totale 74,427€ të cilat ishin paguar gjatë vitit 2025, ishin	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle adekuate rreth përditësimit të regjistrit të obligimeve dhe që faturat e pranuar apo obligimet financiare të prezantohen saktë në	Menagjmenti do t'ju merr të gjitha hapat e veprimit në mënyrë të rregullimit të regjistrit të obligimeve të papaguara.	Drejtoria e Financave	Në vazhdim	

		prezantuar si obligime të papaguara në pasqyrat vjetore financiare. Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuate në menaxhimin dhe përditësimin e regjistrit të obligimeve të papaguara nga zyrtarët përgjegjës.	pasqyrat vjetore financiare.			
5	Çështja B4 - Mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme në pasqyrat vjetore financiare	Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga OB-të, neni 6, përcakton që: OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare. Gjithashtu, sipas Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 10,	Kryetari duhet të sigurojë që pronat komunale të mos ngarkohen me tatim në pronë.	Menagjmenti do t marr të gjitha hapat e veprimit që të dhenat nga protax dhe të dhënat nga kadastri në sistem të rregullohen në menyr që informata të jet e sakt dhe konkrete.	Drejtoria e Kadstrii dhe Financave	Në vazhdimi

	paragrafi 1 përcakton se: Tatimi në pronën e paluajtshme nuk do të vendoset në pronën e paluajtshme e cila është në pronësi ose posedim të: pika 1.1. Institucioneve publike të Republikës së Kosovës. Në regjistrin e llogarive të arkëtueshme të tatimit në pronë, është ngarkuar me tatim në pronë parcela publike që është në pronësi komunale, duke mbivlerësuar llogaritë e arkëtueshme për 26,231€. Kjo kishte ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme në mirëmbajtjen e			
--	---	--	--	--

		regjistrave të llogarive të arkëtueshme.					
6	Çështja A1 - Vazhdimi i kontratës së skaduar të punës pa procedurë të re të rekrutimit	Sipas Rregullores (QRK) nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA), neni 10 përcakton se konkursi për një periudhë të caktuar shpallet në rastet e zëvendësimit të përkohshëm të një nëpunësi, ngarkesës së përkohshme të punës apo për projekte me	Kryetari duhet të sigurojë që angazhimet e punonjësve me kontratë me afat të caktuar realizohen vetëm brenda qëllimit, kushteve kontraktuale dhe afatit të	Menaxhmenti do t'ju merr të gjitha hapat e veprimit dhe bazuar në Rregulloren 19/2024 ne do t'ju rregullojmë që të tilla.	Drejtoria e Arsimit	Në vazhdim	

	kohëzgjatje të caktuar. Ndërsa, sipas nenit 31, për këto angazhime lidhet kontratë pune për periudhë të caktuar, duke specifikuar datën e fillimit dhe përfundimit të saj. Komuna e Vushtrrisë ka zhvilluar një procedurë rekrutimi dhe ka lidhur kontratë pune me afat të caktuar me një mësimdhënëse, me qëllim zëvendësimin e përkohshëm të një mësimdhënëse që ishte në pushim të lehonisë. Me kthimin e mësimdhënëses të rregullt në vendin e saj të punës, e drejta e kontratës me afat të caktuar ka pushuar. Megjithatë, mësimdhënësja e	përcaktuar. Çdo ndryshim i pozitës apo angazhimit të ri, të bëhet përmes procedurës së re të rekrutimit.		
--	--	---	--	--

	angazhuar me kontratë me afat të aktuar është transferuar në një shkollë tjetër për të zëvendësuar një tjetër mësimdhënëse, pa zhvilluar një procedurë të re rekrutimi. Kjo ka ndodhur nga mosrespektimi i kufizimeve ligjore për përdorimin e kontratave me afat të caktuar vetëm për qëllimin për të cilin janë shpallur, si dhe mungesa e inicimit të procedurës së re të rekrutimit për pozitën e krijuar rishtazi, duke vazhduar angazhimin jashtë kornizës fillestare të kontratës.			
--	---	--	--	--

7	Çështja A2 - Mangësi në procesin e subvencionimi të për renovimin e banesave kolektive	Sipas Rregullës Financiare nr. 01/2013/MF, neni 36 kërkon që çdo pagesë nga kjo kategori të ketë bazë të qartë juridike dhe, kur i jepet një subjekti të caktuar, të mbështetet me marrëveshje zyrtare. Sipas Ligjit Nr. 03/L-040, Kuvendi i Komunës ka kompetencë të padelegueshme për miratimin e buxhetit dhe çështjeve financiare, ndërsa sipas Rregullores (KKV) nr. 03/2023, ai vendos për bashkëfinancimet kur pjesëmarrja e komunës është 50% ose më shumë e vlerës së projektit. Gjithashtu, me Deklaratën e Nevojave dhe Disponueshmërisë së Fondeve (DNDF) përcaktohet mënyra e	Kryetari duhet të sigurojë që projektet me bashkëfinanc im të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi i Komunës, dhe përmes marrëveshje s së bashkëfinanc imit të përcaktohen të drejtat dhe obligimet e secilës palë.	Bazuar në rekomandimin e subvencionimi të për renovimin e banesave kolektive si menagjment do i marrim të gjitha hapat e implementimit	Drejtoria e Bujqësis dhe Prokurimit	Në vazhd imsi	Çështja A2 - Subvencionimi për renovimin e banesave kolektive Komenti i korrigjuar: Gjetja ka natyrë të përzier prokurim / subvencion. Kontrata 2,715,335€ është kontratë pune e lidhur përmes prokurimit, por me elemente të bashkëfinancimit 83%. Me qëllim të zbatimit të rekomandimit, Drejtoria për Prokurim do të sigurojë që për kontrata të tilla në Dosjen e Tenderit të bashkëngjitet paraprakisht Marrëveshja e Bashkëfinancimit dhe Vendimi i Kuvendit Komunal për
---	---	---	--	---	---	---------------------	--

	bashkëfinancimit të kontratës publike. Për kontratën e punëve "Renovimi, izolimi, fasadimi, rikonstruimi i çative dhe bodrumeve të objekteve kolektive dhe Komunale" në vlerë 2,715,335€, mungonte marrëveshja e bashkëfinancimit të punimeve mes Komunës, N.P.L. Përparimi SH.A, dhe Këshillit të banesave të qytetarëve. Me kontratë dhe DNDF, komuna ka specifikuar që punimet do të bashkëfinancohen nga Komuna e Vushtrrisë, N.P.L. Përparimi SH.A, dhe qytetarët, ku pjesëmarrja e komunës në financim është planifikuar të jetë 83% e			aprovim të bashkëfinancimit mbi 50%, si dokument i detyrueshëm për inicim, konform Rr. 03/2023. Pagesa nga kategoria Subvencione do të bëhet vetëm me marrëveshje tri-palëshe.
--	--	--	--	---

	vlerës. Kjo kontratë e punëve e klasifikuar në kuadër të kategorisë ekonomike Subvencione dhe Transfere, nuk është aprovuar paraprakisht nga Kuvendi i Komunës, duke marrë parasysh se komuna ka pjesëmarrje të konsiderueshme të financimit të punimeve. Kjo ka ndodhur për shkak të paqartësisë në definimin dhe ndarjes së financimit për përfituesit privat dhe pjesës tjetër që mund ti takojë komunës, si dhe kontrolleve të dobëta të brendshme në fazën e planifikimit dhe aprovimit të projekteve.				
--	---	--	--	--	--

8	Çështja A3 - Mangësi në menaxhimin e kontratave të punëve dhe mos vazhdimi i sigurimit të ekzekutimit	Sipas Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, neni 70.23 përcakton që: Menaxheri i kontratës do të sigurojë se kontraktuesi kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë, Gjithashtu, neni 70.24 përcakton që: menaxheri i kontratës duhet të sigurojë që kontraktuesi i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës. Sipas nenit 63 të LPP-së dhe Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, neni 29, siguria e ekzekutimit (SE) kërkohej si parakusht për nënshkrim të kontratës. Shuma e SE do të jetë e	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave monitorojnë si duhet realizimin e punimeve, të shtojnë masat e kontrollit, dhe të mos aprovojnë punë apo furnizime të papërfunduara. Në rastet kur kontratat nuk arrijnë të përfundohen në kohën e duhur, siguri i ekzekutimit	Menaxhmenti do t'ndermerr të gjitha hapat e veprimit me qëllim të realizimit të rekomandimit të dhën.	Drejtoria Planifikim Urban.Drejtoria e Arsimit dhe Bujqësia	Në vazhdim	Çështja A3 - Mangësi në menaxhimin e kontratave dhe mos vazhdimi i sigurimit të ekzekutimit, Komenti i korrigjuar: _Rekomandim direkt i prokurimit. Drejtoria e Prokurimit ka ndërmarrë masa: 1) Janë njoftuar me shkresë zyrtare të gjithë Menaxherët e Kontratave për obligimin ligjor për vazhdim të Sigurimit të Ekzekutimit sipas LPP Neni 63 dhe Rr.001/2022 Neni 29 - 10% + 30 ditë, 2) Situacionet me punë të pa realizuara (zyra 14,000€, pozicionet
---	---	--	--	---	---	------------	---

	barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës, dhe e njëjta do të mbetet valide për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës. Gjithashtu me kontratat publike përcaktohet edhe garancioni i kualitetit të punimeve që kontraktuesit duhet të ofrojnë pas përfundimit të kontratës. Auditimi i menaxhimit të kontratave të punëve ka identifikuar mangësi në menaxhim. Për kontratat publike që ende janë në proces të realizimit, mangësit janë hasur te: • Kontrata e punëve "Ndërtimi i rrugës 2 Maji me infrastrukturë përcjellëse" pozicioni 1.1	të vazhdohet nga kontraktuesi t, derisa për kontratat e përfunduara të ofrohet garancioni i kualitetit të punimeve.		2,600€ dhe 3,900€) janë kthyer për rishqyrtim tek MK dhe Mbikëqyrësit. Në Planin e Menaxhimit të Kontratës është shtuar pika e kontrollit për validitetin e SE dhe Garancionit të Cilësisë para procesimit të pagesës finale.
--	--	--	--	--

	Punët përgatitore për fillimin e punimeve, mobilizimi i punishtës me zyre dhe shenjat e nevojshme për siguri dhe paralajmërim të vendpunishtes, në vlerë, 14,000€, sipas situacionit të punëve për katër zyra në vendpunishte, gjatë verifikimit në terren është konstatuar se nuk është gjetur asnjë zyrë e vendosur në vendpunishte. Nga dëshmitë e siguruara rezulton se edhe në fazat fillestare kishte qenë e vendosur vetëm një zyrë, e cila më pas është larguar. • Kontrata e punëve "Ndërtimi i shkollës fillore Mustafë Venhari" nga inspektimi i punimeve			
--	---	--	--	--

	eshte identifikuar se pozicioni nr. 14.6, 14.7, 14.8 punimet dhe mbjellja e barit dhe drunjtëve dekorativ për kopsht, në vlerë totale 2,600€ nuk ishin realizuar, por që ishin pranuar si të përfunduara me situacionin e punimeve. • Kontrata e punëve “Ndërtimi i tregut të gjelbër për prodhuesit vendor” nga inspektimi i punimeve është identifikuar se pozicioni 13.3 Furnizimi dhe mveshja e basamakëve të shkallëve dhe pushimoreve me pllaka mermeri, në vlerë 3,900€, ishte i papërfunduara, por që ishte pranuar si të përfunduara me situacionin e punimeve.			
--	---	--	--	--

Gjithashtu, nga auditimi i projekteve kapitale është identifikuar se në katër (4) kontrata tjera sigurimet e ekzekutimit nuk ishin vazhduar kur projektet kapitale nuk kishin arritë të finalizoheshin sipas afatit të kontratave, derisa në gjashtë (6) raste tjera të kontratave garancionet e kualitetit të punimeve nuk ishin sjelle pas përfundimit të punimeve.

Kjo ka ndodhur për shkak të monitorimit të pamjaftueshëm nga menaxherët e kontratave

		dhe mbikqyrësit e drejtëpërdrejt për të siguruar se punimet po realizohen në kohën dhe mënyrën e duhur.				
--	--	---	--	--	--	--

9	Çështja B5 - Vonesa në pagesat e obligimeve financiare	Neni 41 i Rregullës financiare nr. 01/20213/MF shpenzimi i parasë publike, përcakton që, OB duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve të pranuar ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimi të faturës. Në dhjetë (10) pagesa për investime kapitale në vlerë totale 686,513€, faturat nuk ishin paguar brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditësh nga data e pranimi. Vonesat në pagesa ishin nga 1 deri 4 në muaj përtej afatit ligjor. Gjithashtu, nga raporti i obligimeve të papaguara të muajit dhjetor 2025, janë identifikuar 45 fatura në	Kryetari duhet të sigurojë fonde të mjaftueshme të mjeteve në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda 30 ditëve pas pranimi të tyre.	Menaxhmenti do t'ndermerr të gjitha hapat e veprimi me qëllim të realizimi të rekomandimi të dhën.		Në vazhdim	
---	--	---	--	---	--	------------	--

		vlerë totale 2,367,987€, të cilat kishin mbetur pa u paguar deri fund të vitit 2025. Vonesat ishin nga 1 deri në 8 muaj. Mos pagesa me kohë e obligimeve ka ndodhur për shkak të hyrjes në obligime pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore, por edhe për shkak të shpenzimit të buxhetit nga pagesat për vendime gjyqësore.				
10.	Çështja B6 - Mos inspektimi i 20% të pronave të tatueshme për tatimin në pronë	Nenit 15 i Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme parasheh që Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës. Gjatë vitit 2025 Komuna	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete për verifikim të pronave të paluajtshme. Pronat e reja dhe	Menaxhmenti do t'ndermerr të gjitha hapat e veprimit me qëllim të realizimit të rekomandimit të dhën.	Drejtoria e Financave	Shtat or- Dhjet or 2026

	nuk ka bërë asnjë verifikim të pronave ekzistuese, apo edhe pronave të reja që i nënshtrohen tatimit në pronë. Në vitin 2025, Komuna ka kontraktuar një kompani për ofrimin e shërbimeve të inspektimit të objekteve me qëllim të tatimit në pronë dheshërbimeve për inkasimin e obligimeve të tatimit, por për shkak të çështjeve buxhetore, ka vendosur që deri me aprovimin e buxhetit për vitin 2026 të mos fillohet me punë nga kontraktuesi. Megjithatë, as nga zyra përkatëse e tatimit në pronë, personeli nuk është	ndryshimet eventuale të atyre ekzistuese të përfshihen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.		
--	--	--	--	--

		angazhuar për verifikim të pronave				
--	--	---------------------------------------	--	--	--	--

11.	Çështja B7 - Mos pagesa e rregullt e qirasë nga shfrytëzimi i pronave publike komunale	Sipas kontratës së qirasë, neni 6 përcakton veprimet nga dështimet për të përmbushur kontratën, përkatësisht kur qiramarrësi ka paaftësi të pagesës së obligimit. Gjithashtu, me nenin 2 përcaktohet që në rastin kur qiramarrësi dështon të paguajë në kohë siç është përcaktuar në këtë nen, qiramarrësi ia paguan qiradhënësit një dënim në shumë të kamatës ditore 1% të borxhit total të papaguar. Shfrytëzuesit e pronave komunale nuk kishin paguar me rregulltë qiranë vjetore. Mangësit janë hasur në këto raste: • Në kontratën për qira të tokës bujqësore për dhënie të shfrytëzimit në	Kryetari duhet të sigurojë që janë vendosur kontrole efektive për monitorimin e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim. Për qiramarrësit të cilët nuk përmbushin me kohë kushtet e kontratës, të aplikohen penalet për mos pagesën me kohë, apo të shqyrtohet mundësia e	Menaxhmenti do t'ndermerr të gjitha hapat e veprimit me qëllim të realizimit të rekomandimit të dhën.	Drejtoria e Urbanizmit	Në vazhdim
-----	---	---	--	---	------------------------	------------

	afat prej pesëmbëdhjetë (15) viteve, me sipërfaqe të përgjithshme prej 11,97.88ha, me lokacion në Balincë, në vlerë prej 898.41€ për një vit kalendarik. Si pasojë e mos pagesës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 5,391€. • Në kontratën për qira të tokës bujqësore për dhënie të shfrytëzimit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) viteve, me sipërfaqe të përgjithshme prej 23,45.12ha, me lokacion në Gracë , në vlerë prej 7,070.53€ për një vit kalendarik. Si pasojë e mospagesës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 10,301€. • Në kontratën për qira të tokës bujqësore për dhënie të shfrytëzimit në	ndërprerjes së kontratës			
--	--	--------------------------	--	--	--

	afat prej më pak se një vit, me sipërfaqe të përgjithshme prej 23,45.12ha, me lokacion në Gracë, në vlerë prej 5,554.10€ për një vit kalendarik. Si pasojë e mospagesës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 12,480€. • Në kontratën për qira të lokalit afarist nr.2 për dhënie të shfrytëzimit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) viteve, me sipërfaqe të përgjithshme prej 11m2, me lokacion në rr. "Jeton Tërstena" në Vushtrri, në vlerë prej 25.85€ për një muaj. Si pasojë e mospagesës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 1,860€. • Në kontratën për qira të lokalit afarist për dhënie të shfrytëzimit në afat			
--	--	--	--	--

	prej shtatë (7) viteve me sipërfaqe të përgjithshme prej 90m² objekt dhe oborr 187m², me lokacion në rr. "Dëshmorët e Kombit", Vushtrri, në vlerë prej 1,000€ për një muaj. Si pasojë e mospagesës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 30,000€. • Në kontratën për qira të lokalit afarist për dhënie të shfrytëzimit nëafat prej pesëmbëdhjetë (15) viteve, me sipërfaqe të përgjithshme prej 90m² objekt dhe oborr 187m², me lokacion në "Sheshin Hasan Prishtina", Vushtrri, në vlerë prej 1,102€ për një muaj. Si pasojë e mospagesës qiramarrësi ka borxh ndaj komunës 9,980€. Kjo ka ndodhë për shkak			
--	---	--	--	--

		të kontrolleve të brendshme të pamjaftueshme, dhe mungesës së një mekanizmi efektiv për monitorimin e procesit të pronave komunale të cilat janë dhënë me qira.				
--	--	---	--	--	--	--

12.	Çështja B8 - Mangësi në raportim dhe monitorim të projekteve të subvencionuar a	Me Rregulloren MF nr - 04/2017 Mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 23 përcakton që: Përfituesi raporton te zyrtari monitorues, përkatësisht ekipi monitorues, në baza të rregullta, lidhur me zbatimin e projektit, sipas kërkesave të kontratës së përcaktuar në nenin 22 të kësaj Rregulloreje. Raportimi përfshin raporte narrative dhe financiare dhe periudhat raportuese do të përcaktohen me dispozitat e kontratës me përfituesin. Për subvencionimin e projektit "Promovimi i sportit / marrja me aktivitete sportive,	Kryetari duhet të sigurojë mekanizma të monitorimit dhe raportimit, me qëllimin që përfituesit e subvencioneve të dorëzojnë raporte mbi shfrytëzimin e fondeve publike në afatet e përcaktuara. Përfituesit që nuk përmbushin obligimet për raportim të mjeteve	Ne si menagjment bazuar në hartimin e planit të OJQ-ve do i ndermarrim të gjitha hapat e veprimit me qëllim të rregullimit dhe kopletimit të tëdhenave sipas rregulloreve në fuqi.	Drejtoria e Kultures	Në vazhdimsi
-----	---	---	--	---	----------------------	--------------

	ndikimi i tyre në shëndetin e njeriut" në vlerë prej 5,200€, përmes thirrjes së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, OJQ përfituese nuk ka dorëzuar raport narrativ dhe financiar rreth realizimit të projektit. Po ashtu, sipas raportit të komisionit monitorues, edhe pse disa OJQ përfituese kanë dorëzuar raportet narrative dhe financiare, asnjëra prej tyre nuk ka informuar monitoruesit për pjesëmarrje në aktivitetet që do të realizohen, duke kufizuar mundësinë e verifikimit në terren dhe vlerësimit objektiv të zbatimit të projekteve. Kjo ka ndodhë për shkak	të shfrytëzuara duhet të përjashtohet nga e drejta e përfitimit të subvencioneve në të ardhmen.		
--	---	--	--	--

		të kontrolleve të pamjaftueshme për monitorimin e projekteve të subvencionuara nga mbikqyrësit e projekteve.				
--	--	--	--	--	--	--

13.	Çështja B9 - Vonesë në realizim të projekteve kapitale	Sipas nenit 70.23 të Rregullores nr. 002/2024 për prokurimin publik, menaxheri i kontratës do të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave. Tetë (8) projekte kapitale nuk ishin realizuar në afatin kohor të përcaktuar me kontratë. Rastet janë të këto kontrata, ku punimet deri në kohën e auditimit (prill 2026) nuk janë përfunduar: • Rikonstruimi i	Kryetari duhet të sigurojë se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit si në aspektin teknik ashtu edhe në aspektin financiar, përmes hartimit të mirëfillt të projekteve dhe sigurimit të mjaftueshëm të buxhetit në mënyrë që punët të	Duke u bazuar në vonesat e realizimit të projekteve kapitale do të ndermarrim të gjitha hapat e veprimit me qëllim të përmisimit të afatit kohor të ekzekutimit të projekteve.	Drejtoria e Planifikimit Urban, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Kultures	Në vazhdim	Çështja B9 - Vonesë në realizim të projekteve kapitale - 8 kontrata, Komenti i korrigjuar: _Gjetje e drejtpërdrejtë e prokurimit - Neni 70.23 i Rr. 002/2024. Vonesat kanë ardhur si pasojë e mungesës së kushteve paraprake para inicimit (probleme pronësore dhe buxhetore). Drejtoria e Prokurimit do të aplikojë listën e kontrollit (check-list) para publikimit: dëshmia për zgjidhje pronësore, DNDF e plotë dhe zotimi buxhetor.
-----	--	--	---	---	---	------------	---

	Bulevardit Adem Jashari dhe ndërtimi i parkingut nëntokësor, lot 1, në vlerë 2,713,170€, duhej të përfundonte deri në dhjetor 2025, derisa punimet ende vazhdojnë. • Ndërtimi i shkollës fillore Mustafë Venhari, në vlerë 1,078,258€, duhej të përfundonte deri në fund të vitit 2025, derisa punimet ende nuk kanë përfunduar në tërësi. • Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni (kalldrëm), Rr. Pandeli Sotiri, Rr. Shem Nallbani dhe Rr. Hoxhë Kadri Prishtina, në vlerë 147,936€, duhej të përfundonte deri në qershor 2025, punimet ende nuk kanë përfunduar. • Ndërtimi i rrugës Bekim	realizohen sipas planit.			Për kontratat ekzistuese me vonesa (2 Maji, Shkollë Mustafë Venhari, Rrugët me kalldrëm Pandeli Sotiri etj.), MK-ve u është kërkuar të zbatojnë penaltitë 0.10% / ditë sipas kontratës dhe të sigurojnë vazhdimin e SE deri në përfundim.
--	--	--------------------------	--	--	--

	Berisha – Abeja, në vlerë 778,251.43€, duhej të përfundonte në tetor 2024, punimet ende vazhdojnë. • Restaurimi dhe konzervimi i ish Arkivit ë vjetër, në vlerë 124,140€, duhej të përfundonte në gusht 2025, punimet ende nuk janë kryer në tërësi. • Ndërtimi i tregut të gjelbërt për prodhuesit vendor, në vlerë 1,131,057€, duhej të përfundonte në tetor 2025, derisa punimet ende vazhdojnë. • Ndërtimi i rrugës Lumni Surdulli – lot 2, në vlerë 685,260€, duhej të përfundonte në tetor 2024, derisa punët ende vazhdojnë. • Renovimi i palestrës				
--	--	--	--	--	--

		sportive Jeton Tërstena ne vlerë 48,260€, e nënshkruar në tetor 2023, duhej të përfundonte brenda 40 ditëve, derisa kontrata është përfunduar në qershor 2025. Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme nga ana e menaxherëve të kontratave, kontesteve pronësore si dhe mungesës buxhetore të ndodhura nga pagesat e realizuara nga fondi i investimeve kapitale për shkak të vendimeve gjyqësore.				
--	--	---	--	--	--	--

14.	Çështja B10 - Mos vlerësimi i performancës së kontraktuesve përmes e- Prokurimit	Neni 70, pika 23 dhe 25 e Rregullores 002/2024 për prokurimin publik, përcakton që, menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij, derisa mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për shqyrtimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesve të plotësuar në platformën e e-prokurimit. Nga testimet konstatuam se për nëntë (9) kontrata publike të përfunduara, menaxherët e projekteve	Kryetari duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të menaxherëve, bëjnë vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes platformes e-prokurimi.	Ne si menagjment qdo herë informojmë menaxherët e kontratave dhe në të ardhmen do rregullohen	Drejtoria e Prokurimit	Në vazhdim	Çështja B10 - Mos vlerësimi i performancës së kontraktuesve përmes e- Prokurimit, Komenti i korrigjuar: Rekomandim ekskluziv i prokurimit - Rr. 002/2024 Neni 70 pika 23 dhe 25. Drejtoria e Prokurimit ka caktuar si detyrë obligative për të gjithë MK-të dhe Mbikëqyrësit e Drejtpërdrejtë vlerësimin e performancës në modulën "Menaxhimi i Kontratës" në e-prokurimi për 9 kontratat e evidentuara dhe për të gjitha kontratat që mbyllen në vazhdim. Mos-vlerësimi do të konsiderohet
-----	---	---	---	---	------------------------	------------	--

	dhe mbikëqyrësit e menaxherëve nuk kanë bërë vlerësimin e performancës së kontraktuesve në modulin e menaxhimit të kontratës në platformën e-prokurimi. Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxherët e kontratave nuk i kanë kushtuar rëndësinë e duhur kërkesave rregullative që projektet që përfundohen, të vlerësohet edhe performanca e kontraktorit në realizimin e kontratës publike.			shkelje e detyrave të MK dhe do të raportohet. Targeti: 100% vlerësim për kontratat e përfunduara deri 31.12.2026.
--	--	--	--	---

15.	Çështja A4 - Mospërcaktimi i qartë i specifikimeve teknike dhe lëndë jokomplete	Rregulla Financiare Nr.01/2013/MF – Shpenzimi i parave publike, neni 26, paragrafi 2, përcakton që për procedim të pagesës kërkohen këto dokumente: kërkesa për blerje / zotimi, kopja e kontratës që është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i prokurimit si kopje autentike e origjinalit, urdhërblerja, raporti i pranimit, urdhërpagesa dhe fatura origjinale. Gjithashtu, me marrëveshjen kontraktuale duhet të përcaktohet qartë numri i punëtorëve që do të angazhohen, orarin dhe hapësirat ku do të ofrohen shërbimet e pastrimit dhe sigurimit	Kryetari duhet të sigurojë që në marrëveshjen kontraktuale të përcaktohen saktë specifikimet teknike, dhe se furnizimet e mallrave të realizohen përmes procedurave të rregullta të kontraktimit.	Si menagjment jemi të obliguar që lëndet të jenë të kopletuara dhe shpenzimi i parave publike të bëhet në afatet e caktuara sipas planit dinamik të punëve	Drejtoria e Prokurimit	Në vazhdim	Çështja A4 - Mospërcaktimi i qartë i specifikimeve teknike dhe lëndë jo complete, Komenti i korigjuar: Gjetje e prokurimit - Rr. Financiare 01/2013 Neni 26. Rasti 1: Marrëveshja me NPL Përparimi Sh.A për pastrim dhe sigurim fizik pa specifikim të orarit dhe numrit të punëtorëve - Njësia Kërkuese do të rishikojë Aneksin e kontratës me specifikim të qartë teknik (numër punëtorësh, orar, lokacion). Rasti 2: Furnizimi 3,052€ pa procedurë prokurimi - është
-----	---	--	--	--	------------------------	------------	--

	fizik. Nga auditimi i pagesave, janë identifikuar mangësit e mëposhtme: • Në marrëveshjen për kryrje të shërbimeve komunale për pastrim dhe sigurim fizik të objekteve komunale, mes Komunës së Vushtrrisë dhe Ndërmarrjes Publike Lokale - Përparimi Sh.A, nuk është përcaktuar qartë orari i angazhimit dhe numri i punëtorëve që do të angazhohen në ofrimin e këtyre shërbimeve. • Furnizimi me material shpenzues për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, në vlerë prej 3,052€, është bërë pa ndonjë kontratë publike apo procedurë të			lëshuar vërejtje. Në të ardhmen asnjë furnizim mbi 1,000€ nuk do të procedohet pa urdhërblerja dhe procedurë konform LPP. Zyrtari i prokurimit nuk do të nënshkruajë lëndë jo komplete pa kërkesë për blerja, kontratë, raport pranimi dhe faturë origjinale.
--	--	--	--	--

		kontraktimit, por vetem me aprovimin e zyrtarit kryesor administrativ. Kjo ka ndodhur për shkak të planifikimeve jo adekuate nga njësitë kërkuese dhe dobësive në hartimin dhe përcaktimin e qartë të kushteve specifike të marrëveshjes.					
16.	Çështja B11 - Pasuritë në përdorim të kategorizuara si investime në vijim	Sipas Rregullores MF-nr. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në OB, neni 11, përcakton që pas përfundimit të procesit të investimit, pasuria jofinanciare kapitale do të klasifikohet si pasuri jofinanciare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jofinanciare, duke siguruar që të gjitha projektet	Drejtoria do merr të gjitha hapat e veprimit për sigurimin e dokumentacioneve me qëllim të rexhistrimit të pasurive kapitale.	Drejtoria e Financave	Në vazhdim	

	zhvlerësimi. Në regjistrin e pasurisë kapitale, pasuritë me vlerë 13,936,945€ edhe më tutje vazhdojnë të jenë të klasifikuara si investime në vijim. Pasuritë e tilla datojnë të regjistruara nga viti 2015 deri në vitin 2023, të cilat me përfundimin e projekteve do të duhej të klasifikoheshin si pasuri aktive në përdorim. Si pasojë e kësaj, këto pasuri nuk i janë nënshtruar procesit të zhvlerësimit vjetor, me çka vlera e tyre historike nuk paraqet vlerën reale neto në fund të vitit 2025. Në pamundësi të sigurimit të informatave të sakta për kohën e funksionalizimit të këtyre	kapitale të përfunduara të identifikohen dhe t'i nënshtrohen procedurave të nevojshme për transferimin në kohë në kategorinë e pasurive në përdorim, në mënyrë që të mundësohet aplikimi i drejtë i zhvlerësimit dhe raportimi i saktë financiar.		
--	---	--	--	--

		pasurive, nuk ka qenë e mundur të kalkulojmë vlerën e zhvlerësimit, përkatësisht vlerën e mbivlerësimit për këto pasuri. Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jofinanciare ndër vite.					
17.	Çështja B12 - Mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme	Sipas nenit 26 të Ligjit 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) eurove. Derisa, me	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmv e të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesi t, duke i shfrytëzuar	Ne si menagjment do I marrim të gjitha hapat e veprimit me qëllim të realizimit të obligimeve të papaguara në tatimin në pronë	Drejtoria e Financave	Në vazhd imsi	

	neni 27, përcakton që nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në kontratë për secilin lloj të të	të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.			
--	---	---	--	--	--

	hyrave. Llogaritë e arkëtueshme nuk janë menaxhuar si duhet. Saldo e llogarive ka rritje nga viti në vit, ku në fund të vitit 2025 vlera e tyre ishte 9,408,820€, dhe në raport me vitin 2024 kemi rritje për 1,949,744€. Me gjithë veprimet e ndërmarra nga komuna në njoftimin e taksapaguesve për obligimet e papaguara, niveli i arkëtimit ende mbetet i ulët. Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të duhur të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.				
--	--	--	--	--	--

Duke marrë në konsideratë Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA-së), në pajtim me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit jemi zotuar për adresimin e rekomandimeve të dhëna përmes Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve.

- Së bashku me Kryesuesen e Kuvendit të Komunës do të harmonizojmë agjendën e takimit për shqyrtimin e Raportit të Auditimit në mbledhjen e radhës së Kuvendit (gjatë muajit Korrik);
- Po ashtu edhe Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit është prezentuar në seancën e __ Shtatorit 2026, pika __ e rendit të ditës të seancës të rregullt të Kuvendit të Komunës.
- Deri në fund të muajit janar 2027, do të diskutoj në Kuvendin e Komunës për progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit 2026 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transereve; dhe
- Po ashtu, në kohë reale do të dorëzojmë Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të daluara nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Vushtrri,

Datë 03.09.2026

Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës






REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

Drejtoria Për Shërbime Publike

Datë:	14.09.2026
Për:	Kuvendin e Komunës
Propozues:	Ferit Idrizi  Kryetar i Komunës së Vushtrrisë
Hartues:	Drejtoria për Shërbime Publike Drejtori i Drejtorisë Benjamin Shala 
Tema:	Akt - Përcjellës

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur Draft – Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

Ky dokument është hartuar nga komisioni i themeluar me vendim nr.5767/26 të datës 06.02.2026 të kryetarit të komunës dhe i njëjti i ka kaluar të gjitha filtrat ligjor, duke përfshirë edhe diskutimin publik nga data 10.03.2026 deri më 26.03.2026.

Konsultimi publik është mbajtur me datë 23.04.2026 dhe nuk kemi pranuar vërejtje dhe sugjerimet përmbajtësore nga pjesëmarrësit.

Duke konsideruar se ky dokument i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore të njëjtin po ua procedojmë për shqyrtim në KPF dhe të njëjtën për aprovim nga Kuvendi i Komunës.

Me respekt!



Republika e Kosovës/ Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vushtrrisë/Opstina Vucitrn
Municipality of Vushtrri

DRAFT – RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 pika c, nenit 17, pika f, nenit 40.2, pika a dhe g, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 04.06.2008, nenit 8, pika a, nenit 15 pika f, dhe nenin 19.1, të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 03.06.2008, neni 15 dhe 34 të Ligjit Nr. 04/L – 60 për Mbeturina i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 29.06.2012, Ligjin Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina e shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.09.2022 dhe nenit 13 nën par. 1.6, nenit 18 nën par. 1.1 të Statutit Nr. 209/22 të Komunës së Vushtrrisë të miratuar me datë 06.09.2022 nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen _____, e mbajtur __, __.2026, miratoi këtë:

I. DISPOZITAT HYRËSE

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton rregullat, kushtet dhe mënyrën e organizimit të menaxhimit të mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Kjo rregullore ka për qëllim:
 - 2.1. sigurimin e një sistemi efikas, të integruar dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave;
 - 2.2. mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit;
 - 2.3. ruajtjen e pastërtisë dhe përmirësimin e cilësisë së hapësirave publike;
 - 2.4. promovimin e përmirësimit të gjenerimit të mbeturinave, rdarjes në burim, ripërdorimit, riciklurit dhe rikuperimit të mbeturinave;
 - 2.5. përcaktimin e të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësiave të personave fizikë, personave juridikë, institucioneve publike dhe operatorëve të menaxhimit të mbeturinave.

KREUI

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo rregullore zbatohet në të gjithë territorin e Komunës së Vushtrisë.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për:
 - 2.1. organet e Komunës së Vushtrisë dhe institucionet publike;
 - 2.2. personat fizikë;
 - 2.3. personat juridikë;
 - 2.4. prodhuesit dhe zotëruarit e mbeturinave;
 - 2.5. operatorët e menaxhimit të mbeturinave;
 - 2.6. çdo subjekt tjetër që, në çfarëdo cilësie, gjeneron, zotëron, grumbullon, mbledh, transporton, trajton, rikuperon ose deponon mbeturinat në territorin e Komunës së Vushtrisë.

Neni 3

Raza juridike

1. Kjo rregullorë existet në bazë dhe për zbatimin e:

1.1. Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;

1.2. Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071;

1.3. Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;

1.4. akteve nënligjore të nxjerra për zbatimin e ligjeve të përmendura në nenparagrafët 1.1 deri 1.3 të këtij neni;

1.5. Statutit të Komunës së Vushtrisë

Neni 4

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullorë kanë kuptimin e përcaktuar në Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturinat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071, përveç nëse në këtë nen përcaktohet ndryshe.

2. Për qëllimet e kësaj rregullorë, shprehjet në vijim kanë këtë kuptim:

2.1. **Mbeturinë** – çdo substancë ose objekt të cilin mbajtësi e hedh, synon ta hedhë ose kërkohet ta hedhë,

2.2. **Biombeturina** (mbeturina biologjike-organike)- mbetje ashqimore mbetje lopatit, bujqësore apo biologjike (liruta, perime, gjethe, uogë) etj, të cilat shpërbëhen natyrshëm;

2.3. Mbeturine të parrezikshme- mbeturine të pa rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe ambientin, pa veti toksike, korrozive, shpërthyes (letër, mbeturina shpërndarë të zinkuashme).

2.4. Mbeturina Inerte- substanca të ngurta të cilat nuk posedojnë ndryshime të rëndësishme fizike, kimike apo biologjike (beton, tulla, gurë, mbetje ndërtimi),etj.

2.5. Mbeturina metalike - substanca metalike ose lidhje metalike të cilat mund të riciklohen përmes proceseve industriale (metale hekuri, alumini, bakri).

2.6. Mbeturina të vajrave ushqimorë të djegura- mbetje të vajrave ushqimorë të përdorur dhe degraduar në temperaturë të lartë, ndotës të ambientit kur hidhen në kanalizime dhe tokë.

2.7. Mbeturina të vajrave të përdorura të makinave (vajra motorik) – mbetje nga vajrat lubrifikues motorike, të rrezikshme për njerëzit e ambientit për shkak të metaleve të rënda dhe toksike.

2.8. Mbeturina të rrezikshme – mbeturina me substanca toksike, shpërthyes, korrozivë, të ndezshme dhe infektive (vajrat ushqimorë të djegura, vajrat motorikë të përpunuar, mbeturina të substancave kimike, mbeturina të pajisjeve elektrike, mbeturina medicinale dhe farmaceutike, bateri dhe akumulator, pesticide, mbeturina me përmbajtje metalesh të rënda),etj.

2.9. Menaxhim i mbeturinave - aktivitetet që lidhen me grumbëllimin, transportimin, trajtimin, riciklimin dhe eliminimin e mbeturinave.

2.10. Prodhuar i mbeturinave - çdo person fizik ose juridik që krijon mbeturina.

2.11. Operator i autorizuar - subjekti i licencuar, dhe i autorizuar për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave.

2.12. Riciklim - procesi i përpunimit të mbeturinave për krijimin e produkteve ose materialeve të reja.

2.13. Hapësirë publike – rrugët, trotuaret, sheshet, parqet dhe sipërfaqet tjera në pronësi ose administrim publik

2.14. Ndërmarrja – nënkupton N.P.L. "Përmarrimi" Sh. A.

2.15. Leje mjedisore- dokument i lëshuar nga Ministria, i kërkuar për marrjen e lejes së punës.

2.16. Leje e integruar mjedisore-autocizim me shkrim i lëshuar nga autoriteti kompetent në pajtim me ligjin, që kërkohet për marrjen e lejes për operim

2.17. Leje mjedisore komunale - dokument me shkrim që e lëshon komuna që kanë për veprimtari që kanë ndikim në mjedis, sipas ligjit

2.18. Ekonomitë familjare rezidente – nënkupton familjen, ose bashkësinë familjare me banim të përhershëm dhe adresë të regjistruar bazimi në një shtëpi individuale, banesë apo apartament brenda territorit të komunës së Vushtrisë, ndaj së cilës komuna ofron shërbimin e mbledhjes, transportit dhe menaxhimit të mbeturinave në përputhje me kontratën, kushtet e shërbimeve dhe tarifën e përcaktuar me këtë rregullorë.

2.19. Ekonomi familjare me banim sezonal – nënkupton ekonominë familjare që posedon ose shfrytëzon një njësi banimi në territorin e Komunës së Vushtrisë, të cilin e shfrytëzon vetëm gjatë periudhave të caktuara gjatë vitit dhe jo për banim të përhershëm. ndaj se cilës komuna ofron shërbimin e mbledhjes, transportit dhe menaxhimit të mbeturinave për 4 muaj gjatë një viti fiskal, në përputhje me kontratën, kushtet e shërbimeve dhe tarifën e përcaktuar me këtë rregullorë.

2.20. Shtëpi, banesa të pa banuara - shtëpi dhe objekt i pa banuar, që nuk prodhon mbeturina, dhe nuk i nënshtrohet tarifës së pagesës së mbeturinave.

2.21. Enë - Objekt për ruajtjen e perkoshme të mbeturinave të rrezikshme në kushte të kontrolluara dhe të sigurt deri në trajtimin ose shpërndarjen e tyre.

Neni 5

Parimet e menaxhimit të mbeturinave

1. Menaxhimi i mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrisë bazohet në parimet e përcaktuara me Ligjin për Mbeturitat dhe legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit.
2. Parimet nga paragrafi 1 i këtij neni janë:

2.1. parimi i mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe mjedisit, sipas të cilit menaxhimi i mbeturinave organizohet në mënyrë që të mos rrezikojë shëndetin e njeriut dhe të mos shkaktojë ndikime të dëmshme në mjedis;

2.2. parimi i parandalimit, sipas të cilit ndërmerrin masa për të parandaluar ose zvogëluar gjenerimin e mbeturinave dhe ndikimin e tyre në mjedis;

2.3. parimi i hierarkisë së menaxhimit të mbeturinave, sipas të cilit përparësi kanë parandalimi, përgatitja për ripërdorim, riciklimi, rikuperimi dhe depozimi i mbeturinave.

2.4. parimi "ndotësi paguan", sipas të cilit prodhuesi ose zotëuesi i mbeturinave bën shpenzimet e menaxhimit të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.5. parimi i përgjegjësisë së përbashkët, sipas të cilit Komuna, operatorët e menaxhimit të mbeturinave, prodhuesit dhe zotëruarit e mbeturinave, si dhe personat fizikë dhe juridikë, kontribuojnë në menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave, secili brenda kompetencave dhe përpjegjësiave të përcaktuara me ligj.

Neni 6

Përgjegjësitë e Komunës së Vushtrrisë në menaxhimin e mbeturinave

- 1.** Komuna e Vushtrrisë, në kuadër të kompetencave të saj të përcaktuara me ligj, është përgjegjëse për:

- 1.1. organizimin dhe sigurimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave në territorin e saj,
- 1.2. hartimin, miratimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe planeve komunale për menaxhimin e mbeturinave,
- 1.3. përcaktimin e mënyrës së organizimit të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave dhe mbikëqjen e zbatimit të tij,
- 1.4. monitorimin dhe mbikëqjen e cilësisë së shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave që ofrohen në territorin e Komunës,
- 1.5. bashkëpunimin me ministrinë, institucionet publike, operatorët e menaxhimit të mbeturinave dhe subjektet e tjera relevante për zbatimin e legjislacionit në fushën e menaxhimit të mbeturinave,
- 1.6. promovimin e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimin publik për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave, ndaljen në burim, ripërdorimin dhe riciklimin,
- 1.7. sigurimin e transparencës dhe informimit publik lidhur me organizimin dhe ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, në pajtim me legjislacionin në fuqi,
- 1.8. krijimin e kushteve për funksionimin efikas të sistemit të menaxhimit të mbeturinave dhe mbështetjen institucionale të operatorit të menaxhimit të mbeturinave, në përputhje me kompetencat e Komunës
- 1.9. ushtrimin e kompetencave të tjera të përcaktuara me Ligjin për Mbeturinat, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

KREU II

ORGANIZIMI DHE PËRGJEGJËSITË

I. Organizimi institucional i menaxhimit të mbeturinave

Neni 7

Organizimi i shërbimit të menaxhimit të mbeturinave

1. Komuna e Vushtrisë organizon dhe siguron ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave në territorin e saj, në përputhje me Ligjin për Mbeturit, legjislacionin tjetër në fuqi dhe këtë rregullorë.
2. Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave organizohet në mënyrë që të sigurojë:

2.1. mbledhjen, grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbeturinave,

2.2. mbrojtjen e shëndetit të njeriut, kafshëve dhe të mjedisit,

2.3. ofrimin e shërbimeve në mënyrë të vazhdueshme, efikase dhe të barabartë për të gjithë përfituesit e shërbimeve,

3. Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave mund të ofrohet nga:

3.1. Ndërmarrja Publike Lokale "Përparimi" Sh.A.

3.2. operatorë tjerë të menaxhimit të mbeturinave të pajisur me lejen përkatëse mjedisore dhe të kontraktuar nga Komuna, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Komuna përcakton, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratat përkatëse:

4.1. zonat e mbledhjes me shërbim,

4.2. mënyrën e organizimit të shërbimit,

4.3. standardet minimale të cilësive të shërbimit,

4.4. mekanizmat e monitorimit dhe mbikëqyrjes së ofrimit të shërbimit.

Neni 8

Kompetencat e organeve komunale

1. Kuvendi i Komunës, në kuadër të kompetencave të përcaktuara me ligj:

- 1.1. miraton rregulloret dhe aktet e tjera komunale në fushën e menaxhimit të mbeturinave;
- 1.2. miraton planet, programet dhe dokumentet strategjike komunale për menaxhimin e mbeturinave;
- 1.3. miraton lirisinë e tarifave;
- 1.4. mbikëqyr zbatimin e politikave komunale në fushën e menaxhimit të mbeturinave, në përputhje me kompetencat e tij.

2. Kryetari i Komunës, në kuadër të kompetencave të përcaktuara me ligj:

- 2.1. siguron zbatimin e kësaj rregulloreje dhe të akteve të tjera komunale në fushën e menaxhimit të mbeturinave;
- 2.2. organizon dhe koordinon punën e administratës komunale për zbatimin e politikave dhe programave në fushën e menaxhimit të mbeturinave;
- 2.3. propozon Kuvendit të Komunës politika, plane dhe masa për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave;
- 2.4. lidh kontaktin dhe ndërmon veprimet të tjera administrative, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me legjislationin në fuqi.

3. Drejtoriti komunal përgjegjës, në kuadër të kompetencave të saj:

- 3.1. organizon, koordinon dhe monitoron ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave;
- 3.2. monitoron zbatimin e kontratave dhe standardëve të cilësisë së shërbimit;
- 3.3. bashkëpunon me operatorët e menaxhimit të mbeturinave dhe institucionet kompetente;
- 3.4. harton raporte periodike për gjendjen e menaxhimit të mbeturinave dhe propozon masa për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave;
- 3.5. kryen edhe detyra të tjera në përputhje me legjislationin në fuqi dhe aktet e Komunës.

Neni 9

Detyrat e njësisë organizative përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave

1. Njësia organizative komunale përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave, në kuadër të kompetencave të saj, kryen këto detyra:

1.1. harton dhe zbaton planet operative për organizimin dhe përmirësimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave.

1.2. identifikon dhe evidenton problemet, nevojat dhe sfidat që lidhen me menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunes.

1.3. bashkëpunon dhe komunikon me qytetarët, operatorët e menaxhimit të mbeturinave, institucionet publike dhe subjektet e tjera relevante.

1.4. monitoron zbatimin e kontratave për ulimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave dhe raportun për mospërfuthtjet e konstatuara.

1.5. përgatit raporte periodike dhe propozon masa për përmirësimin e organizimit dhe cilësisë së shërbimit të menaxhimit të mbeturinave.

1.6. kryen edhe detyra të tjera në fushën e menaxhimit të mbeturinave, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e Komunes.

.....

II. Përgjegjësitë e operatorit të shërbimit

Neni 10

Detyrimet e operatorit të menaxhimit të mbeturinave

1. Operatori i menaxhimit të mbeturinave i kontraktuar nga Komuna e Vushtrisë është i obliguar që:

1.1. të jetë i pajisur me lejen përkatëse mjecësore dhe të plotësojë kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

1.2. të ketë kontratë të vlefshme me operatorin e objektit për trajtimin ose depozimin e mbeturinave, kar kjo kërkohet sipas legjislacionit në fuqi.

1.3. të dorëzojë të gjitha mbeturinat e grumbulluara vetëm në depozitë të licencuara

1.4. të ofrojë shërbimin në mënyrë të vazhdueshme, profesionale dhe në përputhje me standardet e përcaktuara me ligj dhe këtë rregullore.

1.5. të respektojë uratin, itineraret dhe zonat e mbledhimit të përcaktuara me kontratë.

1.6. të përdorë automjete, pajisje dhe kontejnerë që plotësojnë kushtet teknike dhe mjedisore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

1.7. të sigurojë mirëmbajtjen, pastrimin dhe dezinfektimin e automjeteve, kontejnerëve dhe pajisjeve që përdoren gjatë ofrimit të shërbimit

1.8. të mbajë evidencë për sasinë dhe llojin e mbeturinave të grumbulluara, transportuara dhe të dorëzuara për trajtim ose depozim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1.9. të raportojë Komunës për realizimin e shërbimit, vështirësitë e evidentuara dhe masat e propozuara për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave.

1.10. të zhatojë detyrimet e përcaktuara në kontratën e lidhur me Komunën dhe në legjislacionin në fuqi.

2. Në territorin e Komunes së Vushtrisë, shërbimet e mbledhjes, grumbullimit, transportit dhe menaxhimit të mbeturinave komunale ofrohen nga operatori i kontraktuar nga Komuna, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Dispozita e paragrafit 2 të këtij neni nuk zbatohet për operatorët që janë të pajisur me lejet përkatëse për menaxhimin e kategorive të veçanta të mbeturinave, për të cilat legjislacioni në fuqi ose kontrata komunale nuk ia ngarkon këtë përgjegjësi operatorit të kontraktuar nga Komuna.

4. Çdo person fizik dhe juridik që veshtrimi veprimtarinë e mbledhjes, grumbullimit, transportit, trajtimit ose depozimit të mbeturinave në kundërshtim me paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni i nënshtrohet masave administrative dhe procedurave kundërvajtëse të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Të drejtat e operatorit të menaxhimit të mbeturinave

1. Operatori i menaxhimit të mbeturinave, në kuadër të kontratës së lidhur me Komunën dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka të drejtë:

1.1. të kërkojë qasje në vendet e përcaktuara për vendosjen e kontejnerëve dhe në pikat e grumbullimit të mbeturinave, me qëllim të ofrimit të rregullt të shërbimit.

1.2. të kërkojë nga përfituesit e shërbimit përmbyshjen e detyrimeve kontraktuale, përfshirë pagesën e tarifave për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave

1.3. të refuzojë marrjen e mbeturinave që nuk janë të përfshira në shërbimin për të cilin është kontraktuar ose që nuk janë të depozituara në përputhje me këtë rregullorë, duke ofruar përfituesin e shërbimit dhe Komunën sipas rastit;

1.4. të kërkojë nga personat përgjegjës largimin e automjeteve, objekteve ose pengesave të tjera që pamundësojnë ose vështirësojnë ofrimin e shërbimit, në rast të mosveprimit, të njoftojë organet kompetente të Komunës ose autoritetet përgjegjëse;

1.5. të kërkojë asistencë nga Komuna, organet inspektuese ose organet e tjera kompetente, kur kjo është e nevojshme për ofrimin e rregullt të shërbimit ose për zbatimin e legjislacionit në fuqi;

1.6. të kërkojë nga përfituesit e shërbimit që mbeturinat të ndahen, të depozitohen dhe të dorëzohen në përputhje me këtë rregullorë dhe aktet e tjera në fuqi.

2. Ushtimi i të drejtave nga paragrafi 1 i këtij neni nuk cenon të drejtat e përfituesve të shërbimit dhe ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, kontratën për ofrimin e shërbimit dhe këtë rregullorë.

Neni 12

Obligimet për sigurimin e shërbimit

1. Operatori i menaxhimit të mbeturinave është i obliguar të organizojë dhe të ofrojë shërbimin në mënyrë të vazhdueshme, të rregullt dhe efikase, në përputhje me kontratën, këtë rregullorë dhe legjislacionin në fuqi.
2. Në rast të pengesave teknike, fatkeqësive natyrore, situatave emergjente ose rrethanave të tjera që pamundësojnë përkohësisht ofrimin e rregullt të shërbimit, operatori është i obliguar:

2.1. të ndërmarrë pa vonesë masat e nevojshme për rivendosjen e shërbimit në afatin më të shkurtër të mundshëm;

2.2. të njoftojë Komunën pa vonesë për arsyt e ndërprerjes, masat e ndërmarra dhe kohën e parashikuar për rivendosjen e shërbimit;

2.3. të informojë përfituesit e shërbimit, në mënyrë të përshtatshme, për ndërprerjen e përkohshme dhe mënyrën e ofrimit të shërbimit gjatë kësaj periudhe.

3. Komuna monitoron ofrimin e shërbimit dhe, në rast se konstatohet se operatori nuk e ofron shërbimin në përputhje me kushtet e parashikuara në kontratë, këtë rregullorë ose legjislacionin në fuqi, kërkon ndërmarjen e masave korrigjuese dhe zbaton masat e parashikuara në kontratë dhe legjislacion.

III. Detyrimet e qytetarëve dhe subjekteve tjera

Neni 13

Detyrimet e personave fizikë

1. Personat fizikë janë të obliguar që:

1.1. t'i depozitojnë mbeturinat vetëm në kontejnerët, enet ose vendet e përcaktuara për grumbullimin e tyre;

1.2. të respektojnë orarin dhe mënyrën e përcaktuar për dorëzimin dhe grumbullimin e mbeturinave;

1.3. të përdorin kontejnerët dhe pajisjet për grumbullimin e mbeturinave në mënyrë të rregullt dhe të mos i dëmtojnë, zhvendosin ose përdorin për qëllime të tjera;

1.4. të ndajin mbeturinat në burim, sipas kategorive dhe sistemit të grumbullimit të organizuar nga Komuna ose operatori i menaxhimit të mbeturinave;

1.5. të mbajnë të pastër hapësirat brenda dhe përreth pronës së tyre, në masën që u tregon sipas legjislacionit në fuqi;

1.6. të mos hedhin, djegin ose braktisin mbeturina jashtë vendeve të përcaktuara për grumbullimin e tyre;

1.7. të bashkëpunojnë me operatorin e menaxhimit të mbeturinave dhe organet kompetente për zbatimin e kësaj rregulloreje.

2. Personat fizikë janë të obliguar t'u përmbahen detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullorë dhe në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 14

Detyrimet e personave juridikë dhe subjekteve afariste

1. Personat juridikë dhe subjektet afariste që krijojnë ose zotëjnë një mbeturinë janë përgjegjës për menaxhimin e tyre deri në dorëzimin te operatori i menaxhimit të mbeturinave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Personat juridikë dhe subjektet afariste janë të obliguar që:

- 2.1. të sigurojnë enë ose kontejnerë të përshtatshëm për grumbullimin dhe ruajtjen e mbeturinave, në përputhje me llojin dhe sasinë e tyre;
- 2.2. të lidhin kontratë për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave me operatorin e menaxhimit të mbeturinave të kontraktuar nga Komuna, ose me operator tjetër të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi, kur kjo lejohet;
- 2.3. t'i depozitojnë dhe dorëzojnë mbeturinat në mënyrën dhe vendet e përcaktuara me këtë rregullore;
- 2.4. të mos hedhin, djegin ose braktisin mbeturina në hapësira publike ose në vende që nuk janë të destinuara për këtë qëllim;
- 2.5. të ndajnë mbeturinat sipas kategorive, kur sistemi i ndarjes në bimë është i organizuar nga Komuna ose operator i menaxhimit të mbeturinave;
- 2.6. të respektojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të kësaj rregulloreje për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbeturinave.

Neni 15

Detyrimet e institucioneve publike

1. Institucionet publike që veprojnë në territorin e Komunës së Vushtrrisë janë të obliguara që:
 - 1.1. të organizojnë dhe të sigurojnë menaxhimin e regullt të mbeturinave të krijuara në objektet dhe hapësirat që i përdorin ose i administrojnë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtë rregullore;
 - 1.2. të sigurojnë grumbullimin, ndarjen dhe dorëzimin e mbeturinave të operatori i menaxhimit të mbeturinave, sipas sistemit të organizuar nga Komuna;
 - 1.3. të informojnë masa për parandalimin dhe zvogëlimin e gjenerimit të mbeturinave, si dhe për ripërdorimin dhe riciklimin e tyre, kur kjo është e zbatueshme;
 - 1.4. të përdorin kontejnerët dhe pajisjet për grumbullimin e mbeturinave në përputhje me qëllimin e tyre dhe të mos lejojnë ndodjen e hapësirave përreth;
 - 1.5. të bashkëpunojnë me Komunën dhe operatorin e menaxhimit të mbeturinave në zbatimin e aktiviteteve për edukimin dhe ndërgjegjësimin mjedisor;
 - 1.6. të respektojnë detyrimet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe këtë rregullore.

Neni 16

Detyrimet e përgjithshme të përfituesve të shërbimit

1. Çdo përfitues i shërbimit të menaxhimit të mbeturinave është i obliguar që:

- 1.1. të përdorë shërbimin e organizuar të menaxhimit të mbeturinave në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi;
- 1.2. të lidhë kontratë për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave me operatorin e menaxhimit të mbeturinave;
- 1.3. të paguajë tarifën për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave, në përputhje me aktet e Komunës dhe kontratën përkatëse;
- 1.4. të lejojë qasje të operatorit të menaxhimit të mbeturinave në vendet e caktuara për grumbullimin e mbeturinave, kur kjo është e nevojshme për ofrimin e rregullt të shërbimit;
- 1.5. të respektojë mënyrën e grumbullimit, ndarjes dhe dorëzimit të mbeturinave të përcaktuara me këtë rregullore dhe aktet e Komunës;
- 1.6. të mos paguajë ose vëzhgësojë ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave.

2. Përfundimet e shërbimit janë përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave që krijnë deri në dorëzimin e tyre të operatorit të menaxhimit të mbeturinave ose të operatorit tjetër i autorizuar;
3. Mospërmirësimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë nen përbën shkelje të kësaj rregulloreje dhe trajtohet në përputhje me dispozitat për mbikëqyrjen dhe kundërvajtjet, si dhe me legjislacionin në fuqi.

IV. Financimi dhe tarifat e shërbimit

Neni 17

Financimi i shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave

1. Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave financohen nga:

- 1.1. Tarifat për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave.

1.2. mjetet e buxhetit të Komunës.

1.3. grantet, donacionet dhe fondet nga programet vendore dhe ndërkombëtare.

1.4. burime të tjera financiare të lejura me legjislacionin në fuqi.

2. Tarifat për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave përcaktohen dhe miratohen nga Kuvendi i Komunës.
3. Tarifat nga paragrafi 2 i këtij neni përcaktohen duke respektuar parimin e mbulimit të kostos së shërbimit të shërbimit, efikasitetit, transparencës dhe qëndrueshmërisë financiare të sistemit të menaxhimit të mbeturinave.
4. Të hyrat e realizuara nga tarifat përdoren për financimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 18

Shpërndarja e faturave dhe pagesa për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave

1. Qdo përfutues i shërbimit të menaxhimit të mbeturinave është i obliguar të paguajë tarifën për shërbimin e ofruar, në përputhje me këtë rregullore dhe kontratën përkatëse.
2. Familjet në gjendje të rëndë sociale mund të lirohen ose të subvencionohen nga pagesa e tarifës për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Kuvendit të Komunës, me propozim të Kryetarit të Komunës.
3. Shpërndarja e faturave dhe llogaritja e tarifave për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave kryhen nga operatori i kontraktuar nga Komuna, në përputhje me kontratën dhe legjislacionin në fuqi.
4. Faturat për shërbimin përgatiten në bazë të të dhënave zyrtare të disponueshme dhe u dorëzohen përfutuesve të shërbimit në baza periodike, sipas sistemit të taturimit të operatorit.
5. Dorëzimi i faturave mund të bëhet në formë elektronike ose fizike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Pagesa e tarifës mund të kryhet në llogarinë bankare të operatorit, në institucionet financiare të autorizuar ose përmes mënyrave të tjera të pagesës të përcaktuara nga operatori, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Përfutuesi i shërbimit mund të kryejë parapagesën e tarifës për një periudhë prej gjashtë (6) muajsh ose një (1) vit, sipas kushteve të përcaktuara nga operatori.
8. Personi që përdor një objekt rubi bazën e qirazë është i obliguar të sigurojë pagesën e tarifës për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave, në përputhje me kontratën e qirazë ose marrëveshjen e lidhur me operatorin, si dhe të regjistrohet si përfutues i shërbimit, kur kjo kërkohej nga operatori.
9. Detyrimi për pagesën e tarifës zbatohet për të gjithë përfutuesit e shërbimit në territorin e Komunës së Vushtrisë, përfshirë:

9.1. anvisëritë:

9.2. personat juridikë dhe subjektet afariste;

9.3. institucionet publike dhe private;

9.4. subjektet e tjera që krijojnë mbeturina.

Neni 19

Kriteret për përcaktimin e tarifave

1. Tarifat për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe bazohen në këtu kriteret:

1.1. koston reale të organizimit dhe ofrimit të shërbimit.

1.2. llojin, sasinë dhe karakteristikat e mbeturinave të krijuara, kur kjo është e zbatueshme.

1.3. kategorinë e përfituesit të shërbimit.

1.4. parimin e mbulimit të koston, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë financiare të shërbimit.

2. Tarifat miratohen dhe ndryshohen nga organi kompetent Kuvendi i Komunes, sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Cijatë përcaktimit ose ndryshimit të tarifave merren parasysh interesi publik, cilësia e shërbimit, qëndrueshmëria financiare e sistemit të menaxhimit të mbeturinave dhe parimet e transparencës dhe mosdiskriminimit.

Neni 20

Tarifat për shërbimin sipas kategorive të përfituesve

1. Tarifat për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave përcaktohen sipas kategorive të përfituesve të shërbimit, si në vijim.

1.1. Ekonomitë familjare

1.1.1. ekonomitë familjare rezidente -- 10.00 euro në muaj.

1.1.2. ekonomitë familjare me banicë sezonale -- 40.00 euro në vit.

1.2. Personat juridikë dhe subjektet afariste

2. Subjektet me kosto të ulët dhe të moderuar të shërbimit ngarkohen me tarifën si në vijim:

2.1. subjektet e vogla me veprimtari zejtare dhe shërbyese - **10.00 euro** në muaj;

2.2. subjektet e mesme dhe të mëdha me veprimtari komerciale dhe industriale me kosto të ulët të shërbimit - **20.00 euro** në muaj;

2.3. subjektet e mesme dhe të mëdha me veprimtari komerciale dhe industriale me kosto të moderuar të shërbimit - **25.00 euro** në muaj;

3. Subjektet me kosto të lartë të shërbimit tarifohen si vijon:

3.1. një kontejner me vëllim **1.1 m³ - 14.00 euro**;

3.2. çdo kontejner shtesë me vëllim **1.1 m³**, për të njëjtin subjekt - **10.00 euro**;

3.3. një kontejner me vëllim **5 m³ - 60.00 euro**;

3.4. një kontejner me vëllim **7 m³ - 75.00 euro**;

3.5. shërbimi për grumbullimin dhe asgjësimin e mbetjeve shtazore (eshtrave) - **50.00 euro** për zbraçje.

1.3. Institucionet publike, organizatat joqeveritare dhe institucionet e tjera

4. Institucionet publike, organizatat joqeveritare dhe institucionet e tjera tarifohen si vijon:

4.1. për shërbime me kosto të ulët - **10.00 euro** në muaj;

4.2. për shërbime me kosto të mesme - **20.00 euro** në muaj;

4.3. për shërbime me kosto të lartë:

4.3.1. një kontejner me vëllim **1.1 m³ - 14.00 euro**;

4.3.2. një kontejner me vëllim **7 m³ - 75.00 euro**.

5. Në rast të mospagesës së tarifës brenda afateve të përcaktuara, operatori i kontraktuar nga Komuna ndërmerr procedurat për zbatimin e detyrimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU III

RREGULLAT PËR MENAXHIMIN E SHËRBIMIT

1. Caktimi i zonave të shërbimit, mbledhja dhe transporti i mbeturinave dhe plani operativ i shërbimit

Neni 21

Zonat e shërbimit dhe mbulimi territorial

1. Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave organizohet dhe ofrohet në të gjithë territorin administrativ të Komunës së Vushtrisë, duke përfshirë:

1.1. zonën urbane;

1.2. fshatrat dhe vendbanimet rurale;

1.3. zonat ekonomike, industriale dhe tregtare;

1.4. objektet publike, institucionale dhe hapësirat publike.

2. Komuna, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën për ofrimin e shërbimit, përcakton:

2.1. zonat operative të shërbimit;

2.2. pikat për grumbullimin e mbeturinave;

2.3. itineraret dhe orarin e mbledhjes dhe transportit të mbeturinave;

2.4. dinamikën e ofritit të shërbimit.

3. Operatori i menaxhimit të mbeturinave është i obliguar të ofrojë shërbimin në të gjitha zonat e përcaktuara nga Komuna, në përputhje me kontratën dhe planin operativ të shërbimit.
4. Organizimi dhe zëvendësimi i shërbimit synon:

4.1. mbulimin sa më të plotë të territorit të Komandës me shërbim;

4.2. parandalimin dhe eliminimin e depozitave të paligjshme të mbeturinave.

4.3. sigurimin e qasjes së hapërtë dhe jodiskriminuese të përfituesve të shërbimit në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

4.4. përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimit në përputhje me standardet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 22

Plani operativ i shërbimit

1. Operatori i menaxhimit të mbeturinave i kontraktuar nga Komuna harton planin operativ vjetor për organizimin dhe ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave.
2. Plani operativ i nënshtrohet miratimit nga organi kompetent i Komunës para fillimit të vitit për të cilin hartohet.
3. Plani operativ përmban, së paku:

3.1. zonat e mbulimit me shërbim;

3.2. orarin dhe iteneraret e mbledhjes dhe transportit të mbeturinave,

3.3. numrin, llojin dhe lokacionin e kontejnerëve dhe pikave të prurëmbullimit.

3.4. mënyrën e pranimin, ruajtimit dhe zgjidhjes së ankesave të përfituesve të shërbimit.

3.5. masat organizative për ofrimin e shërbimit gjatë periudhave me ngarkesë të shtuar ose në rrethana të veçanta.

3.6. masat për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

4. Plani operativ mund të ndryshohet ose të plotësohet gjatë vitit, kur kjo kërkohet për shkak të ndryshimeve në organizimin e shërbimit, zgjerimit të zonave të mbulimit ose rrethave të tjera të asyeshme.
5. Pas miratimit, plani operativ publikohet nga Komuna ose operatori, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim informimin e përfituesve të shërbimit.

Neni 23

Organizimi i mbledhjes së mbeturinave

1. Mbledhja e mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrisë organizohet sipas zonave të shërbimit, planit operativ dhe orarit të miratuar nga Komuna, në përputhje me këtë rregullorë dhe kontratën për ofrimin e shërbimit.

2. Shërbimi i mbledhjes së mbeturinave përfshin:

- 2.1. grumbullimin e mbeturinave komunale nga anëtarësitë;
- 2.2. grumbullimin e mbeturinave nga personat juridikë, subjektet afërisht, institucionet publike dhe private, organizatat joqeveritare dhe përfituesit e tjerë të shërbimit;
- 2.3. transportimin e mbeturinave në objektet e autorizuar për trajtim ose deponim, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- 2.4. mirëmbajtjen e pastërtisë në pikat e grumbullimit dhe përcëpi tyze gjatë ofrimit të shërbimit.

3. Operatori i menaxhimit të mbeturinave është i obliguar që:

- 3.1. të ofrojë shërbim të rregullt, të vazhdueshëm dhe efikas në të gjitha zonat e mbulimit;
- 3.2. të respektojë orarin dhe itineraret e përcaktuara për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave;
- 3.3. të kryejë mbledhjen dhe transportin e mbeturinave në mënyrë që të mos rrezikohet shëndeti i njeriut dhe të mos shkaktohet dëmtim i mjedisit.

.....

.....

Neni 24

Orari dhe mënyra e grumbullimit të mbeturinave

1. Komuna, në bashkëpunim me operatorin e menaxhimit të mbeturinave, përcakton orarin, itineraret dhe mënyrën e grumbullimit të mbeturinave për secilën zonë të shërbimit.
2. Orari i grumbullimit të mbeturinave publikohet nga Komuna ose operatori i menaxhimit të mbeturinave, përmes ueh-faqes zyrtare, mijetave të informimit publik ose formave të tjera të përshatshme të komunikimit me përfituesit e shërbimit.
3. Përfituesit e shërbimit janë të obliguar që:
 - 3.1. të vendosin mbeturinat në kontejnerët ose enët e destinuara për grumbullim, në përputhje me orarin dhe mënyrën e përcaktuar për ofrimin e shërbimit;
 - 3.2. të sigurojnë që mbeturinat të depozitohen në mënyrë që të mos pengojnë qarkullimin, të mos rrezikojnë shëndetin e njeriut dhe të mos shkaktojnë dëmtim të mjedisit.

3.3. Ndalohet vendosja e mbeturinave jashtë kontejnerëve ose pikave të grumbullimit të përcaktuara, përveç rasteve të parashikuara me këtë rregullore ose me aktet e Komunës.

3.4. Ndalohet depozitimi i mbeturinave në kundërshtim me orarin dhe mënyrën e grumbullimit të përcaktuar nga Komuna, kur kjo shkakton pengim të ofrimit të shërbimit ose ndotje të mjedisit.

Neni 25

Kontejnerët dhe pikat e grumbullimit të mbeturinave

1. Komuna, në bashkëpunim me operatorin e menaxhimit të mbeturinave, përcakton numrin, llojin dhe vendndodhjen e kontejnerëve dhe pikave të grumbullimit të mbeturinave, në përputhje me nevojat e përfituesve të shërbimit dhe planin operativ.
2. Operatori është i obliguar që:

2.1. të vendosë, mirëmbajë, pastrojë dhe, sipas nevojës, të dezinfektojë kontejneret dhe pajisjet për grumbullimin e mbeturinave;

2.2. të zëvendësojë kontejnerët e dëmtuar ose të papërdorshëm brenda një afati të arsyeshëm;

2.3. të sigurojë që pikat e grumbullimit të mbahen të pastër dhe të mos paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut ose mjedisit;

2.4. të vendosë kontejnerët në lokacionet e miratuar nga Komuna dhe të mos i zhvendosë pa miratimin e saj, përveç rasteve emergjente.

3. Përfituesit e shërbimit janë të obliguar që:

3.1. të përdorin kontejnerët vetëm për qëllimin për të cilin janë vendosur;

3.2. të mos dëmtojnë, zhvendosin ose përdorin kontejnerët në kundërshtim me destinimin e tyre;

3.3. të mos vendosin mbeturina jashtë kontejnerëve ose pikave të grumbullimit, përveç rasteve kur kjo lejohet sipas sistemit të organizuar të grumbullimit;

3.4. të mos depozitojnë në kontejnerët komunalë mbeturina të rrezikshme, mbetje uullëtimore, mbetje të vëllimshme ose kategori të tjera të mbeturinave që nuk janë pjesë e shërbimit të rregullt të grumbullimit.

4. Zhvendosja, shëtimi ose largimi i kontejnerëve bëhet nga operatori vetëm me miratimin e Komunes ose sipas planit operativ të miratuar.
5. Dëmtimi, shkatërrimi, zhvendosja e paautorizuar ose përdorimi i kontejnereve dhe pajisjeve të grumbullimit në kundërshtim me këtë rregullore përbën shkelje dhe trajtohet në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 26

Transporti i mbeturinave

1. Transporti i mbeturinave kryhet nga operatori i menaxhimit të mbeturinave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, këtë rregullore dhe kontratën për ofrimin e shërbimit.
2. Operatori është i obliguar që gjatë transportit të mbeturinave:

2.1. të përdorë automjete dhe pajisje që plotësojnë kushtet teknike, sanitare dhe mjedisore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;

2.2. të sigurojë që mbeturinat të transportohen në mënyrë që të parandalohet derdhja, shpërndarja, rrjedhja, përhapja e aromave të pakëndshme dhe ndotja e mjedisit;

2.3. të transportojë mbeturinat vetëm në objektet e autorizuar për trajtim, rikuperim ose depozim, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

2.4. të mirëmbajë automjetet dhe pajisjet e transportit në gjendje të rregullt teknike dhe higjienike;

2.5. të ndërmerë masat e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit të njeriut, sigurisë publike dhe mjedisit gjatë transportit të mbeturinave.

3. Gjatë transportit të mbeturinave, operatori është përgjegjës për çdo ndotje ose dëm të shkaktuar si pasojë e mosrespektimit të detyrimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, këtë rregullore ose kontratën për ofrimin e shërbimit.

II. Ndarja, ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave

Neni 27

Ndarja e mbeturinave në burim

1. Komuna organizon dhe promovon sistemin e ndarjes së mbeturinave në burim, me qëllim të parandalimit të përzierjes së mbeturinave, ngritjes së ripërdorimit dhe riciklitimit, si dhe zvogëlimit të sasisë së mbeturinave që dërgohen për depozim.

2. Personat fizikë, personat juridikë, institucionet publike dhe përfituesit e tjerë të shërbimit janë të obliguar të ndajnë mbeturinat sipas sistemit të organizuar nga Komuna, kur një sistem i tillë është vendosur.
3. Ndarja e mbeturinave në inurim organizohet sipas kategorive të përcaktuara nga Komuna dhe mund të përfshijë:

3.1. letërën dhe kartonin

3.2. plastikën

3.3. qelqin

3.4. metalin

3.5. bio-mbetrinat

3.6. tekstilin

3.7. mbeturinat elektrike dhe elektronike

3.8. kategori të tjera të mbeturinave, sipas legjislacionit në fuqi dhe sistemit të organizuar nga Komuna.

4. Komuna dhe operatori i menaxhimit të mbeturinave informojnë përfituesit e shërbimit për mënyrën e ndarjes së mbeturinave dhe përdorimin e infrastrukturës së dedikuar për këtë qëllim.

Neni 28

Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave

1. Komuna, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe parimet e ekonomisë qarkore, promovon ripërdorimin, riciklimin dhe format e tjera të rikuperimit të mbeturinave.
2. Për realizimin e objektivave të paragrafit 1 të këtij neni, Komuna mund të:

2.1. organizojë ose mbështesë pika të veçanta për grumbullimin e mbeturinave të riciklueshme

2.2. zhvillojë fushata informuese dhe ndërgjegjësuese për ndarjen, ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave

2.3. bashkëpunojë me institucionet arsimore, subjektet afërisht, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin për zbatimin e programeve të riciklimit

2.4. mbështesë iniciativa dhe projekte që kontribuojnë në zvogëlimin e gjenerimit të mbeturinave dhe rritjen e normës së riciklimit.

3. Operatori menaxhimit të mbeturinave është i obliguar të mbështesë zbatimin e sistemit të grumbullimit të ndarë dhe proceset e riciklitimit në përputhje me kontratat, kushtet teknike dhe legjislativin në fuqi.
4. Grumbullimi, transporti dhe dorëzimi i mbeturinave të ndara për menaxhim kryhen në mënyrë që të ruhet cilësia e tyre dhe të mundësohet trajtimi ose rikuperimi në objektet e autorizuar.

P R I M E R E

1(1). Kategoritë e veçanta të mbeturinave

Neni 29

Menaxhimi i mbeturinave voluminoze

1. Komuna, në bashkëpunim me operatorin e menaxhimit të mbeturinave, organizon grumbullimin, transportin dhe dorëzimin e mbeturinave voluminoze në objektet e autorizuar për trajtim ose depozitim.
2. Mbeturinat voluminoze përfshijnë, ndër të tjera, mobiliet, pajisjet e mëdha shtëpiake dhe mbeturinat e tjera me përmasa që nuk mund të vendosen në kontejnerët e zakonshëm për mbeturinat komunale.
3. Ndalohej vendosja e mbeturinave voluminoze në kontejnerët për mbeturina komunale ose brekatisja e tyre në sipërfaqe publike apo në vende të parautorizuara.
4. Komuna në bashkëpunim me operatorin e menaxhimit të mbeturinave organizon, sipas nevojës, pika të veçanta ose aksione periodike për pranimin e mbeturinave voluminoze.
5. Përfutjesit e shërbimit janë të obliguar ta njoftojnë operatorin për dorëzimin e mbeturinave voluminoze dhe t'i vendosin ato në vendin dhe kohën e përcaktuar nga operatori.

P R I M E R E

Neni 30

Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënim

1. Prodhuuesit e mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënim janë përgjegjës për grumbullimin, transportin dhe dorëzimin e tyre në objektet ose lokacionet e autorizuar, në përputhje me legjislativin në fuqi.
2. Ndalohej hedhja ose depozitimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënim në:

2.1. rrugë

2.2. trotuare

2.3. sipërfaqe publike

2.4. zona të gjelbra

2.5. brigje lumënjsh, kanale ose ujëra

2.6. vende të tjera të paautorizuara

3. Personat fizikë dhe juridikë që gjenuesinë mbeturinaz nga ndërtimet dhe rrënimet janë të obliguar t'i largojnë ato pa vonesë dhe t'i dorëzojnë në lokacionet e caktuara nga Komuna ose në objektet e autorizuara.
4. Në rast të mosrespektimit të këtij neni, Komuna mund të urdhërojë largimin e mbeturinave në shpenzimin të personit përgjegjës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

.....

.....

Neni 31

Menaxhimi i mbeturinave të gjelbra dhe plehut organik

1. Mbeturinat e gjelbra përfshijnë mbeturinat nga krasitja, mirëmbajtja e kopshteve, parqeve, ohoreve dhe sipërfaqeve të tjera të gjelbra
2. Komuna organizon ose mbështet sisteme të veçanta për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbeturinave të gjelbra.
3. Komuna mund të organizojë ose mbështesë kompostimin e bio-mbeturinave dhe mbeturinave të gjelbra, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Ndalohej djegia e pakontrolluar e mbeturinave të gjelbra nëse shkakton ndotje të ajrit, rrezik për shëndetin e njeriut ose rrezik nga zjarri.
5. Ndalohej hedhja ose depozitimi i plehut organik të bagëtive dhe shpendëve në sipërfaqe publike, përgjatë rrugëve, në vende të paautorizuara, si dhe derdhja e lëngjeve të tij në rrjetin e kanalizimit ose në mjedis.
6. Mbetësit e bagëtive dhe shpendëve janë të obliguar të sigurojnë grumbullimin dhe ruajtjen e plehut organik në mënyrë që të parandalohet ndotja e mjedisit dhe rrezikimi i shëndetit publik.

Neni 32

Qendrat komunale për grumbullimin e mbeturinave të veçanta

1. Për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, Komuna mund të krijojë ose të mbështesë funksionimin e qendrave komunale për grumbullimin e kategorive të veçanta të mbeturinave.
2. Në këto qendra mund të prapohen, sipas kushteve të përcaktuara nga Komuna:

2.1. mbeturinat elektrike dhe elektronike

2.2. bateritë dhe akumulatorët

2.3. vajrat e përdorura

2.4. mbeturinat voluminoze

2.5. bio-mbetrinat

2.6. mbeturinat e riciklueshme

2.7. kategori të tjera të mbeturinave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

3. Menaxhimi i këtyre qendrave organizohet në përputhje me legjislacionin për mbeturinat dhe objektet komunale.

Neni 33

Menaxhimi i mbeturinave elektrike dhe elektronike

1. Mbeturinat elektrike dhe elektronike menaxhohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nuk lejohen të hidhen së bashku me mbeturinat komunale.
2. Personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar t'i dorëzojnë mbeturinat elektrike dhe elektronike në pikat e grumbullimit ose te operatorët e miratuar për trajtimin e tyre.
3. Komuna, në bashkëpunim me operatorët e autorizuar, mund të organizojë pikë ose aksione periodike për grumbullimin e mbeturinave elektrike dhe elektronike.

Neni 34

Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme

1. Mbeturinat e rrezikshme menaxhohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nuk lejohen të përziehen me mbeturinat komunale.
2. Prodhuuesi ose poseduesi i mbeturinave të rrezikshme është i obliguar

2.1. t'i ndajë ato nga mbeturinat e tjera

2.2. t'i ruajë në mënyrë të sigurt deri në dorëzimin të operatorit i pajisur me lejen përkatëse mjedisore;

2.3. t'i dorëzojë për transport dhe trajtim në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Ndalohej hedhja, djegia, depozitimi ose derdhja e mbeturinave të rrezikshme në kontejnerët komunalë, në kanalizime, në tokë, në ujëra ose në vende të tjera të parauterizuara.
4. Operatori i menaxhimit të mbeturinave komunale nuk pranon mbeturinaz të rrezikshme së bashku me mbeturinat komunale, përveç rasteve kur është i autorizuar dhe i pajisur sipas legjislacionit në fuqi.
5. Komuna organizon ose mbështet aktivitete informuese për mënyrën e grumbullimit dhe dorëzimit të sigurt të mbeturinave të rrezikshme.

...

...

Neu 35

Menaxhimi i vajrave të përdorur

1. Çdo person fizik ose juridik që gjeneron vajra ushqimorë të përdorur ose vajra lubrifikues të përdorur është i obliguar t'i grumbullojë, t'i ruajë dhe t'i dorëzojë operatorit të pajisur me lejen përkatëse mjedisore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Subjektet që gjenerojnë vajra të përdorur, përfshirë restorantet, objektet hoteliere dhe gastronomike, serviset automobilistike, punëtoritë mekanike, autolarjet, pikat e ndërrimit të vajrave dhe subjektet e tjera, janë të obliguara të sigurojnë pajisje të përshtatshme për grumbullimin dhe ruajtjen e përkohshme të tyre, në mënyrë që të parandalohet rrjedhja, dendhja dhe udotja e mjedisit.
3. Veprimet e ndaluar:

3.1. përzierja e vajrave të përdorur me mbeturina ose substanca të tjera;

3.2. përzierja e vajrave ushqimorë të përdorur me vajra motorikë ose lubrifikues;

3.3. derdhja e vajrave të përdorur në rrjetin e kanalizimit, në tokë, në ujëra ose në kontejnerët për mbeturina komunale.

4. Vajrat e përdorur ruhen vetëm deri në dorëzimin të operatorit i pajisur me lejen përkatëse mjedisore.
5. Personat juridikë që gjenerojnë vajra të përdorur janë të obliguar të mbajnë dokumentacion për dorëzimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ta paraqesin atë me kërkesë të orgaanit kompetent.

IV. Mbrojtja e hapësirave publike

Neni 36

Veprimet e ndaluara

- 1.1. hedhja, braktisja ose depozitimi i mbeturinave në rrugë, trotuare, sheshe, parku, sipërfaqe të gjelbra, brigje lumenjsh, kanale, saka bujqesore, hapësira publike ose vende të tjera të paautorizuara;
- 1.2. krijimi i depozitave ilegale të çdo kategorie të mbeturinave;
- 1.3. hedhja e mbeturinave në kundërshtim me sistemin e grumbullimit të ndarë ose në kontejnerë dhe pika grumbullimi që nuk janë të destinuara për kategorinë përkatëse të mbeturinave
- 1.4. hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve ose pikave të grumbullimit të përcaktuara nga Komuna
- 1.5. hedhja e mbeturinave nga automjetet gjatë lëvizjes ose gjatë ndalimit të tyre
- 1.6. djegia e mbeturinave në hapësira publike, në kontejnerë ose në vende të tjera jashtë objekteve të autorizata për trajtimin e mbeturinave
- 1.7. zhvendosja, dëmtimi ose përdorimi i paautorizuar i kontejnerëve, pikave të grumbullimit ose pajisjeve të tjera të menaxhimit të mbeturinave
- 1.8. nxjerrja, grumbullimi, përzgjedhja ose marrja e mbeturinave nga kontejnerët ose pikat e grumbullimit nga persona të pazatëzuar
- 1.9. përdorimi i kontejnerëve për mbeturina komunale për depozitimin e mbeturinave të ndërtimit dhe punimit, mbeturinave të muzikshene, mbeturinave elektrike dhe elektronike, mbeturinave voluminoze ose kategorive të tjera të mbeturinave që grumbullohen veçmas sipas legjislacionit në fuqi.
- 1.10. transportimi i mbeturinave në mënyrë që shkakton dëmtim, rrjedhjen ose shpërndarjen e tyre në mjedis.
- 1.11. transportimi i mbeturinave pa përdorimin e mjeteve ose masave mbrojtëse që parandalojnë dëmtimin e mjedisit
- 1.12. ushtrimi i veprimtarisë së grumbullimit, transportit, trajtimit ose depozitimit të mbeturinave pa lejen përkatëse mjedisore ose pa kontratë me Komunën, kur një kontratë e tillë kërkohet sipas legjislacionit në fuqi.
- 1.13. dorëzimi i mbeturinave personave të paautorizuar, braktisja, fshetja ose osgjësimi i kundërligjshëm i tyre.

1.14. derdhja e vajrave të përdorur, lubrifikuesve, karburanteve ose lëndëve të tjera ndotëse në kanalizim, në tokë, në ujërë ose në mjedis.

Neni 37

Mirëmbajtja dhe pastërtia e hapësirave publike

1. Komuna siguron mirëmbajtjen dhe pastërtinë e rrugëve, trotuareve, shesheve, parkëve, hapësirave rekreative dhe hapësirave të tjera publike përmes njësisë kompetente ose operatoreve të kontraktuar.
2. Personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar të ruajnë pastërtinë e hapësirave që përdorin, administrojnë ose kanë në shfrytëzim.
3. Organizatorët e aktiviteteve publike, kulturore, sportive, tregtare ose aktiviteteve të tjera janë përgjegjës për largimin e mbeturinave dhe kthimin e hapësirës në gjendjen e mëparshme menjëherë pas përfundimit të aktivitetit.
4. Personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar të bashkëpunojnë me organet kompetente komunale dhe operatorin e menaxhimit të mbeturinave për ruajtjen e pastërtisë së hapësirave publike.

Neni 38

Detyrimi për largimin e mbeturinave dhe rehabilitimin e hapësirës

1. Personi fizik ose juridik që, me veprim ose mosveprim, shkakton ndotjen e një hapësire publike ose private në kundërshtim me këtë rregullorë është i obliguar të largojë mbeturinat dhe ta rikthejë hapësirën në gjendjen e mëparshme.
2. Organi kompetent komunal mund ta urdhërojë personin përgjegjës që, brenda afatit të caktuar, të largojë mbeturinat dhe të ndërmerë masat e nevojshme për rehabilitimin e hapësirës së ndotur.
3. Nëse personi përgjegjës nuk vepron sipas urdhrat të organit kompetent, Komuna mund të organizojë largimin e mbeturinave dhe rehabilitimin e hapësirës në shpërzim të personit përgjegjës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Zbatimi i masave të përcaktuara në këtë nen nuk përjashton përgjegjësinë kundërvajtëse ose përgjegjësi tjetër të parapare me legjislacionin në fuqi.

Neni 39

Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje e ushtriojnë organet kompetente të Komunes, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

2. Inspektorët komunalë, brenda kompetencave të tyre ligjore, janë të autorizuar që:

2.1. të kryejnë inspektime për zbatimin e kësaj rregulloreje.

2.2. të urdhërojnë largimin e mbeturinave të hedhura në kundërshtim me këtë rregullore.

2.3. të ndërmarrin masa administrative dhe të iniciojnë procedurat përkatëse në rast të konstatimit të shkeljeve.

3. Organet kompetente komunale bashkëpunojnë me inspektoratet dhe institucionet e tjera përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 40

Dispozitat ndëshkuese

1. Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje përben kundërvajtje dhe sanksionohet në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturinat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.
2. Përveç masës ndëshkuese të paraparë me legjislacionin në fuqi, personi përgjegjës obligohet të largojë mbeturinat dhe të rikthejë hapësirën në gjendjen e mëparshme, nëse kjo është e mundur.
3. Nëse personi përgjegjës nuk e përmbush detyrimin sipas paragrafit 2 të këtij neni, Komuna mund të organizojë largimin e mbeturinave dhe rehabilitimin e hapësirës në shpenzimet e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Procedurat për shqiptimin e masave administrative dhe kundërvajtëse zhvillohen nga organet kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI X

SIGURIA, MBROJTJA DHE SHËNDETI NË PUNË I PUNONJËSVE TË SHËRMBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

Neni 41

Parimet e përgjithshme

1. Operatori i shërbimit publik për menaxhimin e mbeturinave është i detyruar të sigurojë kushte të sigura dhe të shëndetshme pune për të gjithë punonjësit e angazhuar në grumbullimin, transportimin, trajtimin dhe aktivitetet tjera që lidhen me menaxhimin e mbeturinave.
2. Të gjitha aktivitetet kryhen në pajtim me legjislacionin në fuqi për siguri dhe shëndet në punë, mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen nga rreziqet biologjike, kimike dhe fizike.
3. Punëdhënësi është përgjegjës për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve në vendin e punës.

Neni 42

Pajisjet personale mbrojtëse

1. Punëdhënësi siguron, pa pagesë për punonjësin, pajisjet personale mbrojtëse sipas natyrës së punës.
2. Pajisjet mbrojtëse përfshijnë së paku:
 - 2.1.uniformën e punës me elemente reflektuese
 - 2.2.çizme mbrojtëse kundër depërtimit të njetëve të mprehta dhe kundër nësëqitjes
 - 2.3.doreza mbrojtëse të përshtatshme
 - 2.4.helmetë mbrojtëse, kur kërkohet nga natyra e punë
 - 2.5.syze mbrojtëse
 - 2.6.maska mbrojtëse kundër pluhurit, aerosolëve dhe rreziqeve biologjike
 - 2.7.jelek reflektues
 - 2.8.veshje mbrojtëse kundër shiut dhe temperaturave të uleta
 - 2.9.pajisje tjera sipas vlerësimit të rreziqut.
3. Pajisjet mbrojtëse duhet të jenë të certifikuara, në gjendje funksionale dhe të zëvendësohen menjëherë kur dëmtohen ose humbin vetinë mbrojtëse.
4. Punonjësi është i detyruar t'i përdorë pajisjet mbrojtëse gjatë gjithë kohës së punës dhe t'i ruajë ato sipas udhëzimeve të punëdhënësit.

Neni 43

Veshmbathja e punës

1. Punonjësit duhet të jenë të pajisur me uniforme zyrtare të identifikueshme.
2. Uniforma duhet të jetë e përshtatshme për kushtet klimatike gjatë gjithë vitit dhe të përmbajë elemente reflektuese për punën në rrugë dhe gjatë natës.
3. Punëdhënësi siguron ndërrimin periodik të uniformës dhe larjen ose pastrimin profesional të saj sipas nevojës.
4. Nuk lejohet përdorimi i veshjeve private gjatë kryerjes së punëve që paraqesin rrezik për shenderin ose higjienën.

Neni 44

Higjiena personale dhe kushtet sanitare

1. Punëdhënësi siguron ambiente të përshtatshme për:
 - 1.1. larjen e duarve
 - 1.2. dushim, kor natyra e punës e kërkon
 - 1.3. ndërrimin e veshjeve
 - 1.4. ruajtjen e veçantë të rrobave të punës dhe atyre personale.
2. Pas përfundimit të orarit të punës, punonjësit janë të detyruar të zbatojnë masat e higjienës personale për të parandaluar përhapjen e ndotësve biologjikë dhe kimikë.

Neni 45

Kontrolli shëndetësor dhe vaksinimi

1. Punonjësit që kryejnë punë me mbeturina duhet t'u nënshtrohen kontrollit mjekësor para fillimit të punës dhe kontroleve periodike sipas rekomandimeve të mjekesisë së punës.
2. Punëdhënësi, në bashkëpunim me institucionet shëndetësore kompetente, siguron vaksinimin e punonjësve ndaj sëmundjeve profesionale për të cilat ekziston rekomandim nga autoritetet shëndetësore.
3. Vaksinimi mund të përshihet, sipas vlerësimit profesional dhe rekomandimeve të autoriteteve shëndetësore:

- 3.1. Hepatitin B;
 - 3.2. Tetanozin;
 - 3.3. vaksina te tjera te rekomanduara per ekspozimin profesional.
4. Evidenca per kontrollet shendetesore dhe vaksinimin administrohet nga punëdhënësi duke respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 46

Trajnimi dhe ndërgjegjësimi

1. Punëdhënësi organizon trajnim fillestar dhe periodik për:
 - 1.1. sigurinë dhe shëndetin në punë;
 - 1.2. përdorimin korrekt të pajisjeve mbrojtëse;
 - 1.3. trajtimin e mbeturinave të rrezikshme;
 - 1.4. procedurat emergjente;
 - 1.5. edikimën e parë.
2. Asnjë punëdhës nuk mund të angazhohet në punë pa përfunduar trajnimin përkatës.

Neni 47

Ndalimet për punonjësit

1. grumbullimi manual i mbeturinave pa pajisje mbrojtëse
2. konsumimi i ushqimit ose pijeve gjatë manipulimit me mbeturina
3. pirja e duhanit në vendet ku trajtohen mbeturinat
4. përdorimi i pajisjeve të dëmtuara
5. ekspozimi i panevojshëm ndaj mbeturinave të rrezikshme.

Neni 48

Detyrimet e punonjësve

Punonjësit janë të detyruar:

1. të respektojnë të gjitha procedurat e sigurisë
2. të përdorin pajisjet mbrojtëse sipas udhëzimeve
3. të raportojnë menjëherë çdo aksident, lëndim ose situatë që paraqet rrezik
4. të mbajnë shëndetin e tyre dhe të kolegëve
5. të bashkëpunojnë me punëdhënësin në zbatimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

KREU IV

MBIKËQYRJA DHE MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 49

Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrje

1. Mbikëqytjen e zbatimit të kësaj rregulloreje e ushtrojnë organet kompetente të Komunës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
2. Mbikëqyrja kryhet nga:

2.1. inspektorët komunalë kompetentë.

2.2. njësitë organizative përgjegjëse për shërbimet publike, brenda kompetencave të tyre.

2.3. personat e tjerë të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi.

2. Organet kompetente komunale bashkëpunojnë me institucionet përgjegjëse shtetërore për mbrojtjen e mjedisit dhe organet e zbatimit të Ligjit, sipas kompetencave të tyre

.....

Neni 50

Kompetencat e inspektorit komunal

1. Inspektori komunal, në ushtrimin e kompetencave të tij, është i autorizuar që:

1.1. të kryejë kontrollin e zbatimit të kësaj rregulloreje;

1.2. të inspektojë hapësirat publike, objektet dhe vendet ku gjenerohen, grumbullohen ose menaxhohen mbeturinat;

1.3. të kërkojë dokumentacion dhe informata nga personat fizikë dhe juridikë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

1.4. të urdhërojë eliminimin e panegullsiave të konstatuara;

1.5. të iniciojë procedurat administrative ose kmdërvajtëse, dhe të ndërmerrë masa të tjera të parashikuara me legjislacionin në fuqi;

Neni 51

Procedura e evidentimit të shkeljeve

1. Për çdo shkelje të konstatuar gjatë mbikëqyrjes, organi kompetent harton procesverbal në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Procesverbal i përmban, së paku:

2.1. datën, kohën dhe vendin e kontrollit;

2.2. përshkrimin e gjendjes faktike dhe të shkeljes së konstatuar;

2.3. të dhënat e personit përgjegjës, kur identifikohet;

2.4. masat e urdhënuara ose procedurat që iniciohen.

3. Personi ndaj të cilit është hartuar procesverbal gëzon të drejtat procedurale të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 52

Masat administrative

1. Kur gjatë mbikëqyrjes konstatohet shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje, organi kompetent mund të urdhërojë një ose më shumë nga masat administrative në vijim:

1.1. eliminimin e panegullsiave të konstatuara,

1.2. largimin e mbeturinave nga vendet ku janë hedhur ose depozituar në kundërshtim me këtë rregullore;

1.3. rehabilitimin ose kthimin e hapësirës në gjendjen e mëparshme;

1.4. ndërprerjen e veprimtarisë që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;

1.5. masa të tjera administrative të parashikuara me ligj.

2. Personi ndaj të cilit është shqiptuar masa administrative është i obliguar ta zbatojë atë brenda afatit të caktuar nga organi kompetent
3. Mospërputhja e masave administrative përshkëlqon bazë për ndërmarrjen e procedurave të mëtejshme sipas legjislacionit në fuqi

KREU V

KUNDËRVAJTJET DHE DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 53

Kundërvajtjet

1. Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje përshkëlqon kundërvajtje dhe sanksionohet në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.
2. Përgjegjësi i personit juridik nuk e përjashton përgjegjësinë e personit përgjegjës brenda tij, kur kjo parashihet me legjislacionin në fuqi.

Neni 54

Raportimi i shkeljeve

1. Çdo person ka të drejtë të raportojë rastet e heqjes së kundërligjshme të mbeturinave ose shkelje të tjera të kësaj rregulloreje.
2. Raportimi mund të bëhet përmes:

2.1. platformave elektronike të Komurës;

2.2. numrave zyrtarë të kontaktit;

2.3. paraqitjes pranë organit kompetent komunal.

3. Organi kompetent shqyrton raportimet dhe ndërmerr veprimet përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.

.....

Neni 55

Shpërbilimi për raportimin e shkeljeve

1. Me qëllim të parrëndalimit të hedhjes së kundërligjshmë të mbeturinave, Komuna mund të shpërbijë personat fizikë që ofrojnë informacione ose prova të besueshme, të cilat mundësojnë identifikimin e kryesit të kumçërvajljes.
2. Shpërbilimi mund të jepet vetëm nëse:

2.1. informacioni ose provat rezultojnë të sakta dhe të verifikueshme;

2.2. në bazë të tyre identifikohet kryesi;

2.3. ndaj kryesit është marrë vendimi përfundimtar nga organi kompetent.

3. Lartësia, kriteret dhe procedura për dhënien e shpërbilimit përsaktohen me vendim të Kryetarit të Komunës ose me akt tjetër të veçantë të Komunës, në përputhje me mjetet e planifikuara në buxhetin komunal.

4. Shpërbilimet e parapara me nenin 55 të kësaj rregulloreje financohen nga mjetet e planifikuara në buxhetin e Komunës së Vashtrrisë, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e financave publike.

5. Identiteti i raportuesit mbrohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Nuk jepet shpërbilim për raportime të rreme ose kuqdashese.

.....

KREU VI

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 56

Zbatimi i rregullores

1. Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga organet kompetente të Komunës, operatorët e menaxhimit të mbeturinave dhe subjektet e tjera të përfshira në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.
2. Kryetari i Komunës dhe drejtoritë kompetente, brenda fushës së përgjegjësisë së tyre, udhëzojnë masat e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje.
3. Për zbatimin e njëtrajtshëm të kësaj rregulloreje, Komuna mand të nxjerrë udhëzime, procedura operative ose akte të tjera administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 57

Informimi dhe edukimi mjedisor

1. Komuna zhvillon aktivitete të vazhdueshme për informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve lidhur me:

1.1. parandalimin e gjenerimit të mbeturinave;

1.2. ndarjen e mbeturinave në burime;

1.3. ripërdorimin, riciklimin dhe format e tjera të rikuperimit të mbeturinave;

1.4. mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.

2. Aktivitetet nga paragrafi 1 i këtij neni realizohen në bashkëpunim me institucionet arsimore, organizatat e shoqërisë civile, operatorët e menaxhimit të mbeturinave, subjektet afariste dhe komunitetin.
-

Neni 58

Ndryshimi dhe plotësimi i rregullores

1. Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregulloreje bëhet sipas procedurës së njëjtë me atë të miratimit të saj.
 2. Iniciativën për ndryshimin ose plotësimin e kësaj rregulloreje mund ta paraqesin organet kompetente të Komunës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
-

Neni 59

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet **Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave nr. _____, datë _____**, si dhe çdo akt tjetër komunal që është në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 60

Shtojca

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është edhe shtojca me emërtimin kategorizimi dhe çmimi i shërbimeve për biznese dhe institucione tjera.

Neni 61

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi **tridhjetë (30) ditë** pas publikimit në ueb-faqen zyrtare dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës së Vushtrrisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KUVENDI I KOMUNËS SË VUSHTRRISË

Kryesuesi/Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Nr.: _____

Datë: _____

ARSYETIM

Që nga hyrja në fuqi të Ligjit për Mbeturinat (Ligji nr.04/L-060), sipas politikave të Qeverisë, grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve si dhe shërbimet tjera të pastrimit, i janë deleguar autoriteteve lokale përmes promovimit të decentralizimit. Ky ligj ka deleguar më shumë autoritet dhe përgjegjësi të qeverisja lokale sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Pra në këtë kuadër janë qartësuar edhe përgjegjësitë dhe detyrimet e komunës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Drejtoria për Shërbime Publike në Komunën e Vushtrrisë, me qëllim të implementimit të kësaj infrastrukture ligjore, ka hartuar Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë. Kjo Rregullore për Menaxhim të Mbeturinave korrespondon me ligjin për mbeturinat dhe Strategjinë Kombëtare për menaxhimin e mbeturinave si një plan afat mesëm dhe është një vazhdimësi që synon rritjen e cilësisë së shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, si shërbim prioritar për qytetarët.

Drejtoria për Shërbime Publike në Komunën e Vushtrrisë në kuadër të reformës në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe me qëllim të arritjes së objektivave ka hartuar këtë Rregullore për menaxhim të mbeturinave përmes së cilës synojmë:

- krijimin e mekanizmit institucional përmes fuqizimit të sektorit për menaxhim të mbetjeve,
- fuqizimin e mekanizmave për rritjen e shkallës së inkasimit të taksës për mbeturina dhe
- promovimin e 3R që nënkupton reduktimin, riciklimin dhe ripërdorimin e sasisë së mbeturinave.

Përveç këtyre komunave Vushtrrisë ka ndërtuar një partneritet të qëndrueshëm me GIZ, i cili partneritet, ka ndikuar dukshëm në ngritjen e kapaciteteve të sektorit për menaxhimin e mbeturinave, për formësimin e idesë dhe konceptit për menaxhimin e mbetjeve si shërbim prioritar për qytetarët.

SHTOJCA:

Kategorizimi dhe çmimi i shërbimeve për biznese dhe institucione

Nën-kategoria e parë – Veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbuese me pagesë majore në vlerë prej: 10.00 Euro	Nën-kategoria e dytë – Subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale me kosto të ulët të shërbimit me pagesë majore në vlerë prej: 15.00 – 20.00Euro	Nën-kategoria e tretë – Subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale me kosto të moderuar të shërbimit me pagesë majore në vlerë prej: 25.00Euro	Nën-kategoria e katërt - Subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale me kosto të lartë të shërbimit me pagesë në vlerë prej: 14.00€ për zbrazje të kontejnerit 1.1m ³ , në vlerë prej 50.00€ për zbrazje të kontejnerit prej 5m ³ , dhe në vlerë prej prej 75.00€ për zbrazje të kontejnerit prej 7m ³	Nën-kategoria e pestë Subjektet ekonomike dhe komerciale që ushtrojnë veprimtari të specializuara në trajtim përpunimin, si dhe shitjeve me shumicë ose pakicë të mishit me pagesë për zbrazje në vlerë prej 50.00€
Kioskat dhe shitoret e dyqanet e madhësisë së ngjashme me të kioskave	Lokalet për shitjen e mjeteve motorike (auto sallonet) dhe mirëmbajtjen e automjeteve (duke përfshirë limarët)	Kafiteritë dhe lokalet e vogla të ushqimit të shpejtë	Dyqanet e mëdha (super marketet) dhe furrat e bukës dhe byrektolet	Mishtoret, pikat e specializuara të përpunimit dhe paketimit
Shitoret e dyqanet e vogla si: shitësit e kafesë, disqeve, kozmetikës, syzeve, thjerrëzave dhe suvenirëve (dhuratave) të vogla	Frizerët dhe lokalet e tjera të kujdesit personal	Shitoret ushqimore dhe bodrumet e pijeve	Restorantet (për ahengje familjare, salla dasmesh etj.)	
Axhustatorët (salduesit)	Barnatorët	Zyrat e shërbimeve profesionale me madhësi mbi 20m ² , siç janë: zyrat e avokatëve, noterëve, përmbaruesve, këshilltarëve	Gjellëtolet	

Çmëtarët	Klinikat e vogla dhe ambulanca stomatologjike me deri në dy karrige (për mbeturina komunale)	Qendrat sportive	Veprimtaritë hoteliere
Agjencitë Turistike	Shërbimet e paguajshme teknike dhe e elektrike	Veprimtaritë zgjatëse në tërësi si limarët dhe shantierët	Pompat e benzinit me restorant
Krobaqepësit	Shitoret e tekstilit	Spitalet (vetëm sa i përket mbeturinave komunale)	Veprimtaritë tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë
Kepuçtarët	Sallonet e sanitareve	Pompat e benzinit me mini-market	
Fotografët	Qendrat e finazit	Ndërmarrjet Publike	
Huëkës	Shitoret e vogla përshirë shitoret gjatë rrugës të motrëve, të auto-pjesëve	Veprimtaritë tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë	
Libraritë	Shitoret e këpucëve		
Dyqanet e pashmëlqimit	Veprimtaritë tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë		
Kembimoret			
Udhëtarët-automobilist			
Zyrat e shërbimeve profesionale deri në 20m ² , siç janë: zyrat e vogla të avokatëve, notereve, përmirësuesve, këshilluesve financiarë			
Veprimtaritë tjera të vogla siç janë: parkingjet, qendrat e video-lojëve dhe kurset e pjekësive teknologjike			
Veprimtaritë tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë			

Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të ulët të shërbimit me pagesë mujore në vlerë prej: 10.00€uro	Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të mesme të shërbimit me pagesë mujore në vlerë prej: 20.00€uro	Institucionet publike, OJQ dhe institucionet e tjera me kosto të lartë të shërbimit me pagesë në vlerë prej 14.00€uro për zbrazje të kontejnerit 1.1m³ dhe në vlerë prej 75.00€uro për zbrazje të kontejnerit 7m³
Zyrën e Punësimit	Shkollat fillore dhe të mesme Korrik - Gusht	Akademia për Siguri Publike
Agjencioni për Regjistrim Civil	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare	Stacionet Policore
Ambulantet e Mjekësisë familjare	Spitali Regjional Sheikh Zayed – sa i përket mbeturinave komunale	Qendra korrektuese në Smrekonicë
Qendra për Punë Sociale	Halla e Sporteve – Jeton Tërstena – Tota	Institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë.
Zyrat e Partive Politike	Stadiumi i Futbollit – Ferki Aliu	Shkollat fillore dhe të mesme Shtator - Qershor
Institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë	Stadiumi i Futbollit në fsh. Doberllukë	
	Fakulteti i Sigurisë Publike	
	Gjykata Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtri	
	Institucione të tjera të ngjashme për nga madhësia dhe sasia e mbeturinave që gjenerojnë	



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA VUSHTRRI



Për,
Propozues,

Kuvendin e Komunës

Kryetari i Komunës

Ferit Idrizi

Çështja për shqyrtim, Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12 par. 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040/2008 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 qershor 2008), nenit 7 të Ligjit për Policinë Nr. 04/L-076 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 04/19 mars 2012) nenit 3 par. 2 dhe nenin 4 par. 1 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, si dhe neni 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më _____ 2026 merr këtë:

V E N D I M PËR PLOTËSIM TË VENDIMIT

1. Me këtë vendim plotësohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 22294/26 datë 01.06.2026 për themelimin të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si në vijim: në pikën 1 pas nën pikës 1.22 shtohet nënpika 1.23 në të cilën z. Blerim Ibrahim i përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi "Qendra" në Vushtri caktohet anëtar i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
2. Ky vendim hyn në fuqi Tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen Zyrtare të komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli
Kryesuese e Kuvendit

A r s y e t i m

Propozimi i z. Blerim Ibrahim i përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi "Qendra" në Vushtri, që të caktohet anëtar i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është në pajtim me nenin 4 par. 1 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi,

andaj i propozohet Kuvendit të Komunës që t'a miratoj këtë propozim vendim si në dispozitiv.